



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TE VETËQEVERISJES VENDORE
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT: MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË PASTRIM DHE GJELBERIMIT, BASHKIA TIRANË

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISE”
NË
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË PASTRIMIT DHE
GJELBËRIMIT, BASHKIA TIRANË

MAJ 2023

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.	7
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionin e auditimit.....	8
II. HYRJA.....	12
1. Objekti i auditimit :.....	12
2. Qëllimi i auditimit :.....	12
3. Identifikimi i çështjes:.....	13
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të DPPGJ:.....	13
5. Përgjegjësitë e audituesve:.....	13
6. Kriteret e vlerësimit:.....	13
7. Standardet e auditimit:.....	13
8. Metoda e auditimit.	13
9. Dokumentimi i auditimit.....	14
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	14
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:.....	14
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	14
2.1. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.	14
2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.	18
2.3. Mbi mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe përlllogaritjen, njohjen, regjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore.....	28
2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.	46
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	174
V. ANEKSE.	194

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim financiar dhe përputhshmëri në Drejtorinë e Përgjithëshme të Pastrim Gjelbërimit, Bashkia Tiranë duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, planifikimit, realizimit të prokurimeve dhe zbatimit të kontratave të lidhura për punë publike, mallra dhe shërbime.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 21.11.2022 deri më 31.01.2023, grupi i auditimit auditoi periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 31.12.2021.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 20 akt-konstatime dhe 8 akt-verifikime.

Në përfundim të punës audituese në terren është kryer takimi ballafaques me përfaqësuesit e DPPGJ. Mbi aktet e mbajtura dhe Projekt Raportin e grupit të auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur nga grupi i auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur, në përfundim të auditimit rezultoi se:

- Nga auditimi i llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” u konstatua debitimi i shumës prej 4,724,015 lekë, e cila ka të bëjë me debitorë të trashëguar në vite.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në Pasqyrat Financiare të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantetkorrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit), nga ku debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Shuma prej 4,724,015 lekë e debituar në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është veprim në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” duke kërkuar financim të pritshëm nga shteti me tepër për këtë shumë, vlerë e cila është e pidentifikuar dhe s’ka të bëjë me shpenzime të konstatuar të vitit ushtrimor.

- Nga auditimi konstatohet se nga të dhënat e paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar të Institucionit më 31.12.2021, gjendja debitorë (klasa 4) paraqitet si vijon:

2.1.Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 20,496,402 lekë, të cilat vijjnë kryesisht nga debitorë të krijuar për një periudhë shumë të gjatë rreth 15 vjet. Për këto debitorë, institucioni i DPPGJ-së nuk ka mundësi arkëtimi. E njëjta shumë debitorësh është konstatuar dhe në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH.

2.2.Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivet, por pa ndikim material në rezultatin e pasqyrave financiare. Në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” janë keqklasifikuar “Pajisjet dhe instalimi i kondicionerëve” në shumën 621,600 lekë. Kjo vlerë i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”.

Llogaria 213 “Rruga, rrjete, vepra ujore” paraqitet në pasqyrat financiare me kosto historike. Vlera e amortizimit të akumuluar nuk është përlllogaritur ndër vite, gjë e cila është trashëguar dhe në pasqyrat financiare të vitit 2021.

2.3.Nga lëvizjet e aktiveve nga sistemimet, institucioni bën lëvizjen e aseteve nga llogaria përkatëse 21 “Aktive afatgjata” në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Llogaria 24

“Aktive afatgjata të dëmtuara” në shumën 55,964,019 lekë përfaqëson të gjitha aktivet e dëmtuara që DPPGJ ka identifikuar të dëmtuara nga komisionet e inventarizimit. Shuma prej 55,964,019 lekë është keqklasifikuar në llogarinë 24, pasi secili nga aktivet e dëmtuara duhet të klasifikohet në llogarinë përkatëse të aktiveve, deri në momentin e vlerësimit nga komisioni i vlerësimit të aktiveve. Aktivet kalojnë në llogarinë 24 pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një flete hyrje rikupero.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36, VKM-në nr. 25 datë 20.01.2011 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik”, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109.

- Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se, shuma totale e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë:

-vendime të formës së prerë marrë në vitin 2014 në shumën 913,566 lekë, në vitin 2016 në shumën 268,229 lekë dhe në vitin 2018 në shumën 3,702,911, të cilat janë likuiduar në vitin 2018;

- vendime të formës së prerë marrë në vitin 2017 në shumën 405,769 lekë, dhe në vitin 2018 në shumën 7,639,947 lekë, të cilat janë likuiduar në vitin 2019;

- vendime të formës së prerë marrë në vitin 2017 në shumën 405,769 lekë, në vitin 2018 në shumën 1,537,134 lekë, dhe në vitin 2019 në shumën 4,526,208 lekë të cilat janë likuiduar në vitin 2020;

- vendime të formës së prerë marrë në vitin 2018 në shumën 677,142 lekë, në vitin 2019 në shumën 637,609 lekë, dhe në vitin 2020 në shumën 1,591,305 lekë të cilat janë likuiduar në vitin 2021, nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t'u shlyer.

Si pasojë llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të vitit 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Konkretisht për vitit 2018-2021, ky zë për vendimet gjyqësore reflektohet me vlerë 0 (zero), ndërkohë që duhet të ishte reflektuar me vlerën e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë mbi 30 ditë, përpara mbylljes së pasqyrave financiare për secilin nga vitet.

Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

Duke ju referuar pagesave të kryera nga DPPGJ për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

- Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të DPPGJ-së, u konstatua se institucionika një regjistër elektronik për aktivet afatgjata, i cili nuk është përditësuar me vlerën aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi. Mungesa e një regjistri të plotë aktivesh sjell problematika në kryerjen e një procesi të saktë inventarizimi dhe vlerësimi aktivesh, për shkak të mungesës së informacionit mbi amortizimin e akumuluar, vlerën e tyre dhe kostot nëse mbahen apo nxirren jashtë përdorimi. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu Regjistri i aktiveve të njërive të sektorit publik, Pika 26, 28 dhe 30.

-Nga auditimi i zërave të Aktiveve Afatgjata Materiale u konstatua se:

Sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitet 2018-2020 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vlerënzero lekë. Nga Institucioni nuk disponohet dokumentacion dhe planimetri (genplan) për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve, që ka në dispozicion për periudhën objekt auditimit, me pretendimin se i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i aseteve të institucionit të DPPGJ menaxhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Aseteve dhe Licencimit pranë Bashkisë Tiranë. Për secilin truall duhet të ishin kryer përlllogaritjet dhe evidentimet e vlerës së truallit në kontabilitetin e njësisë shpenzuese, nga zero lekë e pasqyruar në bilancin e periudhës, duke u referuar në çmimin për m² sipas zonave kadastrale, sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë". Sipërfaqja totale e tokës që DPPGJ ka në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet, në kundërshtim me Udhëzimin MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 3.3, paragrafi 62, dhe paragrafi 91.

Për periudhën 2018-2021, komisionete inventarizimit kanë evidentuar ndërtesa të cilat nuk ekzistojnë, por që vazhdojnë të jenë të regjistruara në llogarinë 212 "Ndërtesa e Konstruksione". Në vitin 2019, për secilin objekt, komisioni i inventarizimit ka paraqitur, me anë të shkresës nr. 2985/1 Prot., datë 24.01.2020, procesverbalet e mbajtura për verifikimin në terren, kunë procesverbalin e mbajtur në terren, datë 13.01.2020, Komisioni i inventarizimit konstaton se 3 objektet: (1) "Barakat" (me vlerë kontabël 5,409 lekë, viti 1981), (2) "Zyrat e kuartallave nr. 4" (me vlerë kontabël 45,000 lekë, midis Rrugës së Durrësit dhe Rrugës së Kavajës) dhe (3) "Ofiçina tek Vasil Shanto" (me vlerë kontabël 25,811 lekë, viti 1980), nuk ekzistojnë pasi janë bërë pallate.

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit shprehet se nuk ka në dispozicion asnjë dokumentacion në lidhje me mungesën e aktiveve. Për vitin 2021, komisioni i inventarizimit konstaton një diferencë prej 5,584,596 lekë mes gjendjes fizike dhe të dhënave të regjistruara në kontabilitet, pasqyruar kjo në inventarin përmbledhës për inventarizimin e aseteve të DPPGJ-së për vitin 2021 me nr. 2948/2 Prot., datë 22.01.2022, ku shprehet se 15 prej objekteve pjesë e inventarit nuk ekzistojnë fizikisht. Përpos konstatimeve të komisionit të inventarizimit, nga ana e DPPGJ-së nuk është marrë asnjë masë për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ndërtesave, me qëllim identifikimin dhe rivlerësimin ndërtesave që DPPGJ ka nën administrim.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik", i ndryshuar, pika 95, 101, 118.

- Nga auditimin e 6 procedurave të prokurimit për vitin 2018-2021 me vlerë të fondit limit 32,034,873 lekë pa TVSh, ka rezultuar se në të 6 procedurat janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimet publike. Në këto 6 procedura ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të dokumenteve të tenderit, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 32,034,873 lekë, si vijon:

1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Uniforma dhe Veshje Speciale" viti 2018, me fond limit 3,450,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE "G. H." shpk, me vlerë oferte 3,275,833 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 3,275,833 lekë pa Tvsh;
2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre" viti 2019, me fond limit 6,650,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE "R.C." shpk, me vlerë oferte 6,610,100 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit

të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 6,610,100 lekë pa Tvsh;

3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Uniforma dhe Veshje të tjera Speciale” viti 2019, me fond limit 4,950,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE “G. H.” shpk, me vlerë oferte 4,785,000 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 4,785,000 lekë pa Tvsh;
4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.” viti 2020, me fond limit 5,000,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE “P. S.” shpk, me vlerë oferte 4,995,000 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 4,995,000 lekë pa Tvsh;
5. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” viti 2020, me fond limit 6,666,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE “R. C.” shpk, me vlerë oferte 6,646,200 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 6,646,200 lekë pa Tvsh;

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” viti 2021, me fond limit 5,833,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE “R. C.” shpk, me vlerë oferte 5,722,740 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 5,722,740 lekë pa Tvsh.

-Nga auditimi i procedurës me objekt “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore” nga auditimi i dokumentacionit teknike të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 1,189,575 lekë me tvsh.

-Nga auditimi i procedurës me objekt “Drurë dhe shkurre dekorative” nga auditimi i dokumentacionit teknike të zbatimit, situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 1,660,320 lekë me tvsh.

-Nga auditimi i procedurës me objekt “Rikualifikim i mikrohapësirave të gjelbra” nga auditimi i dokumentacionit teknike të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 37,480 lekë me tvsh.

-Nga auditimi i procedurës me objekt “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi” nga auditimi i dokumentacionit teknike të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 1,137,720 lekë me tvsh

- Nga auditimi i procedurës me objekt “Blerje drurë dhe shkurre dekorative” nga auditimi i dokumentacionit teknike të zbatimit, situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të

kryera në fakt, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 2,061,360 lekë me tvsh.

2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.

Gjetjet e nr.	Përmbledhja e Gjetjes	Referenca me RPA	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi i 7 (shtatë) procedurave të prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit rezultoi se, gjatë hartimit të Dokumenteve të Tenderit u konstatuan parregullsi në argumentimin e kriterëve për kualifikim, të cilat kanë kufizuar konkurrencën, duke mos nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik në kundërshtim me VKM nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.</p> <p>-Në procedurën: “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”</p> <p>-Në procedurën: “Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës (kosha, stola dekorativ)”</p> <p>-Në procedurën “Drurë, shkurre dekorative”</p> <p>-Në procedurën: “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”</p> <p>-Në procedurën: “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvanë në blloqe banimi</p> <p>-Në procedurën: “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”</p> <p>-Në procedurën: “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”</p>	fq.114-180	E Lartë	<p>Njësia e Prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të marrë masa për përcaktimin e procedurës së prokurimit duke u mbështetur në natyrën e kontratës, si dhe për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit duke argumentuar dhe dokumentuar në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për të mos favorizuar operatorë ekonomik të caktuar.</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa që në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të administrohet dokumentacioni i nevojshëm identifikues grafik (si plane, harta, etj.) në mënyrë që të mundësohet evidentimi i vendndodhjes së realizimit të punimeve, që ndër të tjera do të shërbejë si gjurmë auditimi.</p>
2	<p>Nga verifikimi në SPE i 7 (shtatë) procedurave të prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit në 5 procedura u konstatuan pasaktësi në kualifikim e OE të cilat nuk plotësonin të gjitha kriteret për kualifikim në kundërshtim me VKM nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.</p> <p>Në procedurën “Drurë, shkurre dekorative”,</p> <p>Në procedurën “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”,</p> <p>Në procedurën “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvanë në blloqe banimi”,</p> <p>Në procedurën “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”,</p> <p>Në procedurën “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”,</p>	fq.134-182	E Lartë	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, me anë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, për shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratave.</p>
3	<p>Nga auditimi i zbatimit të 7 (shtatë) kontratave u konstatua se për 5 kontrata mungon dokumentacioni kryesorë teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e</p>	fq.127-184	E Lartë	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për ngritjen e një njësie për monitorimin e zbatimit të kontratave, e cila do të</p>

	punimeve, si libri i masave dhe vizatimeve, ditarët e punimeve, provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve etj. dokumentacioni teknik sipas Udhëzimit Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, dhe për 2 kontratat e tjera mungojnë certifikatat e cilësisë së materialeve.			jetë përgjegjëse edhe për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik për secilën kontratë, me qëllim verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve, si dhe cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura dhe dokumentacioni i nevojshëm grafik.
4	Nga auditimi i zbatimit të kontratës për procedurën: “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvanë në blloqe banimi” rezulton mungesa e lejes për hapjen e puseve. Ku sipas akteve ligjore në fuqi duhet që personi, fizik ose juridik, privat ose shtetëror, që kryen shpime për ujërat nëntokësore, me thellësi mbi 15 m nga sipërfaqja e tokës, përpara se të paraqesë projektin hidrogeologjik në këshillin e baseneve, është i detyruar të marrë miratimin për projektin nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, që e shqyrton sipas akteve ligjore përkatëse. Pas miratimit të lejes, një kopje e projektit dhe një kopje e relacionit për rezultatet e punimeve të kryera depozitohen në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë.	Fq.159-160	E Lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për pajisjen me leje për hapje pusi për pusët e hapura dhe ato që do të hapen në vazhdimësi sipas përcaktimeve ligjore për menaxhimin e burimeve ujore.
5	Në objektin “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvanë në blloqe banimi” nga auditimi i dokumentacionit teknike të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 1,137,720 lekë me tvsh.	Fq.161-163	E Lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, të marrë masat për ngritjen e një grupi pune që të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet të fondeve me vlerë prej 1,137,720 lekë me tvsh, vlerë e cila nuk argumentohet apo justifikohet.
	Nga auditimi i procedurës së auditimit “Drurë dhe shkurre dekorative” në lidhje me dokumentacionin teknike të zbatimit, situacionin përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 1,660,320 lekë me tvsh.	fq.139-175	E Lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e sasisë së drurëve që mungojnë në të gjithë kontratën dhe evidentimin e shkaqeve që ka sjellë përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 1,660,320 lekë me tvsh.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit

DPPGJ, bashkia Tiranë, në disa raste, kryesisht në zbatimin e procedurave të prokurimit, nuk ka zbatuar me korrektësi aktet ligjore. Janë konstatuar mangësi në përllogaritjen e fondit limit, në hartimin e dokumenteve të tenderit, në vlerësimin e ofertave dhe në shqyrtimin e ankesave, si dhe në zbatimin e kontratave. Sa i takon zbatimin të kontratave theksojmë se problematika ka të bëjë më shumë në realizimin e punimeve civile, shërbimeve dhe mallrave.

- Janë konstatuar mangësi në lidhje me kontrollin e brendshëm për krijimin e gjurmës së auditit për të gjitha proceset e punës duke e bërë sistemin e kontrollit të brendshëm jo efektiv.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i auditimit financiar i modifikuar me rezervë:

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare Vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, për vitin ushtrimor nga 01.01.2021-31.12.2021, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e

fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinionit:

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin me rezervë”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2021, referuar Ligjit nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), si dhe Udhëzimit e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar nëseksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga DPPGJ, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në juridiksionin, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike nëpërputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është emjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale (por jo të përhapura), të cilat sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të DPPGJ-së. Për këto arsye kemi dhënë opinion me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Nga audimi i zërave të pasqyrës së “Pozicionit Financiar” dhe analizës së të drejtave dhe detyrimeve rezultoi se:

- sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitet 2018-2020 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vlerën zero lekë. Nga Institucioni nuk disponohet dokumentacion dhe planimetri (genplan) për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve, që ka në dispozicion;

-për periudhën 2018-2021, komisionet e inventarizimit kanë evidentuar ndërtesa të cilat nuk ekzistojnë, por që vazhdojnë të jenë të regjistruara në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstrukione”. Në vitin 2019, për secilin objekt, komisioni i inventarizimit ka paraqitur, me anë të shkresës nr. 2985/1 prot., datë 24.01.2020, procesverbalet e mbajtura për verifikimin në terren, ku në procesverbalin e mbajtur në terren, datë 13.01.2020, Komisioni i inventarizimit konstaton se 3 objektet: (1) “Barakat” (me vlerë kontabël 5,409 lekë, viti 1981), (2) “Zyrat e kuartallave nr. 4” (me vlerë kontabël 45,000 lekë, midis Rrugës së Durrësit dhe Rrugës së Kavajës) dhe (3) “Ofiçina tek VasilShanto” (me vlerë kontabël 25,811 lekë, viti 1980), nuk ekzistojnë pasi janë bërë pallate.

Drejtorja e Financës dhe Buxhetit shprehet se nuk ka në dispozicion asnjë dokumentacion në lidhje me mungesën e aktiveve. Për vitin 2021, komisioni i inventarizimit konstaton një diferencë prej 5,584,596 lekë mes gjendjes fizike dhe të dhënave të regjistruara në kontabilitet, pasqyruar kjo në inventarin përmbledhës për inventarizimin e asetëve të DPPGJ-së për vitin 2021 me nr. 2948/2 prot., datë 22.01.2022, ku shprehet se 15 prej objekteve pjesë e inventarit nuk ekzistojnë fizikisht. Përpos konstatimeve të komisionit të inventarizimit, nga ana e DPPGJ-së nuk është marrë asnjë masë për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ndërtesave, me qëllim identifikimin dhe rivlerësimin ndërtesave që DPPGJ ka nën administrim;

-nga lëvizjet e aktiveve nga sistemimet, institucioni bën lëvizjen e aseteve nga llogaria përkatëse 21 "Aktive afatgjata" në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara". Llogaria 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara" në shumën 55,964,019 lekë përfaqëson të gjitha aktivet e dëmtuara që DPPGJ ka identifikuar të dëmtuara nga komisionet e inventarizimit. Shuma prej 55,964,019 lekë është keqklasifikuar në llogarinë 24, pasi secili nga aktivet e dëmtuara duhet të klasifikohet në llogarinë përkatëse të aktiveve, deri në momentin e vlerësimit nga komisioni i vlerësimit të aktiveve;

-në llogarinë 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" është debituar shuma prej 4,724,015 lekë, e cila ka të bëjë me debitorë të trashëguar në vite;

- në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" në shumën 20,496,402 lekë, të cilët paraqesin debitorë të krijuar për një periudhë shumë të gjatë rreth 15 vjet. Për këto debitorë, institucioni i DPPGJ-së nuk ka mundësi arkëtimi;

- institucioni ka një regjistër elektronik për aktivet afatgjata, i cili nuk është përditësuar me vlerën aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi;

-shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit;

Përgjegjësitë e drejtuesve të DPPGJ-së:

Strukturat drejtuese të DPPGJ-së, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 25/2018, "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e grupit për të vazhduar aktivitetin e tij në vijimësi, duke dhënë informacion nëse është e zbatueshme për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë. Titullari i Institucionit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar. Raportimi mbi ecurinë e veprimtarisë dhe raportin e auditimit i jep mundësinë Drejtuesve të DPPGJ-së që nëpërmjet një analize gjithëpërfshirëse, të informohen për zhvillimin dhe performancën e njësisë ekonomike, shoqëruar me një përshkrim të risqeve dhe pasigurive kryesore, me të cilat njësia mund të përballet.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi material apo anomalie që mund të ekzistojë. Identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidence auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Gjatë vlerësimit të risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga subjekti, në mënyrë që të përcaktojë procedura auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat esubjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të subjektit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga subjekti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Opinion mbi përputhshmërinë

Opinion i auditimit i modifikuar/kualifikuar:

Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit të DPPGJ. Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000 .

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e DPPGJ, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinion i kualifikuar.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se aktiviteti i Institucionit, për shkak të rëndësisë të anomalive të trajtuara në këtë raport, ka devijime materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinion i kualifikuar.

Baza për Opinionin

Për gjetjet nga auditimi dhe rekomandimet, jemi dakortësuar me Menaxhmentin e Institucionit, si dhe jemi siguruar prej Tij, që vendimmarrjet në ardhmen të jenë më të spikatura, që të japin shërbime më të mira dhe vlerë më të mirë për parane. Për të arritur këtë, Menaxhmenti i këtij Institucioni të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas programit ekonomik.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga DPPGJ, theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Menaxhmenti i Institucionit është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme në drejtim të garantimit të përputhshmërisë së aktivitetit me kushtet e dispozitave ligjor në fuqi. Gjithashtu menaxhmenti i Institucionit është përgjegjës kryesor për ngritjen e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive në realizimin e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve, duke nisur nga hartimi i rregullave të brendshme, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi të këtij Institucioni, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë.

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse aktiviteti i Institucionit, nuk paraqet anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në

përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të aktivitetit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1008/1 Prot, datë 15.11.2022 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin DPPGJ, Bashkia Tiranë, nga data 21.11.2022 deri më 31.01.2023, u krye auditimi “Mbi Përputhshmërinë”, për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 31.12.2021, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A. L., Përgjegjës Grupi
2. B. B., Auditues
3. A. Gj., Auditues
4. E. K., Auditues

1. Objekti i auditimit :

Objekti kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që DPPGJ, u ka bërë fondeve në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë shoqërisë. Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës* duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet në aktet ligjore si dhe nëse transmetimi i energjisë elektrike në linjat e transmetimit në administrim të DPPGJ, është kryer në mënyrë sa më korrekte, duke shmangur humbjet si pasojë e mos menaxhimit siç duhet të proceseje. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë* ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 4000, p 18).

2. Qëllimi i auditimit :

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara.

3. Identifikimi i çështjes:

DPPGJ duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për administrimin e mirembajtjen, zhvillimit, pastrimit të gjelberimit rrugor dhe të gjelbërimit të zonave të banimit brenda territorit të Bashkisë së Tiranës, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të DPPGJ:

DPPGJ ka si qëllim administrimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e proceseve të punës së pastrimit dhe gjelbërimit rrugor, të gjelbërimit të zonave të banimit brenda territorit të Bashkisë, Tiranë, si dhe administrimin e pastrimit të zonave të pambuluara nga operatorët e kontraktuar nga Bashkia Tiranë.

5. Përgjegjësitë e audituesve:

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Të respektojnë kërkesat etike, planifikojë dhe kryejë auditimin sipas nivelit të sigurisë së kërkuar.

6. Kriteret e vlerësimit:

Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”;

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”

Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Ligji nr.9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;

Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar;

VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar;

VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;

7. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)
- ISSAI 400 - (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë).
- ISSAI 4000 - (Standardet e auditimit të përputhshmërisë).
- Kodi Etik dhe Rregullore e procedurave të auditimit të KLSH.

8. Metoda e auditimit.

Auditimi është zbatuar sipas drejtimeve në programin përkatës, për zbatimin e rekomandimeve lënë në auditimin e mëparshëm, ligjshmërinë e vendimmarrjes së organeve drejtuese, hartimin

dhe zbatimin e programit ekonomik-financiar, strukturën organizative dhe pagat, pasqyrat financiare, procedurat e prokurimit, menaxhimin financiar dhe kontrollin etj. Auditimi është realizuar i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje.

9. Dokumentimi i auditimit.

Mbi bazën e të dhënave të rezultateve të auditimit të grumbulluara, janë mbajtur akt konstatimet, akt verifikimet për të cilat janë shqyrtuar komentet dhe shpjegimeve e të subjektit të audituar, duke hartuar Projekt raportin e Auditimit. Mbi bazën e observacioneve të dërguara nga subjekti janë pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i cili së bashku me rekomandimet do të shërbej në përmirësimin e gjendjes në veprimtarin e DPPGJ.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit është institucion buxhetor në varësi të Bashkisë së Tiranës.

Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Tiranë është krijuar në funksion të administrimit, mirëmbajtjes, zhvillimit të proceseve të punës për pastrimin dhe gjelbërimin rrugor si dhe të gjelbërimit të zonave të banimit brenda territorit të Bashkisë Tiranë.

Gjithashtu DPPGJ përgjigjet për administrimin dhe pastrimin e zonave të pambuluara nga operatorët e kontraktuar nga Bashkia Tirane.

Struktura organike, numri i punonjësve, shtesat apo shkurtimet si dhe niveli i pagave, miratohen nga Këshilli Bashkiak i Tiranës, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Administrata e DPPGJ përbëhet nga funksionarët (jo nëpunës civilë) dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës.

Në krye të Administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Tiranë qëndron Drejtori i Përgjithshëm.

Administrata e DPPGJ e Bashkisë Tiranë është e organizuar në drejtori dhe sektorë.

Struktura organizative miratohet nga Kryetari i Bashkisë dhe numri i personelit të saj miratohet nga Këshilli Bashkiak.

Funksionet sipas rradhës hierarkike, janë:

- Drejtor i Përgjithshëm,
- Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm
- Specialiste Asistente
- Drejtor Drejtorie,
- Përgjegjës Sektori,
- Specialist I
- Specialist II
- Punonjës

Drejtoritë përgjigjen për përmbushjen e detyrave të një ose disa fushave të caktuara, sipas funksioneve të përcaktuara me ligj ose akte nënligjore.

Sektorët përgjigjen për aspekte të veçuara të këtyre elementëve.

Drejtoritë kanë në përbërjen e tyre dhe janë përgjegjës për mbarëvajtjen e disa sektorëve, sipas strukturës administrative të miratuar.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimit të auditimit.

2.1. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1008/1 Prot., datë 15.11.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë.

Ky auditim është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit” dhe Udhëzimin e Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH”.

Objekti i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 2623/3 Prot., datë 24.12.2018 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin tematik” mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në Drejtorinë e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë, (ndryshuar emri i institucionit në DPPGJ) sipas programit të auditimit nr. 1005 Prot., datë 1.09.2018, me objekt “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme në 18 subjektet e evaduara për periudhën e tremujorit të IV-të të vitit 2017 dhe 2 subjekte të evaduara në vitin 2018” për veprimtarinë e DPN1 nga data 15.07.2015 deri më datën 30.06.2017, mbistatusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Nga auditimi i kryer në DPPGJ, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, verifikohet se:

KLSH ka dërguar në DPN1 e Qytetit Tiranë rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 878/8 Prot., datë 20.12.2017, protokolluar në DPN1 të Qytetit Tiranë (ndryshuar emri i institucionit në DPPGJ) me shkresën nr. 2129/6 prot, datë 23.12.2017, ndërsa nga DPN1 e Qytetit Tiranë për zbatimin e rekomandimeve është kthyer përgjigje me shkresën nr. 878/9, datë 23.01.2018, në të cilën janë **21** masa organizative, **2** masa për shpërblim dëmi, **1** masë për eliminimin e efekteve negative në buxhetin e shtetit, dhe **9** masa disiplinore, të cilat janë pranuar nga DPN1 e qytetit Tiranë.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 2623/3 Prot., datë 24.12.2018 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin tematik mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 e punëtorëve të qytetit Tiranë”, për veprimtarinë e DPN1 e qytetit Tiranë nga data 15.07.2015 deri më 30.06.2017, mbistatusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Në raportin përfundimtar tematik me nr. 2623/3 Prot., datë 24.12.2018 për auditimin e ushtruar “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në DPN1 të qytetit Tiranë” konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Janë dhënë 21 masa organizative, janë pranuar plotësisht 21, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 18 janë zbatuar, në proces zbatimi janë 3;
- b) Janë dhënë 2 masa për shpërblim dëmi, janë pranuar plotësisht 2, zbatuar 2;
- c) Është dhënë një masë për eliminimin e efekteve negative në buxhetin e shtetit, e pranuar dhe e zbatuar;
- d) Janë dhënë 9 masa disiplinore, të pranuar dhe të zbatuara.

Me shkresën nr.1005/16 Prot., datë 20.12.2018 Kryetari i KLSH, i ka kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të DPN1 të vijojë me punën për 3 masat organizative të pranuar, të cilat vijnë në proces zbatimi, përkatësisht nr.6.1, nr.8.1 dhe 21.1.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

“MASA ORGANIZATIVE”.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Menaxhimit dhe Shërbimeve, të ngrejë grupin e punës për monitorimin e ambienteve të dhëna me qira, me qëllim ruajtjen e tyre dhe respektimin e kushteve kontraktuale si edhe në rastet e përfundimit të kontratave, apo tjetërsimit të ambienteve të kryejë procedurat sipas legjislacionit në fuqi.

Pretendimi i subjektit:

Ambientet me qira të sipër cituara nuk janë më në kompetencë të Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve Nr. 1 e Qytetit ,pra drejtoria jonë nuk ka më përgjegjësi për monitorimin e tyre . Subjekti “S. A.” ka bërë privatizimin e ambientit botuar ne Fletoren Zyrtare me Vendimin nr. 337, datë 4.5.2016. Ndërsa në lidhje me “Ish këndi i lodrave për fëmijë në rrugën e Elbasanit” është në proces zhvillim projekti nga institucionet qendrore . Në lidhje me të dyja subjektet i kemi drejtuar Bashkisë Tiranë një shkresë me Nr. 3319 Prot., datë 29.12.2017 ku i sqarojmë situatën. Është zhvilluar projekt investimi nga institucioni qendror Bashkia Tiranë .

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Duke u bazuar në Vendimin nr. 337, datë 4.5.2016 “Për Shkëmbimin e pronës me nr.2/141 më emërtim “Sofra e Ariut”, me sipërfaqe 3,150 m² në zonën kadastrale 8280 Tiranë, me pronën me nr. 2/345, me emërtim “Truall”, me sipërfaqe 3,660 m², në ZK 8280, Tiranë”, institucioni nuk ka më përgjegjesi administrative dhe ligjore mbi këto prona, pasi trualli i transferuar është nën administrimin e Bashkisë Tiranë.

Statusi: Rekomandimi konsiderohet *i zbatuar*.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit dhe Planifikimit, Sektori i Financës dhe Drejtoria Juridike të marrin masa për pjesën e llogarive debitore që kalojnë kohën e parashkrimit, të hartojë një raport analitik për strukturat drejtuese të institucionit, për t’ju drejtuar Bashkisë Tiranë, për mënyrën e sistemimit të këtyre shumave të cilat rrinë në llogaritë e saj për periudha mbi 10 vjeçare, për pjesën e llogarive debitore, të cilat nuk janë futur në strategjinë e detyrimit e prapambetura, të jenë pjesë e kësaj analize dhe raporti, për t'u sistemuar. Gjithashtu, nga drejtoritë e sipërcituara të hartohet një procedurë standarde për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve deri në adresimin në organet gjyqësore nëse do të jetë e nevojshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Pretendimi i subjektit:

Kemi marrë masa duke përgatitur një relacion drejtuar titullarit të institucionit ku kemi shpjeguar dhe analizuar të gjithë situatën e kësaj debie të pa shlyer dhe të prapambetur në një afat kohor mbi 10 vite. Në këtë shkresë është sqaruar që kjo është debi e mbartur në vite dhe nuk kemi asnjë mundësi kontakti me personat që kanë pasur përgjegjësi për këto detyrime. Nuk janë gjendur dokumente justifikues por vetëm është trashëguar në bilanc. Gjithashtu mbështetur në ligjin Nr.7850 datë 29.07.1994 (i ndryshuar) neni 115 pika dh i Kodit Civil nuk të jep mundësin e adresimit të çështjes në organet gjyqësore duke qënë se ka kaluar afati 3-vjeçar i paditjes së çështjes. Gjithashtu titullari i institucionit i ka drejtuar një shkresë Kryetarit të Bashkisë në lidhje me këtë çështje ku kërkohet sistemimi i këtij detyrimi dhe heqja nga pasqyrat financiare të DPNr.1 Shkresa me nr.1707/1 Prot, datë 10.05.2018. Në vazhdimësi kemi dërguar shkresa për zgjidhjen e kësaj çështje me shkresë nr.1045 Prot ,datë 27.02.2020 me lëndë “Kërkesë ”drejtuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Gjithashtu shkresë nr.2258 Prot ,datë 22.09.2021 me lëndë “Kërkesë” drejtuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Deri më tani nuk kemi marrë asnjë përgjigje për zgjidhjen e këtij problemi .

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Institucioni i DPPGJ-së ka hartuar raportin analitik në lidhje me debitorët, por kjo shumë vazhdon të trashëgohet në pasqyrat financiare.

Statusi: Rekomandimi konsiderohet *në proces zbatimi*.

3.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit, Shërbimeve si dhe Dega e Financës, të marrin masa për implementimin e një programi financiar për kryerjen

e veprimeve ekonomike, me lehtësimin e punës, shmangien e gabimeve të mundshme dhe marrjen e të dhënave të sakta financiare, sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Pretendimi i subjektit:

Bashkia Tiranë ka implementuar një Sistem Informatik Financiar IMPRO ku kemi hedhur të dhënat financiare që kanë të bëjnë me:

- Regjistrimin e artikujve, hedhjen e Hyrje-Daljeve në magazinë;
- Regjistrimi i kontratave të lidhura përgjatë vitit me të gjitha elementet financiar te saj;
- Regjistrimi i faturave te furnitorëve duke bërë të mundur dhe kontabilizimin e tyre;
- Krijimin e urdhër shpenzimit tek hapësira e faturave dhe lidhja e dy ambienteve;
- Buxheti i miratuar i vitit nga ana e Këshillit Bashkiak është krijuar nga Sektori i Buxhetit te - Bashkisë Tirane dhe nga ana jone kërkohet te hidhen kërkesat për çelje mujore për shpenzime operative dhe kapitale.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Drejtorja e Financës ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit regjistrimet në lidhje me kryerjen e veprimeve ekonomike.

Statusi: Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Titulli i gjetjes	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit.
Situata	<p>“Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit” (këtu e më poshtë DPPGJ) është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën nga data 01.01.2018 deri më 31.12.2021.</p> <p>KLSH ka dërguar në DPN1 e Qytetit Tiranë rekomandimet e auditimit me shkesën nr. 878/8 prot., datë 20.12.2017, protokolluar në DPN1 të Qytetit Tiranë (ndryshuar emri i institucionit në DPPGJ) me shkesën nr. 2129/6 prot, datë 23.12.2017, ndërsa nga DPN1 e Qytetit Tiranë për zbatimin e rekomandimeve është kthyer përgjigje me shkesën nr. 878/9, datë 23.01.2018, në të cilën janë 21 masa organizative, 2 masa për shpërblim dëmi, 1 masë për eliminimin e efekteve negative në buxhetin e shtetit, dhe 9 masa disiplinore, të cilat janë pranuar nga DPN1 e qytetit Tiranë.</p> <p>Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkesën nr. 2623/3 prot., datë 24.12.2018 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin tematik mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 e punëtorëve të qytetit Tiranë”, për veprimtarinë e DPN1 e qytetit Tiranë nga data 15.07.2015 deri më 30.06.2017, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.</p> <p>-Nga rikërkimi i zbatimit të 3 rekomandimeve masa organizative të mbetura në proces është konstatuar se: janë zbatuar 2 rekomandime dhe 1 rekomandim është në proces zbatimi.</p>
Kriteri	Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Shtetit" neni 15, germa j; neni 30.
Ndikimi/Efekti	Moszbatimi i rekomandimeve të lëna me parë nga Kontrolli i Lartë i shtetit krijon vijimësi në moszbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, funksionim jokorrekt me kërkesat ligjore të strukturave tëveçanta të DPPGJ-së.

Shkaku	DPPGJ, nuk ka bërë përpjekjet e duhura për realizimin plotësisht të rekomandimeve të auditimit të mëparshëm të KLSH-së.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	DPPGJ të analizojë me përgjegjësi rekomandimet e pa zbatuara, duke marrë masat e menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësi konkrete ligjore për moszbatimin e tyre, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 1188/6, datë 07.08.2019.
Afati	<i>Menjeherë</i>

2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

Mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë (DPPGj) në bazë të programit të auditimit nr. 1008/1 Prot, datë 15.11.2022, i ndryshuar “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2021, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë”.

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër, pika 1, u auditua planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 993, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2018-2021, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

Nga administrimi i dokumentacionit të mëposhtëm:

- PBA 2018-2021;
- Projekt-buxhetin e miratuar për vitet 2018-2021;
- Vendimet e KB “Për miratimin e buxhetit të Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë” për vitet 2018-2021;
- Vendime të tjera të KB, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacioni i shpenzimeve për vitet 2018-2021 të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë;
- Situacioni i të ardhurave për vitet 2018-2021 të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë;
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Raportimet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura të DPPGj;
- Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

Baza Ligjore:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2018”;
- Ligji nr. 99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”;
- Ligji nr. 137/2020, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2021”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022";
- Udhëzimi nr. 26, datë 27.09.2019, “Procedura për menaxhimin e Vështirësive Financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MFE nr. 27, datë 10.09.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".

1. Programimi i PBA-së për periudhën 2018-2021

Programimi i PBA-së 2018-2020

Programimi i PBA 2018-2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë është shoqëruar me:

- Urdhër nr. 569/1, datë 28.02.2018, “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik”, bashkëlidhur raporti nr. 3523, datë 29.12.2018;
- Shkresën nr. 14541, datë 18.04.2017 “Mbi përgatitjen e buxhetit afatmesëm 2018-2020”;
- Urdhër nr. 1031/1, datë 24.04.2017, “Për ngritjen e komisionit për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse;
- Shkresë nr. 1031/2, datë 05.05.2017, “Planifikimi i investimeve për vitin 2018-2020”, nga Drejtoria e Pastrimit të Qytetit, kërkesë për shtim të numrit të punonjësve, pajisje zyre, etj.;
- Shkresë nr. 1031/3, datë 05.05.2017, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2018-2020”, nga Drejtoria e Pastrimit të Qytetit, kërkesë për materiale mirëmbajtje bashkëlidhur relacioni;
- Shkresë nr. 1031/4, datë 05.05.2017, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2018-2020”, nga Drejtoria e Monitorimit të Territorit, për investime;
- Shkresë nr. 1031/5, datë 05.05.2017, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2018-2020”, nga Drejtoria e Trajtimit të Mbetjeve, Landfill dhe Reciklim, kërkesë për pajisje dhe materiale zyre bashkëlidhur relacioni;
- Shkresë nr. 1031/6, datë 05.05.2017, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2018-2020”, nga Drejtoria e Planifikimeve Menaxhimit dhe Shërbimeve, bashkëlidhur relacioni;
- Shkresë nr. 1031/7, datë 05.05.2017, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2018-2020”, nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjellbërimit të Qytetit, për shpenzime operative;
- Shkresa nr. 1031/8, datë 15.05.2017, “Propozimi i Projekt Buxhetit Afatmesëm 2018-2020, dërguar Bashkisë Tiranë”.

Programimi i PBA-së 2019-2021

Programimi i PBA 2019-2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë është shoqëruar me:

- Urdhër nr. 1061, datë 07.03.2019, “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik”, bashkëlidhur raporti nr. 2994, datë 31.12.2019;
- Shkresë nr. 6622, datë 09.07.2018, “Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”;
- VKB nr. 62, datë 07.06.2018, “Për miratimin e treguesve ekonomik dhe financiar të Bashkisë Tiranë dhe tavanet përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2019-2021”, bashkëlidhur Udhëzimi nr. 6/1, datë 28.02.2018, “Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor”;

- Shkresën nr. 2302/2, datë 03.08.2018, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2019-2021”, nga Drejtoria e Pastrimit të Qytetit, për materiale dhe mirëmbajtje pastrimi, bashkëlidhur relacioni;
- Shkresën nr. 2302/3, datë 03.08.2018, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2019-2021”, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, kërkesë për shlyerje vendime gjyqësore dhe kancelari;
- Shkresën nr. 2302/5, datë 03.08.2018, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2019-2021”, nga Drejtoria e Monitorimit të Terrenit, bashkëlidhur relacioni;
- Shkresën nr. 2302/6, datë 03.08.2018, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2019-2021”, nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit, për shpenzime operative;
- Shkresën nr. 2302/7, datë 19.08.2018, “Mbi përgatitjen e buxhetit afatmesëm 2019-2021”.

Programimi i PBA-së 2020-2022

Programimi i PBA 2020-2022, nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë është shoqëruar me:

- Shkresën nr. 22875, datë 31.05.2019 “Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022”;
- Urdhër nr. 1706/1, datë 05.06.2019, “Për Krijimin e Komisionit për Hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”;
- Raporti i GMS, nr. 3034, datë 31.12.2020;
- Shkresë nr. 1706/2, datë 13.06.2019, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2020-2022”, nga Drejtoria e Pastrimit të Qytetit, për materiale dhe mirëmbajtje pastrimi, bashkëlidhur relacioni;
- Shkresë nr. 1706/3, datë 13.06.2019, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2020-2022”, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, kërkesë për shlyerje vendime gjyqësore, kompjuter, kancelari etj.;
- Shkresë nr. 1706/4, datë 13.06.2019, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2020-2022”, nga Drejtoria e Task-Forcë, Emergjencës dhe Evadimit, për investime dhe materiale;
- Shkresë nr. 1706/5, datë 13.06.2019, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2020-2022”, nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit, për investime dhe materiale;
- Shkresë nr. 1706/6, datë 13.06.2019, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2020-2022”, nga Drejtoria e Planifikim, Menaxhimit, për materiale, bashkëlidhur relacioni;
- Shkresë nr. 1706/7, datë 13.06.2019, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2020-2022”, nga Drejtoria e Monitorimit të Terrenit, bashkëlidhur relacioni për investime;
- Shkresa nr. 1706/8, datë 21.06.2019, “Dërgim informacioni mbi kërkesat buxhetore për periudhën afatmesme 2020-2022”;
- Shkresa nr. 2204/1, datë 09.09.2019, “Dërgim informacioni mbi programin buxhetor për afatmesëm 2020-2022”;
- Shkresë nr. 2872, datë 11.12.2019, “Rishikim i PBA 2020-2022, tabela e investimeve”.

Programimi i PBA-së 2021-2023

Programimi i PBA 2021-2023, nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë është shoqëruar me:

- Urdhër nr. 373, datë 02.02.2021, “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik”, bashkëlidhur raporti nr. 3449, datë 31.12.2021;
- Urdhër nr. 2030, datë 28.07.2020, “Për Krijimin e Komisionit për Hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”;
- Shkresë nr. 2030/1, datë 25.08.2020, “Planifikimi i Kërkesave Buxhetore Afatmesme 2021-2023”, nga Drejtoria e Monitorimit të Terrenit, bashkëlidhur relacioni dhe lista e materialeve;

- Shkresë nr. 2030/2, datë 25.08.2020, “Hartimin e buxhetit afatmesëm 2021-2023”, nga Drejtoria e Task-Forcë, Emergjencës dhe Evadimit, për investime dhe materiale;
- Shkresë nr. 2030/3, datë 25.08.2020, “Planifikimi i buxhetit afatmesëm për periudhën 2021-2023”, nga Drejtoria e Planifikimeve dhe Menaxhimit, për materiale dhe relacioni bashkëlidhur;
- Shkresë nr. 2030/4, datë 27.08.2020, “Planifikimi i Kërkesave Buxhetore Afatmesme 2021-2023”, nga Drejtoria e Pastrimit të Qytetit, për materiale dhe mirëmbajtje pastrimi, bashkëlidhur relacioni;
- Shkresë nr. 2030/5, datë 28.08.2020, “Mbi përgatitjen e programit buxhetor 2021-2023”, nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjellbërimit të Qytetit, për shpenzime operative;
- Shkresë nr. 2030/6, datë 28.08.2020, “Planifikimi i Kërkesave Buxhetore Afatmesme 2021-2023”, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, kërkesë për shlyerje vendime gjyqësie, kompjuter, kancelari etj.;
- Shkresën nr. 2505, datë 02.10.2020, “Dërgim informacioni mbi kërkesat buxhetore për periudhën afatmesme 2021-2023”, dërguar Bashkisë Tiranë;
- Email, datë 16.10.2020, protokolluar me nr. 2590, datë 16.10.2020, dërgimi i tavaneve;
- Shkresën nr. 2505/1, datë 22.10.2020, “Ridërgim informacioni mbi kërkesat buxhetore për periudhën afatmesme 2021-2023”, dërguar Bashkisë Tiranë;
- Shkresën nr. 36685, datë 22.10.2020, “Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023”;
- VKB nr. 123, datë 28.09.2020, “Për miratimin e treguesve ekonomik dhe financiar të Bashkisë së Tiranës dhe tavaneve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2021-2023”.

Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2018-2021 si, objektivat, qëllimi, roli i PBA, prioritet kryesore, parashikimi i investimeve dhe planifikimi i shpenzimeve operative.

Nevojat e shpenzimeve që parashikohen për punimet dhe shërbimet në mbarëvajtjen e aktivitetit të DPPGj, janë hartuar në bazë të kërkesave të drejtorive të varësisë, si dhe shtrirjes së aktivitetit që parashikohet me organizimin e ri territorial të Bashkisë Tiranë. Në këtë kuadër janë hartuar tabelat respektive për shpenzime operative dhe për investime, sipas drejtorive përkatëse. Në përcaktimin e shpenzimeve dhe investimeve të nevojshme për 3 vitet e programit buxhetor afatmesëm 2018 – 2021, është pasur në qendër të vëmendjes shtimin e sipërfaqeve të gjellbërimit dhe për të përmirësuar jetesën e brezave të sotëm e për të gatuar mirëqenien e brezave të ardhshëm në një qytet ekologjik dhe të pastër.

1. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura

Buxheti i vitit 2018, është miratuar me VKB nr. 132, datë 21.12.2017, “Miratimi i programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2018”.

Tabela nr. II.1.1: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2018

Planifikimi i të ardhurave 2018		Planifikimi i shpenzimeve 2018	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për 2018	502	Art. 600 Paga	290,648
-	-	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shënd.	46,227
-	-	Art. 602 Shpenzime operative	195,000
-	-	Art. 231 Investime	100,000
Totali i të Ardhura	502	Totali i shpenzimeve	631,875

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

Buxheti i vitit 2019, është miratuar me VKB nr. 159, datë 21.12.2018, “Miratimi i programit

buxhetor afatmesëm 2019-2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2019”; Buxheti i vitit 2020, është miratuar me VKB nr. 157, datë 26.12.2019, “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”;

Buxheti i vitit 2021, është miratuar me VKB nr. 172, datë 21.12.2020, “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2021”.

Tabela nr. II.1.2: Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2019-2021

000

lekë

Planifikimi i shpenzimeve	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Art. 600 Paga	314,785	332,029	327,336
Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	49,983	52,771	52,025
Art. 602 Shpenzime operative	270,488	200,000	256,889
Art. 604 Transferime korrente të brendshme	-	-	-
Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	-	-	-
Art. 231 Investime	508,917	80,000	112,000
Totali i shpenzimeve	1,144,173	664,800	748,250

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

Nga auditimi rezulton se, buxheti i viteve 2018-2021 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

Buxheti i DPPGj me ndryshimet e miratuara

Gjatë vitit 2018 buxheti i DPPGj ka pësuar disa ndryshime si vijon:

- VKB nr. 41, datë 29.03.2018, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr. 132, datë 21.12.2017, “Miratimi i programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2018”;
- VKB nr. 47, datë 26.04.2018, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr. 132, datë 21.12.2017, “Miratimi i programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2018”;
- VKB nr. 115, datë 27.09.2018, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr. 132, datë 21.12.2017, “Miratimi i programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2018”;
- VKB nr. 129, datë 15.11.2018, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr. 132, datë 21.12.2017, “Miratimi i programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2018”.

Tabela nr. II.1.3: Planifikimi i shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit 2018

lekë

Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë
	1	2	1+2
Art. 600 Paga	313,929,000	-15,000,000	298,929,000
Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	49,841,885	-	49,841,885
Art. 602 Shpenzime operative	185,000,000	15,842,132	200,842,132
Art. 231 Investime	254,586,735	73,481,780	328,068,515
TOTALI SHPENZIMEVE	803,357,620	74,323,912	877,681,532

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

Gjatë vitit 2019 buxheti i DPPGj ka pësuar ndryshime me VKB nr. 49, datë 03.05.2019, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr. 159, datë 21.12.2018, “Miratimi i programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2019””.

Tabela nr. II.1.4: Planifikimi i shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit 2019 lekë

Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë
	1	2	1+2
Art. 600 Paga	320,623,909	-	320,623,909
Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	50,906,694	-	50,906,694
Art. 602 Shpenzime operative	200,000,000	38,500,000	238,500,000
Art. 231 Investime	225,244,639	5,189,885	230,434,524
TOTALI SHPENZIMEVE	796,775,242	43,689,885	840,465,127

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

Gjatë vitit 2020 buxheti i DPPGj ka pësuar disa ndryshime si vijon:

- VKB nr. nr. 22, datë 17.03.2020, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr. 157, datë 26.12.2019, “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”;
- VKB nr. 155, datë 13.11.2020, “Për disa ndryshime në VKB nr. 157, datë 26.12.2019, “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”.

Tabela nr. II.1.5: Planifikimi i shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit 2020 lekë

Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë
	1	2	1+2
Art. 600 Paga	326,708,000	-	326,708,000
Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	51,925,000	-	51,925,000
Art. 602 Shpenzime operative	200,000,000	6,000,000	206,000,000
Art. 231 Investime	80,000,000	40,000,000	120,000,000
TOTALI SHPENZIMEVE	658,633,000	46,000,000	704,633,000

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

Gjatë vitit 2021 buxheti i DPPGj ka pësuar disa ndryshime si vijon:

- VKB nr. 51, datë 06.04.2021, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr. 172, datë 21.12.2020, “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2021”;
- VKB nr. 81, datë 02.07.2021, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr. 172, datë 21.12.2020, “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2021”.

Tabela nr. II.1.6: Planifikimi i shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit 2021 lekë

Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë
	1	2	1+2
Art. 600 Paga	338,246,000	-	338,246,000
Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	53,760,000	-	53,760,000

Art. 602 Shpenzime operative	210,000,000	-	210,000,000
Art. 231 Investime	71,339,550	492,600	71,832,150
TOTALI SHPENZIMEVE	673,345,550	492,600	673,838,150

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2018

Për vitin 2018 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **877,682** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **801,231** mijë lekë, ose në masën **91%**. Artikulli që ka vlerën më të ulët të realizimit është artikulli 602 “Shpenzime operative” i cili është planifikuar 200,842 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 161,414 mijë lekë, ose në masën 80%.

Tabela nr. II.1.7: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2018 lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt DPPGj Bashkia Tiranë				
Nr	Përshkrimi i shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi në %
1	Artikulli - 600 Paga	298,029,452	281,257,721	94%
2	Artikulli - 601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore	49,841,885	44,627,157	90%
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	200,842,132	161,414,391	80%
4	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare	899,548	862,961	96%
5	Artikulli - 231 Investime	328,068,515	313,068,506	95%
	TOTALI	877,681,532	801,230,736	91%

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2019

Për vitin 2019 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **840,465** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **796,489** mijë lekë, ose në masën **95%**. Artikulli që ka vlerën më të ulët të realizimit është artikulli 606 “Transferime tek buxhete familjare” i cili është planifikuar 804 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 656 mijë lekë, ose në masën 82%.

Tabela nr. II.1.8: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2019 lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt DPPGj Bashkia Tiranë				
Nr	Përshkrimi i shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi në %
1	Artikulli - 600 Paga	319,820,159	289,058,113	90%
2	Artikulli - 601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore	50,906,694	48,033,274	94%
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	238,500,000	228,965,096	96%
4	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare	803,750	656,065	82%
5	Artikulli - 231 Investime	230,434,528	229,775,981	100%
	TOTALI	840,465,127	796,488,529	95%

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2020

Për vitin 2020 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **704,633** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **666,231** mijë lekë, ose në masën **95%**. Artikulli që ka vlerën më të ulët të realizimit është artikulli 600 “Paga” i cili është planifikuar 325,547 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 300,767 mijë lekë, ose në masën 92%.

Tabela nr. II.1.9: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2020

lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt DPPGj Bashkia Tiranë				
Nr	Përshkrimi i shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi në %
1	Artikulli - 600 Paga	325,546,825	300,767,328	92%
2	Artikulli - 601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore	51,925,000	50,148,191	97%
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	206,000,000	201,859,399	98%
4	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare	1,161,175	1,089,148	94%
5	Artikulli - 231 Investime	120,000,000	112,366,600	94%
	TOTALI	704,633,000	666,230,666	95%

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2021

Për vitin 2021 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **673,838** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **641,303** mijë lekë, ose në masën **95%**. Artikulli që ka vlerën më të ulët të realizimit është artikulli 600 “Paga” i cili është planifikuar 337,085 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 312,352 mijë lekë, ose në masën 93%.

Tabela nr. II.1.10: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2021

lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt DPPGj Bashkia Tiranë				
Nr	Përshkrimi i shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi në %
1	Artikulli - 600 Paga	337,084,981	312,352,249	93%
2	Artikulli - 601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore	53,760,000	50,269,702	94%
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	210,000,000	206,994,816	99%
4	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare	1,161,019	1,129,408	97%
5	Artikulli - 231 Investime	71,832,150	70,556,346	98%
	TOTALI	673,838,150	641,302,521	95%

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

3. Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit

Nga Drejtoria e Financës është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit për shpenzimet e kryera, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 44 ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 30.07.2018 “Mbi procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore” janë përgatitur vetëm raportime të buxhetit vjetore, të cilat janë dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, Bashkisë Tiranë si vijon:

- Me shkresë nr. 206 prot., datë 28.01.2019, “Dërgim raportesh”, për vitin 2018;
- Me shkresë nr. 87 prot., datë 16.01.2020, “Dërgim raportesh”, për vitin 2019;
- Me shkresë nr. 81 prot., datë 13.01.2021, “Dërgim raportesh”, për vitin 2020;

- Me shkresë nr. 107 prot., datë 18.01.2022, “Dërgim raportesh”, për vitin 2021.

4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara vendimet gjyqësore

Për vitin 2018, vlera e detyrimeve të prapambetura për zërin investime është në vlerën **214,264,539 lekë** për shërbime dhe mallra, si rezultat i faturave të papaguara duke filluar nga muaji Prill i vitit. Këto detyrime të krijuara nga viti 2018 janë paguar në vitin pasardhës si në tabelën mëposhtë:

Tabela nr. II.1.11: Detyrimi i prapambetur për vitin 2018, paguar në vitin 2019 Në lekë

Nr .	Objekti Prokurimit	Subjekti Kreditor	Dt. e kontratës	Data e FT	Nr. serial FT	Shtesat viti 2018	Shlyerj e	Detyrimet 31.12.2018
1	Plehra kimik, furnitura veterinare, farëra, fidane	Gj.2000	03.05.2018	28.12.2018	35563242	4,608,000		4,608,000
2	Shërbim postar	Filiali i postës		26.12.2018	61420001	5,200		5,200
3	Shërbim i sigurisë fizike	L.S.	03.07.2018	30.11.2018 31.12.2018	71821811 71821840	1,781,375		1,781,375
4	Karburant diesel	Sh.-al		01.08.2018	59592710	1,841,850		1,841,850
5	Karburant diesel	Sh.-al	23.07.2018	10.09.2018	59592711	7,819,080		7,819,080
6	Karburant diesel	Sh.-al	23.07.2018	31.10.2018	59592716	3,829,095		3,829,095
7	Karburant diesel	Sh.-al	23.07.2018	27.11.2018	68057953	1,468,613		1,468,613
8	Pjesë këmbimi goma bateri filtra	E.C.C.	02.11.2018	16.11.2018	62131862 62131864	13,291,640		13,291,640
9	Rikualifikim lulishtesh	F.	27.11.2018	31.12.2018	48931840	9,385,092		9,385,092
10	Rehabilitimi i lulishtes "Llazi Miho"	K.	31.10.2016	12.12.2016	31069625	4,587,485		4,587,485
11	Furnizim dhe vendosje drurë dekorative në zonën industriale	F.shpk	22.12.2017	02.04.2018	48930486	165,647,109		165,647,109
	Total i detyrimit							214,264,539

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

Për vitin 2019, vlera e detyrimeve të prapambetura është në vlerën **16,562,142 lekë** për tre fatura të muajit Mars, për blerje karburanti dhe plehra kimike. Këto detyrime të krijuara për këtë vit janë paguar në vitin pasardhës si në tabelën mëposhtë:

Tabela nr. II.1.12: Detyrimi i prapambetur për vitin 2019, paguar në vitin 2020 Në lekë

Nr .	Objekti Prokurimit	Subjekti Kreditor	Dt. e kontratës	Data e FT	Nr. serial FT	Shtesat viti 2019	Shlyerj e	Detyrimet 31.12.2019
1	Blerje karburanti	Sh.Al	05.03.2019	14.06.2019	68057984	3,000,000		3,000,000
2	Blerje karburanti	Sh. Al	05.03.2019	07.10.2019	77455251	6,507,342		6,507,342
3	Plehra kimik, furnitura, veterinare	Gj.2000	28.03.2019	08.11.2019	64853952	7,054,800		7,054,800
	Total i detyrimit							16,562,142

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

Për vitin 2020, vlera e detyrimeve të prapambetura është në vlerën **4,316,191 lekë** për gjashtë fatura, për shërbime të sigurimit dhe ruajtjes dhe energji. Këto detyrime të krijuara për këtë vit janë paguar në vitin pasardhës si në tabelën mëposhtë:

Tabela nr. II.1.13: Detyrimi i prapambetur për vitin 2020, paguar në vitin 2021 Në lekë

Nr.	Objekti Prokurimit	Subjekti Kreditor	Dt. kontratës ^e	Data e FT	Nr. serial FT	Shtesat viti 2020	Shlyerje	Detyrimet 31.12.2020
1	Shërbime të Sigurimit dhe Ruajtjes	I. G.	08.05.2020	30.09.2020	91283956	947,675		947,675
2	Shërbime të Sigurimit dhe Ruajtjes	I. G.	08.05.2020	30.10.2020	91283806	947,675		947,675
3	Shërbime të Sigurimit dhe Ruajtjes	I.G.	08.05.2020	30.11.2020	94219836	947,675		947,675
4	Shërbime të Sigurimit dhe Ruajtjes	I.G.	08.05.2020	30.12.2020	95871466	947,675		947,675
5	Energji	FSHU		30.08.2020		402,466		402,466
6	Energji	FSHU		30.08.2020		123,025		123,025
Total i detyrimit								4,316,191

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

Për vitin 2021, vlera e detyrimeve të prapambetura është në vlerën **4,738,375 lekë** për pesë fatura për shërbime të sigurimit dhe ruajtjes, të cilat nuk janë paguar as për vitin 2022 si në tabelën mëposhtë:

Tabela nr. II.1.14: Detyrimi i prapambetur për vitin 2021 Në lekë

Nr.	Objekti Prokurimit	Subjekti Kreditor	Dt. kontratës ^e	Data e FT	Nr. serial FT	Shtesat viti 2020	Shlyerje	Detyrimet 31.12.2020
1	Shërbime të Sigurimit dhe Ruajtjes	I.G.	08.05.2020	01.09.2021	1838	947,675		947,675
2	Shërbime të Sigurimit dhe Ruajtjes	I.G.	08.05.2020	30.09.2021	2009	947,675		947,675
3	Shërbime të Sigurimit dhe Ruajtjes	I. G.	08.05.2020	01.11.2021	2273	947,675		947,675
4	Shërbime të Sigurimit dhe Ruajtjes	I.G.	08.05.2020	01.12.2021	2664	947,675		947,675
5	Shërbime të Sigurimit dhe Ruajtjes	I. G.	08.05.2020	31.12.2021	2970	947,675		947,675
Totali i detyrimit								4,738,375

Burimi: DPPGj Bashkia Tiranë

Nga auditimit rezulton se:

Detyrimet e krijuara dhe të regjistruara në vitin 2021 janë nga mos likuidimi në vlerë totale **4,738,375 lekë**, nga shërbime të sigurimit dhe ruajtjes. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101 “Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim”.

Titulli i gjetjes	Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara të DPPGj, Bashkisë Tiranë mbi detyrimet e prapambetura.
Situata	Detyrimet e krijuara për vitet 2018-2020 janë likuiduar në vitet pasardhëse, ndërkohë që detyrimet e krijuara dhe të regjistruara në

	vitin 2021 rezultojnë të palikuiduara për vlerën totale 4,738,375 lekë, nga shërbime të sigurimit dhe ruajtjes.
Kriteri	Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101 “Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim”.
Ndikimi/Efekti	Mos shlyerja në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve krijon risk për pagesa penaltitësh të panevojshme dhe pasaktësi në vlera dhe mangësi në raportime të detyrimeve të prapambetura.
Shkaku	Moszbatim i kërkesave ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, vlera jo të besueshme për detyrimet e prapambetura.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	DPPGj, Bashkia Tiranë të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.
Afati	Menjeherë

Për sa më lart mban përgjegjësi: zj. A. B., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, Zj. A. R., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe zj. A.N., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit.

2.3. Mbi mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe përlllogaritjen, njohjen, regjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2021;
2. Formati 2- Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2021;
3. Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare për vitin 2021;
4. Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto për vitin 2021;
5. Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2021;
6. Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre për vitin 2021;
7. Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto për vitin 2021;
8. Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave për vitin 2021.

Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018.”

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve

ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezulton se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.

Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- Për vitin 2021 janë dorëzuar Pasqyrat Financiare pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 560 Prot., datë 25.03.2022 “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2021” duke respektuar afatet ligjore.

Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se:

“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

Viti 2021

a. Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në Pasqyrën e Performancës është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2). Konkretisht për vitin 2021 paraqiten si vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 567,848 mijë lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 565,075 mijë lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 2,773 mijë lekë

Totali ii + iii = 567,848 mijë lekë

Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore“ në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

Llogaria 63 “Ndryshimit të gjendjes së inventarit” në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiare Vjetore, (diferenca midis tepicës më 31.12.2020me 31.12.2021, përkatësisht 31,074,668 – 33,847,359) rezulton 2,772,691 lekë, e cila rezulton e barabartë me shumatoren e llogarisë 63 dhe 73 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr.2, “*Performanca financiare e institucionit*”.

Nga analiza e llogarisë 2 “Gjendje Inventari qarkullues” rezulton të jenë regjistruar llogaria 31 “Materiale”, 32 “Inventar i Imët” dhe 33 “Prodhim në proces”.

Llogarit vjetore për vitin 2021, pasqyrohen në tabelën nr.1, aneksi V.1.

Në tabelën nr.1., përfshihen të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2021, në vlerën 134,760,426 lekë, analizuar si më poshtë:

- Në llogarinë 7115 “Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime” paraqitet në shumën 261,898 lekë, e cila përfaqëson shtesë page për punë në turnin e dytë dhe të tretë, për të cilën janë paguar punonjës të administratës, sipas rekomandimit të lënë në Raportin e Auditit të Brendshëm, Bashkia Tiranë me nr. 12159/5 datë 12.05.2022, ku citohet se:

“...punonjësve të administratës në pozicionet Drejtor, Përgjegjës Sektori, Specialist i parë dhe i dytë, u janë paguar padrejtësisht orë pune turn i dytë dhe i tretë në terren.”

Në llogarinë 72 “Grantekorrente” në vlerën 567,847,653lekë, paraqet financim shtese për të ardhurat e krijuara brenda sistemit (7205) për DPPGJ në vlerën 536,713,704lekë, Financimi i pritsëm nga buxheti (7206) në vlerën 31,540,168 lekë.

- Llogaria 73 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve” paraqitet në shumën 668,117 lekë, si ndryshimi i gjendjes të prodhimit në proces.

*****Në tabelën nr.2 aneksi V.1,** përfshihen shpenzimet e konstatuara gjatë vitit 2021, në vlerën 565,074,962lekë, analizuar si më poshtë:

- Llogaria 600 “Paga e shpenzime personeli” në shumën prej 309,864,522 lekë, përfaqëson pagat e personelit të përhershëm në vlerën 300,167,117 lekë, si dhe shpërblimet ndaj punonjësve për vitin 2021 në vlerën 9,697,405 lekë.

- Llogaria 601 “Kontribute të Sigurimeve Shoqërore” në shumën prej 49,842,938 lekë, përfaqëson shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi.

- Llogaria 6020 “Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme” në shumën prej 9,329,407 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni ka kryer për blerje kancelari, shtypshkrimi dhe materiale pastrimi gjatë vitit 2021.

- Llogaria 6021 “Materiale dhe shërbime special” në shumën prej 26,767,254 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni ka kryer për blerje uniforma dhe veshje të tjera speciale në shumën 6,843,600 lekë dhe blerje plehrash kimike, furnitura veterinare, farëra, fidanë e tjera produkte në shumën 19,923,654 lekë.

- Llogaria 6022 “Shërbime nga të tretët” në shumën prej 39,591,919 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni i ka realizuar për shërbime nga të tretët për energji elektrike në vlerën 2,000,000 lekë, ujë në vlerën 1,930,495lekë, postë në vlerën 31,290 lekë, shpenzime shërbimi të sigurimi dhe ruajtjes në vlerën 11,372,107 lekë dhe shërbime të tjera në vlerën 23,835,840 lekë.

- Llogaria 6023 “Shpenzime transporti” në shumën prej 80,729,968 lekë përfaqësojnë shpenzime për blerje karburant në vlerë 65,876,968 lekë, shpenzime për pjesë këmbimi në vlerën 12,903,600 lekë, si dhe shpenzime sigurim i automjeteve në vlerën 1,949,400 lekë.

- Llogaria 6025 “Shpenzime për mirëmbajtje” në shumën prej 11,476,800lekë përfaqësojnë shpenzimet për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave në vlerën 1,648,800 lekë dhe shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit në vlerën 9,828,000 lekë.

- Llogaria 6027 “Shpenzime për detyrime për kompensime legale” në shumën prej 2,901,656 lekë përfaqësojnë shpenzimet për detyrimet gjyqësore përkatësisht për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimin nga puna në vlerën 2,901,656 lekë.

- Llogaria 6029 “Shpenzime të tjera Operative” në shumën prej 36,620,000lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kritereve të klasifikimit buxhetor si mirëmbajtje mjetesh motorike, mirëmbajtje pemësh dhe mirëmbajtje kosha stola dekorativë të cilat paraqiten në shumën 36,620,000 lekë.

- Llogaria 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” në shumën prej 1,129,408 lekë përfaqëson shpenzime për pensione dhe shpenzime te tjera familjare.

Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruara drejtënë shumën prej 3,440,808 lekë.

Analiza e posteve kryesore te bilancit:

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të pasqyrës së pozicionit financiar rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas pasqyrës së pozicionit financair vjetore rezulton se:

- “Aktivet afatgjata” zënë 94% të vlerës totale të aktivit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 6% të totalit.

Aktivet qarkulluese

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

Në tabelën nr.3 aneksi V.1, përfshihen aktivet afatshkurtra të vitit 2021, analizuar si më poshtë: Klasa 3 “Gjendja e inventarit”, në fund të vitit 2021, rezulton në vlerën 33,847,359 lekë. Në krahasim me vitin 2020 është rritur në vlerën 2,772,691lekë, nga rritja e zërit “Materiale” në vlerën prej 4,642,026 lekë, nga ulja në zërin “Inventar i imët” në vlerën prej 1,201,218 lekë, në të cilën janë kontabilizuar mallra kryesisht kancelari, si dhe ulje në zërin “Prodhim në Proces” e cila përfaqëson shumën e prodhimit në proces për pemë eplantacionenë vlerën 668,117 lekë. Diferenca 2,772,691 lekë përkon me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe llogarinë 73 “Ndryshimi i gjendjes se inventarit te produkteve”.

Llogari të arkëtueshme:

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” paraqitet në vlerën 31,525,808 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka DPPGJ ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2021, përkatësisht për pagat në vlerën 19,331,024lekë, për tatim taksa në vlerën 1,064,565 lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 5,623,495 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 782,709lekë, të cilat paguhën në Janar të vitit 2022. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 421, 431, 435 436 dhe 467. Llogaria 4342 përfaqëson burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor) që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës. Në këtë llogari nga DPPGJ është mbajtur dhe shuma prej 4,724,015 lekë e trashëguar nga viti 2015, për të cilat institucioni nuk disponon asnjë dokumentacion shoqërues justifikues.

Titulli i gjetjes:	Mospasqyrim i saktë i llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” duke trashëguar debitorë të krijuar ndër vite.
Situata:	Nga auditimi i llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” u konstatua debitimi i shumës prej 4,724,015 lekë, e cila ka të bëjë me debitorë të trashëguar në vite. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara

	(grantetkorrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit), nga ku debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe kreditohet llogaria 7206 ”Financim i pritshëm nga buxheti”. Shuma prej 4,724,015 lekë e debituar në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është veprim në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018“Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” duke kërkuar financim të pritshëm nga shteti me tepër për këtë shumë, vlerë e cila është e paidentifikuar dhe s’ka të bëjë me shpenzime të konstatuar të vitit ushtrimor.
Kriteri:	Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018“Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”
Ndikimi/Efekti:	Nuk është vlerë që ka të bëjë me shpenzime të konstatuar të vitit ushtrimor.
Shkaku:	Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtorja e Financës dhe Buxhetit së DPPGJ-së të marrë masa për sistemimin e shumës 4,724,015 lekë, duke bërë veprimin kontabël kreditimin e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe debitimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.
Afati	Menjeherë

Për sa më sipër, mban përgjegjësi znj. A. N., në cilësinë e Drejtorit të Financës dhe Buxhetit.

Detyrimet e prapambetura

- Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” në vlerën 20,496,402 lekë përbëhet nga detyrime të lëna ndër vite, e cila nuk ka ndryshuar ndër vite. Lista e debitorëve pasqyrohet në tabelën nr.4, aneksi V.1.

Nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, ka rezultuar po e njëjta shumë debitorësh në vlerën 20,496,402lekë, për të cilën Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit ka mbajtur korrespondencën e mëposhtme:

Me shkresën nr.1707 Prot.,datë 10.05.2018, me lëndë “Relacion për debitorët”, Përgjegjësi i Sektorit të Financës ka dërguar një relacion shpjegues në lidhje me debitorët, për të cilët nuk ka asnjë dokumentacion justifikues dhe i ka të trashëguar ndër vite.

Nisur nga auditimi i kryer nga KLSH, me shkresën nr.1707/1 Prot.,datë 10.05.2018, me lëndë “Kërkesë”, Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ-së i ka dërguar Kryetarit të Bashkisë Tiranë relacionin në lidhje me debitorët, si dhe ka kërkuar udhëzim për mënyrën e procedimit për heqjen e kësaj shume nga pasqyrat financiare.

Me shkresën nr.1045 Prot.,datë 27.02.2020, Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ-së i ka ridërguar Kryetarit të Bashkisë Tiranë relacionin në lidhje me debitorët, si dhe ka kërkuar udhëzim për mënyrën e procedimit për heqjen e kësaj shume nga pasqyrat financiare.

Me shkresën nr.2258 Prot.,datë 22.09.2021, Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ-së i ka ridërguar Kryetarit të Bashkisë Tiranë relacionin në lidhje me debitorët, si dhe ka kërkuar udhëzim për mënyrën e procedimit për heqjen e kësaj shume nga pasqyrat financiare.

Dhe pse institucioni i DPPGJ-së ka debitorë të krijuar para 15 vitesh, për të cilët nuk ka mundësi arkëtimi në shumën prej 20,496,402lekë, kjo shumë vazhdon të jetë në pasqyrat financiare, për të cilat është lënë rekomandim në auditimin e mëparshëm nga KLSH.

-Llogaria 486“Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në vlerën 4,738,375 lekë. Kjo llogari përfaqëson detyrimete prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve, të cilat ndahen

sipas natyrës së tyre. Shuma prej 4,738,375 lekë përfaqëson detyrimin që institucioni i DPPGJ-së ka ndaj I.G.sha për periudhën Shtator-Dhjetor 2021, për shërbimet e Sigurimit dhe Ruajtjes. Veprimet e mësipërme kanë si kundërparti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se, shuma totale e vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë dhe janë shlyer si vijon:

-Vendime të formës së prerë marrë në vitin 2014 në shumën 913,566 lekë, në vitin 2016 në shumën 268,229 lekë dhe në vitin 2018 në shumën 3,702,911, të cilat janë likuiduar në vitin 2018;

- Vendime të formës së prerë marrë në vitin 2017 në shumën 405,769 lekë, dhe në vitin 2018 në shumën 7,639,947 lekë, të cilat janë likuiduar në vitin 2019;

- Vendime të formës së prerë marrë në vitin 2017 në shumën 405,769 lekë, në vitin 2018 në shumën 1,537,134 lekë, dhe në vitin 2019 në shumën 4,526,208 lekë të cilat janë likuiduar në vitin 2020;

- Vendime të formës së prerë marrë në vitin 2018 në shumën 677,142lekë, në vitin 2019 në shumën 637,609lekë, dhe në vitin 2020 në shumën 1,591,305lekë të cilat janë likuiduar në vitin 2021.

Këto vendime gjyqësore nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer.

1. Si pasojë, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të viteve 2018-2021. Në këtë zë nuk janë reflektuar detyrimet sa i takon shpenzimeve të periudhave të ardhshme për vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formën e prerë përpara mbylljes së pasqyrave financiare të vitit ushtrimor.

2. Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

3. Duke ju referuar pagesave të kryera nga DPPGJ për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura

Titulli i gjetjes:	Mosnjohja e vendimeve gjyqësore si shpenzime periudhë në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por në momentin e likuidimit.
Situata:	Sipas pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit më 31.12.2021, gjendja debitorë (klasa 4) paraqitet si më poshtë vijon: - Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” në vlerën 20,496,402 lekë, të cilat vijnë kryesisht nga dëmtime dhe janë krijuar para 15 vitesh. Për këto debitorë, institucioni i DPPGJ-së nuk ka shpresa arkëtimi. E njëjta shumë debitorësh është konstatuar dhe në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH. Nga auditimi mbivendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se, shuma totale e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë: -vendime të formës së prerë marrë në vitin 2014 në shumën 913,566 lekë, në vitin 2016 në shumën 268,229 lekë dhe në vitin 2018 në shumën 3,702,911, të cilat janë likuiduar në vitin 2018;

	<p>- vendime të formës së prerë marrë në vitin 2017 në shumën 405,769 lekë, dhe në vitin 2018 në shumën 7,639,947 lekë, të cilat janë likuiduar në vitin 2019;</p> <p>- vendime të formës së prerë marrë në vitin 2017 në shumën 405,769 lekë, në vitin 2018 në shumën 1,537,134 lekë, dhe në vitin 2019 në shumën 4,526,208 lekë të cilat janë likuiduar në vitin 2020;</p> <p>- vendime të formës së prerë marrë në vitin 2018 në shumën 677,142 lekë, në vitin 2019 në shumën 637,609 lekë, dhe në vitin 2020 në shumën 1,591,305 lekë të cilat janë likuiduar në vitin 2021, <i>nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t'u shlyer.</i></p> <p>Si pasojë llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të vitit 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Konkretisht për vitit 2018-2021, ky zë për vendimet gjyqësore reflektohet me vlerë 0 (zero), ndërkohë që duhet të ishte reflektuar me vlerën e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë mbi 30 ditë, përpara mbylljes së pasqyrave financiare për secilin nga vitet.</p> <p>Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.</p> <p>Duke ju referuar pagesave të kryera nga DPPGJ për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.</p>
Kriteri:	-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.
Ndikimi/Efekti	Mos njohja e detyrimeve në momentin e konstatimit të tyre, po në momentin që likuidohen.
Shkaku	Mungesë bashkëpunimi midis Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit me Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	<p>- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve të marrin masa për pjesën e llogarive debitorë që kalojnë kohën e parashkrimit me qëllim sistemimin e këtyre shumave të cilat qëndrojnë në llogaritë e DPPGJ-së për periudha mbi 15 vjeçare.</p> <p>- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa në vijimësi për të rakorduar me Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve, sa i takon informacionit të plotë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, të cilat duhet të njihen në vlerën e tyre të plotë, si detyrime për tu shlyer në periudhat e ardhshme dhe për të cilat duhet të provigjionohen shumëat përkatëse. Njëkohësisht vlera e tyre duhet njohur edhe si shpenzim periudhe në pasqyrat financiare të institucionit.</p> <p>-Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura.</p>

	-Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve, të marrë masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
Afati:	Menjeherë

Për sa më lart, mban përgjegjësi znj. A. N. në cilësinë Drejtorit të Financës dhe Buxhetit. dhe z.J. P. në cilësinë e Drejtorit Juridik e të Prokurimeve

Aktivitet afatgjatë

Në tabelën nr.5 aneksi V.1, përfshihen “Aktivitet e Afatgjatë” për vitin 2021 në vlerën neto prej 1,318 milionë lekë, të cilat janë të pasqyruara 100% në zërin “Aktive Afatgjatë materiale analizuar si më poshtë:

- Llogaria 211 “Pyje, Plantacione”, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 939,035,490 lekë, e cila paraqet vlerën e pyje kullotave, plantacioneve që disponon DPPGJ-ja. Gjatë vitit, ka patur shtesa në shumën 58,514,742 lekë nga blerjet dhe donacionet e ndryshme. Si dhe pakësime në shumën 8,597,233 lekë, e cila përfaqëson vlerën e pemëve të dëmtuara gjatë vitit.

- Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 19,708,501 lekë, përbërë nga vlera e 19 objekteve në pronësi të DPPGJ-së. Komisioni i Inventarizimit Fizik konstatoi se vetëm 4 objekte janë në përdorim të institucionit.

Pakësime: Në zbatim të VKM nr. 1082, datë 24.10.2020 “Për transferimin në pronësi apo përdorim të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Tiranë, të disa pronave” dhe VKM nr. 953 datë 02.12.2020 “Për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurive me nr. 8/27, 8/700, 8/582, ZK 8270, të pasurive me nr.3/221, 3/219, ZK 8210 dhe të pasurisë me nr. 2/21, 2/32, 2/287, ZK 8150”, DPPGJ ka bërë transferimin, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Tiranë, të pronave me nr.2-8, 10-15, 17-22 dhe 25-29, sipas lidhjes 1 të VKM nr. 1082, datë 24.10.2020 . Prona me nr.2/21, ZK8150, vol 26, faqja 248, indeks harte TR-O-12, e llojit “Truall dhe ndërtesë” me sipërfaqe totale 132 m², përkon me objektin “Godina e punëtorëve në qendër” (me vlerë 45,838 lekë, viti 1981), pjesë e aktiveve të DPPGJ-së.

Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.7502/4, datë 10.06.2021, është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të pasurive dhe me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPPGJ nr. 1666/1 Prot., datë 24.06.2021, është ngritur komisioni për dorëzimin e pasurive.

Me shkresën nr. 1666/2 Prot., datë 30.06.2021, është bërë Akt-dorëzimi dhe marrja në dorëzim e pasurive me nr. 2/21, 2/32, 2/287, ZK 8150, Tiranë.

Me shkresën nr. 2389 Prot., datë 08.10.2021, Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ ka konfirmuar dorëzimin e pronës me nr. 2/21, ZK8150, vol 26, faqja 248, indeks harte TR-O-12, e llojit “Truall dhe ndërtesë” me sipërfaqe totale 132 m², e cila përkon me objektin “Godina e punëtorëve në qendër”. Gjatë vitit 2021, për përlllogaritjen e amortizimit të ndërtesave, Drejtoria e Financës e ka bërë në baze grupi, dhe jo për secilën ndërtesë më vete. (*Sqaruar me hollësisht në pikën e Inventarit Fizik*).

- Llogaria 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 143,014,780 lekë, e cila paraqet vlerën instalimeve të ndryshme, shatërvanëve të ndryshme, puseve të ujit etj. Gjatë vitit ka patur shtesa në shumën 12,535,371 lekë, si rezultat i blerjeve të ndërtimit të një shatërvani si dhe hapjes së dy puseve uji. Grupi i auditimit konstatoi se për këtë llogari, nuk është llogaritur amortizimi i akumuluar, duke mos shfaqur vlerën reale të saj.

- Llogaria 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 63,776,262 lekë, ku janë kontabilizuar ndër vite vlerat e pajisjeve teknike, si dhe

makinerive. Gjatë vitit 2021 ky zë ka pësuar rritje nga blerja e pajisjeve në vlerën 7,875,278 lekë dhe pakësimi në vlerën 1,579,080 lekë, që përfaqëson vlerën e aktiveve të dëmtuara.

- Llogaria 215 “Mjete Transporti”, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 80,243,050 lekë dhe përfaqëson vlerën automjeteve në dispozicion të DPPGJ. Gjatë vitit 2021 ky zë nuk ka patur shtesa.

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në vlerën neto prej 6,458,134 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime shtesa gjatë vitit si rezultat i blerjes së 3 kondicionerëve në vlerën 268,800 lekë.

- Llogaria 24 “Aktive afatgjata te dëmtuara” në shumën 55,964,019 lekë përfaqëson të gjitha aktivet e dëmtuara që DPPGJ ka identifikuar të dëmtuara në komisionet e inventarizimit. Më pas, duhet te ngrihet grupi i vlerësimit të aktiveve, i cili mban procesverbal për aktivet e dëmtuara dhe arsyet e daljes jashtë përdorimi dhe më pas aktivet e dëmtuara kalojnë në llogarinë 24 “Aktive afatgjata te dëmtuara” me vlerën neto për procedurën e mëtejshme që është asgjësimi/tjetërsimi. Shuma prej 55,964,019 lekë është keqklasifikuar në llogarinë 24, pasi secili nga aktivet e dëmtuara duhet të klasifikohet në llogarinë përkatëse te aktiveve, deri në momentin e vlerësimit nga komisioni i vlerësimit të aktiveve. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar.

- Llogaria 28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata” përfaqëson shumën e Caktimeve të AAGJ-ve, e cila është e mbartur ndër vite dhe përfaqëson larjen e fasadës së Universitetit të Tiranës në vitin 2006. Me shkresën nr.2640 Prot., datë 11.11.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, Bashkia Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ ka kërkuar miratimin që kjo vlerë të mos të mbartet vit pas viti në Pasqyrat financiare. Akoma nuk është ndërmarrë asnjë veprim për heqjen e kësaj shume nga pasqyrat financiare.

Titulli i gjetjes:	Mos klasifikimi i aktiveve sipas llogarive të përcaktuar në planin kontabël publik.
Situata:	<p>Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit për vitet 2020 – 2021 u konstatua se, një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto te aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivet, por pa ndikim materiale në rezultatin e pasqyrave financiare.</p> <p>-Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se “Pajisjet dhe instalimi i kondicionerëve” të cilat paraqiten në vlerën 621,600 lekë janë klasifikuar në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”. Kjo vlerë i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”.</p> <p>- Llogaria 213 “Rruga, rrjete, vepra ujore” paraqitet në pasqyra financiare me kosto historike. Vlera e amortizimit të akumuluar nuk është përlllogaritur ndër vite, gjë e cila është trashëguar dhe në pasqyrat financiare të vitit 2021.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36 ku citohet ... “Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit, dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur.”</p>

Kriteri:	VKM-në nr. 25 datë 20.01.2011 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik “ dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109
Ndikimi/Efekti:	Mos evidentimi i saktë i vlerës neto të aktiveve që disponon institucioni, e cila ndikon në mos Planifikimi e saktë të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve që janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimit.
Shkaku:	Trashëguar në vite mënyra e mbajtjes dhe regjistrimit të aktiveve në kontabilitet.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.
Afati	Menjherë

Për sa më lart, mban përgjegjësi znj. A. N., në cilësinë e Drejtorit të Financës dhe Buxhetit.

Regjistri i aktiveve dhe përlllogaritja e amortizimit

Nga auditimi u konstatua se DPPGJ ka një regjistër elektronik për aktivet afatgjata, i cili nuk është përditësuar me vlerën aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi. Vlera e amortizimit të akumuluar të aktiveve nuk është plotësuar për të gjithë vitet radhazi, nëpërmjet të cilës bëhet verifikimi i vlerës së mbetur të aktiveve në dispozicion të institucionit, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes së tyre etj. si një faktor i rëndësishëm për miradministrim dhe mirë menaxhimin e aktiveve në pronësi.

Përlllogaritja e amortizimit të aktiveve, është bërë në bazë grupi, dhe jo për secilin aktiv më vete, duke mos treguar vlerën reale të aktiveve.

Veprimet e mësipërme janë kryer në mospërputhje me Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, respektivisht me: Pikën 26. “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në forme të sintetizuar”;

Pikë 28. “Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital”;

Pikën 30. “Formati i regjistrimit të aktiveve hartohet në varësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbaj regjistri i aktiveve në varësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”

Titulli i gjetjes:	Mos klasifikimi i aktiveve sipas llogarive të përcaktuar në planin kontabël publik
Situata:	Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit për vitin 2021 u konstatua se:

	<p>-DPPGJ ka një regjistër elektronik për aktivet afatgjata, i cili nuk është përditësuar me vlerën aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi. Mungesa e mbajtjes së regjistrit të aktiveve, sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, ku në varësi të llojit të aktivitetit duhet të përmbajë datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim për secilin aktiv, vlerën e amortizimit të akumuluar ndër vite me qëllim verifikimit të vlerës së mbetur të aktiveve në dispozicion të institucionit, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes së tyre etj. si një faktor i rëndësishëm për miradministrim dhe mirëmenaxhimin e aktiveve në pronësi.</p> <p>Si rrjedhojë mungesa e regjistrit ka sjellë që edhe Amortizimi i aktiveve, i cili është përlogaritur bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36; konstatohet se përlogaritja e tij është bërë për aktivet në total dhe jo për secilin aktiv më vete, duke sjellë vështirësi në përcaktimin e vlerave reale të aktiveve (për artikull) që institucioni disponon.</p> <p>- Nga lëvizjet e aktive nga sistemimet, institucioni bën lëvizjen e aseteve nga llogaria përkatëse 21 “Aktive afatgjata” në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” në shumën 55,964,019 lekë përfaqëson të gjitha aktivet e dëmtuara që DPPGJ ka identifikuar të dëmtuara nga komisionet e inventarizimit. Më pas, duhet të ngrihet grupi i vlerësimit të aktiveve, i cili mban procesverbal për aktivet e dëmtuara dhe arsyet e daljes jashtë përdorimi dhe më pas aktivet e dëmtuara kalojnë në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” me vlerën neto për procedurën e mëtejshme që është asgjësimi/tjetërsimi. Shuma prej 55,964,019 lekë është keqklasifikuar në llogarinë 24, pasi secili nga aktivet e dëmtuara duhet të klasifikohet në llogarinë përkatëse të aktiveve, deri në momentin e vlerësimit nga komisioni i vlerësimit të aktiveve. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109. Aktivet kalojnë në llogarinë 24 pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një flete hyrje rikupero.</p>
Kriteri:	<p>Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III.</p> <p>Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”;</p> <p>VKM-në nr. 25 datë 20.01.2011 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik .“</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Mos disponimi i një regjistri të plotë të aktiveve, si dhe mos evidentimi i saktë i gjendjes reale të aktiveve që disponon institucioni</p>

	ndikon në pa mundësinë që institucioni të vlerësojë nëse këto të fundit përdoren në mënyrë efektive, efikase dhe ekonomike për të ofruar shërbimet publike, si dhe ndikon në mos Planifikimin efektiv financiar afatmesëm të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve, qe janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimit.
Shkaku:	Trashëguar në vite mënyra e mbajtjes dhe regjistrimit të aktiveve në kontabilitet.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të merren masa për krijimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. - Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për sistemimin e llogarisë 24 “Aktive Afatgjata të dëmtuara”, duke mbajtur në këtë llogari në vlerën neto, vetëm ato aktive të cilat janë vlerësuar për jashtë përdorimi.
Afati:	Menjeherë

Për sa më lart, mban përgjegjësi znj. A. N., në cilësinë e Drejtorit të Financës dhe Buxhetit.

Inventari fizik

Viti 2018

Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit për vitin 2018, ka ngritur komisionet e inventarizimit për çdo llogari ekonomike me urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm, të cilat paraqiten në tabelën nr.6 aneksi V.1.

Secili nga komisionet e inventarizimit fizik ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit. Më pas është hartuar nga Sektori i Financës dhe Buxhetit me shkresën nr.245 datë 31.01.2019 Inventari përmbledhës për inventarizimin e aseteve të DPN1 për vitin 2018.

Komisioni i inventarizimit të llogarisë ekonomike 214 “Stola, Kosha, Gjeneratorë etj” konstaton një diferencë prej 20,645,078 lekë mes gjendjes fizike dhe të dhënave të regjistruara në kontabilitet, pasqyruar kjo në relacionin mbi inventarizimin e “Stola, Kosha, Gjeneratorë etj” për vitin 2018 me nr. 3518/2, Prot., datë 25.01.2019.

Viti 2019

Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit për vitin 2019, ka ngritur komisionet e inventarizimit për çdo llogari ekonomike me urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm, të cilat paraqiten në tabelën nr.7 aneksi V.1.

Secili nga komisionet e inventarizimit fizik ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit. Më pas është hartuar nga Sektori i Financës dhe Buxhetit me shkresën nr.221 datë 29.01.2020 Inventarin përmbledhës për inventarizimin e aseteve te DPN1 për vitin 2019.

Komisioni i inventarizimit të llogarisë ekonomike 214 “Stola, Kosha, Gjeneratorë etj” konstaton një diferencë prej 20,262,283 lekë mes gjendjes fizike dhe të dhënave të regjistruara

në kontabilitet, pasqyruar kjo në relacionin mbi inventarizimin e “Stola, Kosha, Gjeneratorë etj” për vitin 2019 me nr. 2982/2, Prot., datë 24.1.2020.

Viti 2020

Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit për vitin 2020, ka ngritur komisionet e inventarizimit për çdo llogari ekonomike me urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm, të cilat paraqiten në tabelën nr.8 aneksi V.1.

Secili nga komisionet e inventarizimit fizik ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit. Më pas është hartuar nga Sektori i Financës dhe Buxhetit me shkresën nr. 3038/3 Prot., datë 22.01.2021 inventari përmbledhës për inventarizimin e aseteve të DPPGJ-së për vitin 2020.

Komisioni i inventarizimit të llogarisë ekonomike 214 “Stola, Kosha, Gjeneratorë etj” konstaton një diferencë 35,073,908 lekë mes gjendjes fizike dhe të dhënave të regjistruara në kontabilitet, pasqyruar kjo në relacionin mbi inventarizimin e “Stola, Kosha, Gjeneratorë etj” për vitin 2020 me nr.3031/2, Prot., datë 22.1.2021.

Viti 2021

Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit për vitin 2021, ka ngritur komisionet e inventarizimit për çdo llogari ekonomike me urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm, të cilat paraqiten në tabelën nr.9 aneksi V.1.

Secili nga komisionet e inventarizimit fizik ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit. Më pas është hartuar nga Sektori i Financës dhe Buxhetit me shkresën nr. 2955/3 Prot., datë 25.01.2022 inventari përmbledhës për inventarizimin e aseteve të DPPGJ-së për vitin 2021.

Titulli i gjetjes:	DPPGJ nuk ka ngritur komisionin për vlerësimin e aktiveve për periudhën objekt auditimi.
Situata:	Nga auditimi i dosjes së inventarizimit rezulton se: Titullari i DPPGJ-së nuk ka ngritur komisionin për vlerësimin e aktiveve, edhe pse nga komisioni i inventarizimit janë evidentuar aktive të dëmtuara për llogarinë ekonomike 214 “Stola, Kosha, Gjeneratorë etj”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 96 ...”Procesi i vlerësimit të aktiveve është një proces që kryhet gjatë ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale.”
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.
Ndikimi/Efekti:	Risku i monitorimit të gjendjes reale të aseteve në institucion.
Shkaku:	Mos respektimi i kuadrit ligjor, lidhur me hapat që duhen ndjekur gjatë procesit të kryerjes së inventarizimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Titullari i institucionit të DPPGJ-së të marrë masa në vazhdimësi, që menjëherë pas marrjes së relacionit nga komisioni i inventarizimit, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.
Afati:	Menjherë

Për sa më lart, mban përgjegjësi Znj. A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Znj. A. N., në cilësinë e Drejtorit të Financës dhe Buxhetit.

Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”

Viti 2019

Për vitin 2019, Komisioni i inventarizimit të llogarisë ekonomike 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” konstaton një diferencë prej 6,789,091 lekë mes gjendjes fizike dhe të dhënave të regjistruara në kontabilitet, pasqyruar kjo në relacionin mbi inventarizimin e “Ndërtesa e Konstruksione” për vitin 2019 me nr. 2985/2 Prot., datë 24.01.2020. Në këtë shkresë, Komisioni shprehet se 15 prej objekteve pjesë e inventarit nuk ekzistojnë fizikisht.

Për secilin objekt, Komisioni i inventarizimit ka paraqitur, me anë të shkresës nr. 2985/1 Prot., datë 24.01.2020, procesverbalet e mbajtura për verifikimin në terren, ku, për disa prej tyre, ka edhe foto bashkëlidhur.

Në procesverbalin e mbajtur në terren, datë 06.01.2020, Komisioni i inventarizimit ka konstatuar se Dhoma e Punëtorëve Kombinat (me vlerë 15,930 lekë, viti 1963) ekziston fizikisht duke bashkangjitur dhe fotot përkatëse, ndërsa në relacionin përfundimtar është shprehur se nuk ekziston. *Veprimi i mësipërm është rregulluar në inventarin e vitit 2020.*

Në procesverbalin e mbajtur në terren, datë 13.01.2020, Komisioni i inventarizimit konstaton se 3 objektet: (1) “*Barakat*” (me vlerë kontabël 5,409 lekë, viti 1981), (2) “*Zyrat e kuartallave nr. 4*” (me vlerë kontabël 45,000 lekë, midis Rrugës së Durrësit dhe Rrugës së Kavajës) dhe (3) “*Ofiçina tek VasilShanto*” (me vlerë kontabël 25,811 lekë, viti 1980), **nuk ekzistojnë, pasi janë bërë pallate.**

Përpos konstatimeve të Komisionit të inventarizimit mbi dëmtimin apo mungesën e aktiveve, DPPGJ nuk ka marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve.

Viti 2020

Për vitin 2020, komisioni i inventarizimit të llogarisë ekonomike 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” konstaton një diferencë prej 5,584,596 lekë mes gjendjes fizike dhe të dhënave të regjistruara në kontabilitet, pasqyruar kjo në inventarin përmbledhës për inventarizimin e asetëve të DPN1 për vitin 2020 me nr. 3038/3 Prot., datë 22.01.2021. Në këtë shkresë, Komisioni shprehet se 15 prej objekteve pjesë e inventarit nuk ekzistojnë fizikisht.

Për secilin objekt, Komisioni i inventarizimit ka paraqitur, me anë të shkresës nr. 3033/1 Prot., datë 21.01.2021, procesverbalet e mbajtura për verifikimin në terren, ku, për disa prej tyre, ka edhe foto bashkëlidhur.

Shtesa: Godina e Zyrave të Gjelbërimit, me vlerë kontabël 2,522,295 lekë, i pasqyruar si Aktive Afatgjata Materiale i DPPGJ-së, ka kaluar nën administrimin e Drejtorisë së Tirana Parking, për përdorim për zyra. Kjo lëvizje është mbështetur në pikën 2 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 23.05.2016 “*Për kalimin e disa pronave në administrim të Tirana Parking*”, në të cilën vendoset kalimi i të drejtës së administrimit të objektit nga DPPGJ të Tirana Parking, me qëllim përdorimin për zyra për administratën. Në këtë vendim nuk është e përcaktuar vlera e godinës. NZ i DPPGJ-së e ka hequr aktivin nga pasqyrat financiare pa dokumentacionin vërtetues të marrjes në dorëzim nga ana e Tirana Parking, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, date 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, pika 56, ku citohet se: “*Për të gjitha hyrjet që bëhen pa pagesë, njësitë publike pritëse e aktiviteti i përcjell aktkonfirmimin dërguesit brenda datës 20 të muajit pasardhës. Aktkonfirmimi firmoset nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues i njësisë pritëse*”. Ky veprim është rregulluar në pasqyrat financiare të vitit 2021, duke e pasqyruar përsëri, bazuar në rekomandimin e lënë në Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Tiranë, dërguar me shkresën nr. 12159/5 Prot., datë 12.05.2022.

Pakësime: Sa i përket objektit “*Rrethim me kangjella mure rrethues në Rr. e Durrësit*” (me vlerë kontabël 1,333,730 lekë, viti 2012), Komisioni i inventarizimit të vitit 2019, në relacionin përfundimtar me nr. 221 Prot., datë 29.01.2020, është shprehur se ky objekt ekziston, ndërkohë Komisioni i inventarizimit të vitit 2020, me shkresën nr. 3033/1 Prot., dt. 21.01.2021, pas verifikimit në terren, dokumentuar me procesverbalin e datës 15.01.2021, shprehet se ky objekt nuk ekziston fizikisht.

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit shprehet se nuk ka në dispozicion asnjë dokumentacion në lidhje me mungesën e këtij aktivi.

Përpos konstatimeve të Komisionit të inventarizimit mbi dëmtimin apo mungesën e aktiveve, DPPGJ nuk ka marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve.

Viti 2021

Për vitin 2021, Komisioni i inventarizimit të llogarisë ekonomike 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” konstaton një diferencë prej 5,584,596 lekë mes gjendjes fizike dhe të dhënave të regjistruara në kontabilitet, pasqyruar kjo në inventarin përmbledhës për inventarizimin e aseteve të DPPGJ-së për vitin 2021 me nr. 2948/2 Prot., dt. 22.01.2022. Në këtë shkresë, Komisioni shprehet se 15 prej objekteve pjesë e inventarit nuk ekzistojnë fizikisht.

Me shkresën nr. 2948/1 Prot., datë 11.01.2022, Komisioni i inventarizimit ka mbajtur procesverbalin e inventarizimit fizik sipas kartelave për gjendjen faktike llogarinë 212.

Pakësime: Në zbatim të VKM nr. 1082, datë 24.10.2020 “*Për transferimin në pronësi apo përdorim të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Tiranë, të disa pronave*” dhe VKM nr. 953 datë 02.12.2020 “*Për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurive me nr. 8/27, 8/700, 8/582, ZK 8270, të pasurive me nr.3/221, 3/219, ZK 8210 dhe të pasurisë me nr. 2/21, 2/32, 2/287, ZK 8150*”, DPPGJ ka bërë transferimin, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Tiranë, të pronave me nr.2-8, 10-15, 17-22 dhe 25-29, sipas lidhjes 1 të VKM nr. 1082, datë 24.10.2020 . Prona me nr. 2/21, ZK8150, vol 26, faqja 248, indeks harte TR-O-12, e llojit “*Truall dhe ndërtesë*” me sipërfaqe totale 132 m², përkon me objektin “*Godina e punëtorëve në qendër*” (me vlerë 45,838 lekë, viti 1981), pjesë e aktiveve të DPPGJ-së.

Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.7502/4, datë 10.06.2021, është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të pasurive dhe me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPPGJ nr, 1666/1 Prot., datë 24.06.2021, është ngritur komisioni për dorëzimin e pasurive.

Me shkresën nr. 1666/2 Prot., datë 30.06.2021, është bërë Akt-dorëzimi dhe marrja në dorëzim e pasurive me nr. 2/21, 2/32, 2/287, ZK 8150, Tiranë.

Me shkresën nr. 2389 Prot., datë 08.10.2021, Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ ka konfirmuar dorëzimin e pronës me nr. 2/21, ZK8150, vol 26, faqja 248, indeks harte TR-O-12, e llojit “*Truall dhe ndërtesë*” me sipërfaqe totale 132 m², e cila përkon me objektin “*Godina e punëtorëve në qendër*”. Nga analiza e zërave të aktiveve konstatohet se në aktivet afatgjata të institucionit nuk ka të pasqyruar vlerën kontabël për zërin truall, e cila ndër vite është në vlerën zero.

Sa më sipër nga institucioni nuk është marrë asnjë masë për vlerësimin dhe regjistrimin e vlerës së “*truallit*” që ka në pronësi institucioni, veprime në kundërshtim me VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “*Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë*”, (*Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 973*), ku për secilin truall duhet të ishin kryer përlllogaritjet dhe evidentimet e vlerës së truallit në kontabilitetin e njësisë shpenzuese.

Sa i takon certifikatave për vërtetimin e pronësisë së aktiveve të DPPGJ, Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve nuk disponon dokumentacionin përkatës, me pretendimin se i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i aseteve të institucionit të DPPGJ menaxhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Aseteve dhe Licencimit pranë Bashkisë Tiranë.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*”, i ndryshuar, përkatësisht:

Pika 95. “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi është një proces që kryhet gjate ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale”;

Pika 101. “Për vlerësimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve afatgjata me rendësi të veçantë për institucionin, komisioni i vlerësimit dhe komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhen nga jo më pak se 7 anëtarë dhe në përbërjen e tyre marrin pjesë detyrimisht dy specialistë të lartë të fushës. Kur këto specialistë të lartë nuk mund të sigurohen nga strukturat përkatëse, aktivizohen specialistë të jashtëm sipas procedurave ligjore”;

Pika 118. “Nxjerrja nga përdorimi e ndërtesave ekonomike dhe administrative, aktiveve financiare në formën e pjesëmarrjes në kapital, aktiveve afatgjata jomateriale si koncesione, patenta, licenca; rezervat shtetërore; terrenet dhe aktivet natyrore bëhet sipas dispozitave të veçanta ligjore në fuqi”.

***** Me shkresën nr.2850 Prot., datë 10.12.2021**, me lëndë “Kërkesë për informacion”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Aseteve dhe Licencimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ-së ka kërkuar informacion në lidhje me objektet e pasqyruara në inventarin e llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione”, ku nga 20 objekte të pasqyruara në Pasqyrat Financiare, ekzistojnë vetëm 5 objekte fizikisht.

Me shkresën nr.49750/1 prot, datë 29.12.2021, me lëndë “Kthim Përgjigje”, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme e Aseteve dhe Licencimit shprehet se Sektori i Inventarizimit dhe Regjistrimit pranë Drejtorisë së Pasurive të Paluajtshme, *nuk ka kompetencë* për të mundësuar mbështetjen e kërkuar në lidhje me kërkesën e mësipërme.

Me shkresën nr.1725/1 Prot, datë 25.01.2022, me lëndë “Kthim Përgjigje”, për dijeni të Drejtorisë së Përgjithshme të Aseteve dhe Licencimit dhe Këshillit Bashkiak, Drejtori i Përgjithshëm i Menaxhimit Financiar udhëzon që DPPGJ të kërkojë konfirmimin e Kryetarit të Bashkisë me argumentimin përkatës dhe dokumentacionin bashkëlidhur sa i takon objekteve në llogarinë 212. Më pas, në rast se kërkesa e DPPGJ-së do të pranohet, DPPGJ duhet t’i drejtohet për miratim Këshillit Bashkiak Tiranë nëpërmjet një relacioni dhe një draft projektvendimi, për heqjen e asetëve që nuk ekzistojnë nga kontabiliteti i DPPGJ-së. Gjithashtu, sugjeron marrjen e një opinionit dhe nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm, Bashkia Tiranë.

Me shkresën nr. 354 Prot., datë 22.02.2022, Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ-së, i është drejtuar Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, për dijeni të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ku ka përshkruar të gjithë korrespondencën e mësipërme, duke kërkuar suportin për të vijuar me sistemimin dhe heqjen e objekteve që nuk ekzistojnë dhe nuk janë më në përdorim të DPPGJ-së sipas inventarizimit vjetor periodik të realizuara nga komisionet përkatëse.

Titulli i gjetjes:	Mos pasqyrimi i saktë në kontabilitet e institucionit “Toka, Troje, Terrene” dhe “Ndërtesa dhe Konstruksiione”
Situata:	Nga auditimi i zërave të Aktiveve Afatgjata Materiale u konstatua se: - Për periudhën 2018-2021, në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksiione” janë evidentuar nga komisioni i inventarizimit ndërtesa të cilat nuk ekzistojnë. Në vitin 2019, për secilin objekt, komisioni i inventarizimit ka paraqitur, me anë të shkresës nr. 2985/1 Prot., datë 24.01.2020, procesverbalet e mbajtura për verifikimin në terren, ku, në procesverbalin e mbajtur në terren, datë 13.01.2020, Komisioni i inventarizimit konstaton se 3 objektet: (1) “ <i>Barakat</i> ” (me vlerë kontabël 5,409 lekë, viti 1981), (2)

“Zyrat e kuartallave nr. 4” (me vlerë kontabël 45,000 lekë, midis Rrugës së Durrësit dhe Rrugës së Kavajës) dhe (3) “Ofiçina tek VasilShanto” (me vlerë kontabël 25,811 lekë, viti 1980), **nuk ekzistojnë, pasi janë bërë pallate.**

Komisioni i inventarizimit të vitit 2019, në relacionin përfundimtar me nr. 221 Prot., datë 29.01.2020, është shprehur se komisioni i inventarizimit objekti “Rrethim me kangjella mure rrethues në Rr. e Durrësit” (me vlerë kontabël 1,333,730 lekë, viti 2012), objekt ekziston, ndërkohë Komisioni i inventarizimit të vitit 2020, me shkresën nr. 3033/1 Prot., dt. 21.01.2021, pas verifikimit në terren, dokumentuar me procesverbalin e datës 15.01.2021, shprehet se ky objekt nuk ekziston fizikisht.


Drejtorja e Financës dhe Buxhetit shprehet se nuk ka në dispozicion asnjë dokumentacion në lidhje me mungesën e këtij aktivi.

Për vitin 2021, komisioni i inventarizimit të llogarisë ekonomike 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione” konstaton një diferencë prej 5,584,596 lekë mes gjendjes fizike dhe të dhënave të regjistruara në kontabilitet, pasqyruar kjo në inventarin përmbledhës për inventarizimin e asetëve të DPPGJ-së për vitin 2021 me nr. 2948/2 Prot., dt. 22.01.2022. Në këtë shkresë, Komisioni shprehet se 15 prej objekteve pjesë e inventarit nuk ekzistojnë fizikisht.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 95, 101, 118.

- Sipërfaqet e tokave dhe trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre për subjektin e audituar në vitin 2021, nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vlerën 0 lekë.

Nga Institucioni nuk disponohet dokumentacion dhe planimetri (genplan) për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve, që ka në dispozicion për periudhën objekt auditimit, me pretendimin se i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i asetëve të institucionit të DPPGJ menaxhohet nga Drejtorja e Përgjithshme e Aseteve dhe Licencimit pranë Bashkisë Tiranë. Në referim të çmimit për m² sipas zonave kadastrale, sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 973), për secilin truall duhet të ishin kryer përlllogaritjet dhe evidentimet e vlerës së truallit në kontabilitetin e njësisë shpenzuese, nga zero lekë e pasqyruar në bilancin e periudhës që auditohet.



Nga auditimi rezulton se: Nuk ka gjetur zbatim pika 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)”, paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se:

“62. Aktivet paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata..

Rubrika e II-të e aktiveve, që përfshin aktivet afatgjata, përbëhet nga shuma e nen rubrikave që përfaqësojnë:

Kriteri:

- VKM nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”; Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 3.3, paragrafi 62, dhe paragrafi 91, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar

Ndikimi/Efekti:

-Mungesa e titullit të pronësisë është pengesë për kryerjen e transaksioneve të ndryshme me pasuritë e paluajtshme, për menaxhimin e risqeve dhe mbrojtjen ndaj tyre dhe kjo bën që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë.
-Risku i monitorimit të gjendjes reale të aseteve në institucion.

Shkaku:

Dobësitë e sistemit të kontrollit të brendshëm

Rëndësia:

E lartë

Rekomandimi:

- DPPGJ në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të marrin masa për të ngritur një grup pune me ekspertë të fushës me qëllim identifikimin e planimetricave dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit.
- DPPGJ në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të marrin masa për të ngritur një grup pune me qëllim identifikimin dhe rivlerësimin e stokut të ndërtesave gjendje nën administrimin e DPPGJ-së. Pas vlerësimit të dalë nga komisionet, të merren masa të menjëhershme, për kryerjen e

	procedurave ligjore për regjistrimin e aktiveve të pa pasqyruara në kontabilitet, si dhe pasqyrimin e tyre në vlera reale referuar tregut.
Afati:	Menjeherë

Për sa më lart, mban përgjegjësi Znj. A. B. në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.185/53, datë 14.04.2023 nga znj A. B., të cilat paraqiten si vijon:

Pretendimi i Subjektit:

- Për vlerën 4,724,015 lekë e cila është trashëguar që nga viti 2015, ku me VKB nr. 41 dt. 23.09.2015 “Për miratimin e Strukturës së re të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë; dhe krijimit të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit” vlerë kjo e trashëguar pas kësaj ndarje te drejtorive. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka sistemuar llogarinë 4342 “Operacione me shtetin të drejta” për pasqyrat financiare të vitit 2022;
- Sa i takon kontabilizimit të detyrimeve gjyqësore janë marrë masat për kontabilizimin e tyre përgjatë vitit 2022 dhe shlyerjen e tyre në vitin pasardhës duke detajuar saktësisht shumën për këto detyrime gjyqësore në zbatim të Ligjit 9936 date 26/06/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" Për shlyerjen e këtyre detyrimeve është ndjekur gjithmonë parimi FIFO sipas radhës së kërkesave të paraqitura nga përmbaruesit gjyqësor;
- Ngritja e komisionit për vlerësimin e aktiveve është kompetencë e Bashkisë Tiranë, e cila menaxhon te gjitha asetet në pronësi te saj. Dokumentacioni përkatës i tyre menaxhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Aseteve dhe Licencimit". Procedura e vlerësimit të aktiveve pritet të iniciohet nga Bashkia Tirane si Institucion Epror dhe të vijohet me bashkëpunimin e të dy institucioneve për përfundimin e saj;
- Referuar vlerës së llogarive përkatëse të “Tokë, Truall, Terrene” janë mbajtur dhe trashëguar ndër vite në vlerën zero. Pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit nuk janë paraqitur asnjëherë dokumentacionet përkatëse për regjistrimin e vlerës së truallit, gjë e cila pengon procesin e përlllogaritjes së vlerës së truallit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

- Sistemimi i llogarisë 4342 “ Operacione me shtetin të drejta” është kryer pas evidentimit të keqklasifikimit nga grupi i auditimit;
- Sa i takon kontabilizimit të shpenzimeve gjyqësore, është konstatuar se deri më 31.12.2021, vendimet gjyqësore nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer si dhe nuk janë njohur në momentin marrjes së vendimit të formës së prerë. Gjithashtu, këto detyrime nuk janë shlyer në bazë të parimit FIFO, duke respektuar radhën e marrjes së vendimit me shlyerjen;
- Sa i takon ngritjes së komisionit të vlerësimit, ngritja e komisionit të vlerësimit të aktiveve të kryhet në bashkëpunim me institucionin e Bashkisë Tiranë, prandaj observacioni për këtë pike nuk do të merret në konsideratë dhe do të pasqyrohet në materialin e auditimit, pasi objeksionet e mësipërme nuk janë mbështetur në evidence dokumentare shtesë.

2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Për periudhën objekt auditimit 2018-2021, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrim Gjelberimit, Bashkia Tirane, ka realizuar procedurat si më poshtë:

Për vitin 2018 në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit (ish Drejtoria e Përgjithshme nr.1 e Punëtorëve të Qytetit) janë realizuar 21 procedura, me vlerë totale **147,580,413.20 lekë pa TVSH.**

Ndër të cilat, Procedura të hapura/Marrëveshje kuadër – Vlera e Kontratave pa TVSH 123,483,230.60 lekë (7 procedura); Kërkesë për propozime / Marrëveshje kuadër - Vlera e Kontratave pa TVSH 20,694,882.60 lekë (5 procedura); Blerje me vlerë të vogël - Vlera e

Kontratave pa TVSH 3,117,800.00 lekë (6 procedura); Blerje me vlerë nën 100 000 lekë - Vlera e Kontratave pa TVSH 284,500.00 lekë (3 procedura);

Për vitin 2019 në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit (ose Drejtoria e Përgjithshme nr.1 e Punëtorëve të Qytetit) janë realizuar 21 procedura, me vlerë totale **204,786,908.14 lekë pa TVSH.**

Ndër të cilat, Procedura të hapura / Marrëveshje kuadër – Vlera e Kontratave pa TVSH 170,086,057.14 lekë (9 procedura); Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës-Vlera e Kontratës pa TVSH 1,579,459.00 lekë (1 procedurë); Kërkesë për propozime - Vlera e Kontratave pa TVSH 30,509,392.00 lekë (7 procedura); Blerje me vlerë të vogël - Vlera e Kontratave pa TVSH 2,612,000.00 lekë (4 procedura);

Për vitin 2020 në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit janë realizuar 28 procedura, me vlerë totale **372,671,335.46 lekë pa TVSH.**

Ndër të cilat, Procedura të hapura / Marrëveshje kuadër – Vlera e Kontratave pa TVSH 326,281,572.06 lekë (9 procedura); Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës-Vlera e Kontratës pa TVSH 4,995,000.00 lekë (1 procedurë); Kërkesë për propozime - Vlera e Kontratave pa TVSH 37,713,850.00 lekë (8 procedura); Blerje me vlerë të vogël - Vlera e Kontratave pa TVSH 3,368,413.40 lekë (6 procedura); Blerje me vlerë nën 100 000 lekë - Vlera e Kontratave pa TVSH 312,500.00 lekë

Për vitin 2021 në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit janë realizuar 26 procedura, me vlerë totale **182,925,991 lekë pa TVSH.**

Ndër të cilat, Procedura të hapura / e hapur e thjeshtuar – Vlera e Kontratave pa TVSH 72,143,578.00 lekë (8 procedura); Minikontrata - Vlera e Kontratës pa TVSH 91,890,045.00 lekë (4 procedura); Kërkesë për propozime - Vlera e Kontratave pa TVSH 16,574,940.00 lekë (4 procedura); Blerje me vlerë të vogël - Vlera e Kontratave pa TVSH 1,829,528.00 lekë (5 procedura); Blerje me vlerë nën 100 000 lekë - Vlera e Kontratave pa TVSH 487,900.00 lekë (5 procedura)

2.4.1. Procedura e Prokurimit me objekt “Blerje Mjete Transporti dhe Agregat”

1.Urdhri i Prokurimit Nr. 113/4 Prot. datë 04.02.2020	3.Hartuesit DST U.P. Nr. 113/4 Prot. datë 04.02.2020 1. J.P. 2. E.Xh.zëvendësuar me A. H. 3. M.Xh.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 113/5 Prot. datë 04.02.2020 1. V. L. 2. I.M. 3. E. Xh.
2.Lloji i Procedurës Procedurë e Hapur		
5.Fondi Limit 12,500,000 leke (pa TVSh)	6.Oferta fituese 11,000,000 (pa TVSh)	7.Diferenca me fondin limit 1,500,000 (pa TVSh)
8. Data e hapjes së tenderit 28.02.2020 ora 11:00	9.Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Tiranë	10.Operatorët Ekonomike <i>a)Pjesëmarrës në tender.</i> 1.G. –A sh.p.k 2.L. B. sh.p.k 3.P. I. sh.p.k <i>b)S’kualifikuar</i> 1.L. B. sh.p.k 2.P.I. sh.p.k <i>c) Kualifikuar</i> 1.G. –A sh.p.k
11.Ankimime për AK/KPP 1. Nr. 330 Prot. datë 10.02.2020 (A. -02 sh.p.k). 2. Nr. 350 Prot. datë 11.02.2020 (L.B..p.k) 3.Nr. 350/1 Prot. datë 11.02.2020 (L.B..p.k)	12. Përgjigje Ankesës nga AK 1. Nr 330/3 prot. datë 12.02.2020 (kthim përgjigje nga KSHA për OE A.sh.p.k). 2. Nr. 350/2 prot. datë 13.02.2020 (kthim përgjigje nga KSHA për OE L. B.p.k).	13.Përgjigje Ankesës nga KKP Vendim Nr. 217/1 Prot. datë 26.02.2020 (protokolluar pranë DPPGJ ME Nr. 1064 Prot. datë 02.03.2020) Vendim Nr. 115/1 Prot datë 19.03.2020 protokolluar pranë DPPGJ ME Nr. 1167 Prot. datë 24.03.2020.

4.Nr. 113/7 Prot. datë 25.02.2020 L.B. sh.p.k (KPP) 1.Nr. 1216 Prot. datë 06.04.2020 (L.B.sh.p.k)	3. Nr. 1216/1 prot. datë 27.04.2020 (kthim përgjigje për OE L. B.sh.p.k).	
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 1715/3 prot. Datë 15.07.2020	15.Vlera e kontratës 13,200,000 leke (me tvsh)	

Titullari i institucionit ka miratuar kërkesën e Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit me shkresën nr.113/1 Prot. datë 17.01.2020 për blerjen e 2 (dy) kamionçina vetëshkarkuese (mbrapa, majtas, djathtas) dhe një Auto kullë (platformë pune).

Hartimi i Fondit limit

Komisioni i ngritur për llogaritjen e FL, ka marrë oferta nga subjektet S.Co, P. I. dhe G.A shpk. Mbi bazën e ofertave të marra më datë 17.01.2020., komisioni i ngarkuar për përllogaritjen e F.L. ka përcaktuar fondin limit në shumën **12,500,000 lekë pa TVSH.**

Kërkesa për blerjen e automjeteve të paraqitura nga komisioni i përllogaritjes së Fondit Limit, nuk ishte shoqëruar me specifikimet teknike për këto mjete.

Për pasojë, mungesa e specifikimeve teknike në kërkesën drejtuar subjekteve private për dhënien e ofertës për këto mjete, ka patur ndikim në vlerën e përllogaritjes së fondit limit, duke sjell për pasoj që ofertat e marra nga subjektet private të mos i përgjigjeshin kërkesave të AK.

Hartimi i specifikimeve teknike

Ngritja e komisionit të përgatitjes së specifikimeve teknike është bërë me shkresën nr. 113/2 Prot, datë 17.01.2020., dhe përbehej nga G.R., R.O. dhe E.V.

Specifikimet teknike janë përcaktuar nëpërmjet shkresës 113/3 Prot. datë 04.02.2020.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

NjP ka hartuar dokumentet e tenderit (DST) më datë 04.02.2020.

Në datën 05.02.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-49029-02-04-2020, me objekt “Blerje mjete transporti dhe agregat”, me fond limit 12,500,000 lekë pa tvsh.

Në datën 11.02.2020 operatori ekonomik “L. B.” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit për kriteret e mëposhtme:

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar Ing Mekanik staf teknik, të përfshirë në licencën e shoqërisë i pajisur me dëshmiaftësi profesionale lëshuar nga Ministria Transportit dhe të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë për periudhën Gusht 2019-Janar 2020 për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës, diploma si dhe listë pagesat e shoqërisë, ku të figurojë i regjistruar inxhinieri i sipërpërmendur.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht, 1(një) Automaknist, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën Gusht 2019-Janar 2020.

- Operatori ekonomik duhet të ketë marrëveshje ose kontrate me shitësin ose distributorin e Autorizuar të shoqëruar me specifikime teknike të mjeteve dhe Foto, në rast se kontrata ose marrëveshja është me shitës ose distributore të huaj duhet të jete e përkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe. Automjetet duhet të jene të prodhuara në Komunitetin European.

- Operatori Ekonomik duhet të disponoj ose të paraqesë kontratë bashkëpunimi me servis të specializuar për riparimin e mjeteve të transportit brenda afatit të garancisë. Për të vërtetuar

këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë edhe foto të ambienteve të brendshme të reparteve të punës.

Shqyrtimi i ankesave

Titullari i institucionit të DPPGJ, ka ngritur komisionin e shqyrtimit të ankesave me shkresën nr. 330/2 Prot. datë 10.02.2020 të përbërë nga E.L., S. J., A.L.

Me shkresën nr.350/2 Prot datë 13.02.2020, Autoriteti Kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, ku ka vendosur mos pranimin e ankesës.

Nga auditimi rezulton se:

1. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se:

Autoriteti Kontraktor DPPGJ, më datë 28.02.2020 ka vijuar me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit objekt ankimimi, konkretisht me hapjen dhe vlerësimin e ofertave.

Megjithëse nuk ishin ezauruar afatet kohore të ankimimit të operatorit ekonomik "L. B." shpk.

Njësia e prokurimit më datë 28.02.2020 ora 11:00 ka hyrë në SPE, nga ku ka rezultuar që kishte vetëm 1 (një) OE pjesëmarrës, OE G.-A me ofertën ekonomike 12,425,000 pa TVSH.

KVO nëpërmjet PV të datës 28.02.2020 ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE Gerard A me ofertë **12,450,000 lekë pa TVSH.**

2. Në datën 24.02.2020 OE "L.B." shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) me të njëjtin objekt ankese drejtuar Autoritetit Kontraktor DPPGJ.

Për sa më lart, rezulton se në datën 28.02.2020., AK ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "Hapjen dhe Vlerësimin e Ofertave" në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik lidhur me respektimin e afateve procedurale të ankimimit, neni 63 pika 6 e LPP.

Vendimi i KPP

Pas ankimimit të OE Luar Bros në KPP, titullari i institucionit të AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 1064/1 Prot. datë 02.03.2020 për pezullimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje mjete transporti dhe agregat" deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit nga KPP.

KPP me vendimin nr. 115/2020 nr. 217 Prot. datë 24.02.2020, ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës së OE Luar Bros dhe njëkohësisht anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.

Rishpallja e procedurës së prokurimit:

AK me shkresën nr., 1167/1 Prot. date 27.03.2020 ka publikuar formularin e njoftimit të anulimit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Me urdhrin nr. 1368 Prot. datë 04.05.2020 është ngritur komisioni për modifikimin e kriterëve teknike i përbërë nga: G.R., R.O.dhe A. D.

Njësia e Prokurimit, më datë 07.05.2020 e përbërë nga R. L., M. Xh. dhe A. H. kanë hartuar DST për tenderin me objekt "Blerje mjete transporti dhe agregat" duke reflektuar vendimin e KPP nr. 115/2020, nr. 217 Prot. datë 24.02.2020

Njoftimi i kontratës është bërë me shkresën nr. 1446/8 Prot. datë 15.05.2020

Afati i fundit për pranimin e ofertave është përcaktuar data 10.06.2020 ora 11:00

Vlerësimi i KVO

Në datën 10.06.2020 ora 11:00 është bërë mbyllja e fazës së dorëzimit të ofertave nga OE pjesëmarrës.

Sipas vlerësimit të KVO të datës 12.06.2020 në sistemin elektronik të APP kishin paraqitur oferta OE si më poshtë:

Nr.	Operatori Ekonomik	Vlera (pa TVSH)	Vlerësimi
1	G.-A	11,000,000 lekë	Kualifikuar
2	L.B.	9,672,000 lekë	S'Kualifikuar
3	P.I.	11,900,000 lekë	S'kualifikuar

Referuar PV të KVO të datës 12.06.2020, rezulton se:

1. OE G.-A është kualifikuar, me ofertë ekonomike 11,000,000 lekë pa TVSH.
2. OE P. I. është s'kualifikuar, me ofertën ekonomike 11,900,000 lekë pa TVSh, pasi nuk përmbushte kriterin 4 të kapaciteteve teknike sepse kamioni me kosh i ofertuar kishte një gjatësi 547 cm, ndërkohë që AK në specifikimet teknike ka kërkuar që ky mjet të ketë gjatësi 450-500 cm. Gjithashtu gjerësia e kërkuara në specifikimet teknike nga AK është 190 cm ndërkohë që OE Poëer Industries e ka ofertuar me gjerësi 210 cm.
3. OE L.B. është s'kualifikuar, me ofertë ekonomike 9,672,000 leke pa TVSH, pasi nuk plotësonte disa nga kriteret e veçanta të përcaktuara nga AK në DST.

Në pikën 6 të PV, KVO shprehet se:

OE L. B. nuk përmbush kriterin 4 të kapacitetit teknik pasi kamionçinat janë **3,500 Kg** ndërkohë që AK ka kërkuar **2900-3400 Kg**

Raporti përmbledhës i KVO nr. 1715/1 Prot. Datë 22.06.2020, i miratuar nga Titullari i Institucionit ka shpallur fitues OE G. A me ofertën 11,000,000 lekë

Titulli i gjetjes	KVO, ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të veçanta të përcaktuar në DST
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurës në SPE, rezulton se:</p> <p>A. OE G.-A i kualifikuar dhe shpallur fitues nga KVO nuk plotëson kriteret e mëposhtme:</p> <p>1. Nuk plotëson kriterin 2.2 pika a (Kapaciteti ekonomik dhe financiar)</p> <p>Autoriteti Kontraktor DPPGJ ka vendosur si kriter që:</p> <p><i>Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2016, 2017, 2018) nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit.</i></p> <p>-OE G.A., ka paraqitur vërtetimin nr. T02380541, datë 04.06.2020 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë për vitet 2017, 2018 dhe 2019. Pra, G.A., nuk e plotëson këtë kriter, pasi AK ka kërkuar xhiron për vitet 2016, 2017 dhe 2018., pra mungon deklarata e xhiros vjetore për vitin 2016 të kërkuar në DST</p> <p>Në DST, është përcaktuar se:</p> <p><i>Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rremë e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.</i></p> <p><u>Për sa me lart, OE G.-A i shpallur padrejtësisht fitues nga KVO duhej të s'kualifikohej.</u></p> <p>***Referuar PV të KVO të datës 12.06.2020, rezulton se:</p>

B. KVO ka s'kualifikuar OE L.B., pasi ky OE nuk plotësonte kriteret e mëposhtme:

1. OE L.B. nuk ka firmën e përkthyesit tek dokumentacioni i paraqitur, e gjithashtu nuk është e qartë çfarë dokumenti është përkthyer pasi nuk cilësohet në dokumentacionin e paraqitur.

Më tej gjuha tek vërtetimi i përkthimit i datës 10/06/2020 Nr. REP 5319 nuk është gjermanisht (deustch) por hollandisht (dutch) tek librezat e qarkullimit të paraqitura.

Gjithashtu ka mospërputhje në përkthim tek mjeti Autokullë (Platformë Pune) pasi në anglisht çmimi është 32,000 Euro ndërsa në shqip është 30,500 Euro.

2. Gjithashtu të gjitha marrëveshjet apo kontratat që OE L. B. pretendon se ka nënshkruar me OE të huaj nuk përmbajnë datë në asnjë prej rasteve.

3. OE L.B. nuk përmbush pikën 4 të specifikimeve teknike pasi kamionçinat e paraqitura të markës Renault Master me numër shasie përkatësisht (V.....) dhe (V.....) nuk janë të llojit vetë-shkarkuese në asnjërin prej rasteve në dokumentacionin e paraqitur, siç edhe janë kërkuar nga AK në dokumentat e tenderit.

Kamionçinat nuk janë vetë-shkarkuese pra nuk janë të llojit kipper siç edhe cilësohet në gjuhë hollandeze nëse ato do të ishin të tilla.

4. OE L. B. nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit teknik pasi pas verifikimeve të kryera nga ana e KVO mbi dokumentacionin e dërguar dhe specifikisht për mjetin Renault Master me nr. shasie (VF1MBH4V550458845), mjeti nuk rezulton të ketë bërë 125,595 km.

5. OE L. B. nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit Teknik në lejen e qarkullimit të mjetit Autokullë (Platformë Pune) ku shkruhet se është dy metra i gjerë ndërkohë që në përkthim të kontratës është 1.8 metra. Gjithashtu sipas specifikimeve teknike kulla kërkohet të jetë maksimumi 1.9 metra e gjerë ndërkohë që është 2 metra e gjerë sipas librezës së qarkullimit. Gjithashtu nuk përmbush specifikimet teknike pasi gjatësia është 5,522 mm (ose 552,2 cm) ndërkohë që sipas specifikimeve teknike gjatësia duhet të jetë 450-500 cm.

6. OE L. B. nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit Teknik pasi kamionçinat janë 3,500 kg ndërkohë që nga AK janë kërkuar 2900-3400 kg.

7. Mos-përputhje nga dokumentacioni i paraqitur për kamionçinën Renault Master me numër shasie përkatësisht (V.....5) ku vëllimi i paraqitur tek dokumentat e përkthyer nuk korrespondon me atë të paraqitur në lejen e qarkullimit, ku specifikisht në dokumentacionin e përkthyer të paraqitur është 2,298 cm³ ndërkohë që në lejen e qarkullimit është 2,299 cm³.

Nga auditimi i procedurës në SPE, rezulton se:

1. OE L. B. në dokumentacionin e ngarkuar në SPE, ka paraqitur të noterizuar nga noteri, Z.P.B. me vërtetimin e përkthimi nr. 5320 Rep. datë 10.06.2020 (Italisht në Shqip); Vërtetim përkthimi nr.5321 Rep datë 10.06.2020 (Anglisht në Shqip), vërtetim përkthimi nr.5319 Rep date 10.06.2020 (Gjermanisht – Shqip).

Pra OE L. B. ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, të noterizuar dhe te përkthyer me përkthyes ligjor të licesuar nga Ministria e Drejtësisë.

2. Për plotësimin e këtij kriteri OE ka paraqitur kontrata me distributor te huaj te cilat janë te përkthyer dhe të noterizuara. Kontratat janë shoqëruar me specifikimet teknike dhe foto të automjeteve.

Për plotësimin e këtij kriteri, OE L. B.ka ngarkuar ne SPE këto kontrata:

1.Kontrate blerje me Intel SRL (shitësi) për mjetin tip Nissan-CABSTAR 35.13

2.Kontrate blerje me V. D. W. V. V.O.F (shitësi) për mjetin Renault-master i vitit 2014

3.Kontrate blerje me O. A. BV (shitësi) për mjetin Renault-master i vitit 2014

Pra OE L. B. ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, të noterizuar dhe te përkthyer me përkthyes ligjor te licesuar nga Ministria e Drejtësisë.

3.Referuar deklaratës mbi përmbushjen e specifikimeve teknike OE L.B., ka deklaruar se i përmbush te gjitha specifikimet teknike. Për mjetet kamionçinë te tipit Renault ka deklaruar qe është vetëshkarkuese (mbrapa majtas djathtas) me 125,595 km dhe për Kamionçinën tjetër tip Renault me 84,446 km, ka deklaruar se është vetëshkarkuese (mbrapa majtas djathtas)

Pra OE L. B. ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, për plotësimin e këtij kriteri

4. Nga auditimi në SPE, konstatohet se fotoja e kroskotit ku paraqitet kilometrazhi për kamionçinën Renault Master me nr. shasie V.....është 125, 595 km.

Pra OE L.B. ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, për plotësimin e këtij kriteri

5. Per mjetin Auto kullë (Platformë Pune) me nr. shasie YËASHFF24A2114642 gjerësia eshte 1,820 mm po ashtu dhe ne përkthimin e noterizuar gjerësia është 1,820 mm.

Ka një devijim te vogël për gjatesinë e mjetit, pasi mjeti auto kullë i ofertuar nga OE L. B. ka gjatësi 5,522 mm ndërkohë që AK ka kërkuar të jetë në diapazonin 4,500-5,000 mm.

Diferenca prej 52 cm është e pa përfillshme dhe nuk ndikon në objektin e procedurës.

Pra OE L. B. ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, për plotësimin e këtij kriteri

6. Pesha 3,500 kg e kamionçinave të ofertuar nga OE L.B. përfaqëson peshën maksimale të lejuar, pasi sipas skedës teknike të mjeteve, kjo peshe përbehet nga pesha maksimale e ngarkuar dhe pesha neto, të dyja sëbashku përbëjnë peshën maksimale të lejuar.

Pra OE e plotëson këtë kriter, pasi vendosja e ketij kriteri nuk është i qartë sepse, AK nuk ka specifikuar peshën maksimale neto dhe peshën maksimale te ngarkuar për te përcaktuar peshën maksimale të lejuar.

Pra OE L. B. ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, për plotësimin e këtij kriteri

7. Mos-përputhje nga dokumentacioni i paraqitur për kamionçinën Renault Master me numër shasie përkatësisht (V.....)ku vëllimi 2,298

	<p>cm³ gjatë rumbullakosjes është 2,299 cm³. Ky kriter plotësohet plotësisht dhe nuk ishte e nevojshme të konstatohej nga KVO si mos plotësim të kriterit, pasi diferenca e tyre është zero (vlera e volumit të paraqitura në vërtetimin e përkthyer dhe ajo në lejen e qarkullimit të mjetit, janë të njëjta)</p> <p><i><u>Pra OE L. B. ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, për plotësimin e këtij kriteri</u></i></p> <p>KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE G. A., i renditur i dyti për nga vlera e ofertës ekonomike në kushtet që nuk plotëson disa nga kriteret e DST të sipërpërmendura.</p> <p><i><u>Për sa më lart, KVO duhej të s'kualifikonte OE G. A dhe në kushtet që kishte s'kualifikuar OE L. B., kjo procedurë duhej të anulohet dhe të përsëritej nga e para.</u></i></p> <p>Megjithatë OE L. B. i renditur i pari për nga oferta ekonomike dhe i s'kualifikuar nga KVO dhe për sa trajtuar më sipër edhe OE G.A i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues me pa të drejt, në këto kushte kjo proceure duhej të anulohet, pasi të dy OE pjesëmarrës nuk plotësonin kriteret e vendosura në DST të miratura nga titullari i institucionit. Diferenca midis ofertës më të ulët dhe ofertës së vendit të dytë të kualifikuar dhe shpallur fitues në shumën 1,593,600 lekë, do të konsiderohet përdorim pa ekonomikitet për buxhetin e DPPGJ.</p>
Kriteri:	Kriteret e veçanta të DST, neni 53 pika 4 e LPP i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Rritje e shpenzimeve jo efektive
Shkaku:	Mos respektim i LPP dhe akteve nën ligjore të Prokurimit Pulik
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Drejtoria e Përgjithëshme e Pastrim Gjelberimit duhet të bëjë kujdesë dhe të përcaktoj kriteret të qarta dhe lehtësisht të verifikueshme të cilat duhet të respektojnë gjithë kerkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor të prokurimeve publike në fuqi, duke përdorur me efikasitet fondet buxhetore në dispozicion dhe të nxjerr përgjegjësi për anëtarët e KVO për shumën 1,593,600 lekë, të përdorur pa ekonomikitet nga buxheti i DPPGJ.
Afati	Menjëherë

Për veprime dhe mos veprimet ngarkohet me përgjegjësi V. L, I. M. dhe E. Xh. në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 185/53 Prot., datë 14.04.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit

... Në lidhje me kualifikimin e OE G.-A,

Për mosplotësimin e kriterit 2.2. pika a., AK, shprehet se:

Megjithatë pika 2.2 e kapacitetit ekonomik dhe financiar plotësohet pasi është kërkuar që vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit. Nga verifikimi i xhiros së viteve 2017 dhe 2018, bazuar në vërtetimin me Nr. T02380541, konstatojmë se mesatarja e xhiros edhe sikur **xhiro për vitin 2016 të ishte me vlerë zero**, nuk është më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit.

Për mos plotësimin e kriterit 2.2 pika b., AK ka sjell për observacion se:

.. nga shqyrtimi i dokumentacionit në SPE të OE Gerard – A, nga KVO janë konstatuar se bilancet e paraqitura janë kopje e noterizuar, dhe kanë konfirmin nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe janë shoqëruar me akt ekspertizën kontabël të ekspertit kontabël të autorizuar (bashkëlidhur fotokopje të këtyre materialeve)

...Në lidhje me skualifikimin e OE L. B.

Sqarojmë që mjetet e paraqitura si kamiona vetëshkarkues, përkatësisht të llojit:

Renault master me nr. shasie V.....dhe V....., nuk janë të llojit vetëshkarkues, pavarësisht deklaratës së përmbushjes së specifikimeve teknike.

Më pas janë sjellë referenca të kodit civil mbi plotësimin e kushteve për ekzistencën e dëmit ekonomik.

Qendrimi i grupit te auditimit.

Megjithëse edhe në fazën e observacionit të Akt konstatimit për këtë çështje grupi i auditimit e ka trajtuar gjerësisht atë. Në kushtet e pasurimit në këtë fazë nga ana e subjektit të audituar me dokumentacion shtesë, grupi i auditimit të KLSH do të marrë në konsiderat pjesërisht disa prej tyre të reflektuar dhe në materialin e auditimit, për pasoj shumë 1,593,600 lekë do ta konsideroj shpenzim pa efektivitet të buxhetit të DPPGJ, pasi kjo procedurë duhej të ishte anuluar sepse të dy OE pjesëmarrës nuk plotësonin kriteret e kërkuara nga AK DPPGJ.

Zbatimi i kontratës

Me nr.1715/3 Prot. date 15.07.2020 është lidhur kontrata midis AK dhe OE G.-A shpk

Me urdhrin nr.1715/4 Prot. date 15.07.2020 nga titullari i institucionit është ngritur komisioni për ndjekjen e dhe zbatimin e kontratës të përbërë nga: E. K., A.R. dhe A.T.

Komisioni i marrjes në dorëzim në PV e datës 15.07.2020, ka dal në përfundimin se malli i dorëzuar nga kontraktuesi G.-A i plotëson specifikimet e kërkuara nga AK sipas kushteve të kontratës. Pas marrjes në dorëzim 2 kamionçinat dhe auto kulla janë bërë hyrje në magazinën e DPPGJ me Flete Hyrjen nr. 5 datë 15.05.2020.

2.4.2. Procedura e Prokurimit me objekt : “Blerje Mjete Transporti”

<p>1.Urdhri i Prokurimit Nr. 433/3 Prot. datë 13.02.2018</p>	<p>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 433/3 Prot. datë 13.02.2018 1. R. L. 2. Xh. T. 3. I.M.</p>	<p>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 433/4 Prot. datë 13.02.2018 1. R. M. 2. G. R. 3. E. Xh. Me Urdhrin Nr. 433/7 Prot, datë 20.03.2020, Z. R. M. është zëvendësuar nga Z. A. Q.</p>
<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e Hapur</p>	<p>6.Oferta fituese: 41,666,660 leke (pa TVSH)</p>	<p>7.Diferenca me fondin limit: 8,333,340 leke (pa TVSH)</p>
<p>5.Fondi Limit: 50,000,000 leke (pa TVSH)</p>	<p>9.Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Tiranë</p>	<p>10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender: 4 OE - G. –A sh.p.k - R&R K. sh.p.k - R-M K.sh.p.k - P.I.sh.p.k b)S’kualifikuar 3 OE, - R&R K sh.p.k - R-I Ksh.p.k - P. I.sh.p.k c) Kualifikuar 1 OE - G. –A sh.p.k</p>
<p>8. Data e hapjes së tenderit: Date 20.03.2018 ora 11:00</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës nga AK</p>	<p>13.Ankimime për KKP S’ka</p>
<p>11.Ankimime për AK-;</p>		

1. Nr. 533 Prot datë 23.02.2018 (O R-M Kompani sh.p.k).	-Me shkresën nr. 533/5 Prot. datë 26.02.2018 KSHA i ka kthyer përgjigje OE ankimues "R-M" Kompani.	
2. Nr. 356 Prot. datë 23.02.2018 (OE R&R Kompani sh.p.k).	- Me shkresën 549/1 Prot. datë 26.02.2018 KSHA i ka kthyer përgjigje OE ankimues "L.B." sh.p.k	
3. Nr. 549 Prot. Date 26.02.2018. (OE L.B.sh.p.k)		
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 433/11 prot. Datë 12.04.2018	15.Vlera e kontratës: 49,999,992 leke (me tvsh)	

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion të grupit të KLSH, rezulton se:

Për nevojat emergjente të Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtoreve të Qytetit, Drejtori z. R. M. në cilësinë e Drejtorit të Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve nëpërmjet shkresës nr. 433 Prot. date 13.02.2018 ka paraqitur kërkesë për blerjen e mjeteve të transportit, si më poshtë

Nr.	Përshkrimi i mallit	njësia	Sasia
1	Autobot 10,000 litra me dy akse	copë	2
2	Autobot 12,000 litra me dy akse	copë	1
3	Ekskavator me rrota	copë	1

Hartimi i Fondi limit:

Grupi i ngritur për përlllogaritjen e fondit limit, me urdhrin nr. 358 Prot. date 07.02.2018, i përbërë nga E. Xh., M. H. dhe A. H. në relacionin e datës 08.02.2018 mbi argumentimin e llogaritjes së Fondit Limit të kontratës, në zbatim të VKM 914 date 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshua neni 59, pika 2 germa a, ka marrë oferta nga tre subjekte, si më poshtë:

1. **A.A.** në shumën 50,500,000 lekë pa TVSH,
2. **G. A** në shumën 49,700,000 leke pa TVSH
3. dhe **I.G. t.s** në shumën 49,800,000 lekë pa TVSH.

Mbi bazën e mesatarizimit të ofertave të marra nga subjekte e sipërcituara, grupi i punës ka përcaktuar si Fond limit për këtë procedurë vlerën **50,000,000 lekë pa TVSH**.

Titulli i gjetjes	Mungesa e hartimit të specifikimeve teknike për disa mallra ka sjelle dhe rritje artificiale të përlllogaritjes së fondit limit
Situata:	Grupi për përlllogaritjen e Fondit Limit, ka marrë oferta nga subjektet e A. A., G. A dhe I. G. t. për mallrat e kërkuar pa patur specifikime teknike për këto mallra. Si pasojë subjektet e sipërcituara kanë dhënë oferta fiktive pasi ofertat e tyre nuk bazohen në karakteristika dhe specifikime teknike për mallrat e kërkuara nga AK DPPGJ, Bashkia Tiranë. Grupi i auditimit të KLSH bëri verifikim të statusit të subjekteve të sipërcituar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, nga rezultoi se, subjekti "A. A.", me NIPT L....U nuk ekziston i regjistruar me këtë NIPT. Pra, ofertat e paraqitura nga grupi për llogaritjen e FL janë fiktive. Anëtarët e grupit të punës për përcaktimin e FL, kanë vepruar në mospërpëthjeje me VKM 914 datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshua neni 59, pika 2/a
Kriteri:	VKM 914 datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshua neni 59, pika 2/a
Ndikimi/Efekti:	Rritje artificiale dhe deformim të FL gjatë përlllogaritjes së saj.

Shkaku:	Mos respektim i LPP dhe akteve nen ligjore te Prokurimit Publik
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Drejtori i Pergjithshem i DPPGJ në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohet në procedurat e prokurimit publik.
Afati	Vazhdimisht

Për sa më sipër E. Xh., M. H. dhe A. H. ngarkohen me përgjegjësi në cilësinë e anëtareve të grupit për përlllogaritjen e fondit limit.

Hartimi i specifikimeve teknike:

Titullari i institucionit ka ngritur komisionin e përgatitjes të specifikimeve teknike me shkresën nr.433/1 Prot . datë 13.02.2018. Komisioni ka në përbërje znj. N. M., z.A. T.dhe z. R. O. Në urdhër e titullarit për ngritjen e këtij komisioni është kërkuar që komisioni duhet të hartoj një relacion përmbledhës për specifikimet teknike dhe kriteret teknike për këtë procedurë prokurimi.

Titulli i gjetjes	Specifikimet teknike nuk pasqyrojnë kërkesat e AK
Situata:	<p>Nga auditimi rezulton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike ka përcaktuar specifikime vetëm për Autobot 10,000 litra me dy akse dhe Ekskavatorin me rrota. 2. Specifikimeve e hartuara nga grupi i punës nuk pasqyrojnë kërkesat e paraqitura në shkresën nr. 433 Prot., datë 13.02.2018 të Drejtorit të Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve të miratuara nga Titullari i AK, pasi në relacionin e datës 13.02.2018 të grupit për hartimin e specifikimeve teknike, nuk janë hartuar specifikimet teknike për Autobotin me kapacitet 12,000 litra. 3. Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës nuk kanë përputhje me specifikimet teknike të pasqyruara në shtrojsën nr.10 të DST, kryesisht për Ekskavatorin me dy rrota. 4. Në DST pasqyrohen specifikime teknike për Auto botin 12,000 litra me dy akse ndërkohë që grupi për përcaktimin e specifikimeve teknike në relacion e vete nuk i ka pasqyruar. 5. Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike ka shkelur rregullat e LPP pasi në specifikimet teknike të ekskavatorit ka kërkuar që ky mjete të këtë për numër të shasisë YD4JZG55KË. (nr. shasisë është unik).
Kriteri:	LPP, Kërkesat e paraqitura në shkresën nr.433/1 Prot . datë 13.02.2018
Ndikimi/Efekti:	Deformim i kërkesave të AK gjatë procesit të prokurimit
Shkaku:	Mos respektim i LPP dhe akteve nën ligjore
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të specifikimeve teknike nga grupet e punës.
Afati	Vazhdimisht

Për sa më sipër N. M., z.A. T. dhe z. R. O. ngarkohen me përgjegjësi në cilësinë e anëtareve të grupit për hartimin e specifikimeve teknike

Hartimi i DST

Me shkresën nr. 433/2 Prot. datë 13.02.2018 mbi bazën e kërkesës së Drejtorisë së planifikimit, menaxhimit dhe shërbimeve, titullari i institucionit ka miratuar hapjen e procedurës së prokurimit me objekt : “Blerje Mjete transporti” në vlerën 50,000,000 lekë pa TVSH.

Njësia e Prokurimit e ngritur me urdhrin e prokurimit nr. 433/3 prot. date 13.02.2018 e përbërë nga R. L., Xh. T.dhe I.M. me anë të PV të datës 13.02.2018 dhe në bashkëpunim me grupin për përcaktimin e kriterëve teknike ka hartuar DST.

Titulli i gjetjes	Vendosja e Specifikime teknike në DST në mospërputhje me LPP
Situata:	NJHDT per blerjen e ekskavatori ka vendosur si kriter në DST, që ai të këtë numrin e shasisë Y. Anëtarët e njësisë se hartimit të dokumentave të tenderit kanë vepruar në mospërputhje me Ligji 9643 për prokurimet publike, i ndryshuar. Neni 23-Specifikimet teknike pika 5, ku parashikohet se: <i>Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.</i>
Kriteri:	Ligji 9643 për prokurimet publike, i ndryshuar. Neni 23-Specifikimet teknike pika 5
Ndikimi/Efekti:	Deformim i kërkesave të AK gjatë procesit të prokurimit
Shkaku:	Mos respektim i LPP dhe akteve nën ligjore
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të DST nga grupet e punës/njësia e prokurimit.
Afati:	Menjeherë

Për sa më sipër R. L., Xh. T. dhe I. M. ngarkohen me përgjegjësi në cilësinë e anëtareve të grupit për hartimin e dokumentave të tenderit

Ndryshimi i kriterëve të veçanta

OE RA-MI kompani ka paraqitur ankese pranë AK DPPGJ , Bashkia Tirane me shkresën nr.533 Prot. datë 23.02.2018.

Ankesa e këtij OE konsistonte në faktin se specifikimet teknike të vendosura në DST janë fikse të detyrueshme duke paracaktuar dhe duke shmangur konkurrencën, gjithashtu mjetei ekskavator kërkohet që të ketë nr. shasisë Y.....

Për sa më lart AK ka vepruar në mospërputhje ,me ligjin e PP neni 23 pika 5.

Të njëjtën ankese ka paraqitur dhe OE R&R kompani me shkresën hyrëse në AK me nr. 536 Prot. date 23.02.2018. Po ashtu edhe OE Luar Bros me shkresën 549 Prot. date 26.02.2018

Titullari i AK, pas ankesave të OE të sipërcituar, me shkresën 533/1 Prot. date 23.02.2018 ka pezulluar procedurën e prokurimit. Me urdhrin nr. 533/2 Prot. date 23.02.2018 titullari ka ngritur komisionin e shqyrtimit të ankesave të përbërë nga M.M., M.H.dhe J.E.

Pas shqyrtimit të ankesave, komisioni bëri ndryshime të specifikimeve teknike të cilat u miratuan nga titullari i AK me shkresën 533/3 Prot. date 26.02.2018.

Modifikimet/ndryshimet e specifikimeve teknike janë pasqyruar në shtojcën për modifikim në DST me shkresën nr. 433/6 Prot. date 26.02.2018.

Data e zhvillimit të tenderit/te paraqitjes së ofertave është shtyrë nga data 15.03.2018 ora 11:00 në date 20.03.2018 ora 11:00.

Ndryshimi i kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

KVO është ngritur me urdhrin nr.433/4 Prot. datë 13.02.2018., i përberë nga R.M., G.R.dhe E. Xh.

Titullari i AK me urdhrin nr.433/7 Prot. datë 20.03.2018 ka zëvendësuar Kryetarin e KVO z. R.M. me z. A. Q.

Vlerësimi i KVO

Në datë 20.03.2018, ora 11:00 është bërë mbyllja e fazës së dorëzimit të ofertave nga OE pjesëmarrës. Sipas Proces Verbalit të përbashkët të NjP dhe KVO të datës 20.03.2018 në sistemin elektronik të APP, kishin paraqitur oferta OE si më poshtë:

Nr.	Operatori Ekonomik	Vlera (pa TVSH)
1	OE R&R kompani	38,600,000 lekë
2	OE G.-A	41,666,660 lekë
3	OE R.-M. kompani	43,700,000 lekë
4	OE P.I.	48,900,000 lekë

*** **Referuar Raportit Përmbledhës nr. 433/8 Prot. date 04.04.2018.**, KVO ka s'kualifikuar BOE "R&R me L.", O R-M dhe OE Po.I.

KVO ka kualifikuar vetëm OE G.-A nga OE pjesëmarrës duke e shpallur fitues për ofertën ekonomike në shumën 41,666,660 lekë (pa TVSH).

Titullari i institucionit ka miratuar raportin përmbledhës të KVO me shkresën nr. 433/9 Prot. datë 04.04.2018.

Pas dorëzimit të dokumentacionit të shkruar nga ana e OE fitues, AK ka nënshkruar kontratën nr. 433/11 Prot. datë 12.04.2018 me OE G. – A

Titulli i gjetjes	KVO, ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të veçanta të përcaktuar në DST
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurës në SPE, rezulton se: OE G.-A i kualifikuar dhe shpallur fitues nga KVO nuk plotëson kriteret e mëposhtme:</p> <p>1.Nuk plotëson kriterin 2.2.1. Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015,2016, 2017) lëshuar nga autoriteti përkatës, pasi OE G.-A ka paraqitur vërtetim për xhiron e viteve 2014, 2015 dhe 2016</p> <p>2.Nuk plotëson kriterin 2.2.2. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015,2016,2017), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. <i>OE ka dorëzuar bilancet e viteve 2014, 2015 dhe 2016 dhe jo atë të viteve 2015, 2016 dhe 2017 siç janë kërkuar në DST.</i></p> <p>3. Nuk plotëson kriterin 2.3.2 MAF - MANUFACTURERS' AUTHORIZATION nuk është i përkthyer dhe noterizuar. Sipas kërkesave të DST, të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. <i>Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim.</i></p>

4.Nuk plotëson kriterin 2.3.3

Pasi, kataloguose fragmente të tij dhe skedat teknike të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi nuk janë të përkthyer dhe të noterizuara.

5.Nuk plotëson 2.3.1 pika 1/b ku parashikohet se:

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Faturat tatimore të shitjes të cilat do të përmbajnë (datën, shumën si dhe sasinë e mallrave të furnizuar) me TVSH

OE G. R për të plotësuar kriterin për eksperiencë të ngjashme, ka paraqitur në SEP vetëm një faturë tatimore, e cila nuk ka nr.serial, nr. dhe datë., duke e bërë të pavlefshme për organin tatimor.

Për sa me lart, OE G.-A i shpallur padrejtësisht fitues nga KVO duhej të s'kualifikohej.

A. KVO ka s'kualifikuar BOE R&R kompani &L., të cilët kanë dhënë ofertën më të ulët dhe janë renditur të parët për nga vlera e ofertës ekonomike.

KVO e ka s'kualifikuar BOE për shkak të mos plotësimit të kriterit 2.3.1., kapacitetit teknik, në të cilin kërkohet që:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me një vlerë jo më e madhe 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

Nga auditimi i procedurës në SPE, konstatohet se:

BOE R&R kompani &L. në SEPP ka paraqitur për plotësimin e kriterit 2.3.1 ka paraqitur fatura tatimore të mëposhtme:

1. Shitje Fadrom-FT Nr.40 date 30.05.2017 (ShitësL.shpk- Blerës 2F Shpk) **Vlefte 9,156,000 leke me TVSH**
2. Shitje Kamion kombinat-FT nr.3 date 27.06.2017 (shitës L.shpk - Bleres ITNEG) **Vlefte 14,160,000 leke me TVSH**
3. Shitje Ekskavator me zinxhir-FT nr.08 date 03.07.2017 (shitës L. – Blerës ITNEG shpk) **Vlefte 8,640,000 lekë**
4. Shitje Ekskavator me goma-FT 26 date 01.05.2018 (shitës R&R Kompani-Bleres S.) **Vlefte 9,840,000 leke me TVSH.**

BOE për plotësimin e kriterit 2.3.1., ka paraqitur fatura tatimore shitje me subjekte private në shumën totale **41,796,000 leke me TVSH** ose **83.5% te fondit limit** për këtë procedurë prokurimi. Kontratat e BOE janë realizuar në sektorin privat, prandaj ky BOE ka paraqitur Faturat tatimore të shitjes të cilat ë përmbajnë (datën, shumën si dhe sasinë e mallrave të furnizuar) me TVSH duke plotësuar kriterin 2.3.1 pika 1/b e DST

KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE G.-A., i renditur i dyti për nga vlera e ofertës ekonomike, dhe ne kushtet që nuk plotëson disa nga kriteret e DST të sipërpërmendura. Në këto kushte KVO, duhej ta s'kualifikonte OE G.-A.

Për sa më lart, KVO duhej të s'kualifikonte OE G. A dhe në kushtet që kishte s'kualifikuar BOE R&R kompani &Ligis, kjo procedurë duhej të anulohet dhe të përsëritej.

Megjithatë **BOE R&R kompani &L.** i renditur i pari për nga oferta ekonomike dhe i s'kualifikuar nga KVO dhe për sa trajtuar më sipër edhe OE G.A i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues me pa të drejt, në këto

	kushte kjo proceure duhej te anulohet, pasi te dy OE pjesëmarrës nuk plotësonin kriteret e vendosura në DST të miratura nga titullari i institucionit. Për sa më lart, Diferenca midis ofertës më të ulët dhe vendit të dyte në shumën 3,066,660 leke (pa TVSH) ose 3,679,992 lekë (me TVSH) , do të konsiderohet përdorim pa ekonomicitet të buxhetit të DPPGJ, Bashkia Tiranë.
Kriteri:	LPP, Kriteret e veçanta te DST
Ndikimi/Efekti:	Rritje te shpenzimeve jo efektive
Shkaku:	Mos respektim i LPP dhe akteve nenligjore te tij
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Drejtoria e Përgjithëshme e Pastrim Gjelberimit të analizoj këtë procedurë dhe të marrë masa për anëtarët e KVO të cilët kanë vepruar hapur në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa ekonomicitet të buxhetit të DPPGJ në shumën 3,679,992 lekë.
Afati	Menjherë

Për sa më lart, me veprimet dhe mos veprimet ngarkohet me përgjegjësi A. Q., G. R., E. Xh. në cilësinë e anëtarëve të KVO

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 185/53 Prot., datë 14.04.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjen nr.2 të Projekt Raportit të Auditimit, faqe 196,...sqarojmë se: OE G. –A ka paraqitur vërtetimin e xhiros për vitet (2014, 2015, 2016)...Mungesa e xhiros për vitin 2018 se edhe sikur kjo xhiro të ishte 0 lekë, gjithësesi do të përmbushte kërkesën në DST. Në lidhje me kriterin 2.2.2 mungesa e bilancit të vitit 2017 nga subjekti silltet ky kundërshtim. ...në rastin kur në dy bilance të njëpasnjëshem nuk ka raporte negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në këtë kuadër theksojmë se bilancet e viteve 2015 dhe 2016 të paraqitur nga OE G. – A nuk kanë raport negativ midis aktivitetit dhe pasivitetit.

Në këtë kontekst KVO ka vepruar në mënyrë e duhur duke kualifikuar OE G.A për plotësimin e kësaj pike, kjo duke marrë parasysh faktin se OE ka paraqitur kontrata, fatura të ngashme me akte zhdoganimi të cilat vërtetojnë plotësimin e kësaj pike të DST. Gjithashtu ju paraqesim faturën në fjalë të cilën KVO ka kryer verifikimet e nevojshme.

Në lidhje me skualifikimin e BOE R&R kompani &L., subjekti ka paraqitur observacionin si më poshtë:

OE R.kompani dhe BOE R&R kompani &L. ne regjistrin tregtar të ngarkuar në SEP në periudhën e zhvillimit të procedurës kanë të njëjtin aksioner mazhoritar me përqindjen më të lartë të aksioneve, të njëjtën adresë biznesi.

Nisur nga ky fakt oferta ekonomike e paraqitur nga BOE R&R kompani &L. është skualifikuar nga KVO.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH

Observacioni i paraqitur nga subjekti nuk ka sjell evidence të re të panjohur më parë nga grupi i auditimit në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e paraqitura në Projekt Raportin e Auditimit. Nga ana e subjektit të audituar DPPGJ, i vetmi dokument i ri i sjelle është fatura tatimore nr.65 datë 02.03.2018 me nr. Serial 48573790 e cila është paraqitur nga OE G. – A për plotësimin e kriterit 2.3.2. të eksperiencës së mëparshme. Paraqitja e kësaj fature dhe pretendimi i

verifikimit të saj nga AK, pas faktit të mungesës së elementeve të saj për sa është trajtur në materialin e auditimit e bën atë të pa vlefshëm pasi në SEP kjo faturë ka mungesë të indentifikimit të nr.serial dhe datë dhe nr. të farurës, duke mos e bere te vlefshëm për organin tatimor. Në këto kushte KVO duhej ta s’kualifikonte OE G.– A ose të kërkonte sqarime sic ka veprura tani. Pra KVO ka vepruar në kundësthim me kuadrin ligjor në fuqi të LPP, por duke e konsideruar këtë faturë të paraqitur si të rregullt, nga ana e grupit të auditimit do të merret në konsiderat vetëm rikonsiderimi i shumës 3,679,992 lekë vetëm si përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore të DPPGJ.

Komisioni i marrjes ne dorëzim

Komisioni i ndjekjes së kontratës i ngritur me urdhrin nr. 433/13 date 12.04.2018 përbëhej nga: J. E.,E.K. dhe M.H..

Komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar dhe marrë në dorëzim mallrat nëpërmjet Proces Verbalit të datës 23.07.2018

Titulli i gjetjes	Mungesa e gjurmës se auditit gjate procesit te marrjes ne dorëzimi te mallrave apo shërbimeve
Situata:	<p>Nga auditimi rezulton se:</p> <p>-Referuar faqes 2 të PV të datës 23.07.2018 të komisionit të marrjes në dorëzim, mjetin Ekskavator me rrota e ka identifikuar nëpërmjet modelit të motorit nr. YD4JZG55KË, sic pasqyrohet në aneksin 2.4.2. Prnt Scr. Nr.1 Model i eskavatorit sipas këtij Proces Verbalit është i njëjtë me modelin e përcaktuar në specifikimet teknike, të cilat pas ankimimit të 3 (tre) OE u hoqën nga DST.</p> <p>Në Proces Verbalin e datës 23.07.2018 komisioni i marrjes në dorëzim ka evidentuar se tipi i motorit të ekskavatorit është me nr. YD4JZG55KË. Ndërkohë që ky model i përketë modelit fillestar që AK paraqiti në specifikimet teknike fillestare në DST, para se ato të ndryshoheshin me shtojcën nr. 433/6 Prot. datë 26.02.2018.</p> <p>-PV i komisionit të marrjes në dorëzim nuk ka bashkëlidhur foto të mallrave që ka marrë në dorëzim.</p> <p>-Gjithashtu në Proces Verbalit i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe kolaudim nuk ka bashkëlidhur dhe as e ka përmendur dokumentin e zhdoganimit të mjeteve, duke mos pasqyruar kështu markën dhe tipin e këtyre mjeteve të marra në dorëzim.</p>
Kriteri:	Kontrata nr. 433/11 Prot. datë 12.04.2018, Proces Verbalit i datës 23.07.2018
Ndikimi/Efekti:	Rritje të shpenzimeve jo efektive për shoqërinë
Shkaku:	Mos respektim i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Drejtori i DPPGJ, të përcaktoj nëpërmjet akteve administrative rregulla të qarta për të mundësuar gjurmën e auditit gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve
Afati	Menjherë

Për sa më lart, me veprimet dhe mos veprimet ngarkohet me përgjegjësi J. E., E. K. dhe M. H. në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 185/53 Prot., datë 14.04.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e Subjektit

Në lidhje me konstatimin e grupit të auditimit të KLSH, se:

...Theksojmë se eskavatori i marrë në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim nuk përmban numërin YD4JZG55KË as numër shasie, as si numër serial dhe as si numër motori. Numri i shasisë së ekskavatorit me targë AHMT89 është 65080310508 (bashkëlidhur foto kopje të certifikatës së pronës së mjetit). Ku tregohet se ky mjet nuk ka të shënuar në asnjë vend (as në motor, as në karroceri e as në kabinë) numrin e shasisë YD4JZG55KË, ashtu sikurse pretendohet në akt konstatim. Numri i cili nga auditi pretendohet se është numër shasie nuk i përket mjetit të llojit Eskavator me goma me Nr.Shasie 6508310508 dhe me targë AHMT89. Për sa më sipër argumentuam juridikisht dhe teknikisht, gjetja 19 e grupit të auditimit të KLSH nuk qëndron dhe duhet të hiqet.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH

Grupi i auditimit dhe në qëndrimin e mbajtur për këtë konstatim gjatë fazës së projekt raportit, ka theksuar se është referuar vetëm proces verbalit të datë 23.07.2018 faqes dy, sic paraqitet në *aneksin 2.4.2., Prn.Scr. Nr.1. Proces Verballi i datës 23.07.2018 i marrjes në dorëzim* (pjesa e vizuar me vijë të kuqe, nga ku dallohet qartë vendosja e numërit YD4JZG55KW), prandaj ky observacion nuk do merret në konsiderat.

Hyrja në magazinë:

Automjetet janë bërë hyrje me Fletë Hyrjen nr.3 date 23.07.2018.

Mbi bazën e faturës tatimore nr.228 date 23.07.2018 (nr.serial 65,322,603).

Me urdhër shpenzim nr.236 datë 16.10.2018, AK ka kryer pagesën në shumën 50,000,000 leke me TVSH në nr. e llogarisë së Kontraktuesin G.-A pranë bankës BKT.

Dalja nga magazina:

-Me Fletë Daljen nr.237 date 30.05.2019, Autoboti 12,000 litra. është bere dalje nga magazina dhe është marrë në dorëzim nga Z. A. Q.

-Me fletë daljen nr.238 date 30.05.2019, Eskavatori me rrota është bere dalje nga magazina dhe është marrë në dorëzim nga Z.A. M.

-Me fletë daljen nr.239 date 30.05.2018, autoboti 10,000 litra është bere dalje nga magazina dhe eshte marrë në dorëzim nga Z. Xh. D.

Urdhrat e dorëzimit janë lëshuar nga G. R.

2.4.3. Procedura e prokurimeve me objekt: “Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Aparate”

1.Urdhri i Prokurimit Nr. 112/4 Prot. Datë 27.02.2020	3.Hartuesit e DST. Urdhër Nr. 112/4 Prot. datë 27.02.2020 1. A.H. 2. J.P. 3. M.Xh.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 112/5 Prot. datë 07.02.2020 1. A.Q. 2. E. Xh. 3. E. H.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1 666 000 leke	6.Oferta fituese (pa tvsh) 1 598 000 leke	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 68 000 leke

8. Data e hapjes së tenderit 09.03.2020 ora 11:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Tiranë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender. 1 OE PC-S. sh.p.k b) Kualifikuar 1 OE - PC-S. sh.p.k
11. Ankimime për AK-; Ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje Ankesës nga KKP
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 112/15 prot. Datë 14.04.2020	15. Vlera e kontratës 1,917,600 leke (me TVSH)	

Hartimi i fondit limit

Komisioni për përlogaritjen e Fondit limit është ngritur në zbatim të urdhrimit të titullarit të institucionit nr.03 Prot. datë 06.01.2020, dhe përbehej nga:

1. E. X.; 2. M. H.; 3. A. L.

Kërkesën për blerjen e pajisjeve kompjuterike është hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse me shkresën nr. 112 Prot., date 17.01.20220, e cila ka kërkuar të prokurohen pajisjet si më poshtë:

r.	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia
1	Kompjuter	cope	10
2	Printer	cope	10
3	Lap top	cope	2
4	Router	cope	1
5	Hard disk	cope	2
6	Aparat Fotografik	cope	1

Titullari i AK ka miratuar kërkesën e Drejtorisë së Planifikimeve dhe Menaxhimit nr. 112/1 Prot., Datë 17.01.2020., duke përcaktuar vlerën e Fondit Limit në shumën 1,666.000 lekë pa TVSh.

Titulli i gjetjes	Mungesa e hartimit të specifikimeve teknike për disa mallra ka sjelle dhe rritje artificiale të përlogaritjes së fondit limit
Situata:	<u><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se:</i></u> Megjithëse Fondi Limit për këtë procedurë është përcaktuar apriori nga Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit, në dosjen e administruar nga grupi i KLSH ndodhet edhe procesi verbal i grupit për përlogaritjen e kësaj procedure prokurimi, nga ku konstatohet se data është e korrigjuar. Sipas PV, grupi i përlogaritjes ka marrë oferta nga subjektet. PC Store computers, b) Smart Store dhe c) IT Progress. Ofertat e subjekteve të sipërcituar nuk kanë datë, dhe janë marrë në kushtet e mungesës së specifikimeve teknike për këto pajisje. Ngritja e komisionit të përgatitjes së specifikimeve teknike është bërë nëpërmjet urdhrimit nr.112/2 Prot. Date 17.01.2020. Komisioni përbehej nga N. J., A. L. dhe M.. <i>Për sa më lart, specifikimet teknike janë hartuar dy muaj më vonë pas marrjes së ofertave nga komisioni i përlogaritjes së fondit limit.</i> Në përbërjen e grupit të punës nuk ka asnjë specialist IT, kjo në mospërputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor të prokurimeve publike.

	Nga verifikimi i statusit ¹ , të subjekteve të sipërcituar rezultoi se, subjekti IT Progress me NIPT M...S është regjistruar më date 23/09/2020, ndërkohë komisioni pretendon që ka marrë oferta ne datën 17.01.2020 (data e korrigjuar). Grupi i përllogaritjes se Fondit Limit i DPPGJ, mbi bazën e mesatarizimin të ofertave të pretenduara ka përllogaritur si Fond Limit të njëjtën vlerë të paraqitur në shkresën nr. 112/1 Prot., Datë 17.01.2020 të drejtorisë së planifikimit dhe menaxhimit. Pra sipas grupit të përllogaritjes së Fondit limit është e njëjta vlerë që ka parashikuar AK në shkresën nr. 112/1 Prot., Datë 17.01.2020 të Drejtorise së Planifikimit dhe Menaxhimit
Kriteri:	Neni 59 pika 2/b të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); Neni 23, pika 1,2,3,4, 5 të LPP dhe neni 27 pika 1 I VKM-së 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Rritje artificiale e fondit limit
Shkaku:	Mos respektim i LPP dhe akteve nën ligjore në lidhje me përllogaritjen e fondit limit dhe përcaktimin e specifikimeve teknike
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Drejtori i Pergjithshëm i DPPGJ në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të planifikoj programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohet në procedurat e prokurimit publik.
Afati	Menjeherë

Për veprimet sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Z. A. Q. ne cilësinë e Drejtorit të planifikimit dhe menaxhimit pranë DPPGJ dhe anëtarët e grupit të përllogaritjes së FL Z. E. Xh. Znj. M. H. dhe Znj.A. L.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 185/53 Prot., datë 14.04.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit
 Subjekti i audituar ka risjelle si argument referimin e nenit 59 VKM 914 date 29.12.2014, e citoj:
 Llogaritja e FL është bërë bazuar ofertave të marra në treg referuar këtyre specifikimeve teknike të cilat janë argumentuara dhe përcjell më date 17.01.2020 dhe janë lehtësisht të aksesueshme dhe gjenerueshme në cdo moment në faqen zyrtare të AKSHI.
Qendrimi i grupit të auditimit të KLSH
 Nga administrimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion grupit të auditimit, ofertat e paraqitura tek subjektet nuk kanë specifikime teknike për pajisjet që do të prokurohen. Gjenerimi i tyre pranë AKSHI nënkupton që AK mund ti përdor ato duke i shoqëruar me ofertat që do të përfitoj dhe jo subjektet që do japin oferta sipas kërkesave të AK. Gjithësesi ky komision pretendon se ka marrë oferta në tre subjekte ndërkohë është konstatuar që njeri prej OE nuk ishte regjistruar pranë QKB, *prandaj ky observacion nuk do të merret në konsiderat dhe do të paraqitet në materialin e auditimit.*

Hartimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike për procedurën “Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Aparate”, janë hartuar nga komisioni nëpërmjet shkresës nr. 112/3 date 27.02.2020.

¹ Qendrën Kombëtare të Biznesit

Ngritja e komisionit të përgatitjes së specifikimeve teknike është bërë nëpërmjet urdhrin nr.112/2 Prot. Date 17.01.2020. Komisioni përbehej nga N.J., A. L. dhe M. D.

******Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT**, rezulton se pas hedhjes në SPE, AK ka bërë modifikime në dokumentet e tenderit. AK me shkresën 112/9 date 03.03.2020, ka hequr nga DST specifikimet teknike për fotokopjes multifunkionale.

Titulli i gjetjes	Mos respektim i akteve ligjore dhe nenligjore te prokurimeve publike ne lidhje me pjesëmarrjen e komisione te specialisteve te fushës.
Situata:	<p>Nga auditimi konstatohet se:</p> <p>1. AK megjithëse ka bërë ndryshim në DST, nuk ka zgjatur afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5(pesë) dite duke vepruar në mospërputhje me nenin 62 te VKM 914 datë 29.12.2014, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku parashikohet se: <i>Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 (pesë) ditë për prokurimet me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë dhe me 10 (dhjetë) ditë për prokurimet me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, në përputhje me nenin 42 të LPP.</i></p> <p>2. Nga auditimi konstatohet se: Në përbërjen e KVO nuk ka specialist të fushës, kjo në mospërputhje me VKM 914 datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 58, ku parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës</p>
Kriteri:	VKM 914 datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 58,
Ndikimi/Efekti:	Ne vlerësimin e Procedurave/marrjes ne dorëzim te produkteve informatike
Shkaku:	Mungesa ne strukturën e DPPGJ te specialistit IT
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Drejtori i Pergjithshem të rris strukturën me specialist të profilit IT, te nevojshëm si gjate fazës së hartimit te specifikimeve teknike, të DST dhe gjatë fazës së vlerësimit të ofertave dhe gjatë marrjes në dorëzim të produkteve/shërbimeve informatike
Afati	Menjherë

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK Znj. A. B. dhe anëtarët e hartimit te Dokumenteve të tenderit A. H., J. P. dhe M. Xh.

Zhvillimi i procedurës:

Komisioni i vlerësimit të ofertave është ngritur me Urdhër Nr. 112/5 Prot. datë 07.02.2020.

KVO përbehej nga A. Q., E. Xh. dhe E. H.

KVO në datë 09.03.2020 ora 11:00 ka zhvilluar hapjen e procedurës.

Në këtë procedure është paraqitur vetëm OE PC Store. Në datë 10.03.2020 KVO ka bere vlerësimin e të vetmit pjesëmarrës duke e kualifikuar dhe shpallur fitues me oferte ekonomike 1,598,000 lekë pa TVSH

Raporti përmbledhës i KVO është miratuar nga titullari i institucionit me shkresën nr. 112/13 Prot., date 08.04.2020

Pas shpalljes se OE fitues dhe para lidhjes së kontratës, KVO me proces verbalin e datës 14.04.2020 ka konfirmuar që OE ka paraqitur dokumentacioni e shkruar të njëjtë me atë të ngarkuar ne SEPP.

Zbatimi i kontratës

Pas dorëzimit të dokumentacionit nga OE dhe konfirmimit nga ana e KVO për dokumentacionin e dorëzuar sipas dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, titullari i AK ka lidhur dhe nënshkruar kontratën nr.112/15 prot. Date 14.04.2020 midis palëve,për vlerën 1,917,600 lekë (me TVSH) me përfaqësuesin e autorizuar të PC Store.

Për zbatimin e kontratës Titullari ka ngritur komisionin me urdhër të brendshëm nr. 1274 Prot. datë 14.04.2020 të përbërë nga A. K., A.N.dhe E.Xh.

Nga auditimi i strukturës administrative rezulton se asnjë prej anëtareve të këtij komisioni të ketë profilin IT.

Pagesa e kontratës

AK DPPGJ nëpërmjet Urdhër shpenzimi nr.112 date 28.07.2020 ka kryer pagesën për PC S. në shumën 1,917,600 lekë, mbi bazën e faturës tatimore të kontraktuesit nr. P057 date 28.04.2020 në vlerën totale 1,917,600 lekë (me TVSH) dhe të Proces Verbalit të datës 28.04.2020 komisionit të marrjes në dorëzim

Marrja në dorëzim e materialeve kompjuterike

Kontraktuesi PC Store ka dorëzuar materialet kompjuterike pranë DPPGJ, Bashkia Tiranë më datë 28.04.2020.

Mallrat janë marrë në dorëzim në prezencë të përgjegjësit material i cili i ka bërë hyrje në magazinë me Flete hyrje nr.2 date 28.04.2020 pa përcaktuar llojin e brand-it (markës) dhe numrat serial të pajisjeve.

Të gjitha pajisjet e marra ne dorëzim janë bërë dalje nga magazina më datë 05.05.2020

Nga dokumentacioni i vendosur ne dispozicion të grupit të KLSH, konstatohet se:

Komisioni i ndjekjes së kontratës ka pranuar dhe ka marrë në dorëzim materialet kompjuterike pa vërejtje, pasi sipas tyre kontraktuesi i ka dorëzuar në përputhje të plotë me specifikimet e përcaktuara në DST dhe kontratë.

*****Në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate**, grupi i auditimit bëri verifikim fizik mbi bazën e flete daljeve për këto mallra. Në tabelën e mëposhtme paraqiten mallrat e ofertuara nga kontraktuesi PC Store kundrejt atyre të dorëzuar nga ky subjekt pranë AK:

Tabela nr.1

Product name	Marka dhe modeli i dorëzuar	Marka dhe modeli i ofertuar	Sasia (Cope)
Lap top	HP lap top Probook 450 G4	HP Lap Top Probook 450 G6	2
Monitor	Monitori model HP V214a	HP monitor 22Ë	10
Printer	Lexmark B2338	Lexmark B2650DË	10

Referuar çmimeve dhe sasive të mallrave të marra në dorëzim në mospërputhje me kontratën të pasqyruar në tabelën nr.1., vlera e përlllogaritur prej 1,411,200 lekë, do konsiderohet përdorim pa efektivitet të buxhetit te DPPGJ dhe ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e marrjes në dorëzim

Tabela nr.2

Nr.	Përshkrimi i mallit	njësia	sasia	Çmimi pa TVSH	Vlera me TVSH
1	Kompjuter	copë	10	76,500	918,000
2	Printer	copë	10	23,500	282,000

3	Lap top	copë	2	88,000	211,200
	Totali				1,411,200

Titulli i gjetjes	Mos zbatim i kushteve të kontratës nga komisioni i marrjes ne dorëzim te mallrave sipas modelit te ofertuar te kontraktuesit
Situata:	<p><u>Nga verifikimi fizik u konstatuar se:</u></p> <p>a. Për pajisjet Lap Top, kontraktuesi PC Store nuk ka dorëzuar tipin dhe modelin e ofertuar dhe te pranuar nga AK. Pasi OE PC STORE për pajisjen LapTop ka ofertuar modelin HP Probook 450 G6 ndërkohë qe ka dorëzuar LAP topin model HP Probook 450 G4.</p> <p>Komisioni i marrjes në dorëzim ngarkohet me përgjegjësi pasi ka pranuar materiale ne kundërshtim me kërkesat e AK dhe ato të pranuar dhe te vlerësuar nga KVO duke pranuar një model të ndryshëm dhe me karakteristika jo të njëjta me ato të kontraktura.</p> <p>b. OE PC Store ka furnizuar AK me Monitorin modelin HP V214a dhe jo modelin e ofertuar HP 22Ë, të pranuar dhe shpallur fitues nga KVO.</p> <p>c. OE PC Store ka dorëzuar pranë DPPGJ, pajisjen Printer model Lexmark B2338 ndërkohë që ka ofertuar Printerin model Lexmark B2650DË</p> <p>Nga auditimi rezulton se:</p> <p>1.OE “PC S.” ka dorëzuar pranë AK mallra të pa kërkuara duke mos ju përmbajtur deklaratës mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6, duke pranuar se:</p> <p><i>Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor</i></p> <p>2.Komisioni i zbatimit të kontratës ka vepruar në mospërputhje me kushtet e kontratës duke konfirmuar fiktivisht realizimin e saj dhe si rezultat OE “PC S.” ka përfituar gjithë shumën e kontratës prej 1,917,600 lekë (me TVSH) duke e liruar kontraktuesin nga detyrimi i sigurimit të kontratës në shumën 10% të saj.</p>
Kriteri:	Kontratës nr.112/15 prot. Date 14.04.2020.
Ndikimi/Efekti:	Perdorim pa efektivitet të fondeve te buxhetit te DPPGJ
Shkaku:	Mos respektim te kushteve te kontratës nr.112/15 prot. Date 14.04.2020.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	DPPGJ të ndjek të gjitha procedurat administrative për kontraktuesin PC Store për të zëvendësuar pajisjet e konstatuara me devijime nga modeli i ofertuar me ato të dorëzuara, pasi PC Store ka shkelur hapur kushtet e kontratës nr.112/15 Prot. Datë 14.04.2020., dhe në rast të kundërt të moszëvendësimit të tyre, shuma prej 1,411,200 lekë do të konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e DPPGJ
Afati	<i>Deri më datë 31.12.2023</i>

Për veprimet sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisioni i zbatimit të kontratës i përbërë nga A. K., A. N. dhe E. Xh.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 185/53 Prot., datë 14.04.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit

Në mënyrë të përmblodhur subjekti i audituar DPPGJ, pranon gjetjet e grupit të auditimit, duke bashkëlidhur dhe dokumentacionin shoqërues si dhe shkresën drejtuar subjektit kontraktues PC Store, e citoj:

Referuar rekomandimeve të KLSH, DPPGJ ka marrë masa për vënien në dijeni të OE PC Store me anë të shkresës me Nr. 543 Prot. datë 28.03.2023. Me anë të shkresës Nr.93 Prot. datë 14.04.2023, OE PC Store me lëndë kthim përgjigje, ka vënë në dijeni DPPGJ se do të zëvendësoj pajisjet sipas rekomandimeve të lëna në projekt raportin e grupit të auditimit të KLSH.

Qëndrimi i Grupit të auditimit të KLSH

Observacioni për këtë pikë do të pranohet me kusht që materialet e ofertuara dhe të pranuar nga KVO me ato të dorëzuara jo sipas kërkesave të AK, të jenë zëvendësuar tërësisht me pajisjet e kontraktuara. Zëvendësimi i tyre duhet të bëhet brenda periudhës së raportimit të zbatimit të rekomandimeve nga DPPGJ, në të kundërt shuma e përcaktuar më sipër do të vijohet të konsiderohet dëm ekonomik.

2.4.4. Procedura e Prokurimit me objekt :“Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra”

1.Urdhri i Prokurimit Nr. 858/4 Prot. datë 16.02.2021	3.Hartuesit e DST U.P Nr.858/4Prot. datë 16.02.2021	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 858/5 Prot. datë 16.02.2021 1. A.Q. 2. J.P. 3. G.R.
2.Lloji i Procedurës Proçedurë e Hapur	1. R.L. 2. A.K. 3. A.K.	
5.Fondi Limit 10,800,000 leke pa TVSH	6.Oferta fituese 10,753,000 leke pa TVSH	7.Diferenca me fondin limit 47,000 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit 12.03.2021 ora 10:00	9.Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Tiranë	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender. 1. R&R Group 2. G.C.sh.p.k 3. E. T.D sh.p.k b)S’kualifikua 1. R&R Group 2. E. T.D sh.p.k c) Kualifikuar 1. G.C.sh.p.k
11.Ankimime për AK. Ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13.Përgjigje Ankesës nga KKP
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr.858/10Prot., Datë 02.04.2021	15.Vlera e kontratës) 12,903,600 leke me TVSH	

Kërkesa për pjesë këmbimi, goma, bateri dhe filtra për vitin 2021., e hartuara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit është miratuar nga titullari i AK me shkresën 858/1 Prot. datë 16.02.2021.

Kërkesa është shoqëruar me relacionin e përgjegjës të sektorit të Flota Transport dhe Oficinë mirëmbajtje.

Titulli i gjetjes	Copëzimi i fondit për prokurimin e mallra me objekt te njejtë
Situata:	<p>Nga auditimi rezulton se:</p> <p>1. Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit ndër të tjera, ka kërkuar blerjen e artikujve “Motorino” dhe “Dinamo”, siç pasqyrohet në aneksin 2.4.4 Tabela nr.1</p> <p>2. Referuar procedurës së prokurimit me objekt “Shpenzime për te tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje e mjeteve)”, rezulton se: <i>Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit në DPPGJ, më datën 08.02.2021 kishte planifikuar FV dinamo dhe FV motorino.</i></p> <p>3. Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit me datë 16.02.2021, ka planifikuar përsëri FV dinamo dhe motorino për procedurën me objekt “Pjesë këmbimi, goma, bateri dhe filtra”.</p> <p><i>Pra, Drejtoria e planifikimit dhe menaxhimit ne DPPGJ, brenda harkut kohor të një jave ka planifikuar dhe miratuar FV per Dinamo dhe Motorino në dy procedura prokurimi të ndryshme te zhvilluar në të njëjtën periudhë.</i></p> <p>4. Objekti i procedurës së prokurimit “Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra”, nuk parashikon blerjen e “dinamove” dhe “motorinove”, por vetëmblerje të gomave, baterive dhe filtrave.</p> <p>5. OE G., i shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt “Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra”, përFV Dinamo dhe Motorinoka ofertuar shumën 270,000 lekë., e cila do të konsiderohet shpenzim pa efektivitet nga Autoriteti Kontraktor DPPGJ, Bashkia Tiranë, sic paraqitet ne aneksin 2.4.4 Tabela Nr.2</p>
Kriteri:	LPP dhe akteve nenligjore te Prokurimeve Publike
Ndikimi/Efekti:	Shpenzim pa efektivitet nga Autoriteti Kontraktor DPPGJ
Shkaku:	Mos repektim i LPP dhe akteve nën ligjore
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Drejtoria e Përgjithëshme e Pastrim Gjelberimit, Bashkia Tiranë të marrë masa që gjatë hartimit të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve publike të mos bëhet copëzim fondi. Mallrat apo grup mallrat duhet të grupohen sipas funksionit me qëllim mos shmangien e procedurave të prokurimit dhe përdorimin e fondeve me efektivitet në përputhje me aktet ligjore në fuqi në fushën e prokurimeve publike
Afati	Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më lart, ngarkohet me përgjegjësi Z.A. Q., në cilësinë e Drejtori i Planifikimit dhe Menaxhimit, I. M. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit oficinë mirëmbajtje dhe G. R. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të flota transportit, pasi kanë hartuar dhe paraqitur kërkesa jashtë objektit prokurimit, si dhe kanë planifikuar të njëjtat artikuj në dy procedura prokurimi të ndryshme të prokuruar në të njëjtën kohë.

Hartimi i fondit limit

Grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.21 date 06.01.2021., i përbërë nga E. L., E.C. dhe D. D. kanë marrë oferta pranë subjekteve private, të pasqyruara në proces verbalin e datës 16.02.202.

Operatori ekonomik	NIPT	Oferta financiare
S.&CO	L...F	10,863,000 leke pa TVSH
G.C.	K...Q	9,948,000 leke pa TVSH
A. S.2000	K...F	11,589,000 leke pa TVSH

Grupi i përllogaritjes së fondit limit, ka përllogaritur shumën 10,800,000 lekë pa TVSh si fond limit për këtë procedure prokurimi mbi bazën e mesatarizimit të ofertave të marra nga subjektet e sipërcituara.

Hartimi i specifikimeve teknike

Titullari i AK me urdhrin nr. 858/2 date 16.02.2021., ka ngritur komisionin përpërgatitjen e specifikimeve teknike, të përbërë nga I. M., A. H. dhe E. K.

Specifikimeve teknike janë shoqëruar me relacionin mbi argumentimin e kritereve teknike me shkresën 853/3 Prot date 16.02.2021.

Hartimi i dokumentave të Tenderit

Njësia e Prokurimit ka hartuar DST më datë 16.02.2021, të paraqitura në Proces Verbalin përkatës të mbajtur prej tyre.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit

Më datë 12.03.2021, ora 10:00 është bërë hapja e ofertave.

KVO gjatë hapjes së ofertave ka konstatuar se në SPE ishin paraqitur 3 OE, si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik	NIPT	Oferta financiare
1	R&R Grup	K....A	Nuk ka paraqitur ofertë
2	E. TD	K....M	9,700,000 lekë pa TVSH
3	G.C.	K.....Q	10,753,000 lekë pa TVSH

Dorëzimi i mostrave

Në DST në pikën 9 kriteri 2.3 (kapaciteti teknik), AK ka kërkuar që:

Në ditën e hapjes së ofertave Operatori Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesë para komisionit mostra për të gjithë artikujt objekt i procedure se prokurimit “Pjese Këmbimi, Goma, Filtra dhe Bateri”.

Në pikën 7 të kriterit 2.3. në DST, AK ka kërkuar që:

Operatori ekonomik duhet të garantojë që mallrat të jenë prodhim sipas standardeve BE apo/ose standardeve DOT Amerikan. Për te vërtetuarkëtë pike te paraqitet certifikata e origjinës se mallit objekt prokurimi, në momentin e dorëzimit të mostrave të mallit.

Nga auditimi i evidencës dokumentare të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH, pjesë e dosjes së procedurës së prokurimit, Rezulton se:

Titulli i gjetjes	Mungesa e dokumentimit të dorëzimit të mostrave nga OE pjesëmarrës
Situata:	<p>a) OE pjesëmarrës, G. C. dhe E. TD, nuk kanë paraqitur certifikatë e origjinës së mallit objekt prokurimi, në momentin e dorëzimit të mostrave të mallit.</p> <p>b) Në dosjen e kësaj procedure, gjenden 2 Proces Verbal të mbajtura nga KVO, më datë 12.03.2021 ora 11:00 me 2 OE pjesëmarrës në këtë procedure.</p> <p>c) Referuar proces verbalit të datës 12.03.2021 konstatohet se, në prani tëanëtareve te komisionit te vlerësimit te ofertave dhe përfaqësuesëve të autorizuar të OE pjesëmarrës janë dorëzuar në zyrën e prokurimeve të DPPGJ, mostrat e mallit nga 2 OE pjesëmarrës.</p> <p>d) Referuar specifikimeve teknike të përcaktuar nga AK për këto mallëra, duke patur parasysh modelet e ndryshme të gomave, hapësira e zyres se prokurimeve nuk do te mjaftonte te administroheshin këto mostra, pasi vetëm sasia e mostrave për artikullin “goma” është 52 copë, për më tepër</p>

	<p>që duhej të paraqiteshin edhe 12 dinamo dhe 12 bateri, pa përmendur nr. e mostrave të filtrave te vajit dhe naftës.</p> <p>e) Gjithashtu konstatohet se, KVO nuk ka mbajtur proces verbal të përbashkët për të 2 OE pjesëmarrës. Në dosjen e kësaj procedure, gjendet vetëm proces verbal të mbajtur me secilin OE pjesëmarrës.</p> <p>Proces verbali i dorëzimit të mostrave për subjekti G. është nënshkruar nga personi i autorizuar i përfaqësuesit ligjor të subjektit G. C., në mungesë të prokurës noteriale të përfaqësimit.</p> <p>Proces verbali i dorëzimit të mostrave nga subjekti E. TD është nënshkruar nga personi i autorizuar nëpërmjet një prokure të posaçme noteriale me nr. 2540 rep, <u>datë 25.10.2016</u></p> <p>Proces verbalet e mbajtura nga KVO, nuk janë shoqëruar me foto të mostrave të dorëzuara për të evidentuar dorëzimin dhe administrimin e tyre.</p> <p>Në referim të nenit 12 të LPP, AK duhet të mbajë proces verbal për administrimin e paraqitjes së mostrave, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të procesit, ku parashikohet se:</p> <p><i>Autoritetikontraktor duhet të mbajë proces verbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.</i></p> <p>Referuar udhëzimit nr.2., datë 02.05.2019., të APP mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik, KVO duhet të mbajë një proces verbal të paraqitjes së mostrave, pasi i shërben procesit të evidentimit dhe ruajtjes së mostrave, deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesi.</p> <p>Mostrat e administruara duhej ti ktheheshin ofertuesit me kërkesën e tij, 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës.</p> <p>Për sa administrohet ne dosjen e procedurës, nuk ka evidence dokumentare, qe te vërtetoj ruajtjen dhe kthimin pas 30 ditësh të mostrave tek kontraktuesi.</p> <p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra”, rezulton se, AK DPPGJ nuk ka hartuar grafikun e shërbimeve për mjetet e transportit planifikuara për shërbime.</p> <p>Proces verbal i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të këtyre shërbimeve i administruar nga grupi i auditimit të KLSH gjatë fazës së terrenit nuk evidentonte shërbimet e kryera pranë kontraktuesitsipas një grafiku të planifikuar por vetem faktin që shërbimet janë realizuar.</p> <p>Në referim të rekomandimit të APP me nr. 2106 Prot. date 24.03.2021, gjatë marrjes në dorëzim për kontratat tip mallra/shërbime, rekomandohet që komisioni i marrjes në dorëzim, duhet të kërkoj nga kontraktuesi respektimin e termave të përcaktuara në dispozitat e kontratës, mbi kushtet e dorëzimit të mallit, duke administruar raporte apo proces verbale, si dhe çdo dokument tjetër, që shkërbenë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësisë apo garancisë që mallrat duhen të kenë, në momentin e dorëzimit pranë AK. Gjate observacionit të kësaj gjetje, AK paraqiti një PV të rregullt sipas kërkesave që parashikon rekomandimi i APP, dhe si rezultat observacioni për këtë pikë u morr në konsideratë, por për të përmirësuar procesin e evidentimit të marrjes në dorëzim, Grupi i auditimit të KLSH la rekomandimin e përkatës për mos përsëritjen e</p>
--	--

	parregullesive të evidentuara gjatë fazës së terrenit nga komisionet përkatëse të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve.
Kriteri:	Neni 12 i LPP; udhëzimit nr.2., datë 02.05.2019., të APP mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik.
Ndikimi/Efekti:	Rritje e shpenzimeve jo efektive
Shkaku:	Mos respektim i LPP dhe akteve nën ligjore
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave. Drejtori i DPPGJ, të hartoj nëpërmjet akteve administrative rregulla të qarta për të mundësuar gjurmën e auditit gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, të cilat në të gjitha rastet duhet të jenë të protokolluara dhe të administrohen nga zyra e protokoll/arkivit të DPPGJ-së sipas rregullave dhe normave arkivore në fuqi, për të mos lënë mundësi që raporte apo proces verbale të mund të gjenenrohen pas afateve kohore të përcaktuara në kushtet e kontratës së shëbimit në këtë rast.
Afati	Në vijimësi

Për sa më lart, me veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave respektivisht, A. Q., J. P., G. R.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 185/53 Prot., datë 14.04.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit

...Ne asnjë parashikim ligjor nuk është përcaktuar forma e mbajtjes së proces verbalit të administrimit të mostrave, pra nuk ka një shtojse të miratuar apo rregull të shkruar mbi proces verbalin e mostrave duhet të mbahet i përbashkët, pra me të gjithë OE pjesëmarrës.

Qendrimi i grupit të auditimit të KLSH

Në referim të nenit 12 të LPP, AK duhet të mbajë proces verbal për administrimin e paraqitjes së mostrave, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të procesit, ku parashikohet se: *Autoritetikontraktor duhet të mbajë proces verbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.*

Referuar udhëzimit nr.2., datë 02.05.2019., të APP mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik, KVO duhet të mbajë një proces verbal të paraqitjes së mostrave, pasi i shërben procesit të evidentimit dhe ruajtjes së mostrave, deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesi. Mostrat e administruara duhej t'i ktheheshin ofertuesit me kërkesën e tij, 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës. Për sa administrohet në dosjen e procedurës, nuk ka evidence dokumentare, që të vërtetoj ruajtjen dhe kthimin pas 30 ditësh të mostrave tek kontraktuesi, prandaj observacioni nuk do të merret në konsideratë.

Vlerësimi i KVO

Më datë 19.03.2021, KVO ka vazhduar me vlerësimin e OE pjesëmarrës.

Referuar Proces Verbalit të vlerësimit, KVO ka kualifikuar OE G. C. me ofertën ekonomike 10,753,000 lekë pa TVSH.

KVO, ka s'kualifikuar OE R&R Grup, pasi ky OE nuk plotësonte asnjë prej kriterëve të përgjithshme, të veçanta, pasi nuk kishte paraqitur asnjë dokument duke përfshirë dhe formularin e ofertës.

KVO ka s'kualifikuar OE E.TD me ofertë ekonomike 9,700,000 leke pa TVSH., i renditur i pari sipas vlerës së ofertës ekonomike, për shkak se nuk plotësonte kriteret e veçanta të mëposhtme:

1. Kriterin 2.e., pasi nuk ka paraqitur vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike.

2. Kriterin 2.2.b., pasi kopjet e bilanceve të OE për tre vitet e fundit ushtrimore nuk janë të konfirmuara nga Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël, siç kërkohet nga AK dhe siç e parashikon ligji e kur në rastin në fjalë hyn në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, germa c, Ligji nr.10091, datë 05.03.2009.

3. Kriterin 2.3.5.,pasi për mallin filtra nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi apo distributori zyrtar, shoqëruar me kontratën apo marrëveshjen e nënshkruar midis palëve.

4. Kriterin 2.3.7., pasi në momentin e dorëzimit të mostrave OE nuk ka paraqitur certifikatën e origjinës së mallit siç edhe është kërkuar nga AK.

5. Kriterin 2.3.9., pasi në momentin e dorëzimit të mostrave nuk ka paraqitur një pjesë prej mostrave të kërkuara siç edhe është pasqyruar në procesverbalin e mbajtur nga KVO dhe OE. Specifikisht OE E. T.D nuk ka paraqitur mostra për artikujt e poshtëshënuar.

Goma me Nr. 23.5/70-16, Goma me Nr. 6.00 LT 13, Goma me Nr. 6.00 LT 15, Goma me Nr. 8.25-16, Goma me Nr. 23.5 R 25, Goma me Nr. 8.25-16-(128 124B), Goma me Nr. 20x10.00-8, Goma me Nr. 16x7.50-8, Goma me Nr. 18x8.50-8NHS, Goma me Nr. 15x6.00-6, Goma me Nr. 4.00-12. Për mallin bateri: nuk është paraqitur mostra për baterinë 185 A.Për mallin filtra OE E. T.D nuk ka paraqitur mostra për artikujt duke filluar nga numri rendor 5 deri tek 51, sipas tabelës, procesverbalit të mbajtur nga KVO.

KVO në raportin përmbledhës nr.858/7 Prot. Date 29.03.2021, ka kualifikua dhe shpallur fitues OE G.C.

Titullari i AK ka miratuar raportin përmbledhës të KVO me vendimin nr. 858/8 Prot. date 29.03.2021.

Njoftimi i fituesit është bërë nëpërmjet formularit të njoftimit të fituesit me nr.858/9 Prot. datë 29.03.2021.

OE G.C., pas shpalljes fitues nga KVO, ka dorëzuar dokumentacionin e shkruar dhe të noterizuar pranë DPPGJ.

KVO me PV e datës 02.04.2021, pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar fizikisht, ka konstatuar se ai është i plotë dhe i njëjtë me atë të ngarkuar në SPE.

OE G.C.ka bërë sigurimin e kontratës, në datë 02.04.2021 në shumën 1,290,360 lekë, më pas AK DPPGJ ka nënshkruar kontratën midis palave nr. 858/10 Prot datë 02.04.2021.

Zbatimi i kontratës

Referuar kontratës nr.858/10 prot. Datë 02.04.2021, faqe 22 parashikohet se:

Ofertuesi merr përsipër të montoj gomat objekt prokurimi sipas kushteve teknike me qëllim mirëmbajtjen e tyre gjatë periudhës së garancisë.Garancia e mallit do jete për 1 (një) Vit.

Marrja në Dorëzim

Me urdhrin 858/11 Prot. datë 02.04.2021, titullari i AK ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të përbërë nga E. L., K.M. dhe N. M.

Komisioni i marrjes në dorëzim ka konfirmuar se mallrat janë dorëzuar sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga AK duke mbajtur PV e marrjes në dorëzim në datë 29.04.2021.

Kontraktuesi për mallrat e dorëzuar ka paraqitur faturën tatimore nr.10 datë 29.04.2021.

Pas marrjes në dorëzim, mallrat janë bërë hyrje në magazinën e DPPGJ me fletë hyrjen nr. 13 datë 29.04.2021.

Pagesa e kontratës.

Kontraktuesi ka dorëzuar faturën tatimore nr.10/2021, datë 29.04.2021 me vlerë 12,903,600 lekë.

AK ka kryer pagesa të pjesshme për kontraktuesin me urdhër shpenzime, si më poshtë:

1. Urdhër Shpenzimin nr.128 date 10.06.2021 me vlere pjesore te faturës 5,000,000 leke.
2. Urdhër Shpenzimin nr.157 date 10.08.2021 me vlere pjesore te faturës 6,703,423 leke.
3. Urdhër Shpenzimin nr.188 date 14.09.2021 me vlere pjesore te faturës 1,200,177 leke

Në referim të nenit 6 pika 2 e kontratës nr.858/10 prot. Date 02.04.2021., në të cilën është parashikuar që pagesa për kontraktuesin, do të behet nga AK brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që është dorëzuar gjithë dokumentacioni i nevojshëm që vërteton përmbushjen e kushteve të kontratës. Referuar ligjit 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 5 “ Llogaritja e kamatëvonesës” dhe Urdhër shpenzimeve respektive të sipërcituar, grupi i auditimit i KLSH, përlllogarit kamatë vonesën, sic pasqyrohet në aneksin 2.4.4. tabela nr.3

2.4.5. Procedura e Prokurimit me objekt: “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Planifikimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit:

Për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit ka planifikuar me shkresën nr.790/1 Prot. datë 08.02.2021, mirëmbajtjen e disa mjeteve motorike pjesë e flotës së transportit të DPPGJ, Bashkia Tiranë. Nevoja për mirëmbajtjen e këtyre mjeteve nëpërmjet procedurës së prokurimit, është përcaktuar nga sektori i ofiçinës.

Anëtarët e komisionit për vlerësimin e defekteve, pasi kanë bërë kontroll të këtyre mjeteve nëpërmjet Akt difektiveve respektive, kane përcaktuar që mjetet e mëposhtme kanë nevojë për shërbim të furnizimit dhe vendosjes (FV) së pjesëve të reja.

Për sa më lart, Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit mbi bazën e Akt Difektiveve të sektorit të ofiçinës, ka planifikuar mirëmbajtjen për automjetet e mëposhtme, nëpërmjet procedurës së prokurimit publik me objekt: “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)” te pasqyruar ne aneksin 2.4.5. tabela nr. 1

Nga auditimi rezulton se:

Mjeti motorik Tip autobot ATV 10,0000 litra, i markës Shandong, vit prodhimi 2018 pas kontrollit në vend nga komisioni i verifikimit të defekteve.

Në Akt Difektimin nr.8 datë 12.01.2021, komisioni ka konstatuar që mjeti ka nevojë për riparim dhe ndërim të pjesëve të pasqyruar ne aneksin 2.4.5 tabela nr.2., për shkak se defektet kanë ardhur si pasoj e **amortizimit** të mjetit.

Titulli i gjetjes	Planifikim i shërbimeve të panevojshme për mjetet e transportit
Situata:	<i>Referuar procedurës së prokurimit me objekt : “Blerje Mjete Transporti” – Viti 2018 rezulton se:</i> Autoboti Shandong, me vit prodhimi 2018, është blerë i ri me zoro km nga DPPGJ në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Mjete Transporti” – Viti 2018. Kontraktuesi e ka dorëzuar këtë mjet më datë 23.07.2018. Autoboti Shandong 10,000 litra është pajisur me targa, leje qarkullimi dhe certifikatë të pronësisë, më datën 19.05.2019.

Gjate kësaj periudhe mjeti i ri (me zero kilometra), ka qëndruar në ruajtje pranë magazinës së DPPGJ nga **data 23.07.2018** deri me **datë 31.05.2019**. Mjeti pas marrjes së certifikatës së pronësisë dhe pajisjes me targa, ka dal nga magazina më datë 31.05.2019 dhe është marrë në dorëzim nga shoferi që posedon këtë mjet.

Pra, Autoboti Shandong 10,000 litra ka qëndruar pa lëvizur nga parku i mjeteve të transportit pranë DPPGJ për një periudhë afro 10 muaj nga data e dorëzimit pranë DPPGJ.

Nga administrimi i dokumentacionit në lidhje me lëvizjet e këtij mjeti, rezulton se:

Autoboti 10,000 litra për periudhën Qershor 2019 - Dhjetor 2020, ka kryer **13,761 km**, pasqyruar në aneksin 2.4.5. tabela nr.3.

Autoboti 10,000 litra i markës Atv Shandong, për periudhën objekt auditimi ka kryer një aktivitet të punës prej 19 muaj, nga momenti i marrjes në dorëzim nga shoferi deri në datën 12.01.2021 kur është bërë kontrolli nga anëtarët e komisionit të defekteve, të cilët kanë konstatuar se mjeti është i amortizuar megjithëse ai ka kryer vetëm **13,761 km**, pra në bazë të kilometrave të kryera ky mjet nuk mund të konsiderohet i amortizuar për më shumë, që në bazë të kilometrave të kryera konsiderohet një mjet i ri me pak kilometra.

Sipas Komisionit të defektimit autoboti Atv Shandong 10,000 litra, brenda një periudhe 19 mujore ka shfaqur problematika dhe nevojën për mirëmbajtje totale të pasqyruar në aneksin 2.4.5 prnt. Scr.nr.1

Referuar procedurës së prokurimit “Blerje Mjete Transporti” – Viti 2018, nga AK është kërkuar dhe kontraktuesi ka pranuar që garancia e këtij mjeti të jetë 1 vit.

Për sa me lart, duke patur parasysh që mjeti ka qëndruar pa lëvizur në ambientet e parkut të transportit të DPPGJ prej 11 muaj. Lëvizja e pare autobotit e ka bërë në muajin Qershor 2019., nga ku ka përshkruar 215 km. *Për sa më lart*, megjithëse Autoboti Atv Shandong 10,000 litra, kishte një vit garanci dhe brenda periudhës së garancisë kishte përshkruar vetëm **13,761 km**, komisioni i verifikimit të gjendjes së këtij autoboti, ka dal në konkluzionin që mjeti është i **amortizuar dhe** ka nevojë për ndërim të pjesëve të mëposhtme:

FV. Bllok Motor Cilindër Testat, Riparim Injektoresh + Pomp Naftë, FV. Pistocina Freni, FV. Tamburo Frenimi, FV Kambio Komplet, FV pompe frenash, FV Radiator Uji, FV Koke paraleli, FV Koke zbarë.

Nga auditimi rezulton se:

Bazuar në akt defektimit nr.8 të datës 12.01.2021, Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit pranë DPPGJ, ka planifikuar një shërbim tërësor ose remont kapital për autobotin 10,000 litra., pasi ka kërkuar të kryen shërbime për zëvendësimin e të gjitha pjesët kryesore të autobotit duke përfshirë edhe zëvendësimin e motorit. Shërbimi i kërkuar nga komisioni i verifikimit të defekteve, me arsyen që mjeti është i amortizuar, ne kushtet kur autoboti për sa cilësuar më lart, është i ri dhe ka kryer vetëm **13,761 km**, nuk justifikon kërkesën për remon kapital të tij.

Akt Defektimi nr.8 të datës 12.01.2021, nuk është firmosur nga shoferi që e përdor autobotin 10,000 litra, i cili nuk ka paraqitur asnjë shqetësim në lidhje me difektet që ka konstatuar komisioni.

	Referuar ofertës ekonomike të kontraktuesit, shërbimet e kryera për mjetin ATV Shandong, i kanë kushtuar buxhetit të DPPGJ 2,761,000 lekë , shumë e cila do të konsiderohet dëm ekonomik deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit të kërkuar dhe të shprehur në qëndrimin e grupit të auditimit të KLSH, në përgjigje të observacionit të paraqitur nga subjekti për Projekt Raportin e Auditimit të KLSH për këtë çështje, duke ngarkua me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të gjendjes së këtij mjeti nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021.
Kriteri:	Rregullorja e Brendshme e DPPGJ
Ndikimi/Efekti:	Rritje të shpenzimeve jo efektive për DPPGJ
Shkaku:	Mungesë e kontrollit të brendshëm dhe gjurmës së auditit për gjithë proceset që janë realizuar brenda periudhës së auditimit
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	DPPGJ të kërkoj nga subjekti fizik/juridik i licensuar në fushën e ekspertizës për shërbimet mekanike për automjetet, i cili ka mbajtur Akt verifikimin nr.544/1 datë 07.04.2023 gjithë dokumentacionin që vërteton që është i licensuar për objektin e verifikimit. Ky dokumentacion shtesë duhet të jetë plotësuar brenda afateve kohore të raportimit të zbatimit të rekomandimeve për KLSH, në rast të mos plotësimit të këtij kushti shuma prej 2,761,000 lekë, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi në mënyrë poropocionale, përgjegjësin e sektorit të oficinës, anëtarët e komisionit të verifikimit të defekteve që kanë hartuar akt defektimin nr. 8 datë 12.01.2021 dhe përgjegjesin e sektorit Flota Transport pranë DPPGJ
Afati	Deri më datë 31.12.2023

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi I. M. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të oficinës, R. O, A. T., E. V., K. M. dhe A. D. në cilësinë e anëtarëve të komisionit të verifikimit të defekteve nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021., si dhe G. M. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit Flota Transport.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 185/53 Prot., datë 14.04.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e Subjektit:

...Mjeti i llojit Autobot 10,000 litra i markës Shangdong ka qënë vazhdimisht pa pushim i angazhuar në procese pune gjatë periudhës së pandemisë Covid 19, pasi me anë të këtij mjeti DPPGJ ka kryer dezinfektimin e rrugëve brënda territorit të Bashkisë Tiranë. Sic është konstatuar nga grupi i auditimit mjeti ka kryer **13,761 km**.

DPPGJ ka kontraktuar një ekspert të jashtëmtë licesuar, i cili në akt verifikimin e kryer me nr. 544/1 prot datë 07.04.2023 ka dalë në përfundimin se:

Riparimi i mjetit është kryer në kushtet normale të verifikueshme lehtësisht sepse të gjitha pjesët quhen pjesë konsumi dhe defekte të paparashikueshme që mund të ndodhin në cdo lloj mjeti.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH

Grupi i auditimit të KLSH, e vlerëson impenjimin e drejtuesit të DPPGJ, për thirjen e një specialiti të fushës sipas tyre të licesuar në fushën e ekspertizës për verifikimin e gjetjeve të grupit të auditimit të paraqitura në materialin auditues. Por në observacionin e DPPGJ është dërguar vetëm akt verifikimi nr.544/1 datë 07.04.2023 i inxhinierit të thirur prej DPPGJ dhe nuk është bashkëlidhur dokumentacioni vërtetues i licesimit të tij për të realizuar këtë akt verifikimi. Përpos kësaj, shuma prej 2,761,000 lekë do të konsiderohet dëm ekonomik deri në

momentin e raportimit të zbatimit të rekomandimeve duke shoqëruar këtë akt verifikimi me licencën e ing të kontraktuar dhe mënyrën e thirrjes së tij, në të kundërt kjo shumë do të konsiderohet dëm ekonomik. Grupi i auditimit do ta ndjek këtë procedurë deri në zbatimin e plotë të këtyre kërkesave, pasi nga dokumentacioni bashkëlidhur observacionit për këtë pikë, nuk ka gjurmë auditi, për të pasqyruar mënyrën e thirrjes së ekspertit të fushës, dhe procedurës se si është lidhur kontrata. Gjithashtu nuk ka informacion mbi objektin e punës së këtij subjekti fizik/juridik, për më tepër që ky akt verifikimi nuk është shoqëruar me licencën e këtij subjekti në këtë fushë.

Procedura e Prokurimit me objekt :“Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)” – Viti 2021

1.Urdhri i Prokurimit Nr. 790/4 Prot. Datë 08.02.2021	3.Hartuesit e DST. Urdhër Nr. 790/4 Prot. datë 08.02.2021 1. R.L. 2. A.K. 3. A. K.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 790/5 Prot. datë 08.02.2020 1. A. Q. 2. J. P. 3. I.M.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur		
5.Fondi Limit 8,291,010 lekë pa TVSH	6.Oferta fituese 8,190,000 leke pa TVSH	7.Diferenca me fondin limit 101,010 leke pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit 04.03.2021 ora 10:00	9.Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Tiranë	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender.: 2 OE -P.I. sh.p.k -A.M.S. sh.p.k b) Skualifikuar 1 OE A. M.S. sh.p.k c) Kualifikuar 1 OE P. I. sh.p.k
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
11.Lidhja e kontratës Nr. 790/11 Datë 23.03.2021	12.Vlera e kontratës 9,828,000 leke me TVSH	

Hartimi i fondit limit

Grupi i punës për përllogaritjen e FL i ngritur me Urdhrin nr.21 date 06.01.2021 dhe i përbërë nga E.L., E. C.dhe D. D., ka marrë oferta nga subjektet:

Nr.	Subjekti privat	Oferta (pa TVSH)
1	S. & Co	8,599,500 leke
2	A. M.	8,083,530 leke
3	P. I.	8,190,000 leke

Mbi bazën e mesatarizimit të ofertave të marra nga subjektet e sipërcituar, grupi i përllogaritjes se fondit limit propozoj vlerën 8,291,010 leke pa TVSH.

Hartimi i specifikimeve teknike

Me shkresën nr.790/2 Prot. date 08.02.2021, Titullari i AK ka ngritur komisionin për hartimin e specifikimeve teknike, i përbërë nga A.D., E.V., S. J.

Me shkresën 790/3 Prot. date 08.02.2021 grupi i punës për përcaktimin e specifikimeve teknike i ka përcjell sektorit te prokurimeve specifikimet teknike për këtë procedurë.

Zhvillimi i procedurës:

Njësia e prokurimit e përbërë nga R.L., A. K. dhe A.K. ne date 08.02.2021 ka hartuar DST për kontratën me objekt: “Shpenzime për te tjera materiale dhe operative (mirëmbajtje mjeteve)”

Vlerësimi i KVO

Ne datën 04.03.2021 ora 10:00 është bërë mbyllja e fazës së dorëzimit të ofertave nga OE pjesëmarrës. KVO ne proces verbalin e hapjes së ofertave, konstatoi se ne sistemin elektronik të APP ishin paraqitur operatorët ekonomik si me poshtë:

Nr.	Operatori Ekonomik	Vlera (pa TVSH)
1	OE P. I.	8,190,000 leke
2	OE A. M. S.	8,289,000 leke

KVO me proces verbalin e vlerësimit të datës 09.03.2021 ka shqyrtuar ofertat e paraqitura nga OE pjesëmarrës.

KVO ka kualifikuar vetëm OE P.I.

KVO ka s’kualifikuar OE A.M. S., për mosplotësim të kriterit 3.3 nënpika 2.4., pasi OE nuk ka paraqitur dokumentacionin i cili vërteton se ka ne organiken e tij 5 xhenerik. OE ka paraqitur dokumentacion vetëm për 3 (tre) xhenerik.

Nuk përmbush piken 3.3 nënpika 3 pasi ne stafin teknik për periudhën nëntor 2020 - janar 2021 OE nuk ka paraqitur dokumentacionin që të vërtetoj se ne stafin e tij ka të punësuar 15 persona për periudhën e kërkuar.

OE nuk përmbush pikën 3.3 nënpika 6 pasi nuk ka paraqitur certifikatën OHSAS 18001:2007/45001:2018 certifikatë e sistemit menaxherial të shëndetit dhe sigurisë në punë.

OE M. nuk përmbush piken 3.3 të kapacitetit teknik, nënpika 9 pasi nuk ka plotësuar një tabelë ku të tregohet kodi i pjesëve që do të zëvendësohen.

KVO, për OE P. I. ka konstatuar se i plotëson kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.

Ne përfundim KVO njoftoj nëpërmjet SEPP OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi në lidhje me vlerësimin dhe klasifikimin, i cili u bë në datë 09.03.2021 në SEPP.

Me shkresën 790/8 Prot. date 17.03.2021 Titullari i AK ka miratuar raportin përfundimtar për procedurën e prokurimit me objekt “ Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje mjeteve)” me FL 8,291,010 leke pa TVSH me fitues OE P. I. me ofertën ekonomike 8,190,000 leke pa TVSH.

Me shkresat 790/10 Prot. date 18.03.2021 është bërë njoftimi i fituesit me formularin e njoftimit të fituesit.

Komisioni i vlerësimit të ofertave me datë 20.03.2021 nga verifikimi i dokumentacionit origjinal dhe të noterizuar të paraqitura nga OE Poëer Industries, ka dalë në konkluzionin se dokumentacioni i shkruar i dorëzuar nga OE fitues përputhet me kërkesat e AK dhe ato të depozituara në SEPP.

Zbatimi i kontratës

AK me OE P.I. të shpallur fitues ka lidhur Kontratën nr.790/11 Prot date 23.03.2021

Me urdhrin nr. 790/12 date 23.03.2021 Titullari i AK për zbatimin e kontratës ka ngritur komisionin e përbërë nga; G. R.Kryetar; Gj.S. K. M.; A.T. dhe R. O.

Ne piken c të urdhrin nr. 790/12 date 23.03.2021, është përcaktuar që komisioni i marrjes së dorëzimit të mallit sipas sasisë të përcaktuar në specifikimet teknike nga Ofertuesi dhe në përfundim do të përgatis proces verbalin e marrjes së dorëzimit.

Marrja në dorëzim

Komisioni i marrjes në dorëzim me date 06.04.2021, sipas tyre pas verifikimit dhe kontrollit në vend për sasi të dhe specifikimet teknike të mallit të sjelle nga kontraktuesi P. I., ka arritur në përfundimin se sasia e mallit ka ardhur sipas specifikimeve të përcaktuara në kontratë.

Titulli i gjetjes	Mungesa e dokumentimit gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave
Situata:	Nga auditimi rezulton se: -Komisioni i marrjes në dorëzim ka marrë në dorëzim 151 pjese (mallra) të cilat përfshijnë dhe vendosjen e tyre, pra kemi mallra dhe shërbime njëkohësisht, për vlerën totale me TVSH 9,828,000 lekë. -Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka dokumentuar me ane të situacioneve, fotove dhe grafikut të shërbimeve për makinat që do ju zëvendësoheshin pjesët në ambientet e kontraktuesit. Nga auditimi nuk konstatohen që këto mjete transporti, sipas një grafiku të kenë qënë pranë ofiçinës së kontraktuesit dhe kenë marrë shërbimin e kontraktuar. Gjithashtu nuk ekziston asnjë proces verbal që të evidentoj dhe të vërtetoj zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara dhe të zëvendësuara me pjesët e reja. Në referim të rekomandimit të APP me nr. 2106 Prot. date 24.03.2021, gjatë marrjes në dorëzim për kontratat tip mallra/shërbime, rekomandohet që komisioni i marrjes në dorëzim, duhet të kërkoj nga kontraktuesi respektimin e termave të përcaktuara në dispozitat e kontratës, mbi kushtet e dorëzimit të mallit, duke administruar raporte apo proces verbale, si dhe çdo dokument tjetër, që shkërbenë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësisë apo garancisë që mallrat duhen të kenë, në momentin e dorëzimit pranë AK.
Kriteri:	Kontrata nr.790/11 Prot date 23.03.202; Urdhrin nr. 790/12 date 23.03.2021
Ndikimi/Efekti:	Rritje të shpenzimeve jo efektive
Shkaku:	Mos respektim i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Drejtori i DPPGJ, të hartoj nëpërmjet akteve administrative rregulla të qarta për të mundësuar gjurmën e auditit gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, të cilat në të gjitha rastet duhet të jenë të protokolluara dhe të administrohen nga zyra e protokoll/arkivit të DPPGJ-së sipas rregullave dhe normave arkivore në fuqi, për të mos lënë mundësi që raporte apo proces verbale të mund të gjenenrohen pas afateve kohore të përcaktuara në kushtet e kontratës së mallrave/shërbimeve
Afati	Në vijimësi

Për sa më lart, për veprimet apo mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi G. R., Gj. S., K. M., A. T. dhe R. O. në cilësinë e anëtarëve të zbatimit të kontratës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 185/53 Prot., datë 14.04.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e Subjektit

... sikurse ju kemi vënë në dijeni me observacionin me Nr. 185/49 Prot. datë 06.02.2023, nga proces –verbali mbajtur midis palëve grupit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës,është specifikuar numëri serial i pjesëve të cilat janë ndëruar mjeteve.

Qendrimi i grupit te auditimit te KLSH

Mqs jeni referuar observacionit të mëparshëm nr. 185/49 Prot., datë 06.02.2023, në mënyrë të përmbledhur keni pohuar, e citoj.

...ne asnjë parashikim ligjor nuk eshte përcaktuar forma e mbajtjes se proces verbalit te kryerjes se shërbimit ne kete rast.

... Pra nuk ka nje shtojce te miratuar apo ndonjë rregull te shkruar se si proces verbali i kryerjes se shërbimit duhet te mbajtur. Ne kete konteks Proces Verbali i kryerjes se shërbimit mbajtur nga OE dhe grupi i ndjekjes se kontratës eshte mbajtur me OE, sipas përcaktimeve kontraktuale dhe specifikimeve duke firmosur bashke proces verbalet përkatëse ne momentin e kryerjes se shërbimit.

Nderkohe qe ne kete faze te observimit keni paraqitur nje proces verbal te ndryshëm nga ai që grupi te auditimit i eshte vendosur në dispozicion gjate fazës së terrenit, referuar dhe observacionit te mëparshëm, ju e pranoni edhe vet, qe proces verbali nuk eshte parashikuar në ndonjë akt se si duhet mbajtur.

Në akt konstatimin respektiv për këtë çështje, grupi i auditimit ka konstatuar se:

Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka dokumentuar me ane të situacioneve, fotove dhe grafikut të shërbimeve për makinat që do ju zëvendësoheshin pjesët në ambientet e kontraktuesit.

Në lidhje me përcaktimin e formës, cdo shërbim që kryet duhet të dokumentohet pasi dhe APP e ka pasur këtë shqetësim për AK të cilat janë këshilluar nëpërmjet udhëzimeve për marrjen në dorëzim, dhe pikërisht për këtë APP në rekomandimin nr. 2106 Prot. date 24.03.2021, ka këshilluar AK që gjatë marrjes në dorëzim për kontratat tip mallra/shërbime, komisioni i marrjes në dorëzim, duhet të kërkoj nga kontraktuesi respektimin e termave të përcaktuara në dispozitat e kontratës, mbi kushtet e dorëzimit të mallit, duke administruar raporte apo proces verbale, si dhe çdo dokument tjetër, që shërben për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësisë apo garancisë që mallrat duhen të kenë, në momentin e dorëzimit pranë AK,. Proces verbali i dorëzuar nga DPPGJ, në këtë fazë të hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, plotëson kërkesat e kërkuara nga udhëzimet e APP-së dhe bazës ligjore në fuqi, si në formë dhe përmbajtje. Përpos faktit që është një dokument pa Nr. Protokolli, grupi i auditimit të KLSH, e pranon me rezerva duke e marrë në konsiderat që ky proces verbal i paraqitur në këtë fazë të hartimit të Raortit Përfundimtar të Auditimit provon realizimin e kontratës për shërbimet e kërkuara nga AK.

2.4.6. Procedura e prokurimit me objekt: “Uniforma dhe Veshje Speciale”

1. Urdhër Prokurimi Nr. 557/4 datë 26.02.2018	2. Njësia e Prokurimit: 1. Xh.T. 2. R.L. 3. M.Xh.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 557/5, datë 26.02.2018: 1. M.M. (Kryetar) 2. I.A. (Anëtare) 3. E. Xh. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”	6. Oferta fituese G.H., me vlerë 3,275,833 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit 174,167 lekë
5. Fondi Limit (pa TVSh) 3,450,000 lekë	9. Burimi Financimit: Nga buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë 1. I-F. 2. G. H. 3. M. 4. R c. 5. M.
8. Data e hapjes së ofertave: 12.03.2018		

11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës datë 18.04.2018 me vlerë 3,931,000 leke (me TVSh)		

Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë ka vendosur që blerja me objekt: “Uniforma dhe veshje speciale” bazuar në Ligjin nr. 6643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 914 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 33, pika 1.

Lidhur me nevojat që ka Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë për prokurimin e uniformave dhe veshjeve speciale pranë Njesisë së Prokurimit është paraqitur kërkesa me nr. 557 Prot., datë 26.02.2018 nga Drejtoria Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve. Bashkëlidhur kërkesës përgatitur po nga kjo drejtori gjendet sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Kominoshe	Palë	50
2	Përparëse standarde pune	Copë	300
3	Mushama shiu	Copë	250
4	Doreza saldimi prej lëkure	Palë	10
5	Doreza pune	Palë	2200
6	Çizme me nr. 38 deri 44	Palë	50
7	Këpucë me maja hekuri nr. 38 deri 40	Palë	55
8	Pajisje mbrojtëse fytyre dhe veshi	Copë	20
9	Jelek me logo, me zinxhir, me shirita, fosfoshent	Copë	1000
10	Çizme të thjeshta me nr. 38 deri 44	Palë	200
11	Rrip sigurie (lartësie)	Copë	5
12	Helmetë mbrojtëse	Copë	30
13	Syze mbrojtëse	Copë	30
14	Kostume pune	Palë	200
15	Këpucë pune nr. 38 deri 44	Palë	100
16	Xhup pune me mëngë të gjata me logo të AK ngjyrë jeshile	Copë	100
17	Xhup pune pa mëngë me logo të AK ngjyrë jeshile	Copë	50
18	Pantallona	Palë	150

Mbështetur në kërkesën e sipër cituar Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) ka nxjerrë Urdhrin nr. 557 datë 26.02.2018, “Për zhvillimin e procedurës procedurën e prokurimit Kërkesë për Propozim “Uniforma dhe Veshje Speciale””.

Referuar këtij urdhri ngarkohet NJP me përbërje: zj. Xh. T., zj. R. L. dhe zj. M. Xh. të zhvillojnë procedurën për blerjen e uniformave dhe veshjeve speciale me vlerë të Fondit Limit (FL) 3,450,000 lekë. Formulari i njoftimit të ofertës të kontratës është bërë më datë 19.04.2018 me afat kohor për dorëzimin e ofertave datë 1 muaj. Lloji i procedurës “Kërkesë për propozim” është përcaktuar nga NJP me proces verbalin pa numër të mbajtur më datë 28.02.2018.

Njësia e Prokurimit me anë të proces verbalit të mbajtur më datë 28.02.2018 ka përcaktuar si kriter për vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Uniforma dhe Veshje Speciale” çmimin më të ulët.

Hartimi i kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike

Struktura përgjegjëse për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike është Drejtoria Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve referuar Urdhrit nr. 557/1, datë 26.02.2018, “Për ngarkimin e strukturave përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë, për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit të parashikuara për vitin 2018”.

Kriteret e veçanta që Operatorët Ekonomik (OE) duhet të plotësojnë për kualifikim janë hartuar me shkresë nr. 557/3 Prot., e datës 26.02.2018.

Llogaritja e fondit limit

Argumentimi i fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt “Uniforma dhe Veshje Speciale” është referuar çmimit të tregut, më datë 26.02.2018, komisioni i përbërë nga Z. E. Xh., Zj. M. H. dhe Zj. A.H., si mëposhtë:

	R.C.	G.H.	E. ShPK
Fondi Limit pa TVSh	3,819,700	3,274,200	3,256,100
Fondi Limit me TVSh	4,583,640	3,929,040	3,907,320
TVSh	763,940	654,840	651,220

$(3,819,700+3,274,200+3,256,100)/3 = 3,450,000$ lekë

Fondi Limit pa TVSh 3,450,000 lekë

Fondi Limit me TVSh 4,140,000 lekë

TVSh 690,000 lekë

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Për hartimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt “Uniforma dhe Veshje Speciale” NJP ka mbajtur proces verbalin pa numër më datë 28.02.2018.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit / Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave me Urdhrin e titullarit të AK nr. 557/5, datë 26.02.2018 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) me përbërje: z. M. M. (Kryetar), zj. I. A. dhe z. E. Xh.

Më datë 12.03.2018 KVO ka hartuar proces verbalin e hapjes së ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik për procedurën e prokurimit me objekt “Uniforma dhe Veshje Speciale” me FL 3,450,000 lekë. Për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertë I-Fire ShPK me Nipt L....H, M. ShPK me Nipt K.....N, G. H. me Nipt K.J, R.K. ShPK me Nipt L....F, dhe M. me Nipt K.....H.

Më datë 16.03.2018 KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit të procedurës së prokurimit “kërkesë për ofertë” me objekt “Uniforma dhe Veshje Speciale” me FL 3,450,000 lekë. Është kualifikuar nga KVO operatori ekonomik G.H.me vlerë oferte 3,275,833 lekë pa TVSh

Nga auditimi rezulton se:

OE “G. H.” nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 germa “g” e “Operatori ekonomik duhet të paraqesë ditën dhe orën e hapjes së ofertave nga një mostër për çdo artikull objekt prokurimi, në përputhje me të gjitha specifikimet e kërkuara në DT”. Nga auditimit rezulton se Proces Verbali i mbajtur datë 12.03.2018, nuk përcakton saktë dhe qartë dorëzimin e mostrave.

Titulli i Gjetjes	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave
Situata	Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese u konstatua se: OE “G. H.” nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 germa “g” e “Operatori ekonomik duhet të paraqesë ditën dhe orën e hapjes së ofertave nga një mostër për çdo artikull objekt prokurimi, në përputhje me të gjitha specifikimet e kërkuara në DT”. Nga auditimit rezulton se Proces Verbali i mbajtur datë 12.03.2018, nuk përcakton saktë dhe qartë dorëzimin e mostrave.

Kriteri	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 24 pika 1, germa ç, neni 46 pika 1, neni, 53, pika 3.
Ndikimi/Efekti	Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.
Shkaku	Operatori Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	DPPGj, Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.
Afati	<i>Menjeherë</i>

Për sa më lart mban përgjegjësi: z. M. M., zj. I. A. dhe z. E. Xh., anëtarë të KVO.

Janë s’kualifikuar OE “I-F.”pasi:

- Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.2 pika 1 e “Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2014, 2015, 2016) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit”;
- Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.2 pika 2 e “Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2014, 2015 dhe 2016) vlera mesatare e së cilës të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit, të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse dhe raportin e auditit nga ekspertit kontabël”;
- Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 germa “b” e “Shoqëria duhet të jetë e pajisur edhe me certifikatat e mëposhtme, Certifikata: Sistemi menaxhimit të cilësisë (ISO 9001-2008), për certifikimin e kompanisë/ve prodhuese, sipas standardit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë, i cili garanton cilësinë e produkteve të kërkuara. Certifikata të jetë e përkthyer dhe e noterizuar”.

OE “M.” pasi:

Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 1 germa “ç” e “Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje)”;

Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 germa “b” e “Shoqëria duhet të jetë e pajisur edhe me certifikatat e mëposhtme, Certifikata: Sistemi menaxhimit të cilësisë (ISO 9001-2008), për certifikimin e kompanisë/ve prodhuese, sipas standardit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë, i cili garanton cilësinë e produkteve të kërkuara. Certifikata të jetë e përkthyer dhe e noterizuar”;

Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 germa “d” e “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë ISO 14001: 2015 vetjake të akredituar nga Institucione të Huaja ose vendase gjithashtu të paraqesë edhe certifikatën e akreditimit, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin që prokurohet”;

Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 germa “g” e “Operatori ekonomik duhet të paraqesë ditën dhe orën e hapjes së ofertave nga një mostër për çdo artikull objekt prokurimi, në përputhje me të gjitha specifikimet e kërkuara në DT”.

OE “R.” pasi:

Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.2 pika 1 e “Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2014, 2015, 2016) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit”;

Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.2 pika 2 e “Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2014, 2015 dhe 2016) vlera mesatare e së cilës të jetë jo më e vogël se 40 % e

vlerës se fondit limit, të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse dhe raportin e auditit nga ekspertit kontabël”;

Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 germa “g” e “Operatori ekonomik duhet të paraqesë ditën dhe orën e hapjes së ofertave nga një mostër për çdo artikull objekt prokurimi, në përputhje me të gjitha specifikimet e kërkuara në DT”;

Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 germa “d” e “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë ISO 14001: 2015 vetjake të akredituar nga Institucione të Huaja ose vendase gjithashtu të paraqesë edhe certifikatën e akreditimit, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin që prokurohet”;

Pasi OE “M.”, ka dorëzuar vetëm xhiron e tre viteve të fundit.

*****Raporti përmbledhës nr. 557/7 Prot., është hartuar nga KVO dhe miratuar nga titullari i AK më datë 27.03.2018.**

Formulari i njoftimit të fituesit nr. 557/9 Prot., është hartuar më datë 27.03.2018 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 13 datë 04.04.2018.

Në përfundim të procedurave për ofrimin uniformave dhe veshjeve speciale Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë është lidhur kontratë sipërmarrje me G.H.me nr. 557/14 Prot., datë 18.04.2018.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin nr. 557/16, datë 19.04.2018 “Për ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të kontratës nr. 557/14, datë 18.04.2018” me Operatorin Ekonomik të shpallur fitues në procedurën e prokurimit. Me OE “G. H.” është lidhur kontrata me vlerë 3,275,833 lekë pa TVSh dhe 3,931,000 lekë me TVSh. Formulari i njoftimit të kontratës është hartuar më nr. 557/15, datë 19.04.2018 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 16, datë 23.04.2018.

Në datë 04.04.2018 është mbajtur një Proces Verbal Rivlerësimi, për arsye të një lapsusi Njësia e Prokurimit në fazën e njoftimit të Kontratës së nënshkruar u konstatua se vlera e ofertuar nga OE ekonomik fitues ishte në vlerën e fondit limit, për këtë arsye Njësia e Prokurimit bëri rikthimin në rivlerësim duke mos bërë asnjë ndryshim nga vlerësimi i mëparshëm.

Zbatimi i kontratës

Grupi i punës është ngritur me Urdhrin nr. 557/16, datë 19.04.2018 “Për ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të kontratës nr. 557/14, datë 18.04.2018” që do të kryejë mbikëqyrjen e kontratës me përbërje z. M.B., z. A. K. dhe z. A.B.

Është mbajtur Proces-Verbali me datë 18.05.2018 për dorëzimin e mallit nga OE, ku shprehen se sasia dhe cilësia e mallit është sipas specifikimeve të përcaktuara në DST e kërkuara nga AK.

Blerja e “Uniforma dhe Veshje Speciale”, është paguar me Urdhër Shpenzimin nr. 145, datë 14.06.2018, shoqëruar me Fletë-hyrjen nr. 9, datë 18.05.2018, faturë nr. 29, datë 18.05.2018, Proces-Verbal datë 18.05.2018 dhe dokumentet e zhvillimit të tenderit.

Uniformat dhe veshjet speciale janë shpërndarë me fletë-daljet nr. 803-821, datë 25.06.2018, nr. 836-892, datë 02.07.2018 dhe 912, datë 10.07.2018.

2.4.7. Procedurës së Prokurimit me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre”

1. Urdhër Prokurimi Nr. 156/4 datë 31.01.2019	2. Njësia e Prokurimit: 1. E.Xh. 2. R. L. 3. M. Xh.	3.KVO U.nr. 156/5, datë 31.01.2019: 1. M. M. (Kryetar) 2. I.A. (Anëtare) 3. E. Xh. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 6,650,000 lekë	6. Oferta fituese	7. Diferenca me fondin limit 39,900 lekë

	R.C., me vlerë 6,610,100 lekë pa TVSh	
8. Data e hapjes së ofertave: 11.02.2019	9. Burimi Financimit: Nga buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë 1. P. I. 2. R. C. 3. L. 4. E. Sh. 5. S. CO
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës datë 25.02.2019 në shumën 7,932,120 leke (me TVSH)		

Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë ka vendosur që blerja me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” bazuar në Ligjin nr. 6643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 914 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 33, pika 1.

Lidhur me nevojat që ka Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë për prokurimin për Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre është paraqitur kërkesa me nr. 156 Prot., datë 21.01.2019 nga Drejtoria Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve. Bashkëlidhur kërkesës përgatitur po nga kjo drejtori gjendet sasia e mallit që kërkohet paraqitur e plotë në aneksin nr. III.1 dhe III.2.

Mbështetur në kërkesën e sipër cituar Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) ka nxjerrë Urdhrit nr. 156/4 datë 31.01.2019, “Për zhvillimin e procedurës procedurën e prokurimit Kërkesë për Propozim “Furnizime dhe materiale të tjera zyre (vegla pune)”.

Referuar këtij urdhri ngarkohet NJP me përbërje: z. E.Xh., zj. R. L. dhe zj. M. Xh. të zhvillojnë procedurën për blerjen e furnizime me materiale të tjera zyre (vegla pune) të Fondit Limit (FL) 6,650,000 lekë. Formulari i njoftimit të ofertës të kontratës është bërë më datë 28.02.2019 me afat kohor për dorëzimin e ofertave datë 1 muaj. Lloji i procedurës “Kërkesë për propozim” është përcaktuar nga NJP me proces verbalin pa numër të mbajtur më datë 11.02.2019.

Njësia e Prokurimit me anë të proces verbalit të mbajtur më datë 13.02.2019 ka përcaktuar si kriter për vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” çmimin më të ulët.

Hartimi i kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike

Struktura përgjegjëse për hartimin e kërkesave është Drejtoria Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve referuar Urdhrit nr. 156, datë 21.01.2019, “Për ngarkimin e strukturave përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit të parashikuara për vitin 2019”.

Kriteret e veçanta që Operatorët Ekonomik (OE) duhet të plotësojnë për kualifikim janë hartuar nga Sektori i Prokurimeve, shkresa nr. 156/3 Prot., e datës 31.01.2019.

Llogaritja e fondit limit

Argumentimi i fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” është referuar çmimit të tregut, më datë 03.01.2019, komisioni i përbërë nga Z. E. Xh., Zj. M.Xh.dhe Zj. A.L., si mëposhtë:

	Ligus	S. C.	P.I.
Fondi Limit pa TVSh	6,570,000	6,900,000	6,480,000
TVSh	1,314,000	1,380,000	1,296,000
Fondi Limit me TVSh	7,884,000	8,280,000	7,776,000

$(6,570,000+6,900,000+6,480,000)/3 = 6,650,000$ lekë

Fondi Limit pa TVSh 6,650,000 lekë

Fondi Limit me TVSh 7,980,000 lekë

TVSh 1,330,000 lekë

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Për hartimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” NJP ka mbajtur proces verbalin pa numër më datë 31.01.2019.

Nga auditimi rezulton se kriteret e vendosura nga NJP janë në përputhje me llojin e shërbimit që kërkohet të prokurohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit / Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave me Urdhrin e titullarit të AK nr. 156/5, datë 31.01.2019 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) me përbërje: z. M. M. (Kryetar), zj. I. A. dhe z. Er. Xh.

Më datë 11.02.2019 KVO ka hartuar proces verbalin e hapjes së ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” me FL 6,650,000 lekë. Për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertë Operatori Ekonomik (OE) “R. C.” ShPK me Nipt L....A. KVO ka vendosur se i duhet më shumë se një ditë punë kohë për të vlerësuar ofertën.

Më datë 13.02.201 KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit të procedurës së prokurimit “kërkesës për propozim” me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” me FL 6,650,000 lekë. Ka paraqitur ofertë vetëm OE “R.C.” ShPK me vlerë oferte 6,610,100lekë pa TVSh, i cili është kualifikuar nga KVO.

Raporti përmbledhës nr. 156/8 Prot., është hartuar nga KVO dhe miratuar nga titullari i AK më datë 21.02.2019.

Formulari i njoftimit të fituesit nr. 156/10 Prot., është hartuar më datë 21.02.2019 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 8 datë 25.02.2019.

Nga auditimi rezulton se:

Nuk është pjesë e dokumentacionit, bilanci i vitin 2015 dhe vlera e xhiros për vitin 2015, sipas DST pika 2.2 germa a dhe b, ku citohet se: “Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar” dhe “Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit”.

Gjithashtu, nuk është pjesë e dokumentacionit, marrëveshja për garancinë, sipas DST pika 2.3.7. ku citohet se: “Për mallrat e cituara në pikën 2.3.6 të kriterëve teknike duhet të jepet 1(një) vit garanci nga dita e lëvrimit të mallit. Kushtet e garancisë do të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve.”

Drejtoria e Përgjithshme e Pastrim Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, ka paraqitur observacione me shkresën nr. 185/53, datë 14.04.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1008/7, datë 18.04.2023:

Pretendimet e subjektit:

1. Lidhur me procedurën e prokurimit "Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.", struktura përgjegjëse për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike është Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve. Duke u nisur nga gjendja aktuale në Shqipëri, ku për shkak të përhapjes së coronavirusit të ri, po merren masa urgjente për dezinfektimin e ambienteve të jashtme të hapsirave publike nën administrimin e DPPGj me qëllim parandalimin e përhapjes së tij. Sqarohet se përse i përket numrit të trajtimeve në DST është përcaktuar se shërbimi do të kryhet çdo 24 orë për një afat 1 muaj nga data e lidhjes së kontratës me intervale të rregullta ditore. Nga këto 15 trajtime për stolat dekorativ dhe 15 trajtime për koshat dekorativ. Pra gjithsej 30 trajtime, 1 trajtim çdo 24 orë.
2. OE kanë bërë dorëzimin e mostrave në ditën dhe orën e hapjes së ofertave me të gjithë specifikimet e kërkuara në DT.
3. Lidhur me mungesën e bilancit të vitit 2015 nga OE, ato i shërbejnë AK për njohjen e gjendjes financiare të OE dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me saktësi të kontratës. Sa më sipër, referuar kuadrit ligjor në fuqi dhe proces verbalit të miratimit të kriterëve për kualifikim të mbajtur nga NjP qëllimi i vendosjes së këtij kriteri është njohja e gjendjes financiare të OE pjesmarrëse në procedurën e prokurimit.
4. ... mungesën e bilancit të vitit 2015 nga OE, ato i shërbejnë AK për njohjen e gjendjes financiare të OE dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me saktësi të kontratës. Sa më sipër, referuar kuadrit ligjor në fuqi dhe proces verbalit të miratimit të kriterëve për kualifikim të mbajtur nga NjP qëllimi i vendosjes së këtij kriteri është njohja e gjendjes financiare të OE pjesmarrëse në procedurën e prokurimit.
5. OE ka paraqitur në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 1 pompë marka "Scout" dhe 10 pompa të markës "Berger-Knapsacs Sprayer"...
6. OE në momentin e ofertimit ka paraqitur deklaratë për garancinë 1 vjeçare të mallit objekt prokurimi...

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për këto observacione nga faqja 48-170 duke përfshirë edhe materialet bashkëlidhur tyre (2.4.8, 2.4.9 dhe 2.4.11) nuk janë fakte të reja dhe këto pretendime janë të njëjtat që janë dërguar në akt-konstatime, dhe për të cilat grupi i auditimit i ka sqaruar në Projekt Raportin e Auditimit.

Titulli i gjetjes	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave
Situata	Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese u konstatua se: nuk është pjesë e dokumentacionit, bilanci i vitin 2015 dhe vlera e xhiros për vitin 2015, sipas DST pika 2.2 germa a dhe b, ku citohet se: "Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar" dhe "Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit". Gjithashtu, nuk është pjesë e dokumentacionit, marrëveshja për garancinë, sipas DST pika 2.3.7. ku citohet se: "Për mallrat e cituara në pikën 2.3.6 të kriterëve teknike duhet të jepet 1(një) vit garanci nga

	dita e lëvrimit të mallit. Kushtet e garancisë do të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve.”
Kriteri	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 24 pika 1, germa ç, neni 46 pika 1, neni, 53, pika 3.
Ndikimi/Efekti	Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.
Shkaku	Operatori Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	DPPGj, Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.
Afati	Menjeherë

Për sa më lart mban përgjegjësi: z. M. M., zj. I. A. dhe z. E. Xh., anëtarë të KVO.

Në përfundim të procedurave për blerjen “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre”, OE është lidhur kontratë sipërmarrje me nr. 156/11 Prot., datë 25.02.2019.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin nr. 156/12, datë 25.02.2019, “Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës nr. 156/11 Prot., datë 25.02.2019 me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre (vegla pune)” me Operatorin Ekonomik të shpallur fitues në procedurën e prokurimit. Me OE “R. C.” është lidhur kontrata me vlerë 6,610,100 lekë pa TVSh dhe 7,932,120 lekë me TVSh. Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 156/13 prot., është hartuar më datë 28.02.2019 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 9, datë 04.03.2019.

Zbatimi i kontratës

Grupi i punës që do të kryejë ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të Kontratës është ngritur me urdhrin e Titullarit të DPPGj, Bashkia Tiranë, nr. 156/12 prot., datë 25.02.2019 me përbërje zj. E.M., zj. A. K. dhe zj. E. K.

Është mbajtur Proces-Verbali me datë 25.03.2019 për dorëzimin e mallit nga OE, ku shprehen se sasia dhe cilësia e mallit është sipas specifikimeve të përcaktuara në DST e kërkuara nga AK. Blerja e “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre”, është paguar me Urdhër Shpenzimit nr. 89, datë 13.05.2019 dhe nr. 118, datë 17.06.2019, shoqëruar me Fletë-hyrjen nr. 7, datë 25.03.2019, faturë nr. 30, datë 25.03.2019, si dhe me fletë-daljet përkatëse nga muaji Maj-Nëntor 2019.

2.4.8. Procedurës së Prokurimit me objekt: “Uniforma dhe Veshje të tjera Speciale”

1. Urdhër Prokurimi Nr. 159/4 datë 31.01.2019	2. Njësia e Prokurimit: 1. E. Xh. 2. R.L. 3. M.Xh.	3. KVO -Urdhër nr. 159/5, datë 31.01.2019: 1. A. Q. (Kryetar) 2. E. Xh. (Anëtar) 3. L.M. (Anëtare)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,950,000 lekë	6. Oferta fituese G.H., me vlerë 4,785,000 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit 165,000 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 25.02.2019	9. Burimi Financimit: Nga buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë 1. G. H. 2. U. P. 3. R.C. 4. P. 5. E.M.

11. Ankimime AK, Ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 08.04.2019	15. Vlera e kontratës (me TVSh)	5,742,000

Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë ka vendosur që blerja me objekt: “Uniforma dhe veshje të tjera speciale” bazuar në Ligjin nr. 6643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 914 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 33, pika 1.

Lidhur me nevojat që ka Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë për prokurimin e uniformave dhe veshjeve të tjera speciale pranë Njesisë së Prokurimit është paraqitur kërkesa me nr. 159 Prot., datë 21.01.2019 nga Drejtoria Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve. Bashkëlidhur kërkesës përgatitur po nga kjo drejtori gjendet sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Kominoshe	Palë	2500
2	Përparëse standarde pune	Copë	1400
3	Mushama shiu	Copë	1100
4	Doreza saldimi prej lëkure	Palë	1000
5	Doreza pune	Palë	80
6	Çizme me nr. 38 deri 44	Palë	2500
7	Këpucë me maja hekuri nr. 38 deri 40	Palë	3900
8	Pajisje mbrojtëse fytire dhe veshi	Copë	2900
9	Jelek me logo, me zinxhir, me shirita, fosforeshent	Copë	650
10	Çizme të thjeshta me nr. 38 deri 44	Palë	1560
11	Rrip sigurie (lartësie)	Copë	7500
12	Helmetë mbrojtëse	Copë	1000
13	Syze mbrojtëse	Copë	400
14	Kostume pune	Palë	4700
15	Këpucë pune nr. 38 deri 44	Palë	3000
16	Xhup pune me mëngë të gjata me logo të AK ngjyrë jeshile	Copë	3600
17	Xhup pune pa mëngë me logo të AK ngjyrë jeshile	Copë	3100
18	Pantallona	Palë	1800
19	Bluze me mëngë të shkurtra me jakë, me shirita fosforeshente, ngjyrë jeshile	Copë	1200

Mbështetur në kërkesën e sipër cituar Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) ka nxjerrë Urdhrit nr. 159/4 datë 31.01.2019, “Për zhvillimin e procedurës procedurën e prokurimit Kërkesë për Propozim “Uniforma dhe Veshje të tjera Speciale”.

Referuar këtij urdhri ngarkohet NJP me përbërje: z. E.Xh., zj. R. L. dhe zj. M. Xh. të zhvillojnë procedurën për blerjen e uniformave dhe veshjeve speciale me vlerë të Fondit Limit (FL) 4,950,000 lekë. Formulari i njoftimit të ofertës të kontratës është bërë më datë 31.01.2019 me afat kohor për dorëzimin e ofertave datë 1 muaj. Lloji i procedurës “Kërkesë për propozim” është përcaktuar nga NJP me proces verbalin pa numër të mbajtur më datë 31.01.2019.

Njësia e Prokurimit me anë të proces verbalit të mbajtur më datë 31.01.2019 ka përcaktuar si kriter për vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Uniforma dhe Veshje të tjera Speciale” çmimin më të ulët.

Hartimi i kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike

Struktura përgjegjëse për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike është Drejtoria Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve referuar Urdhrit nr. 159, datë 21.01.2019, “Për ngarkimin e strukturave përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme e Pastrimit dhe

Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit të parashikuara për vitin 2019”.

Kriteret e veçanta që Operatorët Ekonomik (OE) duhet të plotësojnë për kualifikim janë hartuar nga Sektori i Prokurimeve, shkresa nr. 159/3 Prot., e datës 31.01.2019.

Llogaritja e fondit limit

Argumentimi i fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt “Uniforma dhe Veshje të tjera Speciale” është referuar çmimit të tregut, më datë 03.01.2019, komisioni i përbërë nga Z. E.Xh., Zj. M. H. dhe Zj. A.L., si mëposhtë:

	R.C.	U. P.	G. H.
Fondi Limit pa TVSh	4,457,100	5,607,500	4,785,000
TVSh	891,420	1,121,500	957,000
Fondi Limit me TVSh	5,348,520	6,729,000	5,742,600

$(4,457,100+5,607,500+4,785,000)/3 = 4,950,000$ lekë

Fondi Limit pa TVSh 4,950,000 lekë

Fondi Limit me TVSh 5,940,000 lekë

TVSh 990,000 lekë

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Për hartimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt “Uniforma dhe Veshje të tjera Speciale” NJP ka mbajtur proces verbalin pa numër më datë 31.01.2019.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit / Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave me Urdhrin e titullarit të AK nr. 159/5, datë 31.01.2019 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) me përbërje: z. A. Q.(Kryetar), zj. L. M. dhe z. E.Xh.

Më datë 25.02.2019 KVO ka hartuar proces verbalin e hapjes së ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik për procedurën e prokurimit me objekt “Uniforma dhe Veshje të tjera Speciale” me FL 4,950,000 lekë. Për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertë “G.H.” me Nipt K....J, “U.P.” me Nipt K...M, “R.C.” me Nipt L....A, “P.” ShPK me Nipt L....R dhe “E.M.” me Nipt L....C.

Më datë 01.03.2019 KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit të procedurës së prokurimit “kërkesë për ofertë” me objekt “Uniforma dhe Veshje të tjera Speciale” me FL 4,950,000 lekë. Është kualifikuar nga KVO operatori ekonomik G.H. me vlerë oferte 4,785,000 lekë pa TVSh.

Nga auditimi rezulton se,

1. OE “G.H.” nuk plotëson kriterin e përgjithshëm të vendosur në pikën 2 ku citohet “Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktor. Këto kriteret (pikat 1,2,) duhet të vërtetohen përmes dokumenteve të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës” për detyrimet fiskale dhe detyrimet e sigurimeve shoqërore, pasi OE ka marrë vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria Operacionale dhe Teknike me shkresë nr. 124774/1, datë 04.05.2018, pra është marrë vërtetimi përpara datës 25.11.2018 që llogaritet me afatin e hapjes së ofertës;

2. Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 “Kapaciteti Teknik”, shkronja c, ku citohet “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skeda teknike, katalog ose fragmente të katalogëve të prodhuesve të mallrave objekt prokurimi, si dhe raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, sipas shtojcës 10 në specifikimet teknike”, pasi katalogu ose fragmente të katalogëve të prodhuesve të mallrave objekt prokurimi nuk janë pjesë e dosjes;

3. Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 “Kapaciteti Teknik”, shkronja c, ku citohet “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skeda teknike, katalog ose fragmente të katalogëve të prodhuesve të mallrave objekt prokurimi, si dhe raportet e testimet nga laboratorë të akredituar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, sipas shtojcës 10 në specifikimet teknike”, pasi nuk janë raportet dhe testimet për artikujt: Kominoshe; Përparëse standarde pune; Çizme; Xhup pune me mëngë të gjata me logo të AK ngjyrë jeshile; Xhup pune pa mëngë të gjata me logo të AK ngjyrë jeshile.

Titulli i gjetjes	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave
Situata	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese rezulton se: nuk është pjesë e dokumentacionit, bilanci i vitin 2015 dhe vlera e xhiros për vitin 2015, sipas Nuk plotëson kriterin e përgjithshëm të vendosur në pikën 2 ku citohet “Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktor. Këto kritere (pikat 1,2,) duhet të vërtetohen përmes dokumenteve të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës” për detyrimet fiskale dhe detyrimet e sigurimeve shoqërore, pasi OE ka marrë vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria Operacionale dhe Teknike me shkresë nr. 124774/1, datë 04.05.2018, pra është marrë vërtetimi përpara datës 25.11.2018 që llogaritet me afatin e hapjes së ofertës;</p> <p>Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 “Kapaciteti Teknik”, shkronja c, ku citohet “Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë skeda teknike, katalog ose fragmente të katalogëve të prodhuesve të mallrave objekt prokurimi, si dhe raportet e testimet nga laboratorë të akredituar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, sipas shtojcës 10 në specifikimet teknike”, pasi katalogu ose fragmente të katalogëve të prodhuesve të mallrave objekt prokurimi nuk janë pjesë e dosjes;</p> <p>Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 “Kapaciteti Teknik”, shkronja c, ku citohet “Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë skeda teknike, katalog ose fragmente të katalogëve të prodhuesve të mallrave objekt prokurimi, si dhe raportet e testimet nga laboratorë të akredituar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, sipas shtojcës 10 në specifikimet teknike”, pasi nuk janë raportet dhe testimet për artikujt: Kominoshe; Përparëse standarde pune; Çizme; Xhup pune me mëngë të gjata me logo të AK ngjyrë jeshile; Xhup pune pa mëngë të gjata me logo të AK ngjyrë jeshile.</p>
Kriteri	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 24 pika 1, germa ç, neni 46 pika 1, neni, 53, pika 3.
Ndikimi/Efekti	Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.
Shkaku	Operatori Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	DPPGj, Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e

	kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.
Afati	Menjeherë

Për sa më lart mban përgjegjësi: z. A. Q., zj. L. M. dhe z. E.X.h, anëtarë të KVO.

KVO ka s'kualifikuar: OE "U. P." me oferte ekonomike 4,595,415 lekë pasi:

- Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti teknik germa b "Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë ISO 9001: 2015; ISO 14001: 2015 vetjake të akredituar nga Institucione të Huaja ose vendase gjithashtu të paraqesë edhe certifikatën e akreditimit, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin që prokurohet." Pasi ka sjellë certifikatat ISO, por nuk ka paraqitur Certifikatë e Akreditimit;

- Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti teknik germa c "Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skeda teknike, katalog ose fragmente të katalogëve të prodhuesve të mallrave objekt prokurimi, si dhe raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, sipas shtojcës 10 në specifikimet teknike", pasi nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të ofertës së paraqitur nga ky ofertues, duke qenë se nuk është prodhues i mallrave të ofertuar ka deklaruar se prodhues i mallrave të ofertës prej tij janë përkatësisht shoqëria "M.", "C.", "D.P. H.", ndërkohë që katalogu i produkteve të ofruara është i botuar në emër të operatorit ekonomik "U. P."ShPK dhe jo në emër të shoqërive prodhuese të sipërpërmendura;

-Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti teknik germa c "Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skeda teknike, katalog ose fragmente të katalogëve të prodhuesve të mallrave objekt prokurimi, si dhe raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, sipas shtojcës 10 në specifikimet teknike", pasi nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të ofertës së paraqitur nga ky ofertues, duke qenë se nuk është prodhues i mallrave të ofertuar ka deklaruar se prodhues i mallrave të ofertës prej tij janë përkatësisht shoqëria "M.", "C.", "D. P. H.", ndërkohë që për mallrat e ofruar dhe të prodhuara nga prodhuesit C. dhe D. P. H., nuk ka paraqitur raporte testimi me qëllim plotësimin e standardeve të dhëna në specifikimet teknike ndërsa raportet e analizave të hartuara nga prodhuesi M.dhe të ofruara nuk vërtetojnë se plotësojnë standardet e kërkuara në shtojcën "Specifikimet Teknike";

-Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti teknik germa c "Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skeda teknike, katalog ose fragmente të katalogëve të prodhuesve të mallrave objekt prokurimi, si dhe raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, sipas shtojcës 10 në specifikimet teknike", pasi nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të ofertës së paraqitur nga ky ofertues, konstatohet se nuk përmbush specifikimet dhe standardet për këto produkte:

1. Për artikullin "Mushama shiu" me nr. 3 në "Ofertën Teknike" nuk përcaktohet që është e klasit 3:1.

2. Për artikullin "Doreza dore" me nr. 4 në "Ofertën Teknike" nuk plotëson standardin EN 420:2003.

3. Për artikullin "Çizme me majë hekuri" me nr. 6 në "Ofertën Teknike" nuk plotëson standardet e kërkuara.

4. Për artikullin "Këpucë me majë hekuri" me nr. 7 në "Ofertën Teknike" nuk plotëson standardet e kërkuara.

5. Për artikullin "Pajisje mbrojtëse fytyre dhe veshi" me nr. 8 në "Ofertën Teknike" asnjëri prej modeleve "Balbi2", apo "Pico2", apo "Spa 3", nuk i plotëson e vetëm të gjitha kriteret e kërkuara.

6. Për artikullin “Jelek me logo me zinxhir me shirita fosforeshentë” me nr. 9 në “Ofertën Teknike” nuk përcaktohet që është klasi 2 sipas direktivës 89/686/EEC.

7. Për artikullin “Çizme të thjeshta” me nr. 10 në “Ofertën Teknike” nuk përcaktohet që është prej materiali “PVC nitrile”.

8. Për artikullin “Syze mbrojtëse” me nr. 13 në “Ofertën Teknike” nuk plotëson standardet e kërkuara.

9. Për artikullin “Këpucë pune” me nr. 15 në “Ofertën Teknike” nuk plotëson standardet teknike, pasi nuk jepet asnjë e dhënë lidhur me parametrat teknike.

10. Për artikullin “Pantallona Pune” me nr. 18 në “Ofertën Teknike” nuk përcaktohet që është “UPF 50+”.

OE “R.C.” me ofertë ekonomike 4,917,000 lekë pasi:

- Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti teknik germa c, pasi operatori ekonomik R. C. nuk ka paraqitur skeda teknike, katalog ose fragmente të katalogëve të prodhuara të mallrave objekt prokurimi, si dhe raportet e testimi nga laboratorë të akredituar.

- Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti teknik germa b, pasi operatori ekonomik R. C. nuk ka paraqitur Autorizim nga kompania prodhuese ose nga distributor të autorizuar të saj.

- Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti teknik germa e, pasi ditën dhe orën e hapjes së ofertave 25.02.2019 ora 11:00 nuk është paraqitur pranë ambienteve të AK për të shfaqur mostrat e çdo artikulli objekt prokurimi.

- Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti teknik germa f, pasi dokumenti i paraqitur si ofertë teknike nuk është paraqitur në formatin e tabelës së kërkuar nga AK në DST, kjo përbën shkak për s’kualifikimin e OE R.C.ShPK.

OE “P.” ShPK me oferte ekonomike 4,900,850 lekë pasi:

- Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti teknik germa b, pasi certifikata ISO të paraqitura nga OE nuk janë të shoqëruara me nga certifikata e akreditimit ku objekti i së cilës të jetë i njëjtë me objektin e prokuruar.

-Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti teknik germa c, pasi OE nuk ka paraqitur skeda teknike, katalog ose fragmente të katalogëve të prodhuesve të mallrave objekt prokurimi, si dhe raportet e testimi nga laboratorë të akredituar.

- Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti teknik germa b, pasi OE nuk ka paraqitur Autorizim nga kompania prodhuese ose nga distributor të autorizuar të saj.

- Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti teknik germa e, pasi ditën dhe orën e hapjes së ofertave 25.02.2019 ora 11:00 nuk është paraqitur pranë ambienteve të AK për të shfaqur mostrat e çdo artikulli objekt prokurimi.

- Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti teknik germa f, pasi dokumenti i paraqitur si ofertë teknike nuk është paraqitur në formatin e tabelës së kërkuar nga AK në DST, kjo përbën shkak për s’kualifikimin.

OE “E. M.” pasi, nuk ka dorëzuar asnjë dokument.

Me shkresë nr. 159/8 prot., datë 07.02.2019, “M.” ShPK, sipas shtojcës 21 ka protokolluar në DPPGj “Formulari i ankesës pranë AK”, lidhur me:

Ndryshimin e shtojcës 9, kërkesë për dorëzimin e Eksraktit të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit dhe shtojcës nr. 11, “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore”, si dhe keni ndryshuar shtojcën për Kushtet e Përgjithshme, kërkonti që dokumentet që kërkohet me vetëdeklarim, ju kërkonti ti paraqesin OE, ndërkohë që ato mund të vërtetohen nga ana juaj online.

Lidhur me kriteret e veçanta në pikën 2.3.c, duke parë shtojcën 10, konstatohet se ka paqartësi në kërkesën sipërcituar. Kërkohen raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Duke i parë artikujt një dhe nga një, shikojmë se pjesa më e madhe e artikujve kanë vetëm një përkrahim të ndërtimit të tyre.

Është kthyer përgjigje nga DPPGj me shkresë nr. 159/11 prot., datë 08.02.2019.

Zbatimi i kontratës

Grupi i punës është ngritur me Urdhrin nr. 159/18, datë 08.04.2019 “Për ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të kontratës nr. 159/17, datë 08.04.2019” që do të kryejë mbikëqyrjen e kontratës me përbërje zj. E. M., zj. I. Al. dhe zj. M.Xh.

Është mbajtur Proces-Verbali me datë 08.05.2019 për dorëzimin e mallit nga OE, ku shprehen se sasia dhe cilësia e mallit është sipas specifikimeve të përcaktuara në DST e kërkuara nga AK.

Blerja e “Uniforma dhe Veshje të tjera Speciale”, është paguar me Urdhër Shpenzimin nr. 123, datë 21.06.2019 dhe nr. 143, datë 25.06.2019, shoqëruar me Fletë-hyrjen nr. 9, datë 08.05.2019, faturë nr. 26, datë 08.05.2019, Proces-Verbal datë 08.05.2019 dhe dokumentet e zhvillimit të tenderit. Uniformat dhe veshjet speciale janë shpërndarë me fletë-daljet përkatëse nga muaji Qershor-Gusht 2019.

2.4.9. Procedurës së Prokurimit me objekt: “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.”

1. Urdhër Prokurimi Nr. 1160/4 datë 19.03.2020	2. Njësia e Prokurimit: 1. M. Xh. 2. J. P. 3. A. H.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 1160/5, datë 19.03.2020: 1. M. M. (Kryetar) 2. M.B. (Anëtar) 3. E. Xh. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “me negociim, pa shpallje”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 5,000,000 lekë	6. Oferta fituese P.S., me vlerë 4,995,000 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit 5,000 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 24.03.2020	9. Burimi Financimit: Nga buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë 1. A. 2. P. S. 3. F. 4. E. M. 5. R.C.
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 26.03.2020 në shumën 5,994,000 lekë (me TVSH)		

Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë ka vendosur që blerja me objekt: “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.” bazuar në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM-së nr. 914 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 33, pika 1.

Lidhur me nevojat që ka Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë për prokurimin për dezinfektim të sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj., pranë Njesisë së Prokurimit është paraqitur kërkesa me nr. 1160 Prot., datë 17.03.2020 nga Drejtoria Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve. Bashkëlidhur kërkesës përgatitur po nga kjo drejtori kërkohet:

Shërbimi duhet të kryhet çdo 24 orë.

Shërbimi duhet të kryhet me pompë.

Shërbimi duhet të kryhet nga punonjës të pajisur me të gjitha mjetet e sigurisë në punë (Kostume njëpërdorimshme, dorashka, maska, syze transparente)

Objektet që do të dezinfektohen paraqiten në tabelën e mëposhtme

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Stola	Copë	2000
2	Kosha	Copë	1000

Afatet e ekzekutimit: kohëzgjatja 1 muaj nga data e lidhjes së kontratës me intervale të rregullta ditore.

Mbështetur në kërkesën e sipër cituar Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) ka nxjerrë Urdhrin nr. 1160/4 datë 19.03.2020, “Për zhvillimin e procedurës procedurën e prokurimit Kërkesë për Propozim “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.””.

Referuar këtij urdhri ngarkohet NJP me përbërje: zj. A.H., z. J.P. dhe zj. M. Xh. të zhvillojnë procedurën për blerjen e dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj. me vlerë të Fondit Limit (FL) 5,000,000 lekë. Formulari i njoftimit të ofertës të kontratës është bërë më datë 30.03.2020 me afat kohor për dorëzimin e ofertave për 1 muaj. Lloji i procedurës “Me negociim pa shpallje” është përcaktuar nga NJP me proces verbalin pa numër të mbajtur më datë 19.03.2020.

Njësia e Prokurimit me anë të proces verbalit të mbajtur më datë 19.03.2020 ka përcaktuar si kriter për vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.” çmimin më të ulët.

Nga auditimi rezulton se, në përlllogaritjen e fondit limit është llogaritur për 15 trajtime (dezinfektim), ndërkohë që në DST është specifikuar që shërbimi do të kryhet çdo 24 orë për një afat 1 mujor nga data e lidhjes së kontratës me intervale të rregullta ditore sipas shtojcës 10 “Shërbimet dhe Grafikut të Ekzekutimit”, pra në hartimin e DST nuk është caktuar saktë grafiku i trajtimit (dezinfektimit).

Titulli i gjetjes	Mos përcaktim i saktë i grafikut të dezinfektimit.
Situata	Në përlllogaritjen e fondit limit është llogaritur për 15 trajtime (dezinfektim), ndërkohë që në DST është specifikuar që shërbimi do të kryhet çdo 24 orë për një afat 1 mujor nga data e lidhjes së kontratës me intervale të rregullta ditore sipas shtojcës 10 “Shërbimet dhe Grafikut të Ekzekutimit”, pra në hartimin e DST nuk është caktuar saktë grafiku i trajtimit (dezinfektimit).
Kriteri	Dokumentet Standarde të Tenderit, Shtojca 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit”
Ndikimi/Efekti	Mos llogaritje e saktë e numrit të dezinfektimeve për afatin e kontratës.
Shkaku	Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe DST në përlllogaritjen e fondit limit nga NJP.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Njësia e Prokurimit në çdo rast në përlllogaritjen e fondit limit, duhet të analizojë, argumentojë dhe përcaktojë saktësisht vlerën sipas kriterëve të vendosura në DST.
Afati	Menjherë

Për sa më lart mban përgjegjësi: zj. M. Xh., z. J. P. dhe zj. A. H., në cilësinë e Njesisë së Prokurimit.

Hartimi i kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike

Struktura përgjegjëse për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike është Drejtoria Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve referuar Urdhrit nr. 1160/2, datë 17.03.2020, “Për ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike”. Kriteret e veçanta që OE duhet të plotësojnë për kualifikim, janë hartuar nga Sektori i Prokurimeve, me shkresën nr. 1160/3 Prot., datë 19.03.2020.

Llogaritja e fondit limit

Argumentimi i fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.” është referuar çmimit të tregut, më datë 06.01.2020, komisioni i përbërë nga Z. E.Xh., Zj. M.H. dhe Zj. A. L.si mëposhtë:

	F. ShPK	P. S.	M. A.
Fondi Limit pa TVSh	5,286,000	4,194,000	5,520,000
TVSh	1,057,200	838,800	1,104,000
Fondi Limit me TVSh	3,343,200	5,032,800	6,624,000

$(5,286,000+4,194,000+5,520,000)/3 = 5,000,000$ lekë

Fondi Limit pa TVSh 5,000,000 lekë

Fondi Limit me TVSh 6,000,000 lekë

TVSh 1,000,000 lekë

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Për hartimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.” NJP ka mbajtur proces verbalin pa numër më datë 19.03.2020.

Nga auditimi rezulton se kriteret e vendosura nga NJP janë në përputhje me llojin e shërbimit që kërkohet të prokurohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit / Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave me Urdhrin e titullarit të AK nr. 1160/5, datë 19.03.2020 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) me përbërje: z. M. M. (Kryetar), z. M. B. dhe z. E.Xh.

Më datë 24.03.2020 KVO ka hartuar proces verbalin e hapjes së ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik për procedurën e prokurimit me objekt “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj” me FL 5,000,000 lekë. Për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertë P. S.me Nipt K.....N, me ofertë ekonomike me vlerë 4,995,000 lekë.

Më datë 24.03.2020 KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit të procedurës së prokurimit “negocim pa shpallje” me objekt “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj” me FL 5,000,000 lekë. Është kualifikuar nga KVO operatori ekonomik “P.S.” me vlerë oferte 4,995,000 lekë pa TVSh.

Nga auditimi rezulton se, OE “P. S.” nuk plotëson kriteret e vendosur në DST, përkatësisht “Kritere të veçanta të kualifikimit” pika 2.2, germa “a” e “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, ku citohet, “Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2016, 2017, 2018) nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit”, dhe nga dokumentacioni rezulton se xhiro vjetore është dorëzuar për vitet 2017, 2018 dhe 2019 dhe jo për 2016, 2017 dhe 2018; “Kritere të veçanta të kualifikimit” pika 2.3, germa “g” e “Operatori ekonomik duhet të disponojë pompa të posaçme për dezinfektim (mbi 20 copë) dhe të vërtetohet me paraqitjen e Faturave dhe foto të tyre. Për kryerjen e shërbimit në ambientet e jashtme, duhet të përdoren pompa të posaçme, të cilat duhet të jenë gjendje dhe me të cilat duhet të realizohet shërbim me themel”, OE ka vërtetuar me dokumentacion që disponon 13 pompa nga 20 që kërkohen, si dhe për 10 pompa të blera me faturë nr. 25, datë 12.03.2020 nuk janë paraqitur foto bashkëlidhur.

Titulli i gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave, si dhe mangësi në plotësimin e kriterëve.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese rezulton se: “Kritere të veçanta të kualifikimit” pika 2.2, germa “a” e “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, ku citohet, “Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2016, 2017, 2018) nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit”, dhe nga dokumentacioni rezulton se xhiro vjetore është dorëzuar për vitet 2017, 2018 dhe 2019 dhe jo për 2016, 2017 dhe 2018; “Kritere të veçanta të kualifikimit” pika 2.3, germa “g” e “Operatori ekonomik duhet të disponojë pompa të posaçme për dezinfektim (mbi 20 copë) dhe të vërtetohet me paraqitjen e Faturave dhe foto të tyre. Për kryerjen e shërbimit në ambientet e jashtme, duhet të përdoren pompa të posaçme, të cilat duhet të jenë gjendje dhe me të cilat duhet të realizohet shërbim me themel”, OE ka vërtetuar me dokumentacion që disponon 13 pompa nga 20 që kërkohen, si dhe për 10 pompa të blera me faturë nr. 25, datë 12.03.2020 nuk janë paraqitur foto bashkëlidhur.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 24 pika 1, germa ç, neni 46 pika 1, neni, 53, pika 3 dhe Kriteri pika 2.3, germa “g”.
Ndikimi:	Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.
Shkaku	Operatori Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	DPPGj, Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.
Afati:	Menjeherë

Për sa më lart mban përgjegjësi: z. M. M., z. M.B. dhe z. E.Xh. anëtare të KVO.

Zbatimi i kontratës

Grupi i punës është ngritur me Urdhrin nr. 1182, datë 26.03.2020 “Për ndjekjen e zbatimit të kontratës me objekt “Dezinfektimi i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.”” që do të kryejë mbikëqyrjen e kontratës me përbërje z. B.V., z. E.T.dhe zj. A. T.

Është mbajtur Proces-Verbali me datë 26.04.2020 për zbatimin dhe ndjekjen e kontratës nr. 1160/10, datë 26.03.2020 për “Dezinfektimi i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.”, ku shërbimet e kryera nga OE janë sipas kërkesës dhe kushteve të caktuara nga AK dhe kryer sipas afatit të kontratës 1 muaj nga lidhja e kontratës dhe sipas intervaleve të kërkuara e pasqyruar kjo në situacionet me datë 10.04.2020 për periudhën 28.03.2020-10.04.2020 si dhe situacionit të datës 26.04.2020 për periudhën 11.04.2020-26.04.2020 nënshkruar nga gjithë komisioni i ngritur me urdhrin e sipërcituar, me vlerë përkatëse dhe faturë përkatëse në vlerë 5,994,000 lekë me TVSh.

Nga auditimi rezulton se, janë hartuar 2 situacione të nënshkruara nga mbikëqyrësit e kontratës dhe OE të cilat janë pjesë e dokumentacionit ku dhe është përcaktuar njësia, sasia, çmimi dhe numri i trajtimeve, por rezulton që këto situacione nuk kanë datë, dhe në asnjë rast

nuk është vërtetuar që shërbimi është kryer sipas kontratës nr. 1160/10, datë 26.03.2020 për “Dezinfektimi i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.”, neni 7, ku kërkohet që ky shërbim të jetë kryer çdo 24 orë, me pompë dhe nga punonjës të pajisur me të gjithë mjetet e sigurisë në punë (kostume një-përdorimshe, dorashka, maska, syze transparente).

Titulli i gjetjes:	Mangësi në plotësimin e dokumentacionit justifikues të kryerjes së pagesave (situacionit) nga mbikëqyrësit e kontratës
Situata:	Janë hartuar 2 situacione të nënshkuara nga mbikëqyrësit e kontratës dhe OE të cilat janë pjesë e dokumentacionit ku dhe është përcaktuar njësia, sasia, çmimi dhe numri i trajtimeve, por rezulton që këto situacione nuk kanë datë, dhe në asnjë rast nuk është vërtetuar që shërbimi është kryer sipas kontratës nr. 1160/10, datë 26.03.2020 për “Dezinfektimi i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.”, neni 7, ku kërkohet që ky shërbim të jetë kryer çdo 24 orë, me pompë dhe nga punonjës të pajisur me të gjithë mjetet e sigurisë në punë (kostume një-përdorimshe, dorashka, maska, syze transparente).
Kriteri:	Kontrata nr. 1160/10, datë 26.03.2020 për “Dezinfektimi i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.”, neni 7.
Ndikimi:	Pamundësia për të identifikuar shërbimin e ofruar.
Shkaku	Mos plotësim i saktë i dokumentacionit për pagesë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	DPPGj, Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për plotësimin e saktë të dokumentacionit justifikues për kryerjen e pagesës sipas kushteve të kontratës nga ana e kontraktorit.
Afati:	Menjherë

Për sa më lart mban përgjegjësi: z. B. V., z. E. T. dhe zj. A. T., në cilësinë e mbikëqyrjes dhe zbatimit të kontratës.

Shërbimi “Dezinfektimi i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.”, është paguar me Urdhër Shpenzimin nr. 58, datë 16.04.2020, bashkëlidhur fatura nr. 549, datë 10.04.2020, situacioni pa datë, Urdhër Shpenzimi nr. 77, datë 05.06.2020 dhe nr. 78, datë 09.06.2020, bashkëlidhur fatura nr. 614, datë 27.04.2020 dhe situacioni pa datë.

2.4.10. Procedurës së Prokurimit me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre”

1. Urdhër Prokurimi Nr. 1057/4 datë 28.02.2020	2. Njësia e Prokurimit: 1. A. H. 2. J. P. 3. M.Xh.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 1057/5, datë 28.02.2020: 1. M. M. (Kryetar) 2. I.A. (Anëtar) 3. E. Xh. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 6,666,000 lekë	6. Oferta fituese R. C.me vlerë 6,646,200 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit 19,800 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 12.03.2020	9. Burimi Financimit: Nga buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë 1. P. I. 2. G.H. 3. L. 4. S. C. 5. R. C.
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka
14. Lidhja e kontratës 30.03.2020	15. Vlera e kontratës (me TVSh)	7,975,440

Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë ka vendosur që blerja me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” bazuar në Ligjin nr. 6643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 914 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 33, pika 1.

Lidhur me nevojat që ka Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë për prokurimin për Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre është paraqitur kërkesa me nr. 1057Prot., datë 28.02.2020 nga Drejtoria Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve. Bashkëlidhur kërkesës përgatitur po nga kjo drejtori gjendet sasia e mallit që kërkohet, më i plotë në aneksin III.3 dhe III.4

Mbështetur në kërkesën e sipër cituar Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) ka nxjerrë Urdhrin nr. 1057/4 datë 28.02.2020, “Për zhvillimin e procedurës procedurën e prokurimit Kërkesë për Propozim “Furnizime dhe materiale të tjera zyre (vegla pune)”.

Referuar këtij urdhri ngarkohet NJP me përbërje: zj. A. H., z. J. P. dhe zj. M. Xh. të zhvillojnë procedurën për blerjen e furnizime me materiale të tjera zyre (vegla pune) të Fondit Limit (FL) 6,666,000 lekë. Formulari i njoftimit të ofertës të kontratës është bërë më datë 01.04.2020 me afat kohor për dorëzimin e ofertave datë 1 muaj. Lloji i procedurës “Kërkesë për propozim” është përcaktuar nga NJP me proces verbalin pa numër të mbajtur më datë 28.02.2020.

Njësia e Prokurimit me anë të proces verbalit të mbajtur më datë 28.02.2020 ka përcaktuar si kriter për vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” çmimin më të ulët.

Hartimi i kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike

Struktura përgjegjëse për hartimin e kërkesave është Drejtoria Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve referuar Urdhrit nr. 1057/2, datë 28.02.2020, “Për ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe kriterëve teknike”.

Kriteret e veçanta që Operatorët Ekonomik (OE) duhet të plotësojnë për kualifikim janë hartuar nga Sektori i Prokurimeve, shkresa nr. 1057/3 Prot., e datës 28.02.2020. Sipas kësaj shkrese OE duhet të vërtetojnë se:

Llogaritja e fondit limit

Argumentimi i fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” është referuar çmimit të tregut, më datë 06.01.2020, komisioni i përbërë nga Z. E. Xh., Zj. M. Xh. dhe Zj. A.L. si mëposhtë:

	L.	P. I.	I.ShPK
Fondi Limit pa TVSh	6,430,700	6,942,152	6,625,150
TVSh	1,286,140	1,388,430	1,325,030
Fondi Limit me TVSh	7,716,840	8,330,582	7,950,180

$(6,430,700+6,942,152+6,625,150)/3 = 6,666,000$ lekë

Fondi Limit pa TVSh 6,666,000 lekë

Fondi Limit me TVSh 5,332,800 lekë

TVSh 1,333,200 lekë

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Për hartimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” NJP ka mbajtur proces verbalin pa numër më datë 28.02.2020.

Nga auditimi rezulton se kriteret e vendosura nga NJP janë në përputhje me llojin e shërbimit që kërkohet të prokurohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit / Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave me Urdhrin e titullarit të AK nr. 1057/5, datë 28.02.2020 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) me përbërje: z. M.M. (Kryetar), zj. I.A. dhe z. E. Xh.

Më datë 12.03.2020 KVO ka hartuar proces verbalin e hapjes së ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” me FL 6,666,000 lekë. Për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertë Operatori Ekonomik (OE) “R. C.” ShPK me Nipt L....A. KVO ka vendosur se i duhet më shumë se një ditë punë kohë për të vlerësuar ofertën.

Më datë 17.03.2020 KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit të procedurës së prokurimit “kërkesës për propozim” me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” me FL 6,666,000 lekë. Ka paraqitur ofertë vetëm OE “R. C.” ShPK me vlerë oferte 6,646,200 lekë pa TVSh, i cili është kualifikuar nga KVO.

Raporti përmbledhës nr. 1057/8 Prot., është hartuar nga KVO dhe miratuar nga titullari i AK më datë 25.03.2020.

Formulari i njoftimit të fituesit nr. 1057/10 Prot., është hartuar më datë 25.03.2020 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 17 datë 30.03.2020.

Në përfundim të procedurave për blerjen “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre”, OE është lidhur kontratë sipërmarrje me nr. 1057/11 Prot., datë 30.03.2020.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin nr. 1192, datë 30.03.2020, “Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre (vegla pune)”” me Operatorin Ekonomik të shpallur fitues në procedurën e prokurimit. Me OE “R. C.” është lidhur kontrata me vlerë 6,646,200 lekë pa TVSh dhe 7,975,440 lekë me TVSh. Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 1057/12 prot., është hartuar më datë 01.04.2020 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 19, datë 14.04.2020.

Nga auditimi rezulton se, nuk është pjesë e dokumentacionit, marrëveshja për garancinë, sipas DST pika 2.3 germa “h” ku citohet se: “Për mallrat e cituara në pikën 2.3.6 të kriterëve teknike duhet të jepet 1(një) vit garanci nga dita e lëvrimit të mallit. Kushtet e garancisë do të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve.”

Titulli i gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese u konstatua se, nuk është pjesë e dokumentacionit, marrëveshja për garancinë, sipas DST pika 2.3 germa “h” ku citohet se: “Për mallrat e cituara në pikën 2.3.6 të kriterëve teknike duhet të jepet 1(një) vit garanci nga dita e lëvrimit të mallit. Kushtet e garancisë do të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve.”
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 24 pika 1, germa ç, neni 46 pika 1, neni, 53, pika 3.
Ndikimi:	Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.
Shkaku	Operatori Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	DPPGj, Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.
Afati:	Menjeherë

Për sa më lart mban përgjegjësi: z. M. M., zj. I. A., dhe z. E. Xh., anëtarë të KVO.

Zbatimi i kontratës

Grupi i punës që do të kryejë ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të Kontratës është ngritur me urdhrin e Titullarit të DPPGj, Bashkia Tiranë, nr. 1192 prot., datë 30.03.2020 me përbërje z. E. Xh.j, zj. J.B.dhe z. J. Dh..

Është mbajtur Proces-Verbali me datë 30.06.2020 për dorëzimin e mallit nga OE, ku shprehen se sasia dhe cilësia e mallit është sipas specifikimeve të përcaktuara në DST e kërkuara nga AK.

Blerja e “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre”, është paguar me Urdhër Shpenzimin nr. 118, datë 21.10.2020 dhe nr. 232, datë 11.12.2020, shoqëruar me Fletë-hyrjen nr. 12, datë 30.06.2020, faturë nr. 3, datë 30.06.2020, si dhe me fletë-daljet përkatëse nga muaji Gusht-Shtator 2020.

Nga auditimi rezulton se; fatura origjinale e OE mbart datën 30.06.2020 dhe është paguar me dy Urdhër Shpenzime në datë 21.10.2020 dhe 11.12.2020, pra ka kaluar afati i pagesës së faturës, këto veprime janë në kundërshtim me:

Udhëzimi nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, ku citohet, germa “c”;

Udhëzimin nr. 37, datë 06.10.2020, “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme”, ku citohet se “stok i detyrimeve të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të transaksioneve të shpenzimeve të njësisve shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë të papaguara prej mbi 60 ditë kalendarike që nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik;

Kontratën nr. 1057/11, datë 30.03.2020, nenin 6 “Kushtet e pagesës”, pika 2 ku citohet “Pagesa si rregull do të bëhet, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që është dorëzuar gjithë dokumentacioni i nevojshëm që vërteton përmbushjen e kushteve të kontratës nga kontraktuesi”.

Veprime të tilla nga ana e DPPGj, Bashkia Tiranë, tregojnë për një planifikim të dobët të fondeve buxhetore dhe shton riskun e krijimit të kamatëvonesave dhe shtimin e pagesave joefektive për buxhetin e shtetit.

Titulli i gjetjes:	Vonesa në shlyerjen e detyrimeve kontraktuale.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, konkretisht veprimet bankare, u konstatua se, fatura origjinale e OE mbart datën 30.06.2020 dhe është paguar me dy Urdhër Shpenzime në datë 21.10.2020 dhe 11.12.2020, pra ka kaluar afati i pagesës së faturës.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, ku citohet, germa “c”, Udhëzimin nr. 37, datë 06.10.2020, “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme”, ku citohet se “stok i detyrimeve të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të transaksioneve të shpenzimeve të njësisve shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë të papaguara prej mbi 60 ditë kalendarike që nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik, dhe Kontratën nr. 1057/11, datë 30.03.2020, nenin 6 “Kushtet e pagesës”, pika 2 ku citohet “Pagesa si rregull do të bëhet, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që është dorëzuar gjithë dokumentacioni i nevojshëm që vërteton përmbushjen e kushteve të kontratës nga kontraktuesi”.

Ndikimi:	Ekspozim i DPPGJ, Bashkisë Tiranë përballë riskut të pagesave me penalitete si rezultat i akumulimit të kamat vonesave nga mos shlyerja e detyrimeve kontraktuale.
Shkaku	Mungesë e planifikimit të drejtë të shpenzimeve të vitit dhe deficitit të vitit buxhetor, thyerje të radhës së shlyerjes së faturave dhe selektivitet në përzgjedhjen e tyre për pagesë (mosrespektimi i teknikës FIFO).
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	DPPGJ, Bashkia Tiranë të marrë masa që hartimi i programeve buxhetore afatmesëm të jenë sa më të drejtë e në përputhje me kërkesat e institucionit duke shmangur kështu shpenzime pa efektivitet të penaliteteve që mund të akumulohen nga vonesat në likuidimin e detyrimeve kontraktuale.
Afati:	Menjeherë

Për sa më lart mban përgjegjësi: Zj. A. B. në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe Zj. A. L. në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.4.11. Procedurës së Prokurimit me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre”

1. Urdhër Prokurimi Nr. 871/4 datë 18.02.2021	2. Njësia e Prokurimit: 1. A.K. 2. R. L. 3. A. K.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 871/5, datë 18.02.2021: 1. M. M. (Kryetar) 2. J. P.(Anëtar) 3. A.R. (Anëtare)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 5,833,000 lekë	6. Oferta fituese R. C., me vlerë 5,722,740 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit 110,260 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 01.03.2021	9. Burimi Financimit: Nga buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë 1. P.I. 2. G.H. 3. L. 4. S.C. 5. R. C.
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 26.03.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh)	6,867,288

Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë ka vendosur që blerja me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” bazuar në Ligjin nr. 6643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 914 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 33, pika 1.

Lidhur me nevojat që ka Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë për prokurimin për Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre është paraqitur kërkesa me nr. 871 Prot., datë 18.02.2021 nga Drejtoria Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve. Bashkëlidhur kërkesës përgatitur po nga kjo drejtori gjendet sasia e mallit që kërkohet, më i plotë në ankesin III.5 dhe III.6

Mbështetur në kërkesën e sipër cituar Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) ka nxjerrë Urdhrin nr. 871/4 datë 18.12.2021, “Për zhvillimin e procedurës procedurën e prokurimit Kërkesë për Propozim “Furnizime dhe materiale të tjera zyre (vegla pune)””.

Referuar këtij urdhri ngarkohet NJP me përbërje: zj. A.K., zj. R. L. dhe zj. A.K. të zhvillojnë procedurën për blerjen e furnizime me materiale të tjera zyre (vegla pune) të Fondit Limit (FL) 5,883,000 lekë. Formulari i njoftimit të ofertës të kontratës është bërë më datë 18.02.2021 me

afat kohor për dorëzimin e ofertave datë 1 muaj. Lloji i procedurës “Kërkesë për propozim” është përcaktuar nga NJP me proces verbalin pa numër të mbajtur më datë 18.02.2021. Njësia e Prokurimit me anë të proces verbalit të mbajtur më datë 18.02.2021 ka përcaktuar si kriter për vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” çmimin më të ulët.

Hartimi i kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike

Struktura përgjegjëse për hartimin e kërkesave është Drejtoria Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve referuar Urdhrit nr. 871/2, datë 18.02.2021, “Për ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta”. Kriteret e veçanta që Operatorët Ekonomik (OE) duhet të plotësojnë për kualifikim janë hartuar nga Sektori i Prokurimeve, shkresa nr. 871/3 Prot., e datës 18.02.2021.

Llogaritja e fondit limit

Proces Verbal i përllogaritjes së fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” është referuar çmimit të tregut, çmimet e kontratave të mëparshme dhe çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht më datë 18.02.2021, grupi i punës i përbërë nga Zj. E.L., Zj. E.Ç. dhe Zj. D.a D., si mëposhtë:
 $(65,792,270+5,951,000+5,755,750)/3 = 5,833,007$ lekë pa TVSh
TVSh 1,166,601 lekë
Çmimi me TVSh 6,999,608 lekë

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Për hartimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” NJP ka mbajtur proces verbalin pa numër më datë 18.02.2021. Nga auditimi rezulton se kriteret e vendosura nga NJP janë në përputhje me llojin e shërbimit që kërkohet të prokurohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit / Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave me Urdhrin e titullarit të AK nr. 871/5, datë 18.02.2021 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) me përbërje: z. M. M. (Kryetar), z. J. P. dhe zj. A.R. Më datë 01.03.2021 KVO ka hartuar proces verbalin e hapjes së ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” me FL 5,833,000 lekë. Për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertë Operatori Ekonomik (OE) “R. C.” ShPK me Nipt L.....A. KVO ka vendosur se i duhet më shumë se një ditë punë kohë për të vlerësuar ofertën.

Më datë 04.03.2021 KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit të procedurës së prokurimit “kërkesës për propozim” me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” me FL 5,833,000 lekë. Ka paraqitur ofertë vetëm OE “R. C.” ShPK me vlerë oferte 5,722,720 lekë pa TVSh, i cili është kualifikuar nga KVO.

Raporti përmbledhës nr. 871/8 Prot., është hartuar nga KVO dhe miratuar nga titullari i AK më datë 12.03.2021.

Formulari i njoftimit të fituesit nr. 871/10 Prot., është hartuar më datë 12.03.2021 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 42 datë 23.03.2021.

Nga auditimi rezulton se, nuk është pjesë e dokumentacionit, marrëveshja për garancinë, sipas DST pika 2.3.9. ku citohet se: “Për mallrat e cituara në pikën 2.3.6 të kritereve teknike duhet të jepet 1(një) vit garanci nga dita e lëvrimit të mallit. Kushtet e garancisë do të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve.”

Titulli i gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese u konstatua se, nuk është pjesë e dokumentacionit, marrëveshja për garancinë, sipas DST pika 2.3 germa “h” ku citohet se: “Për mallrat e cituara në pikën 2.3.6 të kriterëve teknike duhet të jepet 1(një) vit garanci nga dita e lëvrimin të mallit. Kushtet e garancisë do të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve.”.
Kriteri:	Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80, pika 1, neni 92, pika 3.
Ndikimi:	Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.
Shkaku	Operatori Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	DPPGj, Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.
Afati:	Menjeherë

Për sa më lart mban përgjegjësi: z. M. M., z. J. P. dhe zj. A. R., anëtarë të KVO.

Në përfundim të procedurave për blerjen “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre”, OE është lidhur kontratë sipërmarrje me nr. 871/11 Prot., datë 26.03.2021.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin nr. 871/12, datë 26.03.2021, “Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës nr. 871/11 Prot., datë 26.03.2021 me objekt “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre (vegla pune)” me Operatorin Ekonomik të shpallur fitues në procedurën e prokurimit. Me OE “R.C.” është lidhur kontrata me vlerë 5,722,740 lekë pa TVSh dhe 6,867,288 lekë me TVSh. Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 871/13 prot., është hartuar më datë 30.03.2021 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 49, datë 06.04.2021.

Zbatimi i kontratës

Grupi i punës që do të kryejë ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të Kontratës është ngritur me urdhrin e Titullarit të DPPGj, Bashkia Tiranë, nr. 871/12 prot., datë 26.03.2021 me përbërje z. H.H., z. E. T.dhe zj. E. Ç.

Është mbajtur Proces-Verbali me datë 27.04.2021 për dorëzimin e mallit nga OE, ku shprehen se sasia dhe cilësia e mallit është sipas specifikimeve të përcaktuara në DST e kërkuara nga AK. Blerja e “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre”, është paguar me Urdhër Shpenzimit nr. 130, datë 10.06.2021, shoqëruar me Fletë-hyrjen nr. 12, datë 27.04.2021, faturë nr. 8/2021, datë 27.04.2021, si dhe me fletë-daljet përkatëse nga muaji Korrik-Dhjetor 2021.

2.4.12. Procedura e Prokurimit: “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”.

1. Urdhër Prokurimi nr. Nr.1326/4 prot. datë 29.03.2018 Njësinë e prokurimit: Xh. T.j, M. Xh., R.L.	3. Llogaritja e fondit limit Me anë të urdhrin nr.358, datë 07.02.2018 është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: M. H.i, E. Xh. dhe A. H. - Urdhër për ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike nr.1326/2 prot. datë	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Shkresa nr. 1326/5 prot. datë 29.03.2018 urdhërohet Komisioni i përbërë nga: A. Q., E.Xh., A. Q..
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur (shërbime)		

	29.03.2018, me përbërje: I. M. Z. B. dhe L.M.	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 8,300,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE "G.A" sh.p.k., me vlerë oferte 8,121,312 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 178,688 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 02.05.2018	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike 1. OE "G.-A" sh.p.k., me vlerë oferte 8,121,312 lekë pa tvsh. 2. "I." sh.p.k. me vlerë oferte 8,150,700 lekë pa tvsh.
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka; APP- nuk ka; KPP- nuk ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.1326/14, datë 30.05.2018 midis Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit (Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit), dhe operatori ekonomik "G.-A" sh.p.k., kontrata me afat 20 ditë nga data e nënshkrimit të saj, me çmim kontrate 8,121,312 lekë pa tvsh / 9,745,574 lekë me tvsh.	15.Vlera e kontratës (me tvsh) lekë: 9,745,574 lekë me tvsh	16.Likuiduar Urdhër shpenzimin me nr 179, datë 02.08.2018.
17- Situacioni Përfundimtar Vlera me tvsh 9,547,465 lekë Vlera pa tvsh 7,956,221 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 20 ditë Zbatuar 19 ditë	19. Zgjatja e kontratës me..... ditë Nuk ka

Për auditimin e kësaj procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2018-31.12.2021;

Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP;

Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar;

Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së;

Përlllogaritja e fondit limit.

Situacionin përfundimtar etj.

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike.

Nisur nga gjendja e amortizuar e godinës në të cilën ndodhen zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit (Sot Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit), me anë të shkresës nr.1326 prot., datë 29.03.2018, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Raportimi Online ka paraqitur kërkesën për shërbimin e mirëmbajtjes së objektit "Godinë në të cilën ndodhen zyrat e DPN1". Bashkëlidhur kësaj shkresë dhe foto të gjendjes ekzistuese të godinës, shkresa e hartuar dhe miratuar nga znj. E. D., znj. M.D., znj. E. D. (Specialiste), znj. B. S. (Përgjegjëse), znj. Sh. D. (Drejtore).

Kërkesa e mësipërme u miratuar nga Drejtoria e Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit z. A.Q., i cili nisur nga sa më lart kërkon hapjen e procedurës së prokurimit me objekt "Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore", me vlerë 8,300,000 lekë pa tvsh, miratuar dhe nga titullari i Autoritetit Kontraktor znj. A. B., me shkresën nr.1326/1 prot. datë 29.03.2018.

Znj.A. B. ka urdhëruar ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike me shkresën nr. 1326/2 prot. datë 29.03.2018, me përbërje: z. I.M., znj. Z. B. dhe znj. L.M.Komisioni i ngritur kanë hartuar dhe dorëzuar me shkresën nr.1326/3 prot. datë

29.03.2018, kriteret teknike që duhet të kenë operatorët ekonomik, (pjesë e DST), si dhe preventivat me sasi të.

Sipas urdhrit nr.358, datë 07.02.2018 “Për ngritjen e komisionit për llogaritjen e vlerës limit të kontratave” është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: znj. M.H., z. E. Xh. dhe znj. A. H. Grupi i punës ka mbajtur argumentimin “Për llogaritjen e vlerës limit”, më datë 29.03.2018, i cili për përlllogaritjen e vlerës së kontratës është bazuar në testimin të tregut, në bazë të tre ofertave. Anëtarët e komisionit të përlllogaritjes së vlerës limit, kanë llogaritur fondin limit me vlerë 8,300,000 lekë pa tvsh, kjo vlerë është mesatarja e tre ofertave. Urdhri i prokurimit me shkresën nr.1326/4 prot. datë 29.03.2018 urdhëron kryerjen e prokurimit me objekt “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”, me fond limit 8,300,000 lekë pa tvsh, procedurë e hapur, dhe ngritjen e njësisë së prokurimit të përbërë nga znj. Xh.T., znj. R. L., znj. M.Xh.

Njësia e prokurimit më datë 29.03.2018 ka mbajtur procesverbalin “Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit për kontratën me objekt “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”, ku ka përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë OE pjesëmarrës në procedurë.

Me anë të shkresave nr 1326/9 prot. datë 24.04.2018, dhe nr.1326/10 prot. datë 24.04.2018, AK ka bërë disa ndryshime në DST me anë të shtojcave për një modifikim në dokumentet standarde të tenderit, ku janë hequr/modifikuar disa kriteret.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve teknike rezulton se në procesverbalin e mbajtur nga grupi ka disa parregullsi në shkelje të Ligjit të prokurimit publik.

- Mungojnë specifikimet teknike për materialet që do të përdorën në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, neni 23 Specifikimet teknike, pika 4, ku citohet: “...Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale...”.

- Referuar DST pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika a ku citohet: “...Licenca profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme sipas modelit nga MPPTT). NS-1A Punime për prishjen e ndërtimeve...”, kriteri i vendosur në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 28 Kontratat e shërbimeve, pika 2, ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”.

Titulli i gjetjes:	Kriteret kualifikuese të paargumentuara dhe të pajustificuara kanë zvogëluar konkurrencën
Situata:	Për procedurën: “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore” rezultoi se: 1. Mungojnë specifikimet teknike për materialet që do të përdorën, në kundërshtim me nenin 23, pika 4, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar. 2. Kategoria e kërkuar e licencës NS-1A “Punime për prishjen e ndërtimeve” nuk ka lidhje me natyrën e kontratës, në kundërshtim me nenin 28, pika 2, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014.

Kriteri:	Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 Specifikimet teknike, pika 4. VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 28 Kontratat e shërbimeve, pika 2.
Ndikimi:	Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.
Shkaku	Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Njësia e Prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të marrë masa për përcaktimin e procedurës së prokurimit duke u mbështetur në natyrën e kontratës, si dhe për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit duke argumentuar dhe dokumentuar në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për të mosfavorizuar operatorë ekonomik të caktuar.
Afati:	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi njësia e prokurimit znj.Xh. T., znj.R. L., znj.M. Xh. në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe komisioni për përgatitjen e specifikimeve dhe kritereve teknike z.I. M., znj.Z. B., znj.L. M. në cilësinë e anëtarëve të komisioneve për përgatitjen e specifikimeve dhe kritereve teknike.

Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas shkresës nr.1326/5 prot. datë 29.03.2018 me lëndë “Urdhër për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave”, ngrihet komisioni i përbërë nga: z. A. Q., z. E. Xh., znj. A. Q. Komisioni më datë 02.05.2018, ka mbajtur procesverbalin e hapjes së ofertave ku ishin paraqitur 2 operatorë ekonomik:

Operatori ekonomik “G.-A” sh.p.k., me vlerë oferte 8,121,312 lekë pa tvsh.

Operatori ekonomik “I.” sh.p.k. me vlerë oferte 8,150,700 lekë pa tvsh.

Më datë 04.05.2018, komisioni ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit ku jepet informacion mbi shqyrtimin e ofertës dhe plotësimin e kritereve nga operatorët pjesëmarrës. Ku përcaktohet se:

Operatori ekonomik “G.-A” sh.p.k. me vlerë oferte 8,121,312 lekë pa tvsh, plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Operatori ekonomik “I.” sh.p.k. me vlerë oferte 8,150,700 lekë pa tvsh, plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

KVO ka klasifikuar Operatori ekonomik “G.-A” sh.p.k. si oferta më ekonomike dhe gjithashtu ka plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

*****Raporti përmbledhës** i mbajtur me nr.1326/11 prot. datë 15.05.2018, jepet informacion mbi procedurën, vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës, dhe klasifikimin nga KVO, në vendin e parë sipas kriterit çmimi më i ulët dhe i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e caktuara në DST, KVO ka klasifikuar operatorin ekonomik “G.-A” sh.p.k.. Ky raport është miratuar me anë të shkresës nr. 1326/12 prot. datë 15.05.2018, nga Titullari i AK znj. A. B. dhe Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit z. A. Q., ku dhe kanë shpallur fitues operatorin ekonomik “G.-A” sh.p.k. me vlerë oferte 8,121,312 lekë pa tvsh.

Nga auditimi i realizimit të procedurës në bazë të DST, rezulton se vlerësimi është realizuar konform kritereve të përcaktuara në DST dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Lidhja e kontratës

Është lidhur kontrata me nr.1326/14, datë 30.05.2018 midis Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit (Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit), të përfaqësuar nga Titullari i DPN1 znj. A. B. dhe operatorit ekonomik “G.-A” sh.p.k. me NIPT L....L, me licencë në zbatim NZ.6770/2, kontrata me afat 20 ditë nga data e nënshkrimit të saj, me çmim kontrate 8,121,312 lekë pa tvsh / 9,745,574 lekë me tvsh.

(Sigurimi i kontratës me vlerë 974,555 lekë me afat deri në zbatimin e kontratës).

Zbatimi i kontratës.

Me shkresën nr.1326/16 prot. datë 01.06.2018, urdhërohet “Për ndjekjen e zbatimit e kontratës me objekt “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore””, komisioni me përbërje: z. B. D.znj. A.N.znj. A. L., i cili ka ndjekur zbatimin e punimeve sipas cilësisë dhe specifikimeve dhe në përfundim duhet të përgatiste procesverbalin për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.

Më datë 18.06.2018, në prani të komisionit për ndjekjen e zbatimit e kontratës dhe të operatorit ekonomik është mbajtur procesverbali ku jepen tabela me sasi të dhe me anë të së cilës komisioni i marrjes në dorëzim ka kontrolluar punimet e realizuara në objekt dhe i konsideron ato të realizuara sipas specifikimeve teknike. Me anë të këtij dokumenti komisioni ka marrë në dorëzim punimet për sasi të sipas tabelës bashkëlidhur.

Situacioni i punimeve nr.1 i miratuar nga sipërmarrësi i punimeve dhe përfaqësuesi i DPN1, ka vlerën 4,900,754 lekë pa tvsh.

Situacioni përfundimtar i punimeve i miratuar nga sipërmarrësi i punimeve dhe përfaqësuesi i DPN1, ka vlerën 3,055,474 lekë pa tvsh. (Protokolluar në DNP1 me nr.2090 prot. datë 18.06.2018).

Situacioni përfundimtar akumulativ i punimeve i miratuar nga sipërmarrësi i punimeve dhe përfaqësuesi i DPN1, ka vlerën 7,956,221 lekë pa tvsh. (Protokolluar në DNP1 me nr.2090/1 prot. datë 18.06.2018).

Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezulton mungesat e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, si libri i masave, ditarët e punimeve, provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve etj. veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” kreu III, Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit, ku citohet:

“...2. Puna e kryer dhe çastet më të rëndësishme gjatë ndërtimit të objektit pasqyrohen në librin e kantierit, që mbahet në formën e ditarit të objektit e të raportit të punimeve.

2.1 Ditari i objektit pasqyron ngjarjet më të rëndësishme gjatë ecurisë së punimeve, deri në fund të periudhës së garancisë së tyre.

...4.Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre.

.... 9.Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen: dh) Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre...” etj.

Titulli i gjetjes:	Mungesat e dokumentave kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”, është konstatuar mungesa e dokumentave

	kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit, që vërtetoi kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, si libri i masave dhe vizatimeve, ditaret e punimeve, provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve, veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.
Kriteri:	Kreu III “Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit”, pika 2, 4, 9, Udhëzimi Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”
Ndikimi:	Mungesa e verifikimit të saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve dhe cilësisë të materialeve e të produkteve.
Shkaku	Mungesa e mbikëqyrjes së punimeve nga ekspert të fushës dhe realizimi i punimeve të ndërtimit si shërbim dhe jo procedura pune.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për ngritjen e një njësie për monitorimin e zbatimit të kontratave, e cila do të jetë përgjegjëse edhe për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik për secilën kontratë, me qëllim verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve, si dhe cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura dhe dokumentacioni i nevojshëm grafik.
Afati:	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, znj. A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

Operatori ekonomik ka sjellë faturën tatimore, me nr.179 datë 12.06.2018, me vlerë 5,880,905 lekë me tvsh / 4,900,754 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 149, datë 18.06.2018 (likuiduar vlera 5,880,905 lekë).

Operatori ekonomik ka sjellë faturën tatimore, me nr.185 datë 18.06.2018, me vlerë 3,666,570 lekë me tvsh / 3,055,475 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 168, datë 11.07.2018 (likuiduar vlera 3,000,000 lekë), likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 179, datë 02.08.2018 (likuiduar vlera 666,750 lekë).

Nga auditimi dokumentacionit mbi pagesën e faturave rezultoi se urdhër shpenzimet mbi pagesën e faturave janë kryer në kundërshtim me nenin nr 15 të KPK Afatet e Pagesës pika 15.4, ku citohet “...Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer shërbimet ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë...”.

Titulli i gjetjes:	Pagesa e faturave me vonesë, përtej afateve të përcaktuara në Kontratë
Situata:	Nga auditimi dokumentacionit mbi pagesën e faturave rezultoi se urdhër shpenzimet mbi pagesën e faturave janë kryer në kundërshtim me nenin nr 15 të KPK Afatet e Pagesës pika 15.4, ku citohet “...Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer shërbimet ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë...”.
Kriteri:	Kontrata me nr.1326/14, datë 30.05.2018 midis Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit (Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit) dhe OE “G.-A” sh.p.k.
Ndikimi:	Mundësi për pagesë fature me kamate në raste se do kërkohej nga OE

Shkaku:	Vonesa në pagesën e faturave
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për likuidimin e detyrimeve financiare, sipas afateve të përcaktuar në kontrata.
Afati:	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e financës dhe buxhetit, znj. L.M., në cilësinë e nënpunësit zbatues dhe znj. A. B., në cilësinë e nënpunësit autorizues.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si mëposhtë:

Tabela nr. 1: Diferencat e volumeve në objektin: “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Fakti	Diferenca në volume	
						Vol.	Vlera
	Pllakë b/a granili mbi parapet tarace,	m2	2,000	133.5	0	133.5	267,000
	Veshje fasade dekorative me elementë terrakote	m2	3,541	72	0	72	254,952
	Dritare d/alumini dyfish xham	m2	10,513	281.5	250	31.5	331,159
	FV Dyer blinduara	copë	505	27	0	27	13,635
	Parapet shkalle e ballkoni me hekur e korimano (veranda)	ton	207,612	0.6	0	0.6	124,567
Shuma							991,313

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit.

Diferencat janë të argumentuara si më poshtë:

Zëri Pllakë b/a granili mbi parapet tarrace. Sipas situacionit përfundimtar sasia e këtij zëri pune është 133.5 m2, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune nuk justifikohet. Nga rillogaritja, sipërfaqja e këtij zëri pune është 133.5 m2 më pak se sipërfaqja e situacionuar.

Zëri Veshje fasade dekorative me elementë terrakote. Sipas situacionit përfundimtar sasia e këtij zëri pune është 72 m2, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune nuk justifikohet. Nga rillogaritja, sipërfaqja e këtij zëri pune është 72 m2 më pak se sipërfaqja e situacionuar.

Zëri Dritare d/alumini dyfish xham. Sipas situacionit përfundimtar sasia e këtij zëri pune është 281.5 m2, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune është realizuar në sasinë 250 m2. Nga rillogaritja, sipërfaqja e këtij zëri pune është 31.5 m2 më pak se sipërfaqja e situacionuar.

Zëri FV Dyer blinduara. Sipas situacionit përfundimtar sasia e këtij zëri pune është 27 copë, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune ishte realizuar nuk është realizuar. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 27 copë më pak se sasia e situacionuar.

Zëri Parapet shkalle e ballkoni me hekur e korimano (veranda). Sipas situacionit përfundimtar volumi e këtij zëri pune është 0.6 ton, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune nuk justifikohet. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 0.6 ton më pak se volumi i situacionuar.

Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 991,313lekë pa tvsh / 1,189,575 lekë me tvsh, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Titulli i gjetjes:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”
Situata:	Nga auditimi i situacionit përfundimtar dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si mëposhtë: Zëri Pllakë b/a granili mbi parapet tarrace. Vlera prej 267,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Veshje fasade dekorative me elementë terrakote. Vlera prej 254,952 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Dritare d/alumini dyfish xham. Vlera prej 331,159 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri FV Dyer blinduara. Vlera prej 13,635 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Parapet shkalle e ballkoni me hekur e korimano (veranda). Vlera prej 124,567 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Argumentimi i këtyre diferencave pasqyrohen më sipër.
Kriteri:	Kreu II, pika 8.1 dhe kreu III, pika 4, i Udhëzimit Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”
Ndikimi:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë prej 1,225,791 lekë me tvsh në fondet e Buxhetit të Shtetit dhe njësisive vendore.
Shkaku	Mungesë e librit të masave si dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve. Mungesë e kontrollit të punimeve nga ana e grupit të marrjes në dorëzim.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, të marrë masat për ngritjen e një grupi pune që të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet të fondeve me vlerë prej 1,189,575 lekë me tvsh, vlerë e cila nuk argumentohet apo justifikohet.
Afati:	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi komisionit për ndjekjen e zbatimit e kontratës z.B. D., znj.A. N., znj.A. L. në cilësinë e anëtarëve të komisionit dhe Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit znj. A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, ka paraqitur observacionin nr. 185/53 prot., datë 14.04.2023, protokolluar KLSH nr. 1008/7 prot., datë 18.04.2023, ku pretendojnë, si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike:

1. Grupi i punës ka miratuar sipas projekt preventivit, së bashku me specifikimet teknike, (fq.56 observacionit);

Konstatime lidhur më zbatimin e kontratës:

2. Mbi pagesën përtej afateve të parashikuara në kontratë, DPPGJ observon se duke qenë institucion varësie e Bashkisë Tiranë, në rast tejkalimi limiti fondesh çdo muaj kërkon për çelje fondesh, (fq.73 observacionit);

3. Mbi sasitë e zërave të cilat mungojnë, (fq.120-140 observacionit):

a. kaseta shkarkimi janë pjesë përbërëse e shkarkimit të çatisë;

- b. Pllaka granili janë instaluar në tarracën e godinës;
- c. Veshje fasade dekorative, ka qenë pjesë e fasadës por është hequr si pasojë e dëmtimeve nga tërmeti, (bashkëlidhur procesverbal dëmtimi);
- d. Parapet, është hequr dhe ndodhet në magazinat e zyrave;
- e. Dritare alumini dyfish xham janë konsideruar dhe ato në dyer e brendshme në korridoret e godinës bashkëlidhur foto.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Mbi observimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike:

1. Mungon dokumentacioni mbi specifikimet e materialeve, jepet vetëm preventivi i punimeve (Preventivi i punimeve nuk ka specifikime teknike në përshkrimin e zërave përkatëse).

Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Mbi observimet lidhur më zbatimin e kontratës:

2. Për sa kohë që AK ka nënshkruar një kontratë, duhet të përmbushë kushtet kontraktuale mbi afatet e likuidimit. Nëse vonesat në pritje të miratimeve janë praktikë e zakonshme, AK të marrë në konsideratë rregullimin e nenit që përcakton afatet e likuidimit, pasi ekziston risku i pagesave me kamate, në rast se do të kërkohet nga OE.

Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

3. Mbi sasitë të cilat mungojnë:

a. kasete shkarkimi observacioni merret në konsideratë.

b. Nga verifikimi në terren u konstatua se nuk kishte pllakë granili mbi parapetin e godinës së shërbimeve, por vetëm parapeti betoni.

c. Veshje fasade dekorative, mungon dokumentacioni verifikues/justifikues i vendosjes gjatë zbatimit ose marrjes në dorëzim.

d. Parapet: në fotot e parapetit të shkallëve nuk janë sipas përshkrimit të zërit parapet shkalle e ballkoni por është parapet për rrugë dhe lulishte (mungesa e specifikimeve), mungon dokumentacioni verifikues/justifikues i vendosjes gjatë zbatimit.

e. Dritare dopio xham janë llogaritur në të dy katet e godinës, materialet e përdorura janë njësoj, pjesa ndarëse e brendshme nuk është dopio xham.

Procesverbalet bashkëlidhur observacioneve janë në kundërshtim me pikën 36 të

Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, në mbështetje të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", përcakton se dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen dhe përmban të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Pika 35.b e këtij udhëzimi jep një përkufizim të dokumenteve vërtetues, të cilët vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike të veprimeve, ku përfshihen, ndër të tjera, edhe procesverbalet. Neni 18 i Normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat" përcakton se procesverbalet kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet të protokollohen.

Referuar nenit 19 të këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë.

Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.

Procesverbalet e paraqitura, duke mos qenë të protokolluara, në kundërshtim me sa cituar më sipër, nuk përbëjnë dokumentacion të rregullt dhe nuk merren në konsideratë.
Për sa më sipër ky observacion merret pjesërisht në konsideratë.

2.4.13. Procedura e Prokurimit: “Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës (kosha, stola dekorativ)”.

1. Të dhëna mbi objektin

2. Urdhër Prokurimi nr. Nr.539/4 prot. Datë 23.02.2018 Njësinë e prokurimit: M.Xh., R.L., Xh. T.	3. Llogaritja e fondit limit Me anë të urdhrit nr.358, datë 07.02.2018 është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: M. H.,E. Xh. dhe A. H. - Urdhër për ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve dhe kritereve teknike nr. 539/1 prot. Datë 23.02.2018 me përbërje: z. E. Xh., H. H. dhe P. B.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Shkresa nr. 539/5 prot. Datë 23.02.2018 urdhërohet Komisioni i përbërë nga: E. Xh., M. B., M. Marku.
3. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur (shërbimi)		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 16,660,000 lekë	4. Oferta fituese (pa tvsh) OE “F.” sh.p.k. me vlerë oferte 16,487,208.60 lekë pa tvsh	5. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 172,791 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 26.03.2018	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operoret Ekonomike 1. OE “F.” sh.p.k. me vlerë oferte 16,487,208.60 lekë pa tvsh
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka; APP– nuk ka; KPP– nuk ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.539/10, datë 10.04.2018 midis Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe operatorit ekonomik “F.” sh.p.k. me afat 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me çmim kontrate 16,487,208.60 lekë pa tvsh.	15.Vlera e kontratës (me tvsh) lekë: 19,784,650.3 lekë me tvsh	16.Likuiduar Urdhër shpenzimin me nr 244, datë 30.10.2018.
17- Faturë Malli nr.52 dt.02.08.2021 Vlera me tvsh 13,945,527 lekë Vlera pa tvsh 11,621,272.50 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 183 ditë (6 muaj) Zbatuar 112 ditë	19. Zgjatja e kontratës me..... ditë Nuk ka

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, nga audituesit e KLSH-së u auditua procedura e prokurimit me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës (kosha, stola dekorativ)”. Për auditimin e kësaj procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2018-31.12.2021;
Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP;
Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar;
Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së;
Përlllogaritja e fondit limit.
Situacionin përfundimtar etj.

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike.

Nisur nga nevoja për të mirëmbajtur aparatet dhe pajisjet teknike dhe veglat e punës (kosha, stola dekorativ), në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, me anë të shkresës nr.539 prot. Datë 23.02.2018, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit z. M. M. ka paraqitur kërkesën për hapjen e procedurës për shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës (kosha, stola dekorativ).

Bashkëlidhur shkresës tabela e sasive dhe elementëve përbërës për mirëmbajtjen e koshave stolave dekorativ.

Kërkesa e mësipërme u miratuar nga Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve z. R. M., i cili nisur nga sa më lart kërkon hapjen e procedurës së prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës (kosha, stola dekorativ)”, miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, znj. A. B.me anë të shkresës nr.539/2 prot. Datë 23.02.2018.

Znj. A. B. ka urdhëruar ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe kriterëve teknike, me shkresën nr. 539/1 prot. Datë 23.02.2018, me përbërje: z. E.Xh. z. H. H. dhe z. P. B.Komisioni i ngritur kanë hartuar dhe dorëzuar me shkresën nr.539/3 prot. Datë 23.02.2020, kriteret teknike dhe specifikimet teknike që duhet të kenë operatorët ekonomik.

Sipas urdhrit nr.358, datë 07.02.2018 “Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës” është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: znj. M. H., z. E. Xh. dhe znj. A. H.

Grupi i punës ka mbajtur argumentimin “Për llogaritjen e vlerës limit”, më datë 23.02.2018, i cili për përllogaritjen e vlerës së kontratës është bazuar në testimin të tregut, në bazë të tre ofertave. Anëtarët e komisionit të përllogaritjes së vlerës limit, kanë llogaritur fondin limit me vlerë 16,660,000 lekë pa tvsh, kjo vlerë është mesatarja e tre ofertave.

Urdhri i prokurimit me shkresën nr.539/4 prot. Datë 23.02.2018, urdhëron kryerjen e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës (kosha, stola dekorativ)” me fond limit 16,660,000 lekë pa tvsh dhe ngritjen e njësisë së prokurimit të përbëhet nga znj. R. L., znj. M. Xh.i, znj. Xh. T.

Njësia e prokurimit më datë 28.02.2018 ka mbajtur procesverbalin “Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit për kontratën me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës (kosha, stola dekorativ)”, ku ka përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë OE pjesëmarrës në procedurë.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve teknike rezulton se në procesverbalin e mbajtur nga grupi ka disa parregullsi në shkelje të Ligjit të prokurimit publik.

- Mungojnë specifikimet teknike për materialet dhe dokumentacioni justifikues si plane, vizatime, modele, makete etj. Nga kanë dalë këto sasi si dhe zonat ku ka nevojë për riparime (Relacione shpjegues për sasi të dhe specifikimet përkatëse). Në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, neni 23 Specifikimet teknike, pika 4, ku citohet: “...Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale...”.

- Referuar DST pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 3, ku citohet: “...Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit inxhinierik përkatës si më poshtë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij për të gjithë periudhën

e kërkuar: ... Inxhinier Mjedisi (1) i pajisur me Certifikatë nga Ministria e Mjedisit, Certifikatë për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë...”.

a. Nuk është specifikuar çfarë tipi certifikate kërkohet nga ministria e Mjedisit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor e lëshuar nga Ministria e Mjedisit duhet të ketë një person i punësuar në kompani i cili ka profilin arsimor si specifikohet në VKM nr.122 datë 17.02.2011. Kriter i vendosur diskriminues në kundërshtim me Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, Neni 1, pika 2d, ku citohet: “...Qëllimi i këtij ligji është: Të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomik, në procedurat e prokurimit publik...”. Dhe VKM nr.122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në vendimin nr.1124, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me Certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”, pika 2, ku citohet: “...të drejtën për t’u pajisur me Certifikatë e kanë specialistët e diplomuar në fushën e mjedisit ose të agromjedisit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në universitetet ose shkollat e larta jopublike, të akredituara për degët e sipërpërmendura ose në institucionet e huaja të arsimit të lartë që ofrojnë këto programe studimi, pas njësimit të diplomës së tyre, si dhe specialistët e diplomuar në shkencat inxhinierike, biologjike, kimike, gjeologjike, hidrologjike, ekonomike dhe gjeografike...”.

b. Inxhinier Mjedisi i pajisur me Certifikatë për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë, Certifikatë që duhet të ketë një person i punësuar në kompani i cili ka profilin arsimor si specifikohet në VKM nr.312, datë 5.5.2010. Kriter i vendosur diskriminues në kundërshtim VKM nr.312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, Neni 10 Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve, pika 1a, ku citohet: “...1. Koordinatori për projektin dhe koordinatori për realizimin e punimeve duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme; a) diplomë universitare në inxhinieri, arkitekturë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi...”.

- Referuar DST pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 10 ku citohet: “...Licence profesionale e Shoqërisë e vlefshme me kategorinë NS-8-A (Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri)...” Referuar VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” lidhja 3 Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) N.S – 8 Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri: Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara. Në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 28 Kontratat e shërbimeve, pika 2, ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”.

- Referuar DST pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 11 ku citohet: “...Lista e makinerive që duhet të disponojë operatori ekonomik të përmbledhura në tabelën e mëposhtme: ...Makineri e lëvizshme me pajisje speciale për testimin e materialeve të ndërtimit...” Referuar punimeve të preventivit nuk është e nevojshme një makineri e tillë. Në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 28 Kontratat e shërbimeve, pika 2, ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”.

Titulli i gjetjes:	Kriteret kualifikuese të paargumentuara dhe të pajustificuara kanë zvogëluar konkurrencën
Situata:	<p>Për procedurën: “Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës (kosha, stola dekorativ)” rezulton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mungon dokumentacioni justifikues si plane, vizatime, modele, makete etj. Nga kanë dalë këto sasi si dhe zonat ku ka nevojë për riparime, në kundërshtim me nenin 23, pika 4, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar. 2. Inxhinier Mjedisi i pajisur me certifikatë nga Ministria e Mjedisit, certifikatë për shëndetin dhe sigurinë në punë i kërkuar në kriterin 2.3, pika 3 e DST Kapaciteti teknik. Certifikata e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor e lëshuar nga Ministria e Mjedisit duhet të ketë një person i punësuar në kompani i cili ka profilin arsimor si specifikohet në VKM nr.122 datë 17.02.2011. Certifikatë për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë, certifikatë që duhet të ketë një person i punësuar në kompani i cili ka profilin arsimor si specifikohet në VKM nr.312, datë 5.5.2010. 3. Kategoria e kërkuar e licencës NS-8-A “Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri” nuk ka lidhje me natyrën e kontratës, në kundërshtim me nenin 28, pika 2, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014. 4. Makineria e lëvizshme me paisje speciale për testimin e materialeve të ndërtimit, pika 3.3 “Kapaciteti teknik” i DST nuk është e nevojshme për natyrën e kontratës, në kundërshtim me nenin 28, pika 2, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014.
Kriteri:	<p>Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 Specifikimet teknike, pika 4. VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 28 Kontratat e shërbimeve, pika 2. VKM nr.122, datë 17.02.2011 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me Çertifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”, pika 2. VKM nr.312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, Neni 10 Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve, pika 1a.</p>
Ndikimi:	Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.
Shkaku	<p>Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. VKM nr.122, datë 17.02.2011 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me Çertifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”. VKM nr.312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””.</p>
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Njësia e Prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të marrë masa për përcaktimin e procedurës së prokurimit duke u mbështetur në natyrën e kontratës, si dhe për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit duke argumentuar dhe dokumentuar në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të

	stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për të mos favorizuar operatorë ekonomik të caktuar.
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa që në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të administrohet dokumentacioni i nevojshëm identifikues grafik (si plane, harta, etj.) në mënyrë që të mundësohet evidentimi i vendndodhjes së realizimit të punimeve, që ndër të tjera do të shërbejë si gjurmë auditimi.
Afati:	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi njësia e prokurimit znj.Xh. T., znj.R. L., znj.M. Xh., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe komisioni për përgatitjen e specifikimeve dhe kritereve teknike z.E. Xh., z.H. H., z.P. B., në cilësinë e anëtarëve të komisioneve për përgatitjen e specifikimeve dhe kritereve teknike. Për mungesën e dokumentacionit justifikues ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit znj,A. B.në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas shkresës nr. 539/5 prot. Datë 23.02.2018 me lëndë “Urdhër për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave”, ngrihet komisioni i përbërë nga: z. M. M., z. E. Xh., z. M.B..

Komisioni më datë 26.03.2018, ka mbajtur procesverbalin e hapjes së ofertave ku është paraqitur 1 operator ekonomik:

Operatori ekonomik “F.” sh.p.k. me vlerë oferte 16,487,208.60 lekë pa tvsh.

Më datë 27.03.2018, komisioni ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit ku jepet informacion mbi shqyrtimin e ofertës dhe plotësimin e kritereve nga operatorët 117itarët117ata. Ku përcaktohet se:

Operatori ekonomik “F.” sh.p.k. me vlerë oferte 16,487,208.60 lekë pa tvsh, plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

KVO ka klasifikuar Operatori ekonomik “F.” sh.p.k. si oferta më ekonomike dhe gjithashtu ka plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Raporti përmbledhës i mbajtur me nr. 539/7 prot. Datë 04.04.2018, jepet informacion mbi procedurën, vlerësimin e operatorit ekonomik pjesëmarrës, dhe klasifikimin nga KVO, në vendin e parë sipas kriterit çmimi më i ulët dhe i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e caktuara në DST, KVO ka klasifikuar operatorin ekonomik OE “F.” sh.p.k.. Ky raport është miratuar me anë të shkresës nr. 539/8 prot. Datë 04.04.2018, nga Titullari i AK znj. A. B. dhe Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit z. A.Q. dhe kanë shpallur fitues OE “F.” sh.p.k. me vlerë oferte 16,487,208.60 lekë pa tvsh.

Nga auditimi i realizimit të procedurës në bazë të DST, rezulton se vlerësimi është realizuar konform kritereve të përcaktuara në DST dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

-Lidhja e kontratës

Është lidhur kontrata me nr.539/10, datë 10.04.2018 midis Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, përfaqësuar nga titullari znj. A. B. dhe operatorit ekonomik “F.” sh.p.k., me NIPT J....N, përfaqësuar nga z. Sh.F., me afat 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me çmim kontrate 16,487,208.60 lekë pa tvsh.

(Sigurimi i kontratës me vlerë 1,978,466 lekë me afat deri në zbatimin e kontratës).

-Zbatimi i kontratës.

Me shkresën nr.539/12 prot. Datë 12.04.2018, urdhërohet “Për monitorimin e kontratës me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës (kosha, stola dekorativ)”, komisioni me përbërje: znj. V. J., z. I. F., z. E.Xh.j, i cili do të monitorojë zbatimin e kontratës.

Operatori ekonomik F.sh.p.k. më datë 12.04.2018, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit me nr.1430 prot. Datë 12.04.2018, ka dorëzuar shkresën për njoftimin e fillimit të punimeve.

Më datë 12.04.2018 është mbajtur akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe procesverbali mbi fillimin e punimeve midis Investitorit, Grupit të ndjekjes së punimeve dhe Sipërmarrësit të punimeve.

Operatori ekonomik F.sh.p.k., më datë 02.08.2018, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit me nr.2456 prot. Datë 02.08.2018, ka dorëzuar shkresën për njoftimin e përfundimit të punimeve.

Situacion përfundimtar për punime deri më datë 02.08.2018, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit me nr.2456/2 prot. Datë 02.08.2018, me vlerë punimesh 19,746,538.30 lekë pa tvsh. (Mbajtur garanci punimesh 5% e vlerës së punimeve 987,326.9 lekë)

Si dhe është dorëzuar proces verbali për rakordimin e volumeve brenda preventivit.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezulton mungesat e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, si libri i masave, ditarët e punimeve, provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve etj. Veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” kreu III, Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit, ku citohet:

“...1. Gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, i cili përmban: a) Dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit.

...2. Puna e kryer dhe çastet më të rëndësishme gjatë ndërtimit të objektit pasqyrohen në librin e kantierit, që mbahet në formën e ditarit të objektit e të raportit të punimeve.

2.1 Ditari i objektit pasqyron ngjarjet më të rëndësishme gjatë ecurisë së punimeve, deri në fund të periudhës së garancisë së tyre.

...4.Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre.

.... 9.Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen: dh) Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre...” etj.

- Mungon dokumentacioni justifikues për kryerjen e shërbimit (Si raporte/relacione mbi vendndodhjen, sasi të që janë riparuar ose ndërtuar në secilën zonë, mbi marrjen në dorëzim sipas situacioneve të punimeve, si dhe foto gjatë procesit të punës dhe përdorimit të mjetet), veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 77 Mbikëqyrja e kontratës, pika 3 dhe 4, ku citohet: “...3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

4. Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti ...”.

Titulli i gjetjes:	Mungesat e dokumentave kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës (kosha, stola dekorativ)”, është konstatuar mungesa e dokumentave kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, si libri i masave dhe vizatimeve, 119itarët e punimeve, provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve, veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.
Kriteri:	Kreu III “Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit”, pika 2, 4, 9, Udhëzimi Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”
Ndikimi:	Mungesa e verifikimit të saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve dhe cilësisë të materialeve e të produkteve.
Shkaku	Mungesa e mbikëqyrjes së punimeve nga ekspert të fushës dhe realizimi i punimeve të ndërtimit si shërbim dhe jo procedura pune.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për ngritjen e një njësie për monitorimin e zbatimit të kontratave, e cila do të jetë përgjegjëse edhe për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik për secilën kontratë, me qëllim verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve, si dhe cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura dhe dokumentacioni i nevojshëm grafik.
Afati:	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, znj. A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

Operatori ka sjellë faturën tatimore, me nr 52 datë 02.08.2018, me vlerë 13,945,527 lekë me tvsh / 11,621,272.50 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimin me nr 191, datë 03.08.2018 (likuiduar 5,500,000 lekë), likuiduar me urdhër shpenzimin me nr 203, datë 13.09.2018 (likuiduar 3,000,000 lekë), likuiduar me urdhër shpenzimin me nr 217, datë 21.09.2018 (likuiduar 2,000,000 lekë), likuiduar me urdhër shpenzimin me nr 229, datë 16.10.2018 (likuiduar 1,000,000 lekë), likuiduar me urdhër shpenzimin me nr 244, datë 30.10.2018 (likuiduar 2,445,527 lekë).

Nga auditimi dokumentacionit mbi pagesën e faturave rezultoi se urdhër shpenzimet mbi pagesën e faturave janë kryer në kundërshtim me nenin nr 15 të KPK Afatet e Pagesës pika 15.4, ku citohet “...Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer shërbimet ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë...”.

Titulli i gjetjes:	Pagesa e faturave me vonesë, përtej afateve të përcaktuara në Kontratë
Situata:	Nga auditimi dokumentacionit mbi pagesën e faturave rezultoi se urdhër shpenzimet mbi pagesën e faturave janë kryer në kundërshtim me nenin nr 15 të KPK Afatet e Pagesës pika 15.4, ku citohet “...Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer

	shërbimet ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë...”.
Kriteri:	Kontrata me nr.539/10, datë 10.04.2018 midis Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit (Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit) dhe OE “F.” sh.p.k.
Ndikimi:	Mundësi për pagesë fature me kamate në raste se do kërkohej nga OE
Shkaku	Vonesa në pagesën e faturave
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për likuidimin e detyrimeve financiare, sipas afateve të përcaktuar në kontrata.
Afati:	Menjherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtorja e financës dhe buxhetit, znj. L. M., në cilësinë e nënpunësit zbatues dhe znj. A. B., në cilësinë e nënpunësit autorizues.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi si më poshtë:

Për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit rezultoi se: Zëri FV Vida druri për fiksimin e ristelave të drurit me krahët ishin të zëvendësuar me vida inoksi për fiksimin e ristelave të drurit me krahët, për arsye të dëmtimit nga kushtet atmosferike.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi hartuesit e preventivit, Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, ka paraqitur observacionin nr. 185/53 prot., datë 14.04.2023, protokolluar KLSH nr. 1008/7 prot., datë 18.04.2023, ku pretendojnë, si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Planifikimi dhe zhvillimi i procedurës:

1. Referuar LPP e parashikon në rast nevojë plotësohet me dokumentacionit justifikues si plane, vizatime, modele, makete etj., nuk është plotësuar me këtë dokumentacion. Specifikimeve teknike janë pjesë e zërave të preventivit (fq.56-57 observacionit);

2. Inxhinier mjedisi i pajisur me certifikatë nga ministria e mjedisit, nevojitet pasi ka punime në preventiv të kësaj natyre (fq.57-58 observacionit);

3. Licenca profesionale dhe aftësitë teknike janë caktuar në mënyrë që ti japi besueshmëri AK se OE përmbushin kriteret për zbatimin me sukses të kontratës (fq.57-58 observacionit);

Zbatimi i kontratës:

4. Mbi pagesën përtej afateve të parashikuara në kontratë, DPPGJ observon se, duke qenë institucion varësie e Bashkisë Tiranë, në rast tejkalimi limiti fondesh, çdo muaj kërkon çelje fondesh, (fq.73 observacionit);

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Mbi observimet lidhur me planifikimin dhe zhvillimin e procedurës:

1. Preventivi i punimeve nuk jep informacion mbi specifikim teknik për secilin element, dokumentacion justifikues si plane, vizatime etj. është e nevojshme për evidentimin e vendndodhjes ku do të realizohet shërbimi nga ana e OE fitues dhe çdo subjekt tjetër që do të kryej verifikimin e realizimit të shërbimit në vazhdimësi.

Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

2. Në lidhje me observacionin e subjektit Inxhinieri i mjedisit dhe certifikimi nga ministria e mjedisit nuk janë kriter që duhet hequr, por kriteri i vendosur ku jepet e specifikuar certifikimin duhet ta ketë një inxhinier mjedisi është një kriter diskriminues duke zvogëluar konkurrimin dhe duke dhënë një orientim jo të saktë ofertuesve të mundshëm. Pasi certifikata e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor e lëshuar nga Ministria e Mjedisit duhet të ketë një person i punësuar në kompani i cili ka profilin arsimor si specifikohet në VKM nr.122 datë 17.02.2011.

Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë

3. Referuar licenca profesionale dhe aftësitë teknike janë caktuar në mënyrë që ti japi besueshmëri AK se OE përmbushin kriteret për zbatimin me sukses të kontratës, AK duhet të caktojë kriteret në përputhje me natyrën e punimeve referuar preventivit dhe akteve ligjore në fuqi. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Mbi observimet lidhur më zbatimin e kontratës:

4. Për sa kohë që AK ka nënshkruar një kontratë, duhet të përmbushë kushtet kontraktuale mbi afatet e likuidimit. Nëse vonesat në pritje të miratimeve janë praktikë e zakonshme, AK të marrë në konsideratë rregullimin e nenit që përcakton afatet e likuidimit, pasi ekziston risku i pagesave me kamate, në rast se do të kërkohej nga OE. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. *Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.*

2.4.14. Procedura e Prokurimit: “Drurë, shkurre dekorative”.

A. Të dhëna mbi objektin

1. Urdhër Prokurimi nr. Nr.336/4 prot. datë 07.02.2019 Njësinë e prokurimit: M. Xh., R. L. dhe E. Xh.	3. Llogaritja e fondit limit Me anë të urdhrit nr.12, datë 03.01.2019 është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: M. H., E.Xh.dhe A. L. - Urdhër për ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike nr. 336/2 prot. datë 07.02.2019 me përbërje: N. J., A. L. dhe A.Q.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Shkresa nr. 336/5 prot. datë 07.02.2019 urdhërohet Komisioni i përbërë nga: E. Xh., M. B., M.M..
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur (mallra)		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 19,900,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE “Gj. 2000” sh.p.k. me vlerë oferte 19,713,600 lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 186,400 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 01.04.2019	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Bashkisë	10. Operatoret Ekonomike 1. Operatori ekonomik “Gj.2000” sh.p.k. me vlerë oferte 19,713,600 lekë pa tvsh. 2. Operatori ekonomik “F.” sh.p.k. me vlerë oferte 19,809,080 lekë pa tvsh. 3. Operatori ekonomik “K.” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. (I skualifikuar)
11. Ankimime	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje Ankesës

Pranë AK- ka; Me anë të shkresës nr.582/1 prot. datë 12.02.2019, protokolluar në DPPGJ (DPN1), me nr.336/7 prot. datë 14.02.2019, ka ardhur një ankesë për modifikim kriteresh nga një OE, me anë të së cilës kërkon ndryshimin dhe saktësimin e disa kriterëve. KPP- ka; Me anë të shkresës së protokolluar në DPPGJ (DPN1), me nr.336/10 prot. datë 25.02.2019, ka ardhur ankesa për modifikim kriteresh nga një OE drejtuar dhe KPP, me anë të së cilës kërkon ndryshimin dhe saktësimin e disa kriterëve.	nga AK –me anë të shkresës nr.336/10 prot. datë 15.02.2019, ka kthyer përgjigje OE ankimes.	nga KKP – me anë të shkresës nr.162/1 datë 21.03.2019, protokolluar pranë DPPGJ (DPN1) me nr.336/14 prot. datë 25.03.2019, dërgimin e Vendimit K.P.P. 162/2019, ku u vendos mos pranohet ankesa e OE ankimes.
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.336/20, datë 16.04.2019 midis Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit (Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit) dhe OE “Gj. 2000” sh.p.k., me afat nga data e nënshkrimit të kontratës deri më 31.12.2019, me çmim kontrate 19,713,600.00 lekë pa tvsh.	15.Vlera e kontratës (me tvsh) lekë: 23,656,320 lekë me tvsh	16.Likuiduar Urdhër shpenzimit me nr 259, datë 11.12.2019.
17- Faturë tatimore nr.142 dt.03.05.2019 Vlera me tvsh 14,110,200 lekë Vlera pa tvsh 11,758,500 lekë Faturë tatimore nr.168 dt.05.11.2019 Vlera me tvsh 9,546,120 lekë Vlera pa tvsh 7,955,100 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 259 ditë Zbatuar 203 ditë	19. Zgjatja e kontratës me..... ditë Nuk ka

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, nga audituesit e KLSH-së u auditua procedura e prokurimit me objekt: “Drurë, shkurre dekorative”. Për auditimin e kësaj procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2018-31.12.2021;

Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP;

Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar;

Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së;

Përlllogaritja e fondit limit.

Situacionin përfundimtar etj.

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike.

Nisur nga nevoja për të shtuar gjelbërimin e qytetit, me anë të shkresës nr.336 prot. datë 07.02.2019, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit z. M. M.ka paraqitur kërkesën për blerje drurë dhe shkurre dekorative. Bashkëlidhur shkresës tabela e sasive përkatësisht F.V për 3628 copë drurë/shkurre.

Kërkesa e mësipërme u miratuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit z. A.Q., i cili nisur nga sa më lart kërkon hapjen e procedurës së prokurimit me objekt “Drurë dhe shkurre dekorative”, me fond limit 19,900,000 lekë pa tvsh, miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, znj. A. B.me anë të shkresës nr.336/1 prot. datë 07.02.2019.

Sipas urdhrin nr.12, datë 03.01.2019 “Për ngritjen e komisionit për llogaritjen e vlerës limit të kontratës” është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: znj. M.H., z. E.Xh. dhe znj. A. L.. Grupi i punës ka mbajtur argumentimin “Për llogaritjen e vlerës limit” më datë 07.02.2019, i cili për përlllogaritjen e vlerës së kontratës është bazuar në testimit të tregut, në bazë të tre ofertave. Anëtarët e komisionit të përlllogaritjes së vlerës limit, kanë

llogaritur fondin limit me vlerë 19,900,000 lekë pa tvsh, kjo vlerë është mesatarja e tre ofertave.

Znj.A. B. ka urdhëruar ngritjen e grupit të specializuar për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve teknike me shkresën nr.336/2 prot. datë 07.02.2019. Grupi i punës i përbërë nga: z. N. J., znj. A. L. dhe znj. A. Q., kanë hartuar dhe dorëzuar me shkresën nr.336/3 prot. datë 07.02.2019, kriteret teknike që duhet të kenë operatorët ekonomik.

Urdhri i prokurimit me shkresën nr.336/4 prot. datë 07.02.2019 urdhëron kryerjen e prokurimit me procedurë të hapur me objekt “Drurë dhe shkurre dekorative” me fond limit 19,900,000 lekë pa tvsh dhe ngritjen e njësisë së prokurimit të përbërë nga znj. R. L., z. E. Xh., znj. M. Xh. Njësia e prokurimit më datë 07.02.2019 ka mbajtur procesverbalin “Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit për kontratën me objekt “Drurë dhe shkurre dekorative””, ku ka përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë OE pjesëmarrës në procedurë.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kritereve teknike rezulton se në procesverbalin e mbajtur nga grupi ka disa parregullsi në shkelje të Ligjit të prokurimit publik.

- Mungon dokumentacioni justifikues si plane, vizatime, modele, makete etj. nga kanë dalë këto sasi si dhe zonat ku ka nevojë për gjelbërim (sipërfaqet e nevojshme). Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, neni 23 Specifikimet teknike, pika 4, ku citohet: “...Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale...”. Si dhe në kundërshtim më me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 27 Kontratat e mallrave, pika 1, ku citohet: “...Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara...”.

- Referuar DST pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 6 ku citohet: “...Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore që vërteton një numër mesatar prej 12 punonjësish nga ku të paktën 4 prej këtyre të jenë të pajisur me Certifikatën e punimeve në lartësi për periudhën vjetore 2017-2018...”, kriteri i vendosur në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 27 Kontratat e mallrave, pika 3, ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve...”. Ky kriter është diskriminues pasi sipas zërave të punimeve nuk ka punime në lartësi.

Titulli i gjetjes:	Kriteret kualifikuese të paargumentuara dhe të pajustificuara kanë zvogëluar konkurrencën
Situata:	Për procedurën: “Drurë, shkurre dekorative” rezulton se: 1. Mungon dokumentacioni justifikues si plane, vizatime, modele, makete etj. nga kanë dalë këto sasi si dhe zonat ku ka nevojë për gjelbërim, në kundërshtim me nenin 23, pika 4, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

	2. Kriteri për 4 prej këtyre të jenë të pajisur me Çertifikatën e punimeve në lartësi i kërkuar në kriterin 2.3, pika 6 e DST, në kundërshtim me nenin 27, pika 3, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014.
Kriteri:	Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 Specifikimet teknike, pika 4. VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, 2, neni 27 Kontratat e mallrave, pika 3.
Ndikimi:	Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.
Shkaku	Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Njësia e Prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të marrë masa për përcaktimin e procedurës së prokurimit duke u mbështetur në natyrën e kontratës, si dhe për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit duke argumentuar dhe dokumentuar në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për të mos favorizuar operatorë ekonomik të caktuar.
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa që në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të administrohet dokumentacioni i nevojshëm identifikues grafik (si plane, harta, etj.) në mënyrë që të mundësohet evidentimi i vendndodhjes së realizimit të punimeve, që ndër të tjera do të shërbejë si gjurmë auditimi.
Afati:	Menjherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi njësia e prokurimit znj.R. L., z.E. Xh., znj.M. Xh. në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe komisioni për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike z.N. J., znj.A. L., znj.A. Q. në cilësinë e anëtarëve të komisionit për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike. Për mungesën e dokumentacionit justifikues ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit znj,A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

OE A. sh.p.k., ka dërguar një ankesë me anë të së cilës kërkon modifikim dhe saktësimin e disa kriterëve, ankesa ardhur me shkresën nr.582/1 prot. datë 12.02.2019, dhe protokolluar në DPPGJ (DPN1), me nr.336/7 prot. datë 14.02.2019.

Me shkresën nr. 336/8 prot. datë 14.02.2019 me lëndë “Urdhër për pezullimin e procedurës së prokurimit me objekt “Drurë dhe shkurre dekorative”, urdhërohet pezullimi i procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga OE në Autoritetin Kontraktor.

Sipas shkresës nr. 336/9 prot. datë 14.02.2019 me lëndë “Urdhër për ngritjen e Komisionit për shqyrtimin e ankesave”, komisioni i përbërë nga: J. P., A. K., M. Xh., ka shqyrtuar ankesën e ardhur nga OE.

Autoriteti Kontraktor me shkresën nr.336/10 prot. datë 15.02.2019, pas shqyrtimit të ankesës nga komisioni i ka kthyer përgjigje OE ankimues.

Me shkresën e protokolluar në DPPGJ (DPN1), me nr.336/10 prot. datë 25.02.2019, ka ardhur ankesa për modifikim kriteresh nga OE A.sh.p.k., drejtuar dhe KPP, me anë të së cilës kërkon ndryshimin dhe saktësimin e disa kriterëve. KPP ka dërguar vendimin nr.295/1 datë 04.03.2019, ku ndër të tjera vendos të kalojë për shqyrtim ankesa e OE A.sh.p.k..

KPP me anë të shkresës nr.162/1 datë 21.03.2019, protokolluar pranë DPPGJ (DPN1) me nr.336/14 prot. datë 25.03.2019, dërgon Vendimit K.P.P. 162/2019, ku është vendosur të mos pranohet ankesa e OE A. sh.p.k..

Me shkresën nr.336/15 prot. datë 25.03.2019 Titullari i AK urdhëron heqjen e pezullimit të procedurës me objekt “Drurë dhe shkurre dekorative” dhe shkresën nr.336/16 prot., datë 25.03.2019 ka nxjerrë shtojcën për modifikim në dokumentet standarde të tenderit përkatësisht për datën e zhvillimit të procedurë e cila shtyhet 01.04.2019.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas shkresës nr.336/5 prot. datë 07.02.2019 me lëndë “Urdhër për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave” ngrihet komisioni i përbërë nga: z. M. M., z. E. Xh., z. M.B.

Komisioni më datë 01.04.2019, ka mbajtur procesverbalin e hapjes së ofertave ku ishin paraqitur 3 operatorë ekonomik:

Operatori ekonomik “F.” sh.p.k. me vlerë oferte 19,809,080 lekë pa tvsh.

Operatori ekonomik “Gj. 2000” sh.p.k. me vlerë oferte 19,713,600 lekë pa tvsh.

Operatori ekonomik “K.” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Më datë 04.04.2019, komisioni ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit ku jepet informacion mbi shqyrtimin e ofertës dhe plotësimin e kriterëve nga operatorët pjesëmarrës. Ku përcaktohet se:

OE “F.” sh.p.k., plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

OE “Gj. 2000” sh.p.k., plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

OE “K.” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

KVO ka klasifikuar “Gj. 2000” sh.p.k. si oferta më ekonomike dhe gjithashtu ka plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Nga auditimi i realizimit të procedurës në sistemin elektronik të APP sipas vlerësimit të KVO, rezultoi se:

- KVO ka kualifikuar OE, i cili ka dorëzuar për 4 punonjës certifikatat e punimeve në lartësi por këto certifikata janë të lëshuara nga një subjekt i pa akredituar për këtë trajnim. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 6, ku citohet: “...Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore që vërteton një numër mesatar prej 12 punonjësish nga ku të paktën 4 prej këtyre të jenë të pajisur me Certifikatën e punimeve në lartësi për periudhën vjetore 2017-2018...”.

Titulli i gjetjes:	Parregullsi në vlerësimin e ofertave
Situata:	Nga auditimi i realizimit të procedurës “Drurë, shkurre dekorative” në sistemin elektronik të APP sipas vlerësimit të KVO, rezultoi se: 1. KVO ka kualifikuar OE, i cili ka dorëzuar për 4 punonjës certifikatat e punimeve në lartësi por këto certifikata janë të lëshuara nga një subjekt i pa akredituar për këtë trajnim. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 6.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
Ndikimi:	Është kryer vlerësimi në kundërshtim me kërkesat ligjore të prokurimit.
Shkaku	Mosvlerësim i saktë i ofertave ekonomike.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, me anë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, për shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi

	në plotësimin e kriterëve, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratave.
Afati:	Menjherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i vlerësimit të ofertave z.M. M., z.E Xh, z.M. B. me cilësinë e anëtarëve të KVO.

Raporti përmbledhës i mbajtur me nr. 336/17 prot. datë 12.04.2019, ku jepet informacion mbi procedurën, vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës dhe klasifikimin nga KVO, në vendin e parë sipas kriterit çmimi më i ulët dhe i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e caktuara në DST, KVO ka klasifikuar operatori ekonomik “Gj.2000” sh.p.k.. Ky raport është miratuar me anë të shkresës nr. 336/18 prot. datë 12.04.2019 nga Titullari i AK znj. A. B.dhe Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit z. A. Q. ku dhe kanë shpallur fitues OE “Gj.2000” sh.p.k. me vlerë oferte 19,713,600 lekë pa tvsh.

-Lidhja e kontratës

Është lidhur kontrata me nr.336/20, datë 16.04.2019 midis Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit (Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit) përfaqësuar nga Titullari znj. A. B. dhe operatorit ekonomik “Gj. 2000” sh.p.k., me NIPT L...D përfaqësuar nga z. F.Sh. me afat nga data e nënshkrimit të kontratës deri më 31.12.2019, me çmim kontrate 19,713,600.00 lekë pa tvsh.

(Sigurimi i kontratës me vlerë 1,990,000 lekë me afat deri në zbatimin e plotë të kontratës).

-Zbatimi i kontratës.

Me shkresën nr.336/21 prot. datë 16.04.2019, urdhërohet “Për ndjekjen e zbatimit të kontratës me objekt “Drurë dhe shkurre dekorative””, komisioni me përbërje: z. A.S., z. E.M., z. H.H., i cili ka marrë në dorëzim drurët dhe shkurret.

Më datë 03.05.2019, në prani të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës dhe të operatorit ekonomik është mbajtur situacioni nr.1, ku jepet tabela me sasi të dhe me vlerë 11,758,500.00 lekë pa tvsh, komisioni ka realizuar vlerësimin e drurëve dhe shkurreve dekorative dhe i konsideron ato që janë realizuar sipas specifikimeve teknike. Me anë të këtij dokumenti komisioni ka marrë në dorëzim mallin (dhe vendosjen) për sasi të sipas këtij situacioni.

Më datë 05.11.2019, në prani të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës dhe të operatorit ekonomik është mbajtur situacioni nr.2, ku jepet tabela me sasi të dhe me vlerë 7,955,100.00 lekë pa tvsh, komisioni ka realizuar vlerësimin e drurëve dhe shkurreve dekorative dhe i konsideron ato që janë realizuar sipas specifikimeve teknike. Me anë të këtij dokumenti komisioni ka marrë në dorëzim mallin (dhe vendosjen) për sasi të sipas këtij situacioni.

Me shkresën nr.2901 prot. datë 16.12.2019 i është dërguar APP informacion mbi zbatimin e procedurës “Drurë dhe shkurre dekorative”. (Vetëm formulari).

Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezulton mungesa e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, si libri i masave, ditarët e punimeve, provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve etj. veprime në kundërshtim me kreun III të Udhëzimit Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, ku citohet:

“1. Gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, i cili përmban: a) Dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit.

2. Puna e kryer dhe çastet më të rëndësishme gjatë ndërtimit të objektit pasqyrohen në librin e kantierit, që mbahet në formën e ditarit të objektit e të raportit të punimeve.

2.1 Ditari i objektit pasqyron ngjarjet më të rëndësishme gjatë ecurisë së punimeve, deri në fund të periudhës së garancisë së tyre.

...4.Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre.

.... 9.Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen: dh) Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre...” etj.

- Mungon dokumentacioni justifikues për kryerjen e shërbimit (Si raporte/relacione mbi vendndodhjen, sasi të që janë riparuar ose ndërtuar në secilën zonë, mbi marrjen në dorëzim sipas situacioneve të punimeve, si dhe foto gjatë procesit të punës dhe përdorimit të mjetet), veprime në kundërshtim me nenin 77, pika 3 dhe 4, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet: “...3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

4. Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti ”.

Titulli i gjetjes:	Mungesat e dokumentave kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Drurë, shkurre dekorative” është konstatuar mungesa e dokumentave kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, si libri i masave dhe vizatimet, ditaret e punimeve, provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve, veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.
Kriteri:	Kreu III “Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit”, pika 2, 4, 9, Udhëzimi Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”
Ndikimi:	Mungesa e verifikimit të saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve dhe cilësisë të materialeve e të produkteve.
Shkaku	Mungesa e mbikëqyrjes së punimeve nga ekspert të fushës dhe realizimi i punimeve të ndërtimit si shërbim dhe jo procedura pune.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për ngritjen e një njësie për monitorimin e zbatimit të kontratave, e cila do të jetë përgjegjëse edhe për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik për secilën kontratë, me qëllim verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve, si dhe cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura dhe dokumentacioni i nevojshëm grafik.
Afati:	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, znj. A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

Operatori ekonomik ka sjellë faturën tatimore, me nr. 142, datë 03.05.2019, me vlerë 11,758,500 lekë pa tvsh dhe 14,110,200 lekë me tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimin me nr. 109, datë 03.06.2019.

(Magazinuar: Fletë hyrje nr.2 datë 03.05.2019).

Operatori ekonomik ka sjellë faturën tatimore nr. 168, datë 05.11.2019, me vlerë 7,955,100 lekë pa tvsh dhe 9,546,120 lekë me tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimin nr. 259, datë 11.12.2019.

(Magazinuar: Fletë hyrje nr.5 datë 05.11.2019).

Nga auditimi i situacionit përfundimtar dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si mëposhtë:

Tabela nr. 2: Diferencat e volumeve në objektin: “Drurë dhe shkurre dekorative”.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar/ relacion / situacionet e brendshme	Fakti	Diferenca në volume	
						Vol.	Vlera
Në lulishten (trekëndëshat) Zogu I Zi							
	Likuidamber	copë	8,000	6	4	2	16,000
	Acer Negundo	copë	11,500	2	1	1	11,500
Blloku i Pallateve në rrugën Frosina Plaku							
	Pishë e butë	copë	13,500	25	0	25	337,500
	Lejlandër	copë	2,200	0	17	-17	-37,400
Rruga Konferenca e Pezës							
	Shkozë e bardhë	copë	7,500	20	0	20	150,000
Pranë Mbikalimit Kthesa e Kamzës							
	Kumbull e kuqe	copë	8,500	20	18	2	17,000
	Cedrus	copë	9,500	10	8	2	19,000
Fusha Aviacionit							
	Agrume	copë	2,500	14	8	6	15,000
Rruga dytësore e autostradës							
	Carac	copë	9,000	90	0	90	855,000
	Total						1,383,600

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit.

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Në lulishten (trekëndëshat) Zogu i Zi.

Zëri Likuidamber. Sipas Situacionit përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 6 copë, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune është realizuar në sasinë 4 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 2 copë më pak se sasia e situacionuar.

Zëri Acer Negundo. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 2 copë, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune është realizuar në sasinë 1 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 1 copë më pak se sasia e situacionuar.

Blloku i Pallateve në rrugën Frosina Plaku.

Zëri Pishë e butë. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 25 copë, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune është

realizuar me Lejländër në sasinë 17 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune me lejlandër dhe sasi 17 copë vlera 300,100 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Rruga Konferenca e Pezës.

Zëri Shkozë e bardhë. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 20 copë, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune nuk është realizuar. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 20 copë më pak se sasia e situacionuar.

Pranë Mbikalimit Kthesa e Kamzës.

Zëri Kumbull e kuqe. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 20 copë, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune është realizuar në sasinë 18 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 2 copë më pak se sasia e situacionuar.

Zëri Cedrus. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 10 copë, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune është realizuar në sasinë 8 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 2 copë më pak se sasia e situacionuar.

Fusha Aviacionit.

Zëri Agrume. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 14 copë, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune është realizuar në sasinë 8 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 6 copë më pak se sasia e situacionuar.

Rruga dytësore e autostradës.

Zëri Carac. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 90 copë, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune nuk është realizuar. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 90 copë më pak se sasia e situacionuar. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 1,383,600 lekë pa tvsh / 1,660,320 lekë me tvsh, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit.

Titulli i gjetjes:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Drurë dhe shkurre dekorative”
Situata:	<p>Nga auditimi i situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit rezultuan diferenca si mëposhtë:</p> <p>Zëri Likuidamber: Në lulishten (trekëndëshat) Zogu i Zi. Vlera prej 16,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet.</p> <p>Zëri Acer Negundo: Në lulishten (trekëndëshat) Zogu i Zi. Vlera prej 11,500 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet.</p> <p>Zëri Pishë e butë: Blloku i Pallateve në rrugën Frosina Plaku. Vlera prej 300,100 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet.</p> <p>Zëri Shkozë e bardhë: Rruga Konferenca e Pezës. Vlera prej 150,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet.</p> <p>Zëri Kumbull e kuqe: Pranë Mbikalimit Kthesa e Kamzës. Vlera prej 17,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet.</p> <p>Zëri Cedrus: Pranë Mbikalimit Kthesa e Kamzës. Vlera prej 19,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet.</p> <p>Zëri Agrume: Fusha Aviacionit. Vlera prej 15,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet.</p>

	Zëri Carac: Rruga dytësore e autostradës. Vlera prej 855,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Argumentimi i këtyre diferencave pasqyrohen të përshkruara në Akt Konstatimin nr.11 dhe në Projekt Raportit të Auditimit.
Kriteri:	Kreu II, pika 8.1 dhe kreu III, pika 4, i Udhëzimit Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”
Ndikimi:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 1,660,320 lekë me tvsh, e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit në fondet e Buxhetit të Shtetit dhe njërive vendore.
Shkaku	Mungesë e librit të masave si dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve dhe mungesa e dokumentacionit justifikues si plane dhe vizatime mbi vendndodhjen e realizimit të punimeve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e sasisë së drurëve që mungojnë në të gjithë kontratën dhe evidentimin e shkaqeve që ka sjellë përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 1,660,320 lekë me tvsh.
Afati:	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi komisionit për ndjekjen e zbatimit e kontratës z.A. S., z.E. M., z.H. H. në cilësinë e anëtarëve të komisionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit znj. A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, ka paraqitur observacionin nr. 185/53 prot., datë 14.04.2023, protokolluar KLSH nr. 1008/7 prot., datë 18.04.2023, ku pretendojnë, si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Mbi hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike:

1. Në lidhje me specifikimet jepen me anë të relacionit bashkëlidhur, Drejtoria ka dërguar sasisë planifikuara dhe vendndodhjen e paracaktuar drejtorisë së Financës me anë të planit për propozimin e PBA 2019-2021, (fq. 57 observacionit).

Mbi zhvillimin e procedurës:

2. KVO e vlerëson certifikimin e punonjësve për punime në lartësi pasi AK nuk e ka cituar që duhet të jenë të akredituara (fq. 64 observacionit).

Mbi zbatimin e kontratës:

3. Mbi diferencat e sasive ekzistojnë proces verbale zëvendësimi, dhe foto të realizimit të tyre në periudhën e realizimit dhe situacionet e marrjes në dorëzim (fq.170-178 observacionit).

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Mbi observimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike:

1. Dokumentacion justifikues si plane, vizatime etj. është e nevojshme për evidentimin e vendndodhjes ku do të vendosen drurët dhe shkurret nga ana e OE fitues dhe çdo subjekt tjetër që do të kryej verifikimin e realizimit të shërbimit në vazhdimësi, dokumentacioni duhet të jetë pjesë e dosjes teknike të prokurimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Mbi observimet lidhur me zhvillimin e procedurës:

2. Sipas LPP në çdo rast AK ka të drejtën të kryejë gjithë verifikimet e nevojshme dhe që OE duhet të kualifikohet vetëm pasi të përmbushë të gjitha kërkesat për kualifikim. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Mbi observimet lidhur më zbatimin e kontratës:

3. Mungesa e dokumentacionit justifikues si plane, vizatime, si dhe librezave të masave sjell dhe mos evidentimin e këtyre sasive me vendndodhjen e tyre gjatë verifikimit në terren. Nga verifikimi në terren i grupit të auditimit në prezencë të specialistëve të DPPGJ, nuk u evidentuan sasitë e konstatuara të munguara në akt konstatimin nr.11 dhe Projekt Raport.

Procesverbalet bashkëlidhur observacioneve janë në kundërshtim me pikën 36 të

Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, në mbështetje të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", përcakton se dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen dhe përmban të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Pika 35.b e këtij udhëzimi jep një përkufizim të dokumenteve vërtetues, të cilët vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike të veprimeve, ku përfshihen, ndër të tjera, edhe procesverbalet. Neni 18 i Normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat" përcakton se procesverbalet kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet të protokollohen. Referuar nenit 19 të këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Procesverbalet e paraqitura, duke mos qenë të protokolluara, në kundërshtim me sa cituar më sipër, nuk përbëjnë dokumentacion të rregullt dhe nuk merren në konsideratë.

2.4.15. Procedura e Prokurimit: "Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta".

A. Të dhëna mbi objektin

1. Urdhër Prokurimi nr. Nr.1682/4 prot. datë 30.05.2019 Njësinë e prokurimit : E. Xh., M.Xh., R. L..	3. Llogaritja e fondit limit Me anë të urdhrit nr.12, datë 03.01.2019 është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: M.H., E.Xh. dhe A. L. - Urdhër për ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike nr. 1682/2 prot. datë 30.05.2019 me përbërje: z. I. M., N. J. dhe L. M.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Shkresa nr. 1682/5 prot. datë 30.05.2019 urdhërohet Komisioni i përbërë nga: M.M., E.Xh., M. B.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim (shërbime)		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 4,100,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE "F." sh.p.k, me vlerë oferte 4,079,632 lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 20,632 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 10.06.2019	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Bashkisë	10. Operatoret Ekonomike 1. OE "F." sh.p.k, me vlerë oferte 4,079,632 lekë pa tvsh
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka; APP- nuk ka; KPP- nuk ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		

14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.1682/11, datë 01.07.2019 midis Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit (Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit) dhe operatori ekonomik “F.” sh.p.k. kontrata me afat 3 muaj nga data e nënshkrimit të saj, me çmim kontrate 4,079,632 lekë pa tvsh / 4,895,559 lekë me tvsh.	15.Vlera e kontratës (me tvsh) lekë: 4,895,559 lekë me tvsh	16.Likuiduar Urdhër shpenzimin me nr 232, datë 15.10.2019
17- Situacioni Përfundimtar Vlera me tvsh 4,641,296.25 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 62 ditë Zbatuar 62 ditë	19.Zgjatja e kontratës me..... ditë Nuk ka

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, nga audituesit e KLSH-së u auditua procedura e prokurimit me objekt: “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”. Për auditimin e kësaj procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2018-31.12.2021;

Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP;

Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar;

Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së;

Përlllogaritja e fondit limit.

Situacionin përfundimtar, librezat masash etj.

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike.

Bazuar në kontrollet në terren të grupeve të gjelbërimit dhe nevojës për ndërhyrje për rikualifikimin e mikrohapësirave të gjelbërta, me anë të shkresës nr.1682 prot. datë 30.05.2019, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit z.M.M.ka paraqitur kërkesën për ndërhyrje për rikualifikimin e mikrohapësirave të gjelbërta. Bashkëlidhur shkresës projekt me skicat mbi lulishtet që do të rikualifikohen. (Të dhëna për dy lulishte nga 10 që janë zbatuar).

Kërkesa e mësipërme, u miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit z.A. Q., i cili nisur nga sa më lart kërkon hapjen e procedurës së prokurimit me objekt “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”, me fond limit 4,100,000 lekë pa tvsh, miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, znj. A. B., me shkresën nr.1682/1 prot. datë 30.05.2019,.

Znj.A. B. ka urdhëruar ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike me shkresën nr. 1682/2 prot. datë 30.05.2019, me përbërje: z. I. M., z. N.J.dhe znj. L.M. Komisioni i ngritur kanë hartuar dhe dorëzuar me shkresën nr.1682/3 prot. datë 30.05.2019, kriteret teknike dhe specifikimet teknike që duhet të kenë operatorët ekonomik, (pjesë e DST), si dhe preventivat me sasi të.

Sipas urdhrit nr.12, datë 03.01.2019 “Për ngritjen e komisionit për llogaritjen e vlerës limit të kontratave” është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: znj. M.H.i, z. E. Xh.dhe znj. A. L.. Grupi i punës ka mbajtur argumentimin “Për llogaritjen e vlerës limit”, më datë 30.05.2019, i cili për përlllogaritjen e vlerës së kontratës është bazuar në testimin të tregut, në bazë të tre ofertave. Anëtarët e komisionit të përlllogaritjes së vlerës limit, kanë llogaritur fondin limit me vlerë 4,100,000 lekë pa tvsh, kjo vlerë është mesatarja e tre ofertave. Urdhri i prokurimit me shkresën nr.1682/4 prot. datë 30.05.2019 urdhëron kryerjen e prokurimit me objekt “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”, me fond limit 4,100,000 lekë pa tvsh, procedurë kërkesë për propozim, dhe ngritjen e njësisë së prokurimit të përbërë nga z. E. Xh., znj. R. L., znj. M. Xh.

Njësia e prokurimit më datë 30.05.2019 ka mbajtur procesverbalin “Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit për kontratën me objekt “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta””, ku ka përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë OE pjesëmarrës në procedurë.

Me anë të shkresës nr.1682/7 prot. datë 31.05.2019, kërkesë për ofertë, drejtuar 5 OE D. 09, F., Sh. I.t, E. K., G. F. sh.p.k. sipas VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 39 Kërkesa për propozime, pika 4, ku citohet: “...Pavarësisht nga publikimi i njoftimit të kontratës, sipas pikës 2, të këtij neni, autoriteti kontraktor fton për të marrë pjesë dhe të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë...”. Mungon argumentimi i përzgjedhjes së OE të mësipërm.

Dhe me shkresën nr. 11/2 prot. datë 10.06.2019 me lëndë “Urdhër për zëvendësimin e anëtarit të njësisë së prokurimit”, zëvendësohet anëtari i njësisë së prokurimit znj. R. L. me z. J. P.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve teknike rezulton se në procesverbalin e mbajtur nga grupi ka disa parregullsi në shkelje të Ligjit të prokurimit publik.

- Referuar DST pika 2.3 Kapaciteti teknik pika 2.3.4 ku citohet: “...Operatori ekonomik duhet të vërtetoj se disponon kualifikimet e duhura të stafit inxhinierik përkatës si më poshtë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për këtë operator ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij për të gjithë periudhën e kërkuar: Inxhinier mekanik (një), Inxhinier mjedisi (një) i pajisur me Certificate nga Ministria e Mjedisit, Inxhinier agronom (dy), Inxhinier hidroteknik (një), Inxhinier gjeolog (një)...”.

a-Kriteri për inxhinier mjedisi i pajisur me Certificate nga Ministria e Mjedisit: Nuk është specifikuar çfarë tipi certificate kërkohet nga ministria e Mjedisit, por certificate e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor e lëshuar nga Ministria e Mjedisit duhet të ketë një person i punësuar në kompani i cili ka profilin arsimor si specifikohet në VKM nr.122 datë 17.02.2011. Kriteri i vendosur diskriminues në kundërshtim me nenin 1, pika 2d, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, ku citohet: “...Qëllimi i këtij ligji është: Të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomik, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik...”, si dhe VKM nr.122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në vendimin nr.1124, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me Certificate të specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”, pika 2, ku citohet: “...të drejtën për t’u pajisur me Certificate e kanë specialistët e diplomuar në fushën e mjedisit ose të agromjedisit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në universitetet ose shkollat e larta jopublike, të akredituara për degët e sipërpërmendura ose në institucionet e huaja të arsimit të lartë që ofrojnë këto programe studimi, pas njësimit të diplomës së tyre, si dhe specialistët e diplomuar në shkencat inxhinierike, biologjike, kimike, gjeologjike, hidrologjike, ekonomike dhe gjeografike...”.

b-kriteri për inxhinierin gjeolog: Kriteri i vendosur në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 28 Kontratat e shërbimeve, pika 2, ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”.

- Referuar DST pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.9 ku citohet: “...Licence profesionale e Shoqërisë e vlefshme me kategorinë ...NS-20-A (Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë) ...” ndërkohë në preventive nuk ka zë për shpim pusi në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 28 Kontratat e shërbimeve, pika 2, ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të

përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”.

Titulli i gjetjes:	Kriteret kualifikuese të paargumentuara dhe të pajustificuara kanë zvogëluar konkurrencën
Situata:	Për procedurën: “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta” rezulton se: 1. Inxhinier Mjedisi i pajisur me certifikatë nga Ministria e Mjedisit dhe inxhinieri gjeolog i kërkuar në kriterin 2.3, pika 2.3.4 e DST Kapaciteti teknik. Certifikata e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor e lëshuar nga Ministria e Mjedisit duhet të ketë një person i punësuar në kompani i cili ka profilin arsimor si specifikohet në VKM nr.122 datë 17.02.2011. Kriteri për inxhinierin gjeolog, në kundërshtim me nenin 28, pika 2, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014. 2. Kategoria e kërkuar e licencës NS-20-A “Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë” nuk ka lidhje me natyrën e kontratës, në kundërshtim me nenin 28, pika 2, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014.
Kriteri:	VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 28 Kontratave të shërbimeve, pika 2. VKM nr.122, datë 17.02.2011 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me Çertifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”, pika 2.
Ndikimi:	Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.
Shkaku	Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. VKM nr.122, datë 17.02.2011 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me Çertifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Njësia e Prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të marrë masa për përcaktimin e procedurës së prokurimit duke u mbështetur në natyrën e kontratës, si dhe për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit duke argumentuar dhe dokumentuar në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për të mosfavorizuar operatorë ekonomik të caktuar.
Afati:	Menjherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi njësia e prokurimit z.E. Xh., znj.R. L., znj.M. Xh. në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe komisioni për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike z.I. M., z.N. J., znj.L. M. në cilësinë e anëtarëve të komisionit për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas shkresës nr. 1682/5 prot. datë 30.05.2019 me lëndë “Urdhër për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave”, ngrihet komisioni i përbërë nga: z.M. M., z.E. Xh., z.M. B.

Komisioni më datë 10.06.2019, ka mbajtur procesverbalin e hapjes së ofertave ku ishin paraqitur 1 operator ekonomik:

Operatori ekonomik “F.” sh.p.k, me vlerë oferte 4,079,632 lekë pa tvsh.

Më datë 12.06.2019, komisioni ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit ku jepet informacion mbi shqyrtimin e ofertës dhe plotësimin e kriterëve nga operatorët pjesëmarrës. Ku përcaktohet se:

Operatori ekonomik “F.” sh.p.k. me vlerë oferte 4,079,632 lekë pa tvsh, plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

KVO ka klasifikuar Operatori ekonomik “F.” sh.p.k. si oferta më ekonomike dhe plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Nga auditimi i realizimit të procedurës në sistemin elektronik të APP sipas vlerësimit të KVO, rezultoi se:

- KVO ka kualifikuar OE, i cili ka dorëzuar diplomën, kontratën e punës (të vlefshme brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave) dhe CV përkatëse, librezat e punës si dhe certifikatat e kërkuara vetëm për një inxhinier agronom nga 2 të kërkuar në kriteret e përcaktuara në DST. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 2.3.4 ku citohet: “...Operatori ekonomik duhet të vërtetoj se disponon kualifikimet e duhura të stafit inxhinierik përkatës si më poshtë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për këtë operator ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin se ka sit ë punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij për të gjithë periudhën e kërkuar: Inxhinier mekanik (një), Inxhinier mjedisi (një) I pajisur me Certifikatë nga Ministria e Mjedisit, Inxhinier agronom (dy), Inxhinier hidroteknik (një), Inxhinier gjeolog (një)... Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomik duhet të paraqesin diplomat, kontratat e punës (të vlefshme brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave) dhe CV përkatëse, librezat e punës si dhe certifikatat e kërkuara më sipër...”.

Titulli i gjetjes:	Parregullsi në vlerësimin e ofertave
Situata:	Nga auditimi i realizimit të procedurës “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta” në sistemin elektronik të APP sipas vlerësimit të KVO, rezultoi se: 1. KVO ka kualifikuar OE, i cili ka dorëzuar diplomën, kontratën e punës (të vlefshme brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave) dhe CV përkatëse, librezat e punës si dhe certifikatat e kërkuara vetëm për një inxhinier agronom nga 2 të kërkuar në kriteret e përcaktuara në DST. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 2.3.4.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
Ndikimi:	Është kryer vlerësimi në kundërshtim me kërkesat ligjore të prokurimit.
Shkaku	Mosvlerësim i saktë i ofertave ekonomike.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, me anë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, për shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratave.
Afati:	Menjherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i vlerësimit të ofertave z.M. M., z.E. Xh., z.M. B., me cilësinë e anëtarëve të KVO.

Raporti përmbledhës i mbajtur me nr. 1682/8 prot. datë 20.06.2019, jepet informacion mbi procedurën, vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës, dhe klasifikimin nga KVO, në vendin e parë sipas kriterit çmimi më i ulët dhe i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e caktuara në DST, KVO ka klasifikuar operatorin ekonomik “F.” sh.p.k. Ky raport është miratuar me anë të shkresës nr. 1682/9 prot. datë 20.06.2019 nga Titullari i AK znj. A. B. dhe Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit z. A. Q. dhe kanë shpallur fitues operatorin ekonomik “F.” sh.p.k. me vlerë oferte 4,079,632 lekë pa tvsh.

-Lidhja e kontratës

Është lidhur kontrata me nr.1682/11, datë 01.07.2019 midis Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit (Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit), të përfaqësuar nga Titullari i DPN1 nr znj. A. B. dhe operatori ekonomik “F.” sh.p.k. me NIPT J...S, me licencë në zbatim NZ.1163/17, kontrata me afat 3 muaj nga data e nënshkrimit të saj, me çmim kontrate 4,079,632 lekë pa tvsh / 4,895,559 lekë me tvsh.

(Sigurimi i kontratës me vlerë 489,556 lekë me afat deri në zbatimin e kontratës).

-Zbatimi i kontratës

Me shkresën nr.1682/12 prot. datë 01.07.2019, urdhërohet “Për ndjekjen e zbatimit të kontratës me objekt “Rikualifikim i mikrohapësirave të gjelbra”, komisioni me përbërje: znj. N.Gj., z. I. F., znj. M. M.j, i cili ka ndjekur zbatimin e punimeve sipas cilësisë dhe specifikimeve dhe në përfundim duhet të përgatiste procesverbalin për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik Fusha sh.p.k. me datë 02.07.2019, ka protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit me nr.1682/14 prot. datë 03.07.2019, ka dorëzuar shkresën për njoftimin e fillimit të punimeve.

Më datë 02.07.2019 është mbajtur akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, proces verbali mbi fillimin e punimeve midis Investitorit, Grupit të ndjekjes së punimeve dhe Sipërmarrësit të punimeve. Si dhe proces verbali mbi akt piketimin e objektit midis Grupit të ndjekjes së punimeve dhe Sipërmarrësit të punimeve

Operatori ekonomik F. sh.p.k. me datë 30.09.2019, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit me nr.1682/16 prot. datë 30.09.2019, ka dorëzuar shkresën për njoftimin e përfundimit të punimeve.

Më datë 30.09.2019 është mbajtur proces verbali i dorëzimit të punimeve midis Grupit të ndjekjes së punimeve dhe Sipërmarrësit të punimeve.

Situacion përfundimtar për punime deri më datë 30.09.2019, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit me nr.1682/15 prot. datë 30.09.2019, me vlerë punimesh 4,641,296.25 lekë me tvsh. (Mbajtur garanci punimesh 5% e vlerës së punimeve 244,278.75 lekë).

Pas përfundimit të punimeve grupi i ndjekjes së punimeve ka hartuar relacionin përfundimtar me informacion mbi zbatimin e punimeve, si dhe foto gjatë punimeve në tre lulishte “Frosina Plaku, Ana Komena, dhe pranë shkollës Pjetër Budi nga 9 lulishte.

Më datë 01.10.2019 midis grupit të marrjes në dorëzim dhe Sipërmarrësit të punimeve është mbajtur procesverbal i marrjes së përkohshme në dorëzim, si dhe është mbajtur certifikata e marrjes në dorëzim të punimeve të objektit “Rikualifikimi i mikrohapësirave të gjelbra”.

Me anë të shkresës nr.1682/19 prot. datë 16.10.2019 i është dërguar APP informacion mbi zbatimin e procedurës “Rikualifikimi i mikrohapësirave të gjelbra”. (Vetëm formulari).

Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezulton mungesa e certifikatave të cilësisë së materialeve, që vërteton cilësinë e punimeve, në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” kreu III, Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit, ku citohet:

“... 9. Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen: dh) Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre...”.

Titulli i gjetjes:	Mungesat e dokumentave kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”, është konstatuar mungesa e një prej dokumentave kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit, që vërteton kontrollin e cilësisë së punimeve, si provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve, veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.
Kriteri:	Kreu III “Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit”, pika 2, 4, 9, Udhëzimi Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”
Ndikimi:	Mungesa e verifikimit të cilësisë të materialeve e të produkteve.
Shkaku	Mungesa e mbikëqyrjes së punimeve nga ekspert të fushës dhe realizimi i punimeve të ndërtimit si shërbim dhe jo procedura pune.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për ngritjen e një njësie për monitorimin e zbatimit të kontratave, e cila do të jetë përgjegjëse edhe për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik për secilën kontratë, me qëllim verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve, si dhe cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura.
Afati:	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, znj. A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

Operatori ka sjellë faturën tatimore, me nr 100 datë 30.09.2019, me vlerë 4,885,575 lekë me tvsh / 4,071,312.50 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimin me nr 232, datë 15.10.2019. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si mëposhtë:

Tabela nr. 3: Diferencat e volumeve në objektin: “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar/ Libreza masash	Fakti	Diferenca në volume	
						Vol.	Vlera
	Strukturë mbajtëse metalike	ml	260	100	40	60	15,600
	Prodhim-montim strukturë mbajtëse metalike	ml	260	100	40	60	15,600
						Shuma	31,200

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit.

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Zërat Strukturë mbajtëse metalike dhe Prodhim-montim strukturë mbajtëse metalike. Sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave gjatësia e këtij zëri pune është 100 m, pas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune është realizuar në gjatësi 40 m. Nga rilogaritja, gjatësia e këtij zëri pune është 60 m më pak se sasia e situacionuar.

Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 31,200 lekë pa tvsh / 37,440 lekë me tvsh, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Titulli i gjetjes:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”
Situata:	Nga auditimi i situacioni përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si mëposhtë: Zëri Strukturë mbajtëse metalike. Vlera prej 15,600 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Prodhim-montim strukturë mbajtëse metalike. Vlera prej 15,600 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Argumentimi i këtyre diferencave pasqyrohen të përshkruara më Akt Konstatimin nr.12 dhe në Projekt Raportit të Auditimit.
Kriteri:	Kreu II, pika 8.1 dhe kreu III, pika 4, i Udhëzimit Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”
Ndikimi:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 37,480 lekë me tvsh, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar në fondet e Buxhetit të Shtetit dhe njësisve vendore.
Shkaku	Mungesë e kontrollit të punimeve nga ana e grupit të marrjes në dorëzim.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, të marrë masat për ngritjen e një grupi pune që të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet të fondeve me vlerë prej 37,480 lekë me tvsh, vlerë e cila nuk argumentohet apo justifikohet.
Afati:	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi komisioni për ndjekjen e zbatimit e kontratës znj.N. Gj., z.I. F., znj.M. M.j në cilësinë e anëtarëve të komisionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit znj. A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, ka paraqitur observacionin nr. 185/53 prot., datë 14.04.2023, protokolluar KLSH nr. 1008/7 prot., datë 18.04.2023, ku pretendojnë, si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Mbi hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike:

1. Inxhinier mjedisi i pajisur me certifikatë nga ministria e mjedisit, nevojitet pasi ka punime në preventiv të kësaj natyre. Licenca profesionale janë caktuar në mënyrë që të provojnë kapacitetin teknik dhe profesional të OE (fq.59-61 observacionit);
2. Inxhinierin gjeolog është vendosur duke qenë se në preventiv janë parashikuar hapje gropash për vendosjen e drurëve dekorativ dhe sistemin e vaditjes (fq.59-61 observacionit);

Mbi zhvillimin e procedurës:

3. KVO e kualifikon OE i cili ka dorëzuar të dhëna për një inxhinier agronom, duke e konsideruar devijim të vogël. (fq.65-66 observacionit);

Mbi zbatimin e kontratës:

4. Mbi diferencat e sasive DPPGJ observon se këto punime janë realizuar në vitin 2019 vërtetuar me situacione por në vitin 2023, kanë ndodhur ndërhyrje në lulishte dhe hapësira publike, ndërhyrje në rrjetin e UKT, OSHE etj. (fq.140-141 observacionit);

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Mbi observimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike:

1. Në lidhje me observacionin e subjektit Inxhinieri i mjedisit dhe certifikimi nga ministria e mjedisit nuk janë kriter që duhet hequr, por kriteri i vendosur ku jepet e specifikuar certifikimin duhet ta ketë një inxhinier mjedisi është një kriter diskriminues duke zvogëluar konkurrimin dhe duke dhënë një orientim jo të saktë ofertuesve të mundshëm. Pasi certifikata e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor e lëshuar nga Ministria e Mjedisit duhet të ketë një person i punësuar në kompani i cili ka profilin arsimor si specifikohet në VKM nr.122 datë 17.02.2011.

Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

2. Referuar preventivit të punimeve nuk ka shpime për ujë dhe puse, pra nuk ka nevojë për inxhinier gjeolog. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Mbi observimet lidhur me zhvillimin e procedurës:

3. Sipas LPP në çdo rast AK ka të drejtën të kryejë gjithë verifikimet e nevojshme dhe që OE duhet të kualifikohet vetëm pasi të përmbushë të gjitha kërkesat për kualifikim, devijimi i vogël duhet të jetë i argumentuar në proces verbal, i cili mungon. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Mbi observimet lidhur më zbatimin e kontratës:

4. Pretendimet e subjektit referuar dokumentacionit të ri bashkëlidhur, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit, qëndrojnë pjesërisht. Për sa më sipër ky observacion merret pjesërisht në konsideratë.

Për sa më sipër ky observacion merret pjesërisht në konsideratë.

2.4.16. Procedura e Prokurimit: “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi”.

A. Të dhëna mbi objektin

1. Urdhër Prokurimi nr. Nr.1724/4 prot. datë 23.06.2020 Njësinë e prokurimit: M.Xh., R. L., A. H.	3. Llogaritja e fondit limit Me anë të urdhrit nr.03, datë 06.01.2020 është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: M. H., E. Xh. dhe A. L. - Urdhër për ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike nr. 1724/2 prot. datë 23.06.2020 me përbërje: N. J., A.Q., D. V., Z. B. dhe L.M.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Shkresa nr. 1724/5 prot. datë 23.06.2020 urdhërohet Komisioni i përbërë nga: M. M., E.Xh., M. B.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur (punë)		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 46,750,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) BOE “A.” sh.p.k. dhe “Sh. I.” sh.p.k. me vlerë oferte 45,346,988.06 lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,403,012 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 03.08.2020	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike 1. Operatori ekonomik “6-D P.” sh.p.k, (I skualifikuar). 2. Operatori ekonomik “G. F.” sh.p.k. me vlerë oferte 46,284,306 lekë pa tvsh. (I skualifikuar). 3. BOE “A.” sh.p.k. dhe “Sh. I.” sh.p.k. me vlerë oferte 45,346,988.06 lekë pa tvsh.
11. Ankimime	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka

Pranë AK- Me anë të shkresës nr.622 prot. datë 30.06.2020, protokolluar në DPPGJ, me nr.1833 prot. datë 02.07.2020, ka ardhur një ankesë për modifikim kriteresh nga një OE, me anë të së cilës kërkon heqjen e disa kriterëve ose uljen e numrit të disa makinerive.	nga AK – Autoriteti Kontraktor me anë të shkresës nr.1833/1 prot. datë 03.07.2020, ka kthyer përgjigje OE ankimues.	
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.1742/12, datë 21.08.2020 midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gj. dhe BOE “A.” sh.p.k. dhe “Sh. I.” sh.p.k. me afat 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me çmim kontrate 45,346,988.06 lekë pa tvsh / 54,416,385.67 lekë me tvsh.	15.Vlera e kontratës (me tvsh) lekë: 54,416,385.60 lekë me tvsh	16.Likuiduar Urdhër shpenzimin me nr 12, datë 21.02.2022.
17- Situacioni Përfundimtar Vlera me tvsh 54,416,386 lekë Vlera pa tvsh 45,346,988 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 365 ditë Zbatuar 314 ditë	19. Zgjatja e kontratës me..... ditë Nuk ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE N.M. PF & “XH & M. sh.p.k.	Licenca Nr: MK.0992/3 MK.1322/7	Kontrata me nr. 2085/7 prot, datë 06.08.2020
21. Kolaudatori i punimeve T.sh.p.k.	Licenca Nr: MK.0919/11	Kontrata me nr. 1806/7 prot., datë 21.07.2021
22.Akt Kolaudimi datë 21.08.2021		

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, nga audituesit e KLSH-së u auditua procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvanë në blloqe banimi”. Për auditimin e kësaj procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2018-31.12.2021;

Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP;

Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar;

Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së;

Përlllogaritja e fondit limit.

Situacionin përfundimtar, libreza masash etj.

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike.

Nisur nga nevoja për të shtuar gjelbërimin e qytetit, me anë të shkresës nr.1724 prot. datë 23.06.2020, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit z.M. M.ka paraqitur kërkesën për hapjen e procedurës “Rikonstruksion i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbërta me shatërvanë në blloqe banimi”. Bashkëlidhur shkresës relacioni mbi rikonstruksionin e mikrohapësirave të gjelbërta në disa prej lulishteve kryesore të qytetit. Kërkesa e mësipërme u miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit z.A. Q., i cili nisur nga sa më lart kërkon hapjen e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbërta me shatërvanë në blloqe banimi”, miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, znj.A.B. me shkresën nr.1724/1 prot. datë 23.06.2020.

Znj.A. B.ka urdhëruar ngritjen e komisionit për përgatitjen e projekt zbatimit, preventivat e punimeve, specifikimeve dhe kriterëve teknike me shkresën nr. 1724/2 prot. datë 23.06.2020. Grupi i punës i përbërë nga: z.N. J., znj.A. Q., znj.D. V., znj.Z. B. dhe znj.L.M. kanë hartuar

dhe dorëzuar me shkresën nr.1724/3 prot. datë 23.06.2020, kriteret teknike që duhet të kenë operatorët ekonomik, si dhe projekt zbatimin dhe preventivat me sasi të.

Sipas urdhrit nr.03, datë 06.01.2020 “Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës” është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: znj.M. H., z.E. Xh.dhe znj.A. L.Grupi i punës ka mbajtur argumentimin “Për llogaritjen e vlerës limit”, më datë 23.06.2020, i cili për përlllogaritjen e vlerës së kontratës është bazuar në testimin të tregut, në bazë të tre ofertave. Anëtarët e komisionit të përlllogaritjes së vlerës limit, kanë llogaritur fondin limit me vlerë 46,750,000 lekë pa tvsh, kjo vlerë është mesatarja e tre ofertave.

Urdhri i prokurimit me shkresën nr.1724/4 prot. datë 23.06.2020 urdhëron kryerjen e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbërta me shatërvanë në blloqe banimi” me fond limit 46,750,000 lekë pa tvsh dhe ngritjen e njësisë së prokurimit të përbërë nga znj.R. L., znj.M.Xh., znj.A. H..

Njësia e prokurimit më datë 24.06.2020 ka mbajtur procesverbalin “Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit për kontratën me objekt “Rikonstruksion i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbërta me shatërvanë në blloqe banimi”, ku ka përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë OE pjesëmarrës në procedurë.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriteve teknike rezulton se në procesverbalin e mbajtur nga grupi ka disa parregullsi në shkelje të Ligjit të prokurimit publik.

- Mungojnë specifikimet teknike për materialet që do të përdoren në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, neni 23 Specifikimet teknike, pika 4, ku citohet: “...Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale...”.

- Referuar DST pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2 ku citohet: “...Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin teknik i cili duhet të ketë një eksperience pune jo më pak se 10 vjet...”, kriteri i vendosur diskriminues, në kundërshtim me VKM Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, Kreu IV Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë, pika 1a ku citohet: “...Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 vjet nga diplomimi...”, sipas VKM eksperiencia e drejtuesit teknik nuk duhet më pak se 5 vite dhe jo 10 vite.

- Referuar DST pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 3 ku citohet: “...Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit inxhinierik përkatës si më poshtë me eksperiencë pune 5 vjeçare për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij për të paktën 3 muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë: Inxhinier Mjedisi (1) i pajisur me Certifikatë nga Ministria e Mjedisit...”. Nuk është specifikuar çfarë tipi certifikate kërkohet nga ministria e Mjedisit, por certifikata e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor e lëshuar nga Ministria e Mjedisit duhet të ketë një person i punësuar në kompani i cili ka profilin arsimor si specifikohet në VKM nr.122 datë 17.02.2011. Kriteri i vendosur diskriminues në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006,

ndryshuar, Neni 1, pika 2d, ku citohet: “...Qëllimi i këtij ligji është: Të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomik, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik...”. Dhe VKM nr.122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në vendimin nr.1124, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me Certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”, pika 2, ku citohet: “...të drejtën për t’u pajisur me Certifikatë e kanë specialistët e diplomuar në fushën e mjedisit ose të agromjedisit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në universitetet ose shkollat e larta jopublike, të akredituara për degët e sipërpërmendura ose në institucionet e huaja të arsimit të lartë që ofrojnë këto programe studimi, pas njësimit të diplomës së tyre, si dhe specialistët e diplomuar në shkencat inxhinierike, biologjike, kimike, gjeologjike, hidrologjike, ekonomike dhe gjeografike...”.

- Referuar DST pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 5 ku citohet: “...Operatori Ekonomik duhet të ketë 1 Inxhinier Menaxhimi Mjedisor i pajisur me Licencë për vlerësimin në fushën “Tokë bujqësore, tokë pyjore, kullota, livadh dhe toka të pafrytshme” ...”. Kjo licencë duhet të ketë një person i punësuar në kompani i cili ka profilin arsimor si specifikohet në VKM nr.712, datë 12.10.2016. Kriter i vendosur diskriminues në kundërshtim me Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, Neni 1, pika 2d, ku citohet: “...Qëllimi i këtij ligji është: Të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomik, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik...”. Dhe VKM nr.712, datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme”, Neni 14, pika 2, ku citohet: “...Individi apo vlerësuesi i shoqërisë që kërkon të pajiset me licencë si vlerësues i tokës bujqësore, i tokës pyjore, i tokës kullotë, i tokës livadh dhe i tokës së pafrytshme, duhet të: a) jetë diplomuar pas kryerjes së studimeve universitare të ciklit të dytë “Master” (ose ekuivalentë të këtij cikli) në degët: “Inxhinieri agrarë”, “Inxhinieri agromjedisi”, “Inxhinieri pyjesh”, “Inxhinieri përpunim druri”, “Ekonomi dhe Agrobiznes”, si dhe në degët e inxhinierisë, arkitekturës ose ekonomisë;...”.

- Referuar DST pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 10 ku citohet: “...Operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme: ...11. Makineri për shkuljen e pemëve - 1 copë; 12. Makineri prerëse me fije diamanti për stola betoni e pajisur me qkl - 1 copë...”. Kriter i vendosur në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 26 Kontratat për punë publike, pika 5, ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve...”.

Titulli i gjetjes:	Kriteret kualifikuese të paargumentuara dhe të pajustificuara kanë zvogëluar konkurrencën
Situata:	Për për procedurën: “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi” rezulton se: 1. Mungojnë specifikimet teknike për materialet që do të përdorën, në kundërshtim me nenin 23, pika 4, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar. 2. Drejtuesin teknik i cili duhet të ketë një eksperience pune jo më pak se 10 vjet i kërkuar në kriterin 2.3, pika 2, të DST, në kundërshtim me Kreu IV, të VKM Nr.42, datë 16.01.2008. 3. Inxhinier Mjedisi i pajisur me certifikatë nga Ministria e Mjedisit i kërkuar në kriterin 2.3, pika 3 e DST Kapaciteti teknik. Certifikata e specialistit, për

	<p>vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor e lëshuar nga Ministria e Mjedisit duhet të ketë një person i punësuar në kompani i cili ka profilin arsimor si specifikohet në VKM nr.122 datë 17.02.2011.</p> <p>4. Inxhinier Menaxhimi Mjedisor i pajisur me Licencë për vlerësimin në fushën “Tokë bujqësore, tokë pyjore, kullota, livadh dhe toka të pafytyrshme” i kërkuar në kriterin 2.3, pika 5 e DST Kapaciteti teknik. Kjo licencë duhet të ketë një person i punësuar në kompani i cili ka profilin arsimor si specifikohet në VKM nr.712, datë 12.10.2016.</p> <p>5. Makineri për shkëlqjen e pemëve dhe Makineri prerëse me fije diamanti për stola betoni e pajisur me qkl e kërkuar në kriterin 2.3, pika 10, të DST, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014.</p>
Kriteri:	<p>Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 Specifikimet teknike, pika 4.</p> <p>VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 26 Kontratat për punë publike, pika 5.</p> <p>VKM nr.122, datë 17.02.2011 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me Çertifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”, pika 2.</p> <p>VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” lidhja 3 Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve). Kreu IV Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë, pika 1a.</p> <p>VKM nr.712, datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme”, Neni 14, pika 2.</p>
Ndikimi:	Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.
Shkaku	<p>Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.</p> <p>VKM nr.122, datë 17.02.2011 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me Çertifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”.</p> <p>VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.</p> <p>VKM nr.712, datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme”.</p>
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Njësia e Prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të marrë masa për përcaktimin e procedurës së prokurimit duke u mbështetur në natyrën e kontratës, si dhe për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit duke argumentuar dhe dokumentuar në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për të mosfavorizuar operatorë ekonomik të caktuar.
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa që në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të administrohet

	dokumentacioni i nevojshëm identifikues grafik (si plane, harta, etj.) në mënyrë që të mundësohet evidentimi i vendndodhjes së realizimit të punimeve, që ndër të tjera do të shërbejë si gjurmë auditimi.
Afati:	Menjherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi njësia e prokurimit znj.R.L., znj.M. Xh., znj.A. H. në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe komisioni për përgatitjen e specifikimeve dhe kritereve teknike z.N. J., znj.A. Q., znj.D. V., znj.Z. B. dhe znj.L. M. në cilësinë e anëtarëve të komisioneve për përgatitjen e specifikimeve dhe kritereve teknike Për mungesën e dokumentacionit justifikues ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit znj,A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

OE L.K. sh.p.k., ka dërguar një ankesë me anë të së cilës kërkon heqjen e disa kritereve ose uljen e numrit të disa makinerive, ankesa ardhur me shkresën nr.622 prot. datë 30.06.2020, dhe protokolluar në DPPGJ me nr.1833 prot. datë 02.07.2020.

Me shkresën nr. 1742/4 prot. datë 02.07.2020 me lëndë “Urdhër për pezullimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbërta me shatërvane në blloqe banimi”, urdhërohet pezullimi i procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga OE në Autoritetin Kontraktor.

Sipas shkresës nr. 1742/5 prot. datë 02.07.2020 me lëndë “Urdhër për ngritjen e Komisionit për shqyrtimin e ankesave”, komisioni i përbërë nga: J.P., B. V., J. K., ka shqyrtuar ankesën e ardhur nga OE.

Autoriteti Kontraktor me shkresën nr.1833/1 prot. datë 03.07.2020, pas shqyrtimit të ankesës nga komisioni i ka kthyer përgjigje OE ankimes.

Autoriteti Kontraktor ka bërë modifikimin një kriteri, ku është hequr kriteri Makineri për shkuljen e pemëve, si dhe kanë ndryshuar datën e hapjes së ofertave, caktuar data e re 03.08.2020. Ky modifikim realizuar me anë të shtojcës për një modifikim në Dokumentet Standarde të Tenderit me objekt: “Rikonstruksion i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbërta me shatërvani në blloqe banimi”, shkresa nr.1742/7 prot. datë 04.07.2020.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas shkresës nr.1724/5 prot. datë 23.06.2020 me lëndë “Urdhër për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave”, ngrihet komisioni i përbërë nga: z.M. M., z.E. Xh., z.M. B.

Komisioni më datë 03.08.2020, ka mbajtur procesverbalin e hapjes së ofertave ku ishin paraqitur 3 operatorë ekonomik:

Operatori ekonomik “6-D P.” sh.p.k, nuk ka paraqitur asnjë ofertë ekonomike.

Operatori ekonomik “G.F.” sh.p.k. me vlerë oferte 46,284,306 lekë pa tvsh.

Bashkimi i operatorëve ekonomik “A.” sh.p.k. dhe “Sh. I.” sh.p.k. me vlerë oferte 45,346,988.06 lekë pa tvsh.

Më datë 04.08.2020, komisioni ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit ku jepet informacion mbi shqyrtimin e ofertës dhe plotësimin e kritereve nga operatorët pjesëmarrës. Ku përcaktohet se:

OE 6-D P. sh.p.k. nuk ka paraqitur asnjë ofertë ekonomike.

OE “G. F.” sh.p.k. me vlerë oferte 46,284,306 lekë pa tvsh, plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim, por nuk plotëson kriteret e veçanta si, pika1 (b,ç,d,dh, e,f,g,gj), pika 2.2 b,pika 2.3 (nënpikat a,b,2,3,5,7,8,10).

BOE “A.” sh.p.k. dhe “Sh. I.” sh.p.k. me vlerë oferte 45,346,988.06 lekë pa tvsh, i cili plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim. KVO ka klasifikuar BOE “A.” sh.p.k. dhe “Sh. I.” sh.p.k. si oferta më ekonomike dhe gjithashtu ka plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Nga auditimi i realizimit të procedurës në sistemin elektronik të APP sipas vlerësimit të KVO, rezultoi se:

- KVO ka kualifikuar OE, referuar preventivit ku janë përcaktuar përqindja e pjesëmarrjes së punës dhe elementet konkrete, OE i cili ka marrë përsipër kryerjen e disa punimeve elektrike, pavarësisht se ky operator ekonomik nuk është i licencuar për punime elektrike (referuar licencën së dorëzuar nga OE në sistemin elektronik të APP).

- KVO ka kualifikuar OE për Drejtuesin Teknik me një eksperiencë pune inxhinierike prej 8 vitesh, referuar diplomimit Diploma Bachelor është marrë në vitin 2012. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 2 ku citohet: "...Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin teknik i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 10 vjet...".

- KVO ka kualifikuar OE, pavarësisht mungesës së fotove për pajisjet e tjera dhe dumper (përfshijë mjetet e targuara dhe gjeneratorin të cilët kanë foto). Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 10, c ku citohet: "...Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje si dhe në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme targa e mjetit...".

- KVO ka kualifikuar OE, i cili për disa nga mjete ka dorëzuar siguracion mjeti jashtë afatit, gjithashtu dhe kontrolli teknik për disa prej tyre është jashtë afatit. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 10, d ku citohet: "...Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme)...".

Titulli i gjetjes:	Parregullsi në vlerësimin e ofertave
Situata:	<p>Nga auditimi i realizimit të procedurës "Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi" në sistemin elektronik të APP sipas vlerësimit të KVO, rezultoi se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. KVO ka kualifikuar OE, referuar preventivit ku janë përcaktuar përqindja e pjesëmarrjes së punës dhe elementet konkrete, OE i cili ka marrë përsipër kryerjen e disa punimeve elektrike, pavarësisht se ky operator ekonomik nuk është i licensuar për punime elektrike (referuar licencën së dorëzuar nga OE në sistemin elektronik të APP). 2. KVO ka kualifikuar OE për Drejtuesin Teknik me një eksperiencë pune inxhinierike prej 8 vitesh, referuar diplomimit Diploma Bachelor është marrë në vitin 2012. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 2. 3. KVO ka kualifikuar OE, pavarësisht mungesës së fotove për pajisjet e tjera dhe dumper (përfshijë mjetet e targuara dhe gjeneratorin të cilët kanë foto). Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 10. 4. KVO ka kualifikuar OE, i cili për disa nga mjete ka dorëzuar siguracion mjeti jashtë afatit, gjithashtu dhe kontrolli teknik për disa prej tyre është jashtë afatit. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 10, d.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Ndikimi:	Është kryer vlerësimi në kundërshtim me kërkesat ligjore të prokurimit.

Shkaku	Mosvlerësim i saktë i ofertave ekonomike.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, me anë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, për shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratave.
Afati	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i vlerësimit të ofertave z.M. M., z.E. Xh., z.M. B. me cilësinë e anëtarëve të KVO.

Raporti përmbledhës i mbajtur me nr.1742/8 prot. datë 12.08.2020, jepet informacion mbi procedurën, vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës, dhe klasifikimin nga KVO, në vendin e parë sipas kriterit çmimi më i ulët dhe i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e caktuara në DST, KVO ka klasifikuar BOE “A.” sh.p.k. dhe “Sh. I.” sh.p.k.. Ky raport është miratuar me anë të shkresës nr.1742/9 prot. datë 12.08.2020 nga Titullari i AK znj. A.B. dhe Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit z. A. Q., ku dhe kanë shpallur fitues BOE “A.” sh.p.k. dhe “Sh. I.” sh.p.k. me vlerë oferte 45,346,988.06 lekë pa tvsh.

-Lidhja e kontratës

Është lidhur kontrata me nr.1742/12, datë 21.08.2020 midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të përfaqësuar nga Titullari znj. A. B. dhe bashkimin e operatorëve ekonomik “A.” sh.p.k. me NIPT L....G, përfaqësuar nga Administratori znj. R.Sh., me licencë në zbatim NZ.6830/1 dhe “Sh. I.” sh.p.k. me NIPT J...T, përfaqësuar nga Administratori z. Sh.C., me licencë në zbatim NZ.1495/21, kontrata me afat 12 muaj nga data e nënshkrimit të saj, me çmim kontrate 45,346,988.06 lekë pa tvsh / 54,416,385.67 lekë me tvsh.

(Sigurimi i kontratës me vlerë 5,441,638.56 lekë me afat deri në zbatimin e kontratës).

Pagesa sipas kontratës do të realizohet në 3 vite kalendarike, vlera prej 13,150,000 lekë me tvsh do të lëvrohet brenda vitit kalendarik 2020, vlera prej 20,975,000 lekë me tvsh do të lëvrohet brenda vitit kalendarik 2021, dhe pjesa e mbetur do të lëvrohet gjatë vitit 2022.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.2085/7 prot, datë 06.08.2020, midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të përfaqësuar nga Titullari znj. A. B. dhe BOE “N. M.” PF me NIPT K....M, përfaqësuar nga znj. N. M., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0992/3, dhe “XH &M.” sh.p.k. me NIPT K.3E, përfaqësuar nga znj. Xh. D., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1322/7 si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 529,011.4 lekë pa tvsh / 634,813.68lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.1806/7 prot, datë 21.07.2021, midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të përfaqësuar nga Titullari znj. A. B. dhe “T.” sh.p.k. me NIPT K...L, përfaqësuar nga znj. D. Q., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0919/11 si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 41,662 lekë pa tvsh / 49,994.4 lekë me tvsh.

-Zbatimi i kontratës

Me shkresën nr.1742/13 prot. datë 21.08.2020, urdhërohet “Për ndjekjen e zbatimit të kontratës me objekt “Rikonstruksion i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbërta me shatërvanë në blloqe banimi”, komisioni me përbërje: z.F.T., znj.V.P., z.Sh. F., i cili do të ndjekë zbatimin e punimeve sipas cilësisë dhe specifikimeve dhe në përfundim do të përgatis procesverbalin për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit, procesverbali i akt piketimit, proces verbali i fillimit të punimeve dhe fillimi i punimeve sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 21.08.2020. Punimet duhet të përfundonin në datën 21.08.2021 dhe kanë përfunduar me datë 30.06.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Me anë të shkresës me datë 15.03.2021, me lëndë kërkesë për miratim çmimesh për objektin “Rikonstruksion i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbërta me shatërvanë në blloqe banimi”, sipërmarrësi i punimeve njofton Mbikëqyrësin e punimeve dhe AK, sipas kërkesës për përmirësim dhe modifikim projekti dhe preventivi, por disa zëra punimesh nuk ekzistojnë në preventivin e ofertës, dhe kërkon miratimin e zërave të rinj. Mbikëqyrësi i punimeve, me shkresën datë 15.03.2021, i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit për miratimin e përmirësimeve teknike-financiare të projektit, duke bashkëlidhur tabelën e ndryshimeve të volumeve, analiza e çmimeve të zërave të rinj, procesverbalet e konstatimeve të ndryshimeve si dhe kërkesën e sipërmarrësit për miratimin e ndryshimeve.

Procesverbali për ndryshimin e volumeve brenda preventivit bazë (volume që shtohen dhe hiqen në objektin: “Rikonstruksion i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbërta me shatërvanë në blloqe banimi”, kryesisht për lulishten pranë rrugës “Irfan Tomini”, lulishte “Vëllezërit Frashëri”), i miratuar nga Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi i Punimeve dhe Autoriteti Kontraktor.

Procesverbali për ndryshimet e projektit, jep shpjegimet mbi arsyet e ndryshimeve, i miratuar nga Sipërmarrësi i Punimeve dhe Mbikëqyrësi i Punimeve.

Për negociimin e çmimeve për zërat e rinj, me datë 19.03.2021, kanë mbajtur procesverbalin e negociimit midis Sipërmarrësit të punimeve, Mbikëqyrësit të Punimeve dhe Autoritetit Kontraktor.

Më datë 07.12.2020, në prani të komisionit për ndjekjen e zbatimit e kontratës dhe të operatorit ekonomik është mbajtur situacioni pjesor nr.1, ku jepet tabela me sasi të dhe me vlerë për secilën nënobjekt të realizuar më vete, komisioni kontrollon punimet e realizuara në objekte dhe i konsideron ato që janë realizuar sipas specifikimeve teknike. Me anë të këtij dokumenti komisioni ka marrë në dorëzim punimet për sasi të sipas këtij situacioni.

Më datë 30.06.2021, në prani të komisionit për ndjekjen e zbatimit e kontratës dhe të operatorit ekonomik është mbajtur situacioni pjesor nr.2, ku jepet tabela me sasi të dhe me vlerë për secilën nënobjekt të realizuar më vete, komisioni kontrollon punimet e realizuara në objekte dhe i konsideron ato që janë realizuar sipas specifikimeve teknike. Me anë të këtij dokumenti komisioni ka marrë në dorëzim punimet për sasi të sipas këtij situacioni.

Situacioni progresiv përfundimtar nga fillimi deri më 30.06.2021, me vlerë punimesh totale 54,416,389 lekë me tvsh, (zbritje garanci punimesh 2,720,819 lekë) miratuar nga Sipërmarrësi i punimeve Shoqëria “A.” sh.p.k., Mbikëqyrësi i punimeve BOE “N. M.” PF & “XH&M.” sh.p.k. dhe Investitori i punimeve Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.

Sipërmarrësi i punimeve me shkresën me nr.extra prot. datë 30.06.2021 ka njoftuar Mbikëqyrësin e punimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, se më datë 30.06.2021 ka përfunduar punimet në objekt. Si dhe procesverbali i dorëzimit të punimeve është mbajtur më datë 30.06.2021, midis Sipërmarrësit të punimeve dhe Mbikëqyrësit të punimeve.

Procesverbali i kolaudimit, mbajtur më datë 21.08.2021, nga kolaudatori i punimeve shoqëria “T.” sh.p.k., Mbikëqyrësi i punimeve BOE “N. M.” PF & “XH & M.” shpk dhe Sipërmarrësi i punimeve BOE “A.” shpk & “Sh. I.” shpk.

Më datë 29.09.2022 është dërguar me postë elektronike monitorimit të kontratave të APP formulari i raportimit mbi zbatimin e punimeve.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezulton mungesa e certifikatave të cilësisë së materialeve, që vërteton cilësinë e punimeve, në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për

zbatimin e punimeve të ndërtimit” kreu III, Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit, ku citohet:

“... 9. Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen: dh) Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre...”.

Titulli i gjetjes:	Mungesat e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”, është konstatuar mungesa e një prej dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit, që vërteton kontrollin e cilësisë së punimeve, si provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve, veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.
Kriteri:	Kreu III “Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit”, pika 2, 4, 9, Udhëzimi Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”
Ndikimi:	Mungesa e verifikimit të cilësisë të materialeve e të produkteve.
Shkaku	Mungesa e kontrollit të cilësisë së punimeve.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Mbikëqyrësi i Punimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit të marrë masat për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik, me qëllim verifikimin e cilësinë së punimeve dhe materialeve e të produkteve të përdorura.
Afati	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve BOE “N. M.” PF, dhe “XH &M.” sh.p.k. znj. N. M. dhe znj. Xh.D., në cilësinë e Mbikëqyrësit të punimeve.

Nga auditimi rezulton se:

Mungesa e lejes për hapjen e puseve veprime në kundërshtim me ligjin Nr. 111/2015 Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar neni 8, Aksesin ndaj projekteve hidrogjeologjike, ku citohet: “... 1. Personi, fizik ose juridik, privat ose shtetëror, që kryen shpime për ujërat nëntokësore, me thellësi mbi 15 m nga sipërfaqja e tokës, përpara se të paraqesë projektin hidrogjeologjik në këshillin e baseneve, është i detyruar të marrë miratimin për projektin nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, që e shqyrton sipas akteve ligjore përkatëse...2. Pas miratimit të lejes, një kopje e projektit dhe një kopje e relacionit për rezultatet e punimeve të kryera depozitohen në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë....”, dhe ligjit Nr.6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” Neni 41 Përdorimi me leje i ujit, pika 1 ku citohet: “...1. Veprimtaritë e mëposhtme, që mund të kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, do të ushtrohen në bazë të lejes administrative të lëshuar nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore.... b) Ujitja....”.

Dhe Neni 56 Shpuesit profesionistë, pika 2-6 ku citohet: “...2. Organet e menaxhimit të burimeve ujore japin leje për kryerjen e shpimit pasi shpuesi profesionist paraqet projektin teknik dhe hidrogjeologjik për shpimin, të hartuar nga subjekte juridike të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi. 3. Shpuesi profesionist, jo më vonë se një muaj pas përfundimit të shpimit, u paraqet organeve të administrimit të burimeve ujore, në dy kopje, një raport të hollësishëm hidrogjeologjik në lidhje me shpimin, me mostrat e shtresave të shpuara, si dhe gjithë dokumentacionin përkatës, projektin fillestar të shpimit dhe relacionin pas shpimit. Organet e administrimit të burimeve ujore i dërgojnë një kopje Arkivit Qendror Gjeologjik. 4.

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar duhet t'u japë informacionin përkatës organeve të menaxhimit të burimeve ujore për projektet hidrogeologjike dhe relacionet e shpimit, të dorëzuara nga subjektet pranë këtij institucioni. 5. Leja e shfrytëzimit për nxjerrje uji lëshohet nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, pasi shpuesi profesionist paraqet relacionin teknik dhe hidrogeologjik për përdorimin potencial të pusit, të hartuar nga subjekte juridike të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi. 6. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë së shpimit për nxjerrje uji nga ana e subjekteve fizike, juridike apo personave të pa licencuar, pa leje përkatëse të shpimit nga organet e menaxhimit të burimeve ujore...”.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e lejeve për hapjen e puseve
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës për procedurën “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvanë në blloqe banimi” u konstatua mungesa e lejes për hapjen e puseve, veprime në kundërshtim me nenin 8 të ligjit Nr. 111/2015 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, si dhe nenit 41 dhe 56 të ligjit nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar.
Kriteri:	Ligji Nr. 111/2015 Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar neni 8, Aksesi ndaj projekteve hidrogeologjike. Ligji Nr.6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” Neni 41 Përdorimi me leje i ujit, pika 1, Neni 56 Shpuesit profesionistë, pika 2-6.
Ndikimi:	Realizimi i hapjes së puseve për vaditje pa u pajisur me leje nga entet përkatëse.
Shkaku	Mosrespektimi i legjislacionit në fuqi për menaxhimin e burimeve ujore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për pajisjen me leje për hapje pusi për pusët e hapura dhe ato që do të hapen në vazhdimësi sipas përcaktimeve ligjore për menaxhimin e burimeve ujore.
Afati:	Menjherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, znj. A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

Operatori ekonomik ka sjellë faturën tatimore, me nr 71 datë 07.12.2020, me vlerë 14,342,040 lekë me tvsh / 11,951,700 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 245, datë 22.12.2020 (likuiduar vlera 13,150,000 lekë me tvsh), likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 34, datë 25.02.2021 (likuiduar vlera 1,192,040 lekë me tvsh).

(Magazinuar: Fletë hyrje nr.8 datë 07.12.2020).

Operatori ekonomik ka sjellë faturën tatimore, me nr 04/2021 datë 06.09.2021, me vlerë 40,074,345 lekë me tvsh / 33,395,287.5 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 210, datë 12.10.2021 (likuiduar vlera 28,807,960 lekë me tvsh). likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 12, datë 21.02.2022 (likuiduar vlera 11,266,385 lekë me tvsh).

(Magazinuar: Fletë hyrje nr.5 datë 06.09.2021).

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si mëposhtë:

Tabela nr. 4: Diferencat e volumeve në objektin: “Rikonstruksion i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbërta me shatërvanë në blloqe banimi”.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libreza masash	Fakti	Diferenca në volume	
							Vol.	Vlera

Lulishte "Ali Demi"								
	Spote uji	copë	15,000	4	4	0	4	60,000
Shuma 1								60,000
Lulishte pranë kryqëzimit të rrugës "Gjin Bue Shpata" dhe rrugës "Pjetër Bogdani"								
	Stola dekorativ për pushim	copë	40,000	4	4	2	2	80,000
	Gardh druri 1.6x100xH80cm	ml	2,500	50	50	30	20	50,000
Shuma 2								130,000
Lulishte pranë TOB								
	Sprucator spërkatës për shatërvan	copë	16,700	10	10	7	3	50,100
	Spote uji	copë	15,000	8	8	0	8	120,000
Shuma 3								170,100
Pylli orbital, ndërmjet rrugëve "Dervish Luzha" dhe "Ali Beshiri"								
	Bordura trotuari 20x35cm të parapërgatitura	ml	1,200	720	720	230	490	588,000
Shuma 4								588,000
Total (Shuma 1-4)								948,100

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit.

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Lulishte "Ali Demi".

Zëri Spote uji. Sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave sasia e këtij zëri pune është 4 copë, pas verifikimit në terren u konstatua se ky zë pune nuk është realizuar. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 4 copë më pak se sasia e situacionuar.

Lulishte pranë kryqëzimit të rrugës "Gjin Bue Shpata" dhe rrugës "Pjetër Bogdani".

Zëri Stola dekorativ për pushim. Sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave sasia e këtij zëri pune është 4 copë, pas verifikimit në terren u konstatua se ky zë pune është realizuar me sasinë 2 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 2 copë më pak se sasia e situacionuar.

Zëri Gardh druri 1.6x100xH80cm. Sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave gjatësia e këtij zëri pune është 50 m, pas verifikimit në terren u konstatua se ky zë pune është realizuar me gjatësi 30m. Nga rillogaritja, gjatësia e këtij zëri pune është 20 m më pak se gjatësia e situacionuar.

Lulishte pranë TOB.

Zëri Sprucator spërkatës për shatërvan. Sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave sasia e këtij zëri pune është 10 copë, pas verifikimit në terren u konstatua se ky zë pune është realizuar me sasinë 7 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 3 copë më pak se sasia e situacionuar.

Pylli orbital, ndërmjet rrugëve "Dervish Luzha" dhe "Ali Beshiri".

Zëri Bordura trotuari 20x35cm të parapërgatitura. Sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave gjatësia e këtij zëri pune është 720 m, pas verifikimit në terren u konstatua se ky zë pune është realizuar me gjatësi 230 m. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 490 m më pak se gjatësia e situacionuar.

Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 948,100 lekë pa tvsh / 1,137,720 lekë me tvsh, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Titulli i gjetjes:	Diferenca në volume për punime të deklaruarra të kryera në objektin “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi”
Situata:	Nga auditimi i situacioni përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si mëposhtë: Lulishte “Ali Demi”. Zëri Spote uji. Vlera prej 60,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Lulishte pranë kryqëzimit të rrugës “Gjin Bue Shpata” dhe rrugës “Pjetër Bogdani”. Zëri Stola dekorativ për pushim. Vlera prej 80,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Gardh druri 1.6x100xH80cm. Vlera prej 50,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Lulishte pranë TOB Zëri Sprucator spërkatës për shatërvan. Vlera prej 50,100 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Spote uji. Vlera prej 120,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Pylli orbital, ndërmjet rrugëve “Dervish Luzha” dhe “Ali Beshiri”. Zëri Bordura trotuari 20x35cm të parapërgatitura. Vlera prej 588,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Argumentimi i këtyre diferencave pasqyrohen të përshkruara në Akt Konstatimin nr.13 dhe në Projekt Raportit të Auditimit.
Kriteri:	Kreu II, pika 8.1 dhe kreu III, pika 4, i Udhëzimit Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”
Ndikimi:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 1,137,720 lekë me tvsh, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar në fondet e Buxhetit të Shtetit dhe njësisve vendore.
Shkaku	Mungesë e kontrollit të punimeve nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, të marrë masat për ngritjen e një grupi pune që të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet të fondeve me vlerë prej 1,137,720 lekë me tvsh, vlerë e cila nuk argumentohet apo justifikohet.
Afati:	Menjherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve BOE “N. M.” PF dhe “XH & M.” sh.p.k. përfaqësuar nga znj. N. M. dhe znj. Xh. D. në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve dhe Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, znj. A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, ka paraqitur observacionin nr. 185/53 prot., datë 14.04.2023, protokolluar KLSH nr. 1008/7 prot., datë 18.04.2023, ku pretendojnë, si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Mbi zhvillimin e procedurës:

1. Zëri i punimeve elektrike është vlerë e vogël, KVO e ka gjykuar si devijim i vogël dhe ka kualifikuar OE, (fq. 66-67 observacionit).

2. KVO e ka kualifikuar OE referuar eksperiencës në CV dhe librezën e punës, (fq. 67 observacionit).

3. KVO e ka kualifikuar OE pasi ka paraqitur një sërë makinerish dhe pajisjesh shtesë. Dhe mangësitë e konstatuara i ka konsideruar si devijime të vogla, (fq. 67 observacionit).

Mbi zbatimin e kontratës:

4. Mbi diferencat e sasive DPPGJ observon se këto punime janë realizuar në vitin 2020 vërtetuar me situacione dhe libreza masash por në vitin 2023, kanë ndodhur ndërhyrje në lulishte dhe hapësira publike, ndërhyrje në rrjetin e UKT, OSHE etj., bashkëlidhur dhe procesverbalet e dëmtimit të konstatuara.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Mbi observimet lidhur me zhvillimin e procedurës:

1. Në lidhje me gjykimin si devijim të vogël të kushtit mbi marrjen e punimeve elektrike të OE që nuk e ka pikë të licencës KVO duhet ta kishte argumentuar konstatimin e devijimit të vogël, në përputhje me nenin 53 të LPP 9643 datë 20.11.2006 pika 4. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

2. Para marrjes së titullit me anë të diplomimit, punëmarrësi nuk mund të jetë i punësuar me titull inxhinier/teknik ndërtimi. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

3. Në lidhje me gjykimin si devijim të vogël të mjeteve KVO duhet ta kishte argumentuar konstatimin e devijimit të vogël, në përputhje me nenin 53 të LPP 9643 datë 20.11.2006 pika 4.

4. Gjithashtu mangësitë e konstatuara nga grupi i auditimit mbi mungesën e fotove, siguracionit dhe kontrollit teknik janë për pajisje dhe mjete të deklaruara sipas kriterëve të kërkuara në DST. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Mbi observimet lidhur me zbatimin e kontratës:

4. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur:

- Lulishte pranë rrugës Irfan Tomini, është marrë në konsideratë në Projekt Raport.

- Lulishte përballë rrugës Mustafa Qosja, pranë kopshtit nr.11, zëri hapje gropa 60x60x60 cm, ky observacion merret në konsideratë.

- Lulishte përballë kryqëzimit të rrugëve Ali Demi dhe Spiro Velko, është marrë në konsideratë në Projekt Raport.

- Lulishte Ali Demi, zëri spote uji, nga verifikimi në terren mungonin, gjithashtu mungon dokumentacioni verifikues për vendosjen 4 spoteve, procesverbalet nuk përmbajnë elementët kryesor që të jenë dokument i rregullt në kundërshtim me udhëzimin nr.30 të ministrisë së financave, ky observacion nuk merret në konsideratë.

- Lulishte pranë kryqëzimit të rrugës Gjin Bue Shpata dhe Pjetër Bogdani, zëri bordura trotuari 20x35 cm, ky observacion merret në konsideratë.

- Lulishte pranë kryqëzimit të rrugës Gjin Bue Shpata dhe Pjetër Bogdani, gjatë auditimit në terren zëri stolat mungonin, ky observacion nuk merret në konsideratë.

- Lulishte pranë kryqëzimit të rrugës Gjin Bue Shpata dhe Pjetër Bogdani, zëri gardh druri nga verifikimi në terren mungon 20 ml, ky observacion nuk merret në konsideratë.

- Lulishte Vëllezërit Frashëri, zëri hapje gropa 60x60x60 cm, ky observacion merret në konsideratë.

- Lulishte tek fusha aviacionit pranë kopshtit xixëllonja, zëri hapje gropa 60x60x60 cm, ky observacion merret në konsideratë.

- Lulishte tek fusha aviacionit pranë kopshtit xixëllonja, zëri bordura trotuari 20x35 cm, ky observacion merret në konsideratë.

- Lulishte pranë parlamentit, zëri sprucator spërkatës për shatërvan, është marrë në konsideratë në Projekt Raport.

- Lulishte pranë TOB, zëri sprucator spërkatës për shatërvan, nga verifikimi në terren është realizuar në sasinë 7 copë, mungon dokumentacioni verifikues i vendosjes procesverbalet nuk

përmbajnë elementët kryesor që të jenë dokument i rregullt në kundërshtim me udhëzimin nr.30 të ministrisë së financave, ky observacion nuk merret në konsideratë.

- Pylli orbital, ndërmjet rrugëve Dervish Luzha dhe Ali Beshiri, bordura në terren 20x35 cm të parapërgatitura, ky observacion nuk merret në konsideratë.

Procesverbalet bashkëlidhur observacioneve janë në kundërshtim me pikën 36 të

Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, në mbështetje të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", përcakton se dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen dhe përmban të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Pika 35.b e këtij udhëzimi jep një përkufizim të dokumenteve vërtetues, të cilët vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike të veprimeve, ku përfshihen, ndër të tjera, edhe procesverbalet. Neni 18 i Normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat" përcakton se procesverbalet kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet të protokollohen. Referuar nenit 19 të po këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Procesverbalet e paraqitura, duke mos qenë të protokolluara, në kundërshtim me sa cituar më sipër, nuk përbëjnë dokumentacion të rregullt dhe nuk merren në konsideratë, ndërsa dokumentacioni i hartuar sipas dispozitave ligjore merren në konsideratë.

Për sa më sipër ky observacion merret pjesërisht në konsideratë.

2.4.17. Procedura e Prokurimit: "Blerje drurë dhe shkurre dekorative".

A. Të dhëna mbi objektin

1. Urdhër Prokurimi nr. Nr.110/4 prot. datë 04.03.2020 Njësinë e prokurimit: M. X., J.P., A.H..	3. Llogaritja e fondit limit Me anë të urdhrit nr.03, datë 06.01.2020 është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: M.H., E.Xh. dhe A. L. - Urdhër për ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve dhe kritereve teknike nr. 110/2 prot. datë 17.01.2020 me përbërje: N. J., B. V. dhe H.H.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Shkresa nr. 110/5 prot. datë 04.03.2020 urdhërohet Komisioni i përbërë nga: E.Xh., M.B., M.M..
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur (mallra)		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 35,833,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE "A." sh.p.k. me vlerë oferte 35,800,000 lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 33,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 30.03.2020	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Bashkisë	10. Operoret Ekonomike 1. OE "A." sh.p.k. me vlerë oferte 35,800,000 lekë pa tvsh
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka; APP- nuk ka; KPP- nuk ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi 2020		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur marrëveshja kuadër me nr.110/10, datë 14.05.2020 midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit dhe operatorit ekonomik	15.Vlera e kontratës (me tvsh) lekë: 18,492,600 lekë me tvsh	16.Likuiduar Urdhër shpenzimit me nr 37, datë 25.02.2021.

“A.” shpk me afat 24 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. a) Është lidhur kontrata me nr.110/12, datë 14.05.2020 me afat 12 muaj.		
17- Faturë Malli nr.09 dt.08.07.2020 Vlera me tvsh 10,020,900 lekë Vlera pa tvsh 8,350,750 lekë Faturë Malli nr.44 dt.12.11.2020 Vlera me tvsh 8,471,700 lekë Vlera pa tvsh 7,059,750 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 365 ditë Zbatuar 182 ditë	19. Zgjatja e kontratës me..... ditë Nuk ka
b. Zbatimi i MiniKontratës 2021		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur marrëveshja kuadër me nr.110/10, datë 14.05.2020 midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit dhe operatorit ekonomik “A.” shpk me afat 24 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. b) Është lidhur kontrata me nr.99/3, datë 18.01.2021 me afat 12 muaj.	15.Vlera e kontratës (me tvsh) lekë: 24,467,400 lekë me tvsh	16.Likuiduar Urdhër shpenzimin me nr 250, datë 31.12.2021.
17- Faturë Malli nr.5000/2021 dt.10.05.2021 Vlera me tvsh 13,573,800 lekë Vlera pa tvsh 11,311,500 lekë Faturë Malli nr. 36/2021 dt.03.12.2021 Vlera me tvsh 10,893,600 lekë Vlera pa tvsh 9,078,000 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 365 ditë Zbatuar 347 ditë	19. Zgjatja e kontratës me..... ditë Nuk ka

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë, nga audituesit e KLSH-së u auditua procedura e prokurimit me objekt: “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”. Për auditimin e kësaj procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2018-31.12.2021;

Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP;

Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar;

Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së;

Përlllogaritja e fondit limit.

Situacionin përfundimtar etj.

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike.

Nisur nga nevoja për të shtuar gjellbërimitin e qytetit, me anë të shkresës nr.110 prot. datë 17.01.2020, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjellbërimit të Qytetit z.M.M. ka paraqitur kërkesën për blerje drurë dhe shkurre dekorative. Bashkëlidhur shkresës tabela e sasive përkatësisht për 1610 copë drurë dhe 1060 copë shkurre, si dhe shkuljen e 70 drurëve dekorativ ekzistues, gjithashtu dhe relacioni me karakteristikat silvobiologjike për disa nga llojet e drurëve dhe shkurreve si përbërës kryesor të gjellbërimit në rikonstruksionin e mikrohapsirave të gjellërta.

Kërkesa e mësipërme u miratuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit z.A. Q., i cili nisur nga sa më lart kërkon hapjen e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”, miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, znj.A.B.me anë të shkresës nr.110/1 prot. datë 17.01.2020.

Znj.A. B. ka urdhëruar ngritjen e grupit të specializuar për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve teknike me shkresën nr. 110/2 prot. datë 17.01.2020. Grupi i punës i përbërë nga: z.N.J., z.B. V. dhe z.H. H., kanë hartuar dhe dorëzuar me shkresën nr.110/3 prot. datë 04.03.2020, kriteret teknike dhe specifikimet teknike që duhet të kenë operatorët ekonomik.

Sipas urdhrorit nr.03, datë 06.01.2020 “Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës” është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: znj.M. H., z.E.Xh. dhe znj.A.L. Grupi i punës ka mbajtur argumentimin “Për llogaritjen e vlerës limit” në datën 17.01.2020, i cili për përlllogaritjen e vlerës së kontratës është bazuar në testimin të tregut, në bazë të tre ofertave. Anëtarët e komisionit të përlllogaritjes së vlerës limit, kanë llogaritur fondin limit me vlerë 35,833,000 lekë pa tvsh, kjo vlerë është mesatarja e tre ofertave.

Urdhri i prokurimit me anë të shkresës nr.110/4 prot. datë 04.03.2020 urdhëron kryerjen e prokurimit me objekt “Blerje drurë dhe shkurre dekorative” me fond limit 35,833,000 lekë pa tvsh dhe ngritjen e njësisë së prokurimit të përbëhet nga z.J. P., znj.M.Xh., znj.A.H.

Njësia e prokurimit më datë 04.03.2020 ka mbajtur procesverbalin “Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit për kontratën me objekt “Blerje drurë dhe shkurre dekorative””, ku ka përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë OE pjesëmarrës në procedurë.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriteve teknike rezulton se në procesverbalin e mbajtur nga grupi ka disa parregullsi në shkelje të Ligjit të prokurimit publik.

- Mungon dokumentacioni justifikues si plane, vizatime, modele, makete etj. nga kanë dalë këto sasi si dhe zonat ku ka nevojë për gjelbërim (sipërfaqet e nevojshme). Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 23 Specifikimet teknike, pika 4, ku citohet: “...Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale...”. Si dhe në kundërshtim më me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 27 Kontratat e mallrave, pika 1, ku citohet: “...Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara...”.

Titulli i gjetjes:	Kriteret kualifikuese të paargumentuara dhe të pajustificuara kanë zvogëluar konkurrencën
Situata:	Për procedurën: “Blerje drurë dhe shkurre dekorative” rezulton se: 1. Mungon dokumentacioni justifikues si plane, vizatime, modele, makete etj. nga kanë dalë këto sasi si dhe zonat ku ka nevojë për gjelbërim, në kundërshtim me nenin 23, pika 4, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.
Kriteri:	Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 Specifikimet teknike, pika 4.
Ndikimi:	Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.
Shkaku	Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa që në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të administrohet dokumentacioni i nevojshëm identifikues grafik (si plane, harta, etj.) në

	mënyrë që të mundësohet evidentimi i vendndodhjes së realizimit të punimeve, që ndër të tjera do të shërbejë si gjurmë auditimi.
Afati:	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, znj. A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas shkresës nr. 110/5 prot. datë 04.03.2020 me lëndë “Urdhër për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave” ngrihet komisioni i përbërë nga: z. M. M., z. E. Xh., z. M. B.

Komisioni më datë 30.03.2020, ka mbajtur procesverbalin e hapjes së ofertave ku është paraqitur 1 operator ekonomik:

Operatori ekonomik “A.” sh.p.k. me vlerë oferte 35,800,000 lekë pa tvsh.

Më datë 01.04.2020, komisioni ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit ku jepet informacion mbi shqyrtimin e ofertës dhe plotësimin e kriterëve nga operatorët pjesëmarrës. Ku përcaktohet se:

OE “A.” sh.p.k. plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, KVO ka klasifikuar OE “A.” sh.p.k. me vlerë oferte 35,800,000 lekë pa tvsh si oferta më ekonomike dhe gjithashtu ka plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Nga auditimi i realizimit të procedurës në sistemin elektronik të APP sipas vlerësimit të KVO, rezultoi se:

- KVO ka kualifikuar OE, i cili ka dorëzuar Certifikata ISO 39001-2012 e cila është lëshuar nga një subjekt i pa akredituar për këtë certifikim. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 11, ku citohet: “...Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur Certifikatën ISO 39001-2012 për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) ...”.

Titulli i gjetjes:	Parregullsi në vlerësimin e ofertave
Situata:	Nga auditimi i realizimit të procedurës “Blerje drurë dhe shkurre dekorative” në sistemin elektronik të APP sipas vlerësimit të KVO, rezultoi se: 1. KVO ka kualifikuar OE, i cili ka dorëzuar Certifikata ISO 39001-2012 e cila është lëshuar nga një subjekt i pa akredituar për këtë certifikim. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 11.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
Ndikimi:	Është kryer vlerësimi në kundërshtim me kërkesat ligjore të prokurimit.
Shkaku	Mos vlerësim i saktë i ofertave ekonomike.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, me anë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, për shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratave.
Afati:	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i vlerësimit të ofertave z.M. M., z.E. Xh., z.M. B., me cilësinë e anëtarëve të KVO.

Raporti përmbledhës i mbajtur me nr. 110/7 prot. datë 27.04.2020, ku jepet informacion mbi procedurën, vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës dhe klasifikimin nga KVO, në vendin e parë sipas kriterit çmimi më i ulët dhe i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e caktuara në DST, KVO ka klasifikuar operatori ekonomik “A.” sh.p.k.. Ky raport është miratuar me anë të shkresës nr. 110/8 prot. datë 27.04.2020 nga Titullari i AK znj. A. B. Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit z. A. Q. ku dhe kanë shpallur fitues OE “A.” sh.p.k. me vlerë ofertë 35,800,000 lekë pa tvsh.

-Lidhja e kontratës 2020

Është lidhur marrëveshja kuadër me nr.110/10, datë 14.05.2020 midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit përfaqësuar nga titullari znj.A.B. dhe operatorit ekonomik “A.” shpk me NIPT K....N, përfaqësuar nga z.P. T., me afat 24 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Me anë të shkresës nr.110/11 prot. datë 14.05.2020, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit z.M.M. ka paraqitur kërkesën me sasi të parashikuara për blerje drurë dhe shkurre dekorative për vitin e parë të marrëveshjes kuadër. Bashkëlidhur shkresës tabela e sasive përkatësisht për 897 copë drurë dhe 260 copë shkurre, si dhe shkuljen e 25 drurëve dekorativ ekzistues, gjithashtu dhe procesverbali me llojet dhe sasi të pritshme të mbillen gjatë 12 muajve të parë të marrëveshjes kuadër me vlerë 15,410,500.00 lekë pa tvsh. Kërkesa është miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit z.A. Q.

Është lidhur kontrata me nr.110/12, datë 14.05.2020 midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit përfaqësuar nga titullari znj.A. B. dhe operatorit ekonomik “A.” shpk me NIPT K....N, përfaqësuar nga z.P. T., me afat 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me çmim kontrate 15,410,500.00 lekë pa tvsh.

(Sigurimi i kontratës me vlerë 1,541,050 lekë me afat 14.05.2020 – 13.05.2021).

-Zbatimi i kontratës 2020

Me shkresën nr.1441 prot. datë 14.05.2020, urdhërohet “Për ndjekjen e zbatimin e kontratës me objekt “Blerje drurë dhe shkurre dekorative””, komisioni me përbërje: z. A.B., z. E.M., z. A.K., i cili duhet të ndjekë zbatimin e shërbimit dhe ka marrë në dorëzim drurët dhe shkurret. Më datë 08.07.2020, në prani të komisionit për ndjekjen e zbatimin e kontratës dhe të operatorit ekonomik është mbajtur situacioni nr.1, ku jepet tabela me sasi të parashikuara dhe me vlerë 8,350,750.00 lekë pa tvsh, komisioni ka realizuar vlerësimin e drurëve dhe shkurreve dekorative dhe i konsideron ato që janë realizuar sipas specifikimeve teknike. Me anë të këtij dokumenti komisioni ka marrë në dorëzim mallin (dhe vendosjen) për sasi të parashikuara sipas këtij situacioni.

Më datë 12.11.2020, në prani të komisionit për ndjekjen e zbatimin e kontratës dhe të operatorit ekonomik është mbajtur situacioni nr.2, ku jepet tabela me sasi të parashikuara dhe me vlerë 7,059,750.00 lekë pa tvsh, komisioni ka realizuar vlerësimin e drurëve dhe shkurreve dekorative dhe i konsideron ato që janë realizuar sipas specifikimeve teknike. Me anë të këtij dokumenti komisioni ka marrë në dorëzim mallin (dhe vendosjen) për sasi të parashikuara sipas këtij situacioni.

-Lidhja e kontratës 2021

Me anë të shkresës nr.99 prot. datë 18.01.2021, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit z.M. M. ka paraqitur kërkesën me sasi të parashikuara për blerje drurë dhe shkurre dekorative për vitin e dytë të marrëveshjes kuadër. Bashkëlidhur shkresës tabela e sasive përkatësisht për 713 copë drurë dhe 800 copë shkurre, si dhe shkuljen e 45 drurëve dekorativ ekzistues. Kërkesa është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm znj. A. B. Është lidhur kontrata me nr.99/3, datë 18.01.2021 midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit përfaqësuar nga titullari znj.A. B.dhe operatorit ekonomik “A.” shpk me NIPT K....N, përfaqësuar nga z.P. T., me afat 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me çmim kontrate 20,389,500.00 lekë pa tvsh.

(Sigurimi i kontratës me vlerë 2,446,740 lekë me afat 14.01.2021 – 16.01.2022).

-Zbatimi i kontratës 2021

Me shkresën nr.99/4 prot. datë 18.01.2021, urdhërohet Për ndjekjen e zbatimit të kontratës me objekt “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”, komisioni me përbërje: z. A. B., z. E.M., z. A. K., i cili do të marrë në dorëzim mallin.

Më datë 10.05.2021, në prani të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës dhe të operatorit ekonomik është mbajtur situacioni nr.1, ku jepet tabela me sasi dhe me vlerë 11,311,500.00 lekë pa tvsh, komisioni ka realizuar vlerësimin e drurëve dhe shkurreve dekorative dhe i konsideron ato që janë realizuar sipas specifikimeve teknike. Me anë të këtij dokumenti komisioni ka marrë në dorëzim mallin (dhe vendosjen) për sasi sipas këtij situacioni.

Me anë të shkresës nr.99/5 prot. datë 12.10.2021, urdhërohet “Për ndjekjen e zbatimit të kontratës me objekt “Blerje drurë dhe shkurre dekorative””, zëvendësoi anëtarin e komisionit z. E. M. me z. R. J.

Më datë 03.12.2021, në prani të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës dhe të operatorit ekonomik është mbajtur situacioni nr.2, ku jepet tabela me sasi dhe me vlerë 9,078,000.00 lekë pa tvsh, komisioni ka realizuar vlerësimin e drurëve dhe shkurreve dekorative dhe i konsideron ato që janë realizuar sipas specifikimeve teknike. Me anë të këtij dokumenti komisioni ka marrë në dorëzim mallin (dhe vendosjen) për sasi sipas këtij situacioni.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezulton mungesat e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, si libri i masave, ditarët e punimeve, provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve etj. veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” kreu III, Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit ku citohet:

“...1. Gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, i cili përmban: a) Dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit....

...2.Puna e kryer dhe çastet më të rëndësishme gjatë ndërtimit të objektit pasqyrohen në librin e kantierit, që mbahet në formën e ditarit të objektit e të raportit të punimeve.

2.1 Ditari i objektit pasqyron ngjarjet më të rëndësishme gjatë ecurisë së punimeve, deri në fund të periudhës së garancisë së tyre.

...4.Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre.

.... 9.Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen: dh) Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre...” etj.

- Mungon dokumentacioni justifikues për mbjelljen e pemëve (Si raporte/relacione mbi vendndodhjen, sasi që janë mbjellur në secilën zonë, si dhe foto gjatë procesit të punës dhe përdorimit të mjetet), veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; nr.797, datë 29.12.2017; nr.80, datë 14.2.2018), neni 77 Mbikëqyrja e kontratës, pika 3 dhe 4, ku citohet:

“...3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

4. Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një

raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti...”.

Titulli i gjetjes:	Mungesat e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”, është konstatuar mungesa e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, si libri i masave dhe vizatimet, ditarët e punimeve, provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve, veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”. Për procedurat:
Kriteri:	Kreu III “Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit”, pika 2, 4, 9, Udhëzimi Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”
Ndikimi:	Mungesa e verifikimit të saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve dhe cilësisë të materialeve e të produkteve.
Shkaku	Mungesa e mbikëqyrjes së punimeve nga ekspert të fushës dhe realizimi i punimeve të ndërtimit si shërbim dhe jo procedura pune.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për ngritjen e një njësie për monitorimin e zbatimit të kontratave, e cila do të jetë përgjegjëse edhe për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik për secilën kontratë, me qëllim verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve, si dhe cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura dhe dokumentacioni i nevojshëm grafik.
Afati	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, znj. A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

Operatori ka sjellë faturën tatimore, me nr 09 datë 08.07.2020, me vlerë 10,020,900 lekë me tvsh / 8,350,750 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimin me nr 136, datë 19.08.2020.

(Magazinar: Fletë hyrje nr.4 datë 08.07.2020).

Operatori ka sjellë faturën tatimore, me nr 44 datë 12.11.2020, me vlerë 8,471,700 lekë me tvsh / 7,059,750 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimin me nr 233, datë 10.12.2020 (likuiduar 7,979,100 lekë me tvsh) dhe me urdhër shpenzimin me nr 37, datë 25.02.2021 (likuiduar 492,600 lekë me tvsh).

(Magazinar: Fletë hyrje nr.6 datë 12.11.2020).

Operatori ka sjellë faturën tatimore, me nr 5000/2021 datë 10.05.2021, me vlerë 13,573,800 lekë me tvsh / 11,311,500 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimin me nr 134, datë 09.06.2021. (Magazinar: Fletë hyrje nr.1 datë 10.05.2021).

Operatori ka sjellë faturën tatimore, me nr 36/2021 datë 03.12.2021, me vlerë 10,893,600 lekë me tvsh / 9,078,000 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimin me nr 247, datë 31.12.2021 (likuiduar 10,401,000) dhe me urdhër shpenzimin me nr 250, datë 31.12.2021 (likuiduar 492,600). (Magazinar: Fletë hyrje nr.6 datë 03.12.2021).

Nga auditimi dokumentacionit mbi pagesën e faturave rezultoi se urdhër shpenzimet mbi pagesën e faturave janë kryer në kundërshtim me nenin nr 19 të KPK Afatet e Pagesës

pika 19.4, ku citohet "...Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa për mallrat do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë pranuar mallrat ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë...".

Titulli i gjetjes:	Pagesa e faturave me vonesë, përtej afateve të përcaktuara në Kontratë
Situata:	Nga auditimi dokumentacionit mbi pagesën e faturave rezultoi se urdhër shpenzimet mbi pagesën e faturave janë kryer në kundërshtim me nenin nr 19 të KPK Afatet e Pagesës pika 19.4, ku citohet "...Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa për mallrat do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë pranuar mallrat ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë...".
Kriteri:	Kontrata me nr.99/3, datë 18.01.2021 midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit dhe OE "A." sh.p.k.
Ndikimi:	Mundësi për pagesë fature me kamate në raste se do kërkohej nga OE
Shkaku	Vonesa në pagesën e faturave
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për likuidimin e detyrimeve financiare, sipas afateve të përcaktuar në kontrata..
Afati	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e financës dhe buxhetit, znj. A.L. dhe znj. A. R. në cilësinë e nënpunësit zbatues dhe znj. A. B., në cilësinë e nënpunësit autorizues.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si mëposhtë:

Tabela nr. 5: Diferencat e volumeve në objektin: "Blerje drurë dhe shkurre dekorative".

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar/ relacion / situacionet e brendshme	Fakti	Diferenca në volume	
						Vol.	Vlera
2020							
Rruga e Kavajës							
	Lojfat	copë	7,200	3	2	1	7,200
Pranë Mbikalimit Kthesa e Kamzës							
	Rrap	copë	12,000	15	11	4	48,000
Fusha Aviacionit							
	Ilqe	copë	7,200	8	2	6	43,200
Rruga dytësore e autostradës							
	Rrap	copë	12,000	80	50	30	360,000
Shuma 1 (2020)							458,400
2021							
Blloku i Pallateve në rrugën Frosina Plaku							
	Lejlandër	copë	12,000	3	1	2	24,000

Lulishte në rrugën Muhamet Gjollesha							
	Dafinë	copë	14,400	5	3	2	28,800
	Mimozë	copë	6,300	15	1	14	88,200
Pranë Mbikalimit Kthesa e Kamzës							
	Pishë e butë	copë	28,000	10	5	5	140,000
Zgjatimi Verior i rrugës Ana Komnena							
	Liridendro	copë	20,000	65	24	41	820,000
Rruga dytësore e autostradës							
	Dafinë	copë	14,400	35	25	10	144,000
	Lis	copë	7,200	5	3	2	14,400
Shuma 2 (2021)							1,259,400
Total							1,717,800

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Rruga e Kavajës.

Zëri Lojfat. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 3 copë, pas verifikimit në terren rezulton se ky zë pune është realizuar në sasinë 2 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 1 copë më pak se sasia e situacionuar.

Pranë Mbikalimit Kthesa e Kamzës.

Zëri Rrap. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 15 copë, pas verifikimit në terren rezulton se ky zë pune është realizuar në sasinë 11 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 4 copë më pak se sasia e situacionuar.

Fusha Aviacionit.

Zëri Ilqe. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 8 copë, pas verifikimit në terren rezulton se ky zë pune është realizuar në sasinë 2 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 6 copë më pak se sasia e situacionuar.

Rruga dytësore e autostradës.

Zëri Rrap. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 80 copë, pas verifikimit në terren rezulton se ky zë pune është realizuar në sasinë 50 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 30 copë më pak se sasia e situacionuar.

Zëri Lejlandër. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 3 copë, pas verifikimit në terren rezulton se ky zë pune është realizuar në sasinë 1 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 2 copë më pak se sasia e situacionuar.

Lulishte në rrugën Muhamet Gjollesha.

Zëri Dafinë. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 5 copë, pas verifikimit në terren rezulton se ky zë pune është realizuar në sasinë 3 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 2 copë më pak se sasia e situacionuar.

Zëri Mimozë. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 15 copë, pas verifikimit në terren rezulton se ky zë pune është realizuar në sasinë 1 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 14 copë më pak se sasia e situacionuar.

Pranë Mbikalimit Kthesa e Kamzës.

Zëri Pishë e butë. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 10 copë, pas verifikimit në terren rezulton se ky zë pune është realizuar në sasinë 5 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 5 copë më pak se sasia e situacionuar.

Zgjatimi Verior i rrugës Ana Komnena.

Zëri Liridendro. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 65 copë, pas verifikimit në terren rezulton se ky zë pune është realizuar në sasinë 24 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 41 copë më pak se sasia e situacionuar.

Rruga dytësore e autostradës.

Zëri Dafinë. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 35 copë, pas verifikimit në terren rezulton se ky zë pune është realizuar në sasinë 25 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 10 copë më pak se sasia e situacionuar.

Zëri Lis. Sipas Situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) sasia e këtij zëri pune në këtë zonë është 5 copë, pas verifikimit në terren rezulton se ky zë pune është realizuar në sasinë 3 copë. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 2 copë më pak se sasia e situacionuar.

Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 1,717,800 lekë pa tvsh / 2,061,360 lekë me tvsh, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit.

Titulli i gjetjes:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”
Situata:	<p>Nga auditimi i situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit rezultuan diferenca si mëposhtë:</p> <p>Viti 2020: Zëri Lojfat: Rruga e Kavajës. Vlera prej 7,200 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Rrap: Pranë Mbikalimit Kthesa e Kamzës. Vlera prej 48,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Ilqe: Fusha Aviacionit. Vlera prej 43,200 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Rrap: Rruga dytësore e autostradës. Vlera prej 360,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet.</p> <p>Viti 2021: Zëri Lejlandër: Blloku i Pallateve në rrugën Frosina Plaku. Vlera prej 24,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Dafinë: Lulishte në rrugën Muhamet Gjollësja. Vlera prej 28,800 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Mimosë: Lulishte në rrugën Muhamet Gjollësja. Vlera prej 88,200 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Pishë e butë: Pranë Mbikalimit Kthesa e Kamzës. Vlera prej 140,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Liridendro: Zgjatimi Verior i rrugës Ana Komnena. Vlera prej 820,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet.</p>

	Zëri Dafinë: Rruga dytësore e autostradës. Vlera prej 144,000 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Zëri Lis: Rruga dytësore e autostradës. Vlera prej 14,400 lekë pa tvsh nuk argumentohet apo justifikohet. Argumentimi i këtyre diferencave pasqyrohen të përshkruara në Akt Konstatimin nr.14 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.
Kriteri:	Kreu II, pika 8.1 dhe kreu III, pika 4, i Udhëzimit Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”
Ndikimi:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 2,061,360 lekë me tvsh, e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit në fondet e Buxhetit të Shtetit dhe njësive vendore.
Shkaku	Mungesë e librit të masave si dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve dhe mungesa e dokumentacionit justifikues si plane dhe vizatime mbi vendndodhjen e realizimit të punimeve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e sasisë së drurëve që mungojnë në të gjithë kontratën dhe evidentimin e shkaqeve që ka sjellë përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 2,061,360 lekë me tvsh.
Afati	Menjeherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi komisionit për ndjekjen e zbatimit e kontratës me anëtar z.A. B., z.E. M., z.R. J., z.A. K.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, ka paraqitur observacionin nr. 185/53 prot., datë 14.04.2023, protokolluar KLSH nr. 1008/7 prot., datë 18.04.2023, ku pretendojnë, si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Mbi hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike:

1. Në lidhje me specifikimet jepen me anë të relacionit bashkëlidhur, Drejtorja ka dërguar sasi të planifikuara dhe vendndodhjen e paracaktuar drejtorisë së Financës me anë të planit për propozimin e PBA 2019-2021, (fq. 61 observacionit).

Mbi zhvillimin e procedurës:

2. Certifikata ISO 39001-2012 e cila është lëshuar nga një subjekt i pa akredituar për këtë certifikim KVO e ka gjykuar si devijim i vogël, (fq. 68 observacionit).

Mbi zbatimin e kontratës:

3. Mbi pagesën përtej afateve të parashikuara në kontratë, DPPGJ observon se duke qenë institucion varësie e Bashkisë Tiranë, në rast tejkalimi limiti fondesh çdo muaj kërkon për çelje fondesh (fq.73 observacionit).

4. Mbi diferencat e sasive ekzistojnë proces verbale zëvendësimi, dhe foto të realizimit të tyre në periudhën e realizimit dhe situacionet e marrjes në dorëzim (fq.179-193 observacionit).

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Mbi observimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike:

1. Dokumentacion justifikues si plane, vizatime etj. është e nevojshme për evidentimin e vendndodhjes ku do të vendosen drurët dhe shkurret nga ana e OE fitues dhe çdo subjekt tjetër

që do të kryej verifikimin e realizimit të shërbimit në vazhdimësi, dokumentacioni duhet të jetë pjesë e dosjes teknike të prokurimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë. Mbi observimet lidhur me zhvillimin e procedurës:

2. Në lidhje me gjykimin si devijim të vogël të kriterit për Certifikatën ISO 39001-2012, KVO duhet ta kishte argumentuar konstatimin e devijimit të vogël, në përputhje me nenin 53 të LPP 9643 datë 20.11.2006 pika 4. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Mbi zbatimin e kontratës:

3. Për sa kohë që AK ka nënshkruar një kontratë, duhet të përmbushë kushtet kontraktuale mbi afatet e likuidimit. Nëse vonesat në pritje të miratimeve janë praktikë e zakonshme, AK të marrë në konsideratë rregullimin e nenit që përcakton afatet e likuidimit, pasi ekziston risku i pagesave me kamate, në rast se do të kërkohej nga OE. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

4. Mungesa e dokumentacionit justifikues si plane, vizatime, si dhe librezave të masave sjell dhe mos evidentimin e këtyre sasive me vendndodhjen e tyre gjatë verifikimit në terren. Nga verifikimi në terren i grupit të auditimit në prezencë të specialistëve të DPPGJ, nuk u evidentuan sasitë e konstatuara të munguara në akt konstatimin nr.11 dhe Projekt Raport.

Procesverbalet bashkëlidhur observacioneve janë në kundërshtim me pikën 36 të

Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, në mbështetje të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", përcakton se dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen dhe përmban të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Pika 35.b e këtij udhëzimi jep një përkufizim të dokumenteve vërtetues, të cilët vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike të veprimeve, ku përfshihen, ndër të tjera, edhe procesverbalet. Neni 18 i Normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat" përcakton se procesverbalet kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet të protokollohen. Referuar nenit 19 të po këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Procesverbalet e paraqitura, duke mos qenë të protokolluara, në kundërshtim me sa cituar më sipër, nuk përbëjnë dokumentacion të rregullt dhe nuk merren në konsideratë.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

2.4.18. Procedura e Prokurimit: "Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)".

A. Të dhëna mbi objektin

<p>1. Urdhër Prokurimi nr. Nr.827/4 prot. datë 11.02.2021 Njësinë e prokurimit : R. L., A. K., A.K.</p>	<p>2.Llogaritja e fondit limit.Me anë të urdhrit nr.21, datë 06.01.2021 është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: E. L., E.C. dhe D. D. - Urdhër për ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike nr. 827/2 prot. datë 11.02.2021 me përbërje: E.Xh., I.M. dhe E.Ç.</p>	<p>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Shkresa nr. 827/5 prot. datë 11.02.2018 urdhërohet Komisioni i përbërë nga: M.M., J.P., R. M..</p>
<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur (shërbimi)</p>		

5.Fondi Limit (pa tvsh) 16,650,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE "G.-A" sh.p.k. me vlerë oferte 16,283,489 lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 366,511 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 08.03.2021	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike 1. OE "G.-A" sh.p.k. me vlerë oferte 16,283,489 lekë pa tvsh
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka; APP- nuk ka; KPP- nuk ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.827/10, datë 14.04.2021 midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit dhe OE "G.-A" shpk, me afat 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me çmim kontrate 16,283,489 lekë pa tvsh/19,540,187 lekë me tvsh.	15.Vlera e kontratës (me tvsh) lekë: 19,540,187 lekë me tvsh.	16.Likuiduar Urdhër shpenzimit me nr 144, datë 08.07.2021.
17- Faturë Malli nr.107/2021 dt.15.06.2021. Vlera me tvsh 13,724,991 lekë. Vlera pa tvsh 11,437,492 lekë . Faturë Malli nr.108/2021 dt. 01.07.2021 Vlera: 5,815,196 Lekë. (Me TVSH), 4,845,997 lekë. pa TVSH	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 91 ditë (3 muaj) Zbatuar 78 ditë	19. Zgjatja e kontratës me..... ditë Nuk ka

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë, nga audituesit e KLSH-së u auditua procedura e prokurimit me objekt: "Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)". Për auditimin e kësaj procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2018-31.12.2021;
- Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP;
- Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar;
- Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së;
- Përllogaritja e fondit limit.
- Situacionin përfundimtar etj.
- Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike.

Nisur nga fakti se elementët dekorativ kosha dhe stola dëmtohen vazhdimisht si rezultat i faktorëve natyror dhe subjektiv, si dhe nevojës për mirëmbajtjen dhe funksionimin e elementëve dekorativ, me anë të shkresës nr.827 prot. datë 11.02.2021, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjellbërimit të Qytetit z.M.M. ka paraqitur kërkesën për hapjen e procedurës me objekt "Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)". Bashkëlidhur shkresës tabela e sasive dhe elementëve përbërës për mirëmbajtjen e koshave stolave dekorativ.

Kërkesa e mësipërme u miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit z.A. Q., i cili nisur nga sa më lart kërkon hapjen e procedurës së prokurimit me objekt "Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)", miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, me fond limit 16,650,000 lekë pa tvsh, miratuar dhe nga titullari i Autoritetit Kontraktor znj. A. B., me shkresën nr.827/1 prot. datë 11.02.2021.

Znj. A.B.ka urdhëruar ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe kritereve teknike, me shkresën nr. 827/2 prot. datë 11.02.2021, me përbërje: z.E. Xh., z.I.

M.dhe znj.E. Ç.. Komisioni i ngritur kanë hartuar dhe dorëzuar me shkresën nr.827/3 prot. datë 11.02.2021, kriteret teknike dhe specifikimet teknike që duhet të kenë operatorët ekonomik, (pjesë e DST).

Sipas urdhrit nr.21, datë 06.01.2021 “Për ngritjen e grupit të punës llogaritjen e vlerës limit të kontratave objekt prokurimi të planifikuar për tu prokuruar gjatë vitit 2021” është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: znj.E.L., znj.E. C. dhe znj.D.D. Grupi i punës ka mbajtur “Procesverbalin për përlllogaritjen e fondit limit” në datën 11.02.2021, i cili për përlllogaritjen e vlerës së kontratës është bazuar në testimin të tregut, në bazë të tre ofertave. Anëtarët e komisionit të përlllogaritjes së vlerës limit, kanë llogaritur fondin limit me vlerë 16,650,000 lekë pa tvsh, kjo vlerë është mesatarja e tre ofertave.

Urdhri i prokurimit me shkresën nr.827/4 prot. datë 11.02.2021 urdhëron kryerjen e prokurimit me objekt “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”, me fond limit 16,650,000 lekë pa tvsh, procedurë e hapur, dhe ngritjen e njësisë së prokurimit të përbërë nga znj.R. L., znj.A. K., znj.A. K.

Njësia e prokurimit më datë 11.02.2021 ka mbajtur procesverbalin “Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit për kontratën me objekt “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”, ku ka përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë OE pjesëmarrës në procedurë.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve teknike rezulton se në procesverbalin e mbajtur nga grupi ka disa parregullsi në shkelje të Ligjit të prokurimit publik.

- Mungon dokumentacioni justifikues si plane, vizatime, modele, makete etj. nga kanë dalë këto sasi si dhe zonat ku ka nevojë për riparime. (Relacione shpjegues për sasi dhe specifikimet përkatëse). Në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 23 Specifikimet teknike, pika 4, ku citohet: “...Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale...”.

- Mungojnë specifikimet teknike për materialet që do të përdoren në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 23 Specifikimet teknike, pika 4, ku citohet: “...Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale...”.

- Referuar DST pika 3.3 Kapaciteti teknik, pika 3 ku citohet: “...Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve, të përfshirë në licencën e shoqërisë ose pajisur me licencë individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Gusht 2020- Janar 2021 stafi inxhinierik si më poshtë: 1 (një) inxhinier Ndërtimi, 1 (një) inxhinier Mekanik, 1 (një) inxhinier Mjedisi, 1 (një) inxhinier Elektrik...”, Inxhinieri elektrik nuk përputhet me tipologjinë e punimeve sipas preventivit, kriter në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 28 Kontratat e shërbimeve, pika 2, ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet

të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”

- Referuar DST pika 3.3 Kapaciteti teknik, pika 10 ku citohet: “...Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: ...Makineri e lëvizshme me pajisje speciale për testimin e materialeve të ndërtimit...” Referuar punimeve të preventivit nuk është e nevojshme një makineri e tillë. Në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, neni 28 Kontratat e shërbimeve, pika 2, ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”

Titulli i gjetjes:	Kriteret kualifikuese të paargumentuara dhe të pajustificuara kanë zvogëluar konkurrencën
Situata:	Për procedurën: “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)” rezulton se: 1. Mungon dokumentacioni justifikues si plane, vizatime, modele, makete etj. nga kanë dalë këto sasi si dhe zonat ku ka nevojë për riparime, në kundërshtim me nenin 23, pika 4, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar. 2. Mungojnë specifikimet teknike për materialet që do të përdorën, në kundërshtim me nenin 23, pika 4, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar. 3. Inxhinieri elektrik i kërkuar në pikën 3.3 “Kapaciteti teknik” i DST nuk përputhet me tipologjinë e punimeve sipas preventivit, kriter në kundërshtim me nenin 28, pika 2, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014. 4. Makineria e lëvizshme me paisje speciale për testimin e materialeve të ndërtimit, pika 3.3 “Kapaciteti teknik” i DST nuk është e nevojshme për natyrën e kontratës, në kundërshtim me nenin 28, pika 2, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014.
Kriteri:	Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 Specifikimet teknike, pika 4. VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 28 Kontratat e shërbimeve, pika 2.
Ndikimi:	Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.
Shkaku	Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
Rëndësia:	E lartë
1.Rekomandimi:	Njësia e Prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të marrë masa për përcaktimin e procedurës së prokurimit duke u mbështetur në natyrën e kontratës, si dhe për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit duke argumentuar dhe dokumentuar në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për të mos favorizuar operatorë ekonomik të caktuar.
2.Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa që në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të administrohet

	dokumentacioni i nevojshëm identifikues grafik (si plane, harta, etj.) në mënyrë që të mundësohet evidentimi i vendndodhjes së realizimit të punimeve, që ndër të tjera do të shërbejë si gjurmë auditimi.
Afati:	Menjherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi njësia e prokurimit znj.R. L., znj.A. K., znj.A. K. në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe komisioni për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike z.E. Xh.j, z.I. M.dhe znj.E. Ç. në cilësinë e anëtarëve të komisioneve për përgatitjen e specifikimeve dhe kriterëve teknike. Për mungesën e dokumentacionit justifikues ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit znj,A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas shkresës nr. 827/5 prot. datë 11.02.2021 me lëndë “Urdhër për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave” ngrihet komisioni i përbërë nga: z.M. M., z.J. P., z.R.M.

Komisioni më datë 08.03.2021, ka mbajtur procesverbalin e hapjes së ofertave ku është paraqitur 1 operator ekonomik:

Operatori ekonomik “G.-A” sh.p.k. me vlerë oferte 16,283,489 lekë pa tvsh.

Më datë 10.03.2021, komisioni ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit ku jepet informacion mbi shqyrtimin e ofertës dhe plotësimin e kriterëve nga operatorët pjesëmarrës. Ku përcaktohet se:

OE “G.A” sh.p.k. plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, KVO e ka kualifikuar OE “G.-A” sh.p.k. me vlerë oferte 16,283,489 lekë pa tvsh, si oferta më ekonomike dhe plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Nga auditimi i realizimit të procedurës në sistemin elektronik të APP sipas vlerësimit të KVO, rezultoi se:

- KVO ka kualifikuar OE, pa patur asnjë dokument që të vërtetoj pozicionin për punonjësi teknik ndërtimi, pasi nuk është i regjistruar si i tillë në list pagesë dhe nuk ka asnjë dëshmi që të vërtetoj, gjithashtu punonjësi A. K. nuk e ka të rregullt IQT. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 3.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 5 ku citohet: “...Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 3 (tre) punonjës Bojaxhi, 3 (tre) punonjës Saldatore, 1 (një) punonjës elektrikist, 1 (një) punonjës mekanik, 1 (një) punonjës teknik ndërtimi. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Gusht 2020 - Janar 2021...”.

- KVO ka kualifikuar OE, i cili ka dorëzuar Certifikatat ISO 39001-2012 dhe UNI EN ISO 3834-2-2006 të cila janë të lëshuara nga një subjekt i pa akredituar për këtë certifikim. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 3.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 6 ku citohet: “...Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: ...Certifikate ISO 39001 -2012 (e vlefshme), Certifikate UNI EN ISO 3834-2-2006 (e vlefshme) ...”.

- KVO ka kualifikuar OE, i cili për njërin nga mjetet që ka dorëzuar mungon certifikata e kontrollit teknik. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 3.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 10 ku citohet: “...Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e

kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikate për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme) ...”.

Titulli i gjetjes:	Parregullsi në vlerësimin e ofertave
Situata:	<p>Nga auditimi i realizimit të procedurës “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)” në sistemin elektronik të APP sipas vlerësimit të KVO, rezultoi se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. KVO ka kualifikuar OE, pa patur asnjë dokument që të vërtetoj pozicionin për punonjësi teknik ndërtimi, pasi nuk është i regjistruar si i tillë në list pagesë dhe nuk ka asnjë dëshmi që të vërtetoj, gjithashtu punonjësi A. K. nuk e ka të rregullt IQT. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 3.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 5. 2. KVO ka kualifikuar OE, i cili ka dorëzuar Çertifikatat ISO 39001-2012 dhe UNI EN ISO 3834-2-2006 të cila janë të lëshuara nga një subjekt i pa akredituar për këtë certifikim. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 3.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 6. 3. KVO ka kualifikuar OE, i cili për njërin nga mjetet që ka dorëzuar mungon 169enojnë169ata e kontrollit teknik. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 3.3 të DST Kapaciteti teknik, pika 10.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
Ndikimi:	Është kryer vlerësimi në kundërshtim me kërkesat ligjore të prokurimit.
Shkaku	Mosvlerësim i saktë i ofertave ekonomike.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, me anë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, për shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratave.
Afati:	<i>Menjeherë</i>

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i vlerësimit të ofertave z.M. M., z.J. P., z.R. M. me cilësinë e anëtarëve të KVO.

Raporti përmbledhës i mbajtur me nr. 827/7 prot. datë 18.03.2021, ku jepet informacion mbi procedurën, vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës dhe klasifikimin nga KVO, në vend të parë sipas kriterit çmimi më i ulët dhe i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e caktuara në DST KVO ka klasifikuar OE “G.-A” sh.p.k.. Ky raport është miratuar me anë të shkresës nr. 827/8 prot. datë 18.03.2021 nga Titullari i AK znj. A. B. dhe Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit z. A.Q. dhe kanë shpallur fitues OE “G.-A” sh.p.k. me vlerë oferte 16,283,489 lekë pa tvsh.

-Lidhja e kontratës

Është lidhur kontrata me nr.827/10, datë 14.04.2021 midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, përfaqësuar nga titullari znj. A. B. dhe operatorit ekonomik “G.-A” shpk, me NIPT L....L, përfaqësuar nga z.S.K., me afat 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me çmim kontrate 16,283,489 lekë pa tvsh/19,540,187 lekë me tvsh. (Sigurimi i kontratës me vlerë 1,998,000 lekë me afat deri në zbatimin e kontratës).

-Zbatimi i kontratës

Me shkresën nr.827/11 prot. datë 14.04.2021, urdhërohet “Për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të kontratës me objekt “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”, komisioni me përbërje: znj. N. Gj., z. A. D., z. M. Gj., i cili duhet të marrë në dorëzim mallin dhe të përgatis procesverbalin e marrjes në dorëzim.

Më datë 15.06.2021, në prani të komisionit për ndjekjen e zbatimin e kontratës dhe të operatorit ekonomik është mbajtur situacioni nr.1, ku jepet tabela me sasi të dhe me vlerë 11,437,492 lekë pa tvsh, komisioni ka realizuar vlerësimin e elementëve dekorative të riparuar dhe i konsideron ato që janë realizuar sipas specifikimeve teknike. Me anë të këtij dokumenti komisioni ka marrë në dorëzim mallin për sasi të sipas këtij situacioni, bazuar dhe në situacionet ditore në çdo njësi administrative.

Më datë 01.07.2021, në prani të komisionit për ndjekjen e zbatimin e kontratës dhe të operatorit ekonomik është mbajtur situacioni nr.2, jepet tabela me sasi të dhe me vlerë 4,845,997 lekë pa tvsh, komisioni ka realizuar vlerësimin e elementëve dekorative të riparuar dhe i konsideron ato që janë realizuar sipas specifikimeve teknike. Me anë të këtij dokumenti komisioni ka marrë në dorëzim mallin për sasi të sipas këtij situacioni, bazuar dhe në situacionet ditore në çdo njësi administrative.

Më datë 01.07.2021, në prani të komisionit për ndjekjen e zbatimin e kontratës dhe të operatorit ekonomik është mbajtur situacioni përfundimtar, jepet tabela me sasi të dhe me vlerë 16,283,489 lekë pa tvsh, komisioni ka realizuar vlerësimin e elementëve dekorative të riparuar dhe i konsideron ato që janë realizuar sipas specifikimeve teknike. Me anë të këtij dokumenti komisioni ka marrë në dorëzim mallin për sasi të sipas këtij situacioni, bazuar dhe në situacionet ditore në çdo njësi administrative.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezulton mungesat e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, si libri i masave, ditarët e punimeve, provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve etj. veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” kreu III, Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit ku citohet:

“...1. Gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, i cili përmban: a) Dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit....

...2.Puna e kryer dhe çastet më të rëndësishme gjatë ndërtimit të objektit pasqyrohen në librin e kantierit, që mbahet në formën e ditarit të objektit e të raportit të punimeve.

2.1 Ditari i objektit pasqyron ngjarjet më të rëndësishme gjatë ecurisë së punimeve, deri në fund të periudhës së garancisë së tyre.

...4.Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre.

.... 9.Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen: dh) Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre...” etj.

- Mungon dokumentacioni justifikues për mbjelljen e pemëve (Si raporte/relacione mbi vendndodhjen, sasi të që janë mbjellur në secilën zonë, si dhe foto gjatë procesit të punës dhe përdorimit të mjetet), veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 77 Mbikëqyrja e kontratës, pika

3 dhe 4, ku citohet: "...3. Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi. 4. Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti..."

Titulli i gjetjes:	Mungesat e dokumentave kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës "Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)", është konstatuar mungesa e dokumentave kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, si libri i masave dhe vizatimeve, ditaret e punimeve, provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve, veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit". Për procedurat:
Kriteri:	Kreu III "Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit", pika 2, 4, 9, Udhëzimi Nr.2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"
Ndikimi:	Mungesa e verifikimit të saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve dhe cilësisë të materialeve e të produkteve.
Shkaku	Mungesa e mbikëqyrjes së punimeve nga ekspert të fushës dhe realizimi i punimeve të ndërtimit si shërbim dhe jo procedura pune.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për ngritjen e një njësie për monitorimin e zbatimit të kontratave, e cila do të jetë përgjegjëse edhe për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik për secilën kontratë, me qëllim verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve, si dhe cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura dhe dokumentacioni i nevojshëm grafik..
Afati:	Menjherë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtorisë e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, znj. A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ.

Operatori ka sjellë faturën tatimore, me nr 107/2021 datë 15.06.2021, me vlerë 13,724,991 lekë me tvsh / 11,437,492 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 136, datë 16.06.2021 (likuiduar 1,727,375 lekë), likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 142, datë 08.07.2021 (likuiduar 355,734 lekë), likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 143, datë 08.07.2021 (likuiduar 11,641,882 lekë).

Operatori ka sjellë faturën tatimore, me nr 108/2021 datë 01.07.2021, me vlerë 5,815,196 lekë me tvsh / 4,845,997 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 144, datë 08.07.2021 (likuiduar 5,815,196 lekë).

Nga auditimi i situacionit përfundimtar dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit rezultojnë si mëposhtë:

- Zëri FV Vida druri për fiksimin e ristelave të drurit me krahët ishin të zëvendësuar me vida inoksi për fiksimin e ristelave të drurit me krahët, për arsye të dëmtimit nga kushtet atmosferike.
- Kosha dekorativ rrugore: Lulishte Kongresi i Lushnjes, koshat mungojnë.
- Kosha dekorativ rrugore: Shkolla Drita Pelinku, koshat mungojnë.
- Kosha dekorativ diferencimi: Myslym Shyri (Lulishtet mes pallateve), koshat mungojnë.
- Kosha dekorativ diferencimi: Lulishtet Metrix, koshat mungojnë.
- Kosha dekorativ diferencimi: Çerdhja 47, koshat mungojnë.
- Kosha dekorativ diferencimi: Çerdhja 17, koshat mungojnë.
- Kosha dekorativ diferencimi: Çerdhja 24, koshat mungojnë.
- Kosha dekorativ diferencimi: Shkolla Gustav Majer, koshat mungojnë.

Titulli i gjetjes:	Mungesa në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”
Situata:	Nga auditimi i situacioni përfundimtar (relacion) dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit rezultuan mungesat si mëposhtë: Zëri FV Vida druri për fiksimin e ristelave të drurit me krahët ishin të zëvendësuar me vida inoksi për fiksimin e ristelave të drurit me krahët, për arsye të dëmtimit nga kushtet atmosferike. Kosha dekorativ rrugore: Lulishte Kongresi i Lushnjes, koshat mungojnë. Kosha dekorativ rrugore: Shkolla Drita Pelinku, koshat mungojnë. Kosha dekorativ diferencimi: Myslym Shyri (Lulishtet mes pallateve), koshat mungojnë. Kosha dekorativ diferencimi: Lulishtet Metrix, koshat mungojnë. Kosha dekorativ diferencimi: Çerdhja 47, koshat mungojnë. Kosha dekorativ diferencimi: Çerdhja 17, koshat mungojnë. Kosha dekorativ diferencimi: Çerdhja 24, koshat mungojnë. Kosha dekorativ diferencimi: Shkolla Gustav Majer, koshat mungojnë. Argumentimi i këtyre diferencave pasqyrohen të përshkruara në Akt Konstatimin nr.15 dhe në Projekt Raportit të Auditimit.
Kriteri:	Kreu II, pika 8.1 dhe kreu III, pika 4, i Udhëzimit Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”
Ndikimi:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, nuk mund të evidentohen sasia dhe vlera për këto zëra si pasojë dhe e mungesës së librezave të masave e evidentuar, e përfituar nga sipërmarrësi, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit në fondet e Buxhetit të Shtetit dhe njësisive vendore.
Shkaku	Mungesë e librit të masave si dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve dhe mungesa e dokumentacionit justifikues si plane dhe vizatime mbi vendndodhjen e realizimit të punimeve.

Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e sasisë që mungojnë në të gjithë kontratën dhe evidentimin e shkaqeve që ka sjellë përdorim pa efektivitet të fondeve, dhe përcaktimin e vlerës së evidentuar pa efektivitet.
Afati:	<i>Menjherë</i>

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi hartuesit e preventivit, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, znj.A. B. në cilësinë e përfaqësuesit të DPPGJ dhe komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës znj.N. Gj., z.A. D., z.M. Gj. në cilësinë e anëtarëve të komisionit.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, ka paraqitur observacionin nr. 185/53 prot., datë 14.04.2023, protokolluar KLSH nr. 1008/7 prot., datë 18.04.2023, ku pretendojnë, si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Mbi hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike:

1. Referuar LPP e parashikon në rast nevojë plotësohet me dokumentacionit justifikues si plane, vizatime, modele, makete etj., nuk është plotësuar me këtë dokumentacion. Specifikimeve teknike janë pjesë e zërave të preventivit, (fq. 62 observacionit).

Mbi zhvillim e procedurës:

2. KVO e ka konsideruar devijime të vogla mangësitë e konstatuara nga grupi i auditimit, (fq. 68 observacionit).

Mbi zbatimin e kontratës:

3. DPPGJ observon se koshat janë në terren, (fq. 194-206 observacionit).

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Mbi hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike:

Mbi observimet lidhur me planifikimin dhe zhvillimin e procedurës:

1. Preventivi i punimeve nuk jep informacion mbi specifikim teknik për secilin element, dokumentacion justifikues si plane, vizatime etj. është e nevojshme për evidentimin e vendndodhjes ku do të realizohet shërbimi nga ana e OE fitues dhe çdo subjekt tjetër që do të kryej verifikimin e realizimit të shërbimit në vazhdimësi. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Mbi zhvillimin e procedurës:

2. Në lidhje me gjykimin si devijim të vogël, KVO duhet ta kishte argumentuar konstatimin e devijimit të vogël, në përputhje me nenin 53 të LPP 9643 datë 20.11.2006 pika 4. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Mbi observimet lidhur me zbatimin e kontratës.

3. Nga verifikimi në terren i grupit të auditimit në prezencë të specialistëve të DPPGJ, u evidentuan mungesat e sasive të konstatuara në akt konstatimin dhe Projekt Raport. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit” (këtu e më poshtë DPPGJ) është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën nga data 01.01.2018 deri më 31.12.2021.

KLSH ka dërguar në DPN1 e Qytetit Tiranë rekomandimet e auditimit me shkesën nr. 878/8 prot., datë 20.12.2017, protokolluar në DPN1 të Qytetit Tiranë (ndryshuar emri i institucionit në DPPGJ) me shkresën nr. 2129/6 prot, datë 23.12.2017, ndërsa nga DPN1 e Qytetit Tiranë për zbatimin e rekomandimeve është kthyer përgjigje me shkresën nr. 878/9, datë 23.01.2018, në të cilën janë 21 masa organizative, 2 masa për shpërblim dëmi, 1 masë për eliminimin e efekteve negative në buxhetin e shtetit, dhe 9 masa disiplinore, të cilat janë pranuar nga DPN1 e qytetit Tiranë.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 2623/3 prot., datë 24.12.2018 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin tematik mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 e punëtorëve të qytetit Tiranë”, për veprimtarinë e DPN1 e qytetit Tiranë nga data 15.07.2015 deri më 30.06.2017, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

-Nga rikërkimi i zbatimit të 3 rekomandimeve masa organizative të mbetura në proces është konstatuar se është 1 (një) rekomandim në proces zbatimi.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 15-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: DPPGJ të analizojë me përgjegjësi moszbatimin e rekomandimeve, duke marrë masat e menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 1188/6, datë 07.08.2019.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” u konstatua debitimi i shumës prej 4,724,015 lekë, e cila ka të bëjë me debitorë të trashëguar në vite.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në Pasqyrat Financiare të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantetkorrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit), nga ku debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe kreditohet llogaria 7206 ”Financim i pritshëm nga buxheti”.

Shuma prej 4,724,015 lekë e debituar në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është veprim në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018“Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” duke kërkuar financim të pritshëm nga shteti me tepër për këtë shumë, vlerë e cila është e pidentifikuar dhe s’ka të bëjë me shpenzime të konstatuar të vitit ushtrimor.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 33-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit së DPPGJ-së të marrë masa për sistemimin e shumës 4,724,015 lekë, duke bërë veprimin kontabël kreditimin e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe debitimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Menjëherë e në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi:Nga auditimi konstatohet se nga të dhënat e paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar të Institucionit më 31.12.2021, gjendja debitorë (klasa 4) paraqitet si vijon:
2.1.Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 20,496,402 lekë, të cilat vijnë kryesisht nga debitorë të krijuar për një periudhë shumë të gjatë rreth 15 vjet. Për këto debitorë, institucioni i DPPGJ-së nuk ka mundësi arkëtimi. E njëjta shumë debitorësh është konstatuar dhe në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH.

2.2.Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivet, por pa ndikim material në rezultatin e pasqyrave financiare. Në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” janë keqklasifikuar “Pajisjet dhe instalimi i kondicionerëve” në shumën 621,600 lekë. Kjo vlerë i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”.

Llogaria 213 “Rruga, rrjete, vepra ujore” paraqitet në pasqyrat financiare me kosto historike. Vlera e amortizimit të akumuluar nuk është përlllogaritur ndër vite, gjë e cila është trashëguar dhe në pasqyrat financiare të vitit 2021.

2.3.Nga lëvizjet e aktiveve nga sistemimet, institucioni bën lëvizjen e aseteve nga llogaria përkatëse 21 “Aktive afatgjata” në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” në shumën 55,964,019 lekë përfaqëson të gjitha aktivet e dëmtuara që DPPGJ ka identifikuar të dëmtuara nga komisionet e inventarizimit. Shuma prej 55,964,019 lekë është keqklasifikuar në llogarinë 24, pasi secili nga aktivet e dëmtuara duhet të klasifikohet në llogarinë përkatëse të aktiveve, deri në momentin e vlerësimit nga komisioni i vlerësimit të aktiveve. Aktivet kalojnë në llogarinë 24 pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një flete hyrje rikupero.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36, VKM-në nr. 25 datë 20.01.2011 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik”, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 3-6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi:Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve të marrin masa për pjesën e llogarive debitorë që kalojnë kohën e parashkrimit me qëllim sistemimin e këtyre shumave të cilat qëndrojnë në llogaritë e DPPGJ-së për periudha mbi 15 vjeçare.

Menjëherë e në vijimësi

3.2. Rekomandimi: - Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.

Menjëherë e në vijimësi

3.3.Rekomandimi:Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për sistemimin e llogarisë 24 “Aktive Afatgjata të dëmtuara”, duke mbajtur në këtë llogari në vlerën neto, vetëm ato aktive të cilat janë vlerësuar për jashtë përdorimi.

Menjëherë e në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se, shuma totale e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë:

-vendime të formës së prerë marrë në vitin 2014 në shumën 913,566 lekë, në vitin 2016 në shumën 268,229 lekë dhe në vitin 2018 në shumën 3,702,911, të cilat janë likuiduar në vitin 2018;

- vendime të formës së prerë marrë në vitin 2017 në shumën 405,769 lekë, dhe në vitin 2018 në shumën 7,639,947 lekë, të cilat janë likuiduar në vitin 2019;

- vendime të formës së prerë marrë në vitin 2017 në shumën 405,769 lekë, në vitin 2018 në shumën 1,537,134 lekë, dhe në vitin 2019 në shumën 4,526,208 lekë të cilat janë likuiduar në vitin 2020;

- vendime të formës së prerë marrë në vitin 2018 në shumën 677,142 lekë, në vitin 2019 në shumën 637,609 lekë, dhe në vitin 2020 në shumën 1,591,305 lekë të cilat janë likuiduar në vitin 2021,nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer.

Si pasojë llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të vitit 2018, 2019,2020 dhe 2021. Konkretisht për vitit 2018-2021, ky zë për vendimet gjyqësore reflektohet me vlerë 0 (zero), ndërkohë që duhet të ishte reflektuar me vlerën e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë mbi 30 ditë, përpara mbylljes së pasqyrave financiare për secilin nga vitet.

Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

Duke ju referuar pagesave të kryera nga DPPGJ për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 35-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandimi:Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë e në vijimësi

4.2.Rekomandimi:Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve, të marrë masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Menjëherë e në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të DPPGJ-së, u konstatua se institucionika një regjistër elektronik për aktivet afatgjata, i cili nuk është përditësuar me vlerën

aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi. Mungesa e një regjistri të plotë aktivesh sjell problematika në kryerjen e një procesi të saktë inventarizimi dhe vlerësimi aktivesh, për shkak të mungesës së informacionit mbi amortizimin e akumuluar, vlerën e tyre dhe kostot nëse mbahen apo nxirren jashtë përdorimi. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu Regjistri i aktiveve të njësitë të sektorit publik, Pika 26, 28 dhe 30.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 4-5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të merren masa për krijimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpashme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Menjëherë e në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së inventarizimit u konstatua se titullari i institucionit të DPPGJ-së nuk ka ngritur asnjë komision për vlerësimin e aktiveve, edhe pse nga komisioni i inventarizimit janë evidentuar aktive të dëmtuara për llogarinë ekonomike 214 “Stola, Kosha, Gjeneratorë etj”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 96.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 42-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Titullari i institucionit të DPPGJ-së të marrë masa në vazhdimësi, që menjëherë pas marrjes së relacionit nga komisioni i inventarizimit, për ngritjen e komisionit të vlerësimin e aktiveve, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

Menjëherë e në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të Aktiveve Afatgjata Materiale u konstatua se: Sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitet 2018-2020 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vlerën zero lekë. Nga Institucioni nuk disponohet dokumentacion dhe planimetri (genplan) për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve, që ka në dispozicion për periudhën objekt auditimit, me pretendimin se i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i aseteve të institucionit të DPPGJ menaxhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Aseteve dhe Licencimit pranë Bashkisë Tiranë. Për secilin truall duhet të ishin kryer përlllogaritjet dhe evidentimet e vlerës së truallit në kontabilitetin e njësisë shpenzuese, nga zero lekë e pasqyruar në bilancin e periudhës, duke u referuar në çmimin për m² sipas zonave kadastrale, sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”. Sipërfaqja totale e tokës që DPPGJ ka në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet, në kundërshtim me Udhëzimin MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.3, paragrafi 62, dhe paragrafi 91.

Për periudhën 2018-2021, komisionete inventarizimit kanë evidentuar ndërtesa të cilat nuk ekzistojnë, por që vazhdojnë të jenë të regjistruara në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstrukione”. Në vitin 2019, për secilin objekt, komisioni i inventarizimit ka paraqitur, me anë të shkresës nr. 2985/1 Prot., datë 24.01.2020, procesverbalet e mbajtura për verifikimin në

terren, kunë procesverbalin e mbajtur në terren, datë 13.01.2020, Komisioni i inventarizimit konstaton se 3 objektet: (1) “Barakat” (me vlerë kontabël 5,409 lekë, viti 1981), (2) “Zyrat e kuartallave nr. 4” (me vlerë kontabël 45,000 lekë, midis Rrugës së Durrësit dhe Rrugës së Kavajës) dhe (3) “Ofiçina tek VasilShanto” (me vlerë kontabël 25,811 lekë, viti 1980), nuk ekzistojnë pasi janë bërë pallate.

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit shprehet se nuk ka në dispozicion asnjë dokumentacion në lidhje me mungesën e aktiveve. Për vitin 2021, komisioni i inventarizimit konstaton një diferencë prej 5,584,596 lekë mes gjendjes fizike dhe të dhënave të regjistruara në kontabilitet, pasqyruar kjo në inventarin përmbledhës për inventarizimin e asetëve të DPPGJ-së për vitin 2021 me nr. 2948/2 Prot., datë 22.01.2022, ku shprehet se 15 prej objekteve pjesë e inventarit nuk ekzistojnë fizikisht. Përpos konstatimeve të komisionit të inventarizimit, nga ana e DPPGJ-së nuk është marrë asnjë masë për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ndërtesave, me qëllim identifikimin dhe rivlerësimin ndërtesave që DPPGJ ka nën administrim.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 95, 101, 118.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 47-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: DPPGJ në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të marrin masa për të ngritur një grup pune me ekspertë të fushës me qëllim identifikimin e planimetricave dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit.

Menjëherë e në vijimësi

7.2. Rekomandimi: DPPGJ në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të marrin masa për të ngritur një grup pune me qëllim identifikimin dhe rivlerësimin e stokut të ndërtesave gjendje nën administrimin e DPPGJ-së. Pas vlerësimit të dalë nga komisionet, të merren masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për regjistrimin e aktiveve të pa pasqyruara në kontabilitet, si dhe pasqyrimin e tyre në vlera reale referuar tregut.

Menjëherë e në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.”, të vitit 2020, rezulton se:

Në përlllogaritjen e fondit limit në total është llogaritur për 15 trajtime (dezinfektim), ndërkohë që në DST është specifikuar që shërbimi do të kryhet çdo 24 orë për një afat 1 muor nga data e lidhjes së kontratës me intervale të rregullta ditore sipas shtojcës 10 “Shërbimet dhe Grafikut të Ekzekutimit”, pra në hartimin e DST nuk është caktuar saktë grafiku i trajtimit (dezinfektimit). Këto veprime në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit, Shtojca 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit”.

(Më hollësisht trajtuar në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit në çdo rast në përlllogaritjen e fondit limit, duhet të analizojë, argumentojë dhe përcaktojë saktësisht vlerën sipas kritereve të vendosura në DST.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.”, të vitit 2020, rezulton se, janë hartuar 2 situacione të nënshkruara nga mbikëqyrësit e kontratës dhe OE të cilat janë pjesë e dokumentacionit ku dhe është përcaktuar njësia, sasia, çmimi dhe numri i trajtimeve, por rezulton që këto situacione nuk kanë datë, dhe në asnjë rast nuk është vërtetuar që shërbimi është kryer sipas kontratës nr. 1160/10, datë 26.03.2020 për “Dezinfektimi i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.”,

neni 7, ku kërkohet që ky shërbim të jetë kryer çdo 24 orë, me pompë dhe nga punonjës të pajisur me të gjithë mjetet e sigurisë në punë (kostume një-përdorimshe, dorashka, maska, syze transparente), veprime në kundërshtim me Kontratën nr. 1160/10, datë 26.03.2020 për “Dezinfektimi i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, neni 7. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 99-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1 Rekomandimi: DPPGj, Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për plotësimin e saktë të dokumentacionit justifikues për kryerjen e pagesës sipas kushteve të kontratës nga ana e kontraktorit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre”, të vitit 2020, nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, konkretisht veprimet bankare, u konstatua se, fatura origjinale e OE mbart datën 30.06.2020 dhe është paguar me dy Urdhër Shpenzime në datë 21.10.2020 dhe 11.12.2020, pra ka kaluar afati i pagesës së faturës. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, ku citohet, germa “c”, Udhëzimin nr. 37, datë 06.10.2020, “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme”, ku citohet se “*stok i detyrimeve të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të transaksioneve të shpenzimeve të njëjësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë të papaguara prej mbi 60 ditë kalendarike që nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik, dhe Kontratën nr. 1057/11, datë 30.03.2020, nenin 6 “Kushtet e pagesës”, pika 2 ku citohet “Pagesa si rregull do të bëhet, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që është dorëzuar gjithë dokumentacioni i nevojshëm që vërteton përmbushjen e kushteve të kontratës nga kontraktuesi”.* *(Më hollësisht trajtuar në faqet 106-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1 Rekomandimi: DPPGJ, Bashkia Tiranë të marrë masa që hartimi i programeve buxhetore afatmesëm të jenë sa më të drejtë e në përputhje me kërkesat e institucionit duke shmangur kështu shpenzime pa efektivitet të penaliteteve që mund të akumulohen nga vonesat në likuidimin e detyrimeve kontraktuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 7 (shtatë) procedurave të prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit rezultoi se, gjatë hartimit të Dokumenteve të Tenderit u konstatuan parregullsi në argumentimin e kriterëve për kualifikim, të cilat kanë kufizuar konkurrencën, duke mos nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik në kundërshtim me VKM nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në procedurën: “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”
- Në procedurën: “Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës (kosha, stola dekorativ)”
- Në procedurën “Drurë, shkurre dekorative”
- Në procedurën: “Rikualifikim i mikrohapësirave të gjelbërta”
- Në procedurën: “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvanë në blloqe banimi
- Në procedurën: “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”
- Në procedurën: “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”

(Më hollësisht trajtuar në faqet 114-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1.Rekomandimi: Njësia e Prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të marrë masa për përcaktimin e procedurës së prokurimit duke u mbështetur në natyrën e kontratës, si dhe për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit duke argumentuar dhe dokumentuar në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për të mos favorizuar operatorë ekonomik të caktuar.

11.2.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa që në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të administrohet dokumentacioni i nevojshëm identifikues grafik (si plane, harta, etj.) në mënyrë që të mundësohet evidentimi i vendndodhjes së realizimit të punimeve, që ndër të tjera do të shërbejë si gjurmë auditimi.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në SPE i 7 (shtatë) procedurave të prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit në 5 procedura u konstatuan pasaktësi në kualifikim e OE të cilat nuk plotësonin të gjitha kriteret për kualifikim në kundërshtim me VKM nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në procedurën “Drurë, shkurre dekorative”,
- Në procedurën “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”,
- Në procedurën “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvanë në blloqe banimi”,
- Në procedurën “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”,
- Në procedurën “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”,

(Më hollësisht trajtuar në faqet 134-182 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, me anë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, për shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratave.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të 7 (shtatë) kontratave u konstatua se për 5 kontrata mungon dokumentacioni kryesorë teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, si libri i masave dhe vizatimeve, ditarët e punimeve, provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve etj. dokumentacioni teknik sipas Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, dhe për 2 kontratat e tjera mungojnë certifikatat e cilësisë së materialeve. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 127-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për ngritjen e një njësie për monitorimin e zbatimit të kontratave, e cila do të jetë përgjegjëse edhe për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik për secilën kontratë, me qëllim verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve, si dhe cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura dhe dokumentacioni i nevojshëm grafik.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës për procedurën: “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvanë në blloqe banimi” rezulton mungesa e lejes për hapjen e puseve. Ku sipas akteve ligjore në fuqi duhet që personi, fizik ose juridik, privat ose shtetëror, që kryen shpime për ujërat nëntokësore, me thellësi mbi 15 m nga sipërfaqja e tokës, përpara se të paraqesë projektin hidrogjeologjik në këshillin e baseneve, është i detyruar të marrë miratimin për projektin nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, që e shqyrton sipas akteve ligjore përkatëse. Pas miratimit të lejes, një kopje e projektit dhe një kopje e relacionit për rezultatet e punimeve të kryera depozitohen në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 159-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1.Rekomandimi: Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për pajisjen me leje për hapje pusi për puset e hapura dhe ato që do të hapen në vazhdimësi sipas përcaktimeve ligjore për menaxhimin e burimeve ujore.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit mbi pagesën e faturave rezultoi se në 3 kontrata, përkatësisht kontratën me nr.1326/14, datë 30.05.2018, kontratën me nr.539/10, datë 10.04.2018 dhe kontratën me nr.99/3, datë 18.01.2021, janë kryer pagesat me urdhër shpenzime pas afatit 30 ditë si specifikohet në KPK neni Afatet e Pagesës, ku citohet “...Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer shërbimet ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë...”. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 127-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1.Rekomandimi: Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për likuidimin e detyrimeve financiare, sipas afateve të përcaktuar në kontrata.

Në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Grupi për përlllogaritjen e Fondit Limit, ka marrë oferta nga subjektet e A. A., G. A dhe I. G. technologies për mallrat e kërkuar pa patur specifikime teknike për këto mallra.

Si pasoj subjektet e sipërcituara kanë dhënë oferta fiktive pasi ofertat e tyre nuk bazohen në karakteristika dhe specifikime teknike për mallrat e kërkuara nga AK DPPGJ, Bashkia Tiranë. Grupi i auditimit të KLSH, bëri verifikim e statusit të subjekteve te sipërcituar, ne Qendrën Kombëtare të Biznesit, nga rezultoi se, subjekti “A. A.”, me NIPT L....U nuk ekziston i regjistruar me këtë NIPT.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 58-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1.Rekomandimi: Drejtori i Pergjithshem i DPPGJ në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohet në procedurat e prokurimit publik.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje Mjete Transporti” rezulton se, grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike ka përcaktuar specifikime vetëm për Autobot 10,000 litra me dy akse dhe Ekskavatorin me rrota.

Specifikimeve e hartuara nga grupi i punës nuk pasqyrojnë kërkesat e paraqitura në shkresën nr. 433 Prot., datë 13.02.2018 të Drejtorit të Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve të miratuara nga Titullari i AK, pasi në relacionin e datës 13.02.2018 të grupit për hartimin e specifikimeve teknike, nuk janë hartuar specifikimet teknike për Autobotin me kapacitet 12,000 litra.

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës nuk kanë përputhje me specifikimet teknike të pasqyruara në shtrojsën nr.10 të DST, kryesisht për Ekskavatorin me dy rrota.

Në DST pasqyrohen specifikime teknike për Auto botin 12,000 litra me dy akse ndërkohë që grupi për përcaktimin e specifikimeve teknike në relacion e vete nuk i ka pasqyruar.

Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike ka shkelur rregullat e LPP pasi në specifikimit teknike të ekskavatorit ka kërkuar që ky mjete të ketë për numër të shasisë YD4JZG55KË. (nr. shasisë është unik).

- NJHDT për blerjen e ekskavatori ka vendosur si kriter në DST, që ai të ketë numrin e shasisë YD4JZG55KW. Anëtarët e njësisë së hartimit të dokumentave të tenderit kanë vepruar në mospërputhje me Ligji 9643 për prokurimet publike, i ndryshuar. Neni 23-Specifikimet teknike pika 5, ku parashikohet se:

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 59-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1.Rekomandimi: Titullari i AK t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të DST nga grupet e punës/njësia e prokurimit.

Në vijimësi

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje Mjete Transporti” rezulton se, komisioni i marrjes në dorëzim dhe koaludimit, në process verbalin e mbajtur për marrjen në dorëzim të ekskavatorit me rrota, në faqen 2 të PV, mjetin ekskavator me rrota e kanë identifikuar nëpërmjet nr të motorit YD4JZG55KË.

Nga auditimi rezulton se, ky model është i njëjtë me specifikimet e përcaktuara nga komisioni i hartimit të specifikimeve teknike, të cilat pas ankimimit të bërë nga 3 OE u hoqën nga DST.

Por komisioni i marrjes në dorëzim ka vazhduar që në process verbalin e hartuar gjatë procesit të marrjes në dorëzim të pasqyroj tipin e motorit të ekskavatorit me modelin fillestar që AK paraqiti fillimisht në specifikimet teknike dhe të pasqyruara në DST, para se ato të ndryshoheshin me shtojcën nr. 433/6 Prot. date 26.02.2018.

-Gjithashtu PV i komisionit të marrjes në dorëzim nuk është shoqëruar me foto të mjeteve të transportit të marra në dorëzim dhe në PV nuk ka referuar dokumentin e zhdoganimit të mjeteve dhe duke mos pasqyruar markën dhe tipin e mjeteve të të transportit të marra në dorëzim

(Më hollësisht trajtuar në faqet 60-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1.Rekomandimi: Drejtori i DPPGJ, të përcaktojë nëpërmjet akteve administrative rregulla të qarta për të mundësuar gjurmën e auditit gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve.

Në vijimësi

19.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi “Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Aparate”, rezulton se, Ofertat e paraqitura nga subjektet PC Store computers, b) Smart Store dhe c) IT Progress për

përlllogaritjen e Fondit limit për këtë procedurë, nuk kanë datë, dhe nuk janë shoqëruar me specifikimet teknike.

-Specifikimet teknike janë hartuar dy muaj pas marrjes së ofertave nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit.

-Në përbërjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike nuk ka specialist IT, kjo në mospërputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor të prokurimeve publike.

-Nga verifikimi i statusit, të subjekteve që kanë paraqitur ofertë për grupin e punës përlllogaritjen e fondit limit, rezultoi se:

Subjekti IT P. me NIPT M....S është regjistruar më datë 23/09/2020, ndërkohë që komisioni pretendon që ofertën e ka marrë në datën 17.01.2020 (data është e korrigjuar)

-Grupi i përlllogaritjes së FL i DPPGJ, mbi bazën e mesatarizimit të ofertave të pretenduara se ka marrë ka përlllogaritur si Fond Limit të njëjtën vlerë të paraqitur në shkresën nr. 112/1 Prot., Datë 17.01.2020 të drejtorisë së planifikimit dhe menaxhimit.

-Pra sipas grupit të ngritur për llogaritjen e Fondit nga ana e tyre është përlllogaritur e njëjta vlerë që ishte parashikuar nga AK në shkresën nr. 112/1 Prot., Datë 17.01.2020 të Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit

(Më hollësisht trajtuar në faqet 65-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të planifikoj programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohet në procedurat e prokurimit publik.

19.2.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ të rris strukturën me specialist të profilit IT, të nevojshëm si gjatë fazës së hartimit të specifikimeve teknike, të DST dhe gjatë fazës së vleresimit të ofertave dhe marrjes në dorëzim të produkteve/shërbimeve informatike.

Menjëherë

20.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra”, rezulton se, AK ka kërkuar që: *Në ditën e hapjes së ofertave Operatori Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesë para komisionit mostra për të gjithë artikujt objekt i procedure se prokurimit “Pjesë Këmbimi, Goma, Filtra dhe Bateri”.* Në pikën 7 të kriterit 2.3. në DST, AK ka kërkuar që: *Operatori ekonomik duhet të garantojë që mallrat të jenë prodhim sipas standardeve BE apo/ose standardeve DOT Amerikan. Për të vërtetuar këtë pike të paraqitet certifikata e origjinës së mallit objekt prokurimi, në momentin e dorëzimit të mostrave të mallit.*

Referuar udhëzimit nr.2., datë 02.05.2019., të APP mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik, KVO duhet të mbajë një proces verbal të paraqitjes së mostrave, pasi i shërben procesit të evidentimit dhe ruajtjes së mostrave, deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesi.

Mostrat e administruara duhej të ktheheshin ofertuesit me kërkesën e tij, 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës.

Nga auditimi rezulton se, nuk ka evidence dokumentare, për të dokumentuar ruajtjen dhe kthimin e mostrave tek kontraktuesi pas 30 ditësh nga AK.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra”, rezulton se, AK DPPGJ nuk ka hartuar grafikun e shërbimeve për mjetet e transportit planifikuar për shërbime.

Proces verbal i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të këtyre shërbimeve i administruar nga grupi i auditimit të KLSH gjatë fazës së terrenit nuk evidentonte shërbimet e kryera pranë kontraktuesit sipas një grafiku të planifikuar por vetëm faktin që shërbimet janë realizuar.

Në referim të rekomandimit të APP me nr. 2106 Prot. date 24.03.2021, gjatë marrjes në dorëzim për kontratat tip mallra/shërbime, rekomandohet që komisioni i marrjes në dorëzim, duhet të

kërkoj nga kontraktuesi respektimin e termave të përcaktuara në dispozitat e kontratës, mbi kushtet e dorëzimit të mallit, duke administruar raporte apo proces verbale, si dhe çdo dokument tjetër, që shkërbenë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësisë apo garancisë që mallrat duhen të kenë, në momentin e dorëzimit pranë AK. Gjate observacionit të kësaj gjetje, AK paraqiti një PV të rregullt sipas kërkesave që parashikon rekomandimi i APP, dhe si rezultat observacioni për këtë pikë u morr në konsideratë, por për të përmirësuar procesin e evidentimit të marrjes në dorëzim, Grupi i auditimit të KLSH la rekomandimin e përkatës për mos përsëritjen e parregullesive të evidentuara gjatë fazës së terrenit nga komisionet përkatëse të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve
(Më hollësisht trajtuar në faqet 74-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1.Rekomandimi: Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave. Drejtori i DPPGJ, të hartoj nëpërmjet akteve administrative rregulla të qarta për të mundësuar gjurmën e auditit gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, të cilat në të gjitha rastet duhet të jenë të protokolluara dhe të administrohen nga zyra e protokoll/arkivit të DPPGJ-së sipas rregullave dhe normave arkivore në fuqi, për të mos lënë mundësi që raporte apo proces verbale të mund të gjenenrohen pas afateve kohore të përcaktuara në kushtet e kontratës së shëbimit në këtë rast.

Në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Aparate” nga ana e grupit të auditimit në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate u realizua verifikim fizik i pajisje që ishin në inventarin e stafit të brendshëm të DPPGJ. Grupi i auditimit me përzgjedhje bëri verifikimin e modelit, dhe specifikimeve teknike të pajisjeve kompjuterave, Laptop dhe Printera, nga ku rezultoi se:

a. Për pajisjet Lap Top, kontraktuesi PC Store nuk ka dorëzuar tipin dhe modelin e ofertuar dhe të pranuar nga AK. Pasi OE PC STORE për pajisjen LapTop ka ofertuar modelin HP Probook 450 G6 ndërkohë që ka dorëzuar LAP topin model HP Probook 450 G4.

Komisioni i marrjes në dorëzim ngarkohet me përgjegjësi pasi ka pranuar materiale në kundërshtim me kërkesat e AK dhe ato të pranuar dhe të vlerësuar nga KVO duke pranuar një model të ndryshëm dhe me karakteristika jo të njëjta me ato të kontraktura.

b. OE PC Store ka furnizuar AK me Monitorin modelin HP V214a dhe jo modelin e ofertuar HP 22Ë, të pranuar dhe shpallur fitues nga KVO.

c. OE PC Store ka dorëzuar pranë DPPGJ, pajisjen Printer model Lexmark B2338 ndërkohë që ka ofertuar Printerin model Lexmark B2650DË

Nga auditimi rezultoi se:

1.OE “PC Store” ka dorëzuar pranë AK mallra të pa kërkuara duke mos ju përmbajtur deklaratës mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6, duke pranuar se:

Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

2.Komisioni i zbatimit të kontratës ka vepruar në mospërputhje me kushtet e kontratës duke konfirmuar fiktivisht realizimin e saj dhe si rezultat OE “PC Store” ka përfituar gjithë shumën e kontratës prej 1,917,600 lekë (me TVSH) duke e liruar kontraktuesin nga detyrimi i sigurimit të kontratës në shumën 10% të saj.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 69-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: DPPGJ të ndjek të gjitha procedurat administrative për kontraktuesin PC Store për të zëvendësuar pajisjet e konstatuara me devijime nga modeli i ofertuar me ato të dorëzuara, pasi OE PC Store ka shkelur hapur kushtet e kontratës nr.112/15 prot. Datë 14.04.2020 dhe në rast të moszëvendësimit të tyre, shuma **1,411,200 lekë** do të konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e DPPGJ.

Deri më datën 31.12.2023

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)” rezulton se:

Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit pranë DPPGJ, ka planifikuar një shërbim tërësor ose remont kapital për autobotin 10,000 litra. Ky planifikimi është bazuar në akt defektimin nr.8 të datës 12.01.2021 i mbajtur nga nje komision i posaçëm. Në këtë akt defektimi komisioni i sipërcituar ka kërkuar të kryen shërbime për zëvendësimin e bllokut të motorit cilindër testat, riparim injektorësh + pomp naftë, fv. pistocina freni, fv. tamburo frenimi, fv kambio komplet, fv pompe frenash, fv radiator uji, fv koke paraleli, fv koke zbarë.

Shërbimi është kërkuar nga komisioni i verifikimit të defekteve, se sipas tyre ky mjet është i amortizuar. Por nga auditimi i procedurës se blerjes se këtij mjeti rezulton se ky është blerë i ri dhe ka kryer vetëm **13,761 km**, duke mos justifikuar kërkesën për remont kapital.

-Akt Defektimi nr.8 të datës 12.01.2021, nuk është firmosur nga shoferi që e përdor autobotin 10,000 litra, i cili nuk ka paraqitur asnjë shqetësim në lidhje me difektet që ka konstatuar komisioni.Referuar ofertës ekonomike të kontraktuesit, shërbimet e kryera për mjetin ATV Shandong, i kanë kushtuar buxhetit të DPPGJ **2,761,000 lekë**, shumë e cila do të konsiderohet dëm ekonomik deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit të kërkuar dhe të shprehur në qëndrimin e grupit të auditimit të KLSH, në përgjigje të observacionit të paraqitur nga subjekti për Projekt Raportin e Auditimit të KLSH për këtë çështje, duke ngarkua me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të gjendjes së këtij mjeti nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 79-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: DPPGJ të kërkoj nga subjekti fizik/juridik i licensuar në fushën e ekspertizës për shërbimet mekanike për automjetet, i cili ka mbajtur Akt verifikimin nr.544/1 datë 07.04.2023 gjithë dokumentacionin që vërteton që është i licensuar për objektin e verifikimit.

Ky dokumentacion shtesë duhet të jetë plotësuar brenda afateve kohore të raportimit të zbatimit të rekomandimeve për KLSH, në rast të mos plotësimit të këtij kushti shuma prej **2,761,000 lekë**, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi në mënyrë poropocionale, përgjegjësien e sektorit të oficinës, anëtarët e komisionit të verifikimit të defekteve që kanë hartuar akt defektimin nr. 8 datë 12.01.2021 dhe përgjegjesin e sektorit Flota Transport pranë DPPGJ.

Deri më datën 31.12.2023

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1-6 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 6 (gjashtë) procedurave të prokurimit për vitin 2018-2021 me vlerë të fondit limit 32,034,873 lekë pa TVSh, ka rezultuar se në të 6 procedurat janë konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimet publike.

1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Uniforma dhe Veshje Speciale” viti 2018, me fond limit 3,450,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE “G. H.” shpk, me vlerë oferte 3,275,833 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet të fondeve publike për vlerën 3,275,833 lekë pa Tvsh;
2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” viti 2019, me fond limit 6,650,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE “R.C.” shpk, me vlerë oferte 6,610,100 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet të fondeve publike për vlerën 6,610,100 lekë pa Tvsh;
3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Uniforma dhe Veshje të tjera Speciale” viti 2019, me fond limit 4,950,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE “G.H.” shpk, me vlerë oferte 4,785,000 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 4,785,000 lekë pa Tvsh;
4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.” viti 2020, me fond limit 5,000,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE “P. S.” shpk, me vlerë oferte 4,995,000 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 4,995,000 lekë pa Tvsh;
5. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” viti 2020, me fond limit 6,666,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE “R. C.” shpk, me vlerë oferte 6,646,200 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 6,646,200 lekë pa Tvsh;
6. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” viti 2021, me fond limit 5,833,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE “R.C.” shpk, me vlerë oferte 5,722,740 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 5,722,740 lekë pa Tvsh. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 105-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1-1.6 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore” nga auditimi i dokumentacionit teknike të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se kanë sjellë një efekt negativ të buxhetit të shtetit me vlerë 1,189,575 lekë me tvsh.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 119-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, të marrë masat për ngritjen e një grupi pune i cili do të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet të fondeve me vlerë prej 1,189,575 lekë me tvsh, vlerë e cila nuk argumentohet apo justifikohet.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së auditimit “Drurë dhe shkurre dekorative” në lidhje me dokumentacionin teknike të zbatimit, situacionin përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 1,660,320 lekë me tvsh. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 139-175 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e sasisë së drurëve që mungojnë në të gjithë kontratën dhe evidentimin e shkaqeve që ka sjellë përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 1,660,320 lekë me tvsh.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Rikualifikim i mikrohapësirave të gjelbra” në lidhje me dokumentacionin teknike të zbatimit, situacionin përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacioneve si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 37,480 lekë me tvsh. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 147-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, të marrë masat për ngritjen e një grupi pune që të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet të fondeve me vlerë prej 37,480 lekë me tvsh, vlerë e cila nuk argumentohet apo justifikohet.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi” nga auditimi i dokumentacionit teknike të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 1,137,720 lekë me tvsh. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 161-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, të marrë masat për ngritjen e një grupi pune që të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet të fondeve me vlerë prej 1,137,720 lekë me tvsh, vlerë e cila nuk argumentohet apo justifikohet.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës “Blerje drurë dhe shkurre dekorative” referuar dokumentacionit teknike të zbatimit, situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, për zonat e audituara me përzgjedhje rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 2,061,360 lekë me tvsh. *(Më hollësisht trajtuar në faqe të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e sasisë së drurëve që mungojnë në të gjithë kontratën dhe evidentimin e shkaqeve që ka sjellë përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 2,061,360 lekë me tvsh.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)” nga auditimi i dokumentacionit teknike të zbatimit, situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit rezultuan mungesa të koshave dhe mos evidentimin e sasisë dhe vlerës së punimeve, veprime të cilat kanë sjellë që ka sjellë përdorim jo efektiv të fondeve. *(Më hollësisht trajtuar në faqe të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e sasisë që mungojnë në të gjithë kontratën dhe evidentimin e shkaqeve që ka sjellë përdorim pa efektivitet të fondeve, dhe përcaktimin e vlerës së evidentuar pa efektivitet.

Menjëherë

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra” rezulton se:

Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit ndër të tjera, ka kërkuar edhe blerjen e artikujve “Motorino” dhe “Dinamo”, siç pasqyrohet në aneksin 2.4.4 Tabela nr.1

Në referim të procedurës së prokurimit “Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje e mjeteve)”, rezulton se:

Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit në DPPGJ, **më datën 08.02.2021** kishte planifikuar FV dinamo dhe FV motorino.

3. Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit me datë **16.02.2021**, ka planifikuar përsëri FV dinamo dhe motorino për procedurën me objekt “Pjesë këmbimi, goma, bateri dhe filtra”.

Pra, Drejtoria e planifikimit dhe menaxhimit në DPPGJ, brenda harkut kohor të një jave ka planifikuar dhe miratuar FV për Dinamo dhe Motorino në dy procedura prokurimi të ndryshme të zhvilluar në të njëjtën periudhë.

4. Objekti i procedurës së prokurimit “Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra”, nuk parashikon blerjen e “dinamove” dhe “motorinove”, por vetëmblerje të gomave, baterive dhe filtrave.

5. OE G., i shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt “Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra”, për FV Dinamo dhe Motorinoka ofertuar shumën **270,000 lekë**, e cila do të konsiderohet shpenzim pa efektivitet nga Autoriteti Kontraktor DPPGJ, Bashkia Tiranë.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 71-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë të marrë masa që gjatë hartimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike të mos bëhet copëzim fondi. Mallrat apo grup mallrat duhet të grupohen sipas funksionit me qëllim mos shmangien e procedurave të prokurimit dhe përdorimin e fondeve me efektivitet në përputhje me aktet ligjore në fuqi në fushën e prokurimeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës “Blerje Mjete Transporti dhe Agregat”, në SPE, rezultoi se, OE G.-A i kualifikuar dhe shpallur fitues nga KVO nuk plotësonte kriterin

2.2 pika a (Kapaciteti ekonomik dhe financiar) dhe si rezultat OE G.-A i shpallur padrejtësisht fitues nga KVO duhej të s'kualifikohej.

*****Referuar PV të KVO të datës 12.06.2020**, rezulton se:

KVO ka s'kualifikuar OE L. B., pasi ky OE nuk plotësonte kriteret e mëposhtme:

1.OE L.B. nuk ka firmën e përkthyesit tek dokumentacioni i paraqitur, e gjithashtu nuk është e qartë çfarë dokumenti është përkthyer pasi nuk cilësohet në dokumentacionin e paraqitura.

Më tej gjuha tek vërtetimi i përkthimit i datës 10/06/2020 Nr. REP 5319 nuk është gjermanisht (deustch) por hollandisht (dutch) tek librezat e qarkullimit të paraqitura.

Gjithashtu ka mospërputhje në përkthim tek mjeti Autokullë (Platformë Pune) pasi në anglisht çmimi është 32,000 Euro ndërsa në shqip është 30,500 Euro.

2.Gjithashtu të gjitha marrëveshjet apo kontratat që OE L.B. pretendon se ka nënshkruar me OE të huaj nuk përmbajnë datë në asnjë prej rasteve.

3.OE L.B. nuk përmbush pikën 4 të specifikimeve teknike pasi kamionçinat e paraqitura të markës Renault Master me numër shasie përkatësisht (VAFQMBH4S551168619) dhe (VF1MBH4V55458845) nuk janë të llojit vetë-shkarkuese në asnjërin prej rasteve në dokumentacionin e paraqitur, siç edhe janë kërkuar nga AK në dokumentat e tenderit.

Kamionçinat nuk janë vetë-shkarkuese pra nuk janë të llojit kipper siç edhe cilësohet në gjuhë hollandeze nëse ato do të ishin të tilla.

4.OE L. B. nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit teknik pasi pas verifikimeve të kryera nga ana e KVO mbi dokumentacionin e dërguar dhe specifikisht për mjetin Renault Master me nr. shasie (VF1MBH4V550458845), mjeti nuk rezulton të ketë bërë 125,595 km.

5. OE L. B.nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit Teknik në lejen e qarkullimit të mjetit Autokullë (Platformë Pune) ku shkruhet se është dy metra i gjerë ndërkohë që në përkthim të kontratës është 1.8 metra. Gjithashtu sipas specifikimeve teknike kulla kërkohet të jetë maksimumi 1.9 metra e gjerë ndërkohë që është 2 metra e gjerë sipas librezës së qarkullimit. Gjithashtu nuk përmbush specifikimet teknike pasi gjatësia është 5,522 mm (ose 552,2 cm) ndërkohë që sipas specifikimeve teknike gjatësia duhet të jetë 450-500 cm.

6. OE L. B. nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit Teknik pasi kamionçinat janë 3,500 kg ndërkohë që nga AK janë kërkuar 2900-3400 kg.

7. Mos-përputhje nga dokumentacioni i paraqitur për kamionçinën Renault Master me numër shasie përkatësisht (VF1MBH4V55458845) ku vëllimi i paraqitur tek dokumentat e përkthyer nuk korrespondon me atë të paraqitur në lejen e qarkullimit, ku specifikisht në dokumentacionin e përkthyer të paraqitur është 2,298 cm³ ndërkohë që në lejen e qarkullimit është 2,299 cm³.

Për sa më lart, KVO duhej të s'kualifikonte OE G. A dhe në kushtet që kishte s'kualifikuar OE Luar Bros, kjo procedurë duhej të anulohet dhe të përsëritej nga e para.

Megjithese OE L. B. ishte i renditur i pari për nga oferta ekonomike është s'kualifikuar nga KVO. Gjithashtu edhe OE G. A i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues me pa të drejt nga KVO duhej të skualifikohej për mosplotësim të disa kriterëve të sipërcituar.

Në këto kushte, KVO duhej të anulonte procedurën, pasi të dy OE pjesëmarrës nuk plotësonin kriteret e vendosura në DST të miratura nga titullari i institucionit. Diferenca midis ofertës më të ulët dhe ofertës së vendit të dytë të kualifikuar dhe shpallur fitues në shumën 1,593,600 lekë, do të konsiderohet përdorim pa efektivitet për buxhetin e DPPGJ. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 52-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1. Rekomandimi: Drejtorja e Përgjithëshme e Pastrim Gjelberimit duhet të bëjë kujdesë dhe të përcaktoj kriteret e qarta dhe lehtësisht të verifikueshme të cilat duhet të respektojnë gjithë kerkesat e kuadrit ligjor dhe nenligjor të prokurimeve publike në fuqi, duke përdorur me eficence fondet buxhetore në dispozicion dhe të nxjerr përgjegjesi për anëtarët e KVO për shumën **1,593,600 lekë**, të përdorur pa efektivitet nga buxheti i DPPGJ.

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi “Blerje Mjete Transporti” rezulton se, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE G.-A., i renditur i dyti për nga vlera e ofertës ekonomike, dhe ne kushtet që nuk plotëson disa nga kriteret e DST të sipërpërmendura. Në këto kushte KVO, duhej ta s’kualifikonte OE G.-A.

KVO duhej të s’kualifikonte OE G. A dhe në kushtet që kishte s’kualifikuar BOE R&R kompani &L., kjo procedurë duhej të anulohet dhe të përsëritej.

KVO ka s’kualifikuar BOE R&R kompani &Ligus të renditur të parët për nga oferta ekonomike, gjithashtu KVO, për sa trajtuar në materialin e auditimit në këtë Raport Përfundimtar duhej të skualifikonte edhe OE G. A të cilin e ka kualifikuar dhe shpallur fitues me pa të drejt, në këto kushte kjo proceure duhej të anulohet, pasi të dy OE pjesëmarrës nuk plotësonin kriteret e vendosura në DST të miratura nga titullari i institucionit. Për sa më lart, Diferenca midis ofertës më të ulët dhe vendit të dyte në shumën 3,066,660 leke (pa TVSH) ose **3,679,992 lekë (me TVSH)**, do të konsiderohet **përdorim pa efektivitet** i buxhetit të DPPGJ, Bashkia Tiranë. (Më hollësisht trajtuar në faqet 61-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithëshme e Pastrim Gjelberimit të analizoj këtë procedurë dhe të marrë masa për anëtarët e KVO të cilët kanë vepruar hapur në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të DPPGJ në shumën 3,679,992 lekë.

D.MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013; Për nëpunësin civil, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmartjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 15 – Masat disiplinore, të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithëshëm të Drejtorisë së Pastrim Gjelberimit, Bashkia Tiranë vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore ndaj:

- 1. Z. V. L.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit “Blerje Mjete Transporti dhe Agregat”.
Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 52-56 të Raportit të Auditimit
- 2. Z. I. M.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit “Blerje Mjete Transporti dhe Agregat”.
Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 52-56 të Raportit të Auditimit
-Në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të oficinës për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”
Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit
- 3. Z.E. Xh.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit “Blerje Mjete Transporti dhe Agregat”.
Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 52-56 të Raportit të Auditimit

-Në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave për procedurën “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.16 faqe 154-156 të Raportit të Auditimit

- Në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procedurën e prokurimit “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.17 faqe 167-168 të Raportit të Auditimit

- Në cilësinë e anëtarëve të KVO për procedurën : “Uniforma dhe Veshje Speciale”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.6 faqe 86-87 të Raportit të Auditimit

- Në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit “Blerje Mjete Transporti”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.2 faqe 61-63 të Raportit të Auditimit

4. **Z.A. Q.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit “Blerje Mjete Transporti”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.2 faqe 61-63 të Raportit të Auditimit

5. **Z.G. R.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit “Blerje Mjete Transporti”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.2 faqe 61-63 të Raportit të Auditimit

6. **Znj. A. K.**, në cilësinë e komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Aparate”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 71-72 të Raportit të Auditimit

7. **Z. E. Xh.**, në cilësinë e komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Aparate”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 71-72 të Raportit të Auditimit

8. **Z. R. O.**, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të verifikimit të defekteve nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021., për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit

9. **Z. G. M.**, në cilësinë e përgjegjës të sektorit Flota Transport për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit

10. **Z. A. T.**, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të verifikimit të defekteve nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021., për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit

11. **Z. E. V.**, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të verifikimit të defekteve nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021., për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit

12. **Z. K. M.**, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të verifikimit të defekteve nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021., për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit

- 13. Z. A. D.**, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të verifikimit të defekteve nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021., për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit

-Në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.18 faqe 183-185 të Raportit të Auditimit

- 14. Z. M. M.**, në cilësinë e anëtarëve të KVO për procedurën : “Uniforma dhe Veshje Speciale” (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4.6 faqe 86-87) të Raportit të Auditimit)

-Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të kontratave për procedurën “Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4.18 faqe 180-182) të Raportit të Auditimit)

-Në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procedurën e prokurimit “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4.17 faqe 167-168) të Raportit të Auditimit)

-Në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave për procedurën “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.16 faqe 154-156 të Raportit të Auditimit

- 15. Znj. I. A.**, në cilësinë e anëtarëve të KVO për procedurën : “Uniforma dhe Veshje Speciale”
Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.6 faqe 86-87 të Raportit të Auditimit

- 16. Z. B. D.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për procedurën “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.12 faqe 117-119 të Raportit të Auditimit

- 17. Znj.A. N.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për procedurën “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4.12 faqe 117-119) të Raportit të Auditimit)

-Në cilësinë e anëtarit të komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Aparate”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 71-72 të Raportit të Auditimit

- 18. Znj.A. L.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për procedurën “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.12 faqe 117-119 të Raportit të Auditimit

- 19. Z.A. S.**, në cilësinë e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për procedurën “Drurë, shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.14 faqe 137-139 të Raportit të Auditimit

- 20. Z. E. M.**, në cilësinë e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për procedurën “Drurë, shkurre dekorative”. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4.14 faqe 137-139) të Raportit të Auditimit)

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.17 faqe 172-175 të Raportit të Auditimit

21. Z.H. H., në cilësinë e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për procedurën “Drurë, shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.14 faqe 137-139 të Raportit të Auditimit

22. Znj.N. Gj., në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës për procedurën “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.15 faqe 147-148 të Raportit të Auditimit)

-Në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.18 faqe 183-185 të Raportit të Auditimit

23. Z. I. F., në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës për procedurën “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.15 faqe 147-148 të Raportit të Auditimit

24. Znj.M. M., në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës për procedurën “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.15 faqe 147-148 të Raportit të Auditimit

25. Z.M. B., në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave për procedurën “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4.16 faqe 154-156) të Raportit të Auditimit)

-Në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procedurën e prokurimit “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.17 faqe 167-168 të Raportit të Auditimit

26. Z.A. B., në cilësinë e anëtarit të komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.17 faqe 172-175 të Raportit të Auditimit

27. Z.R. J., në cilësinë e anëtarit të komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.17 faqe 172-175 të Raportit të Auditimit

28. Z.A. K., në cilësinë e anëtarit të komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.17 faqe 172-175 të Raportit të Auditimit

29. Z.J. P., në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të kontratave për procedurën “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.18 faqe 180-182 të Raportit të Auditimit

30. Z.R. M., në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të kontratave për procedurën “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.18 faqe (180-182) të Raportit të Auditimit

31. Z.M. Gj., në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.18 faqe 183-185 të Raportit të Auditimit

V. ANEKSE.

Aneksi nr.2.3. “Mbi hartimin, shqyrtimin, zbatimin dhe raportimin e programit ekonomiko-financiar” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe (y) të Projektraportit të Auditimit)

Tabela nr.1: Formati nr. 2-Performanca Financiare/Të ardhurat në lekë

Nr	Nr.llog.	Përshkrimi i operacioneve	Viti 2021	Viti 2020
1	A	TE ARDHURAT	567,847,653	541,562,821
34	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	261,898	0
35	710	1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia	0	0
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	261,898	0
45	7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	261,898	
53	72	V.GRANTE KORENTE	568,253,872	542,524,606
54	720	1.Grant korrent i Brendshëm	568,253,872	542,524,606
60	7205	Financim shtese për te ardhurat e krijuara brenda sistemit	536,713,704	508,492,131
61	7206	Financim I pritshëm nga buxheti	31,540,168	34,032,475
73	73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE	-668,117	-961,785

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr.2.: Formati nr. 2- Performanca Financiare/Shpenzimet në lekë

Nr	Nr. llogarie	Përshkrimi i operacioneve	Viti 2021	Viti 2020
74	B	SHPENZIMET	565,074,962	539,314,853
75	600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	309,864,522	302,604,826
76	6001	Paga, personel i përhershëm	300,167,117	302,604,826
78	6003	Shpërblime	9,697,405	
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	49,842,938	50,306,332
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	49,842,938	50,306,332
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	207,417,004	189,613,448
85	6020	Materiale zyre e te përgjithshme	9,329,407	10,361,040
86	6021	Materiale dhe shërbime speciale	26,767,254	38,766,360
87	6022	Shërbime nga te trete	39,591,919	37,169,807
88	6023	Shpenzime transporti	80,729,968	72,125,776
90	6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	11,476,800	
92	6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	2,901,656	9,000,000
94	6029	Shpenzime të tjera operative	36,620,000	22,190,465
101		V.TRANSFERIME KORENTE	1,129,408	0
112	606	3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë	1,129,408	0
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	1,129,408	
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	-3,440,808	-3,209,753
131		IX.TOTALI OPERACIONEVE	261,898	0
135	8422	Transferim te ardhurave brenda sistemit	261,898	

136	85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES (Rezultati I Veprimtarisë se vitit Ushtrimor)	2,772,691	2,247,968
-----	----	---	-----------	-----------

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr.3.: Formati nr. 1: Pozicioni Financiar/AASH në lekë

Nr	Nr. llogarie	Përshkrimi i operacioneve	Viti 2021	Viti 2020
2		I.Aktivët Afatshkurtra	90,607,944	90,327,560
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	0	0
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	33,847,359	31,074,668
12	31	Materiale	6,706,804	2,064,778
13	32	Inventar imët	17,852,765	19,053,983
14	33	Prodhim në proces	9,287,790	9,955,907
21		3.Llogari të Arkëtushme	52,022,210	54,936,701
32	468	Debitorë të ndryshëm	20,496,402	20,496,402
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	31,525,808	34,440,299
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	4,738,375	4,316,191
41	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	4,738,375	4,316,191

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr.4.: Lista e debitorëve. në lekë

Nr	Emertimi i Debitorit	Detyrim para 2018
1	Vjedhje tollona nafte	57,400
2	B. C.	34,520
3	D.Sh.	3,960
4	A. Sh.	15,577
5	G.D.	14,340
6	J. Xh.	8,944
7	P. K.	440,000
8	G. S.	162,505
9	M. D.	188,298
10	Sh. A.	34,058
11	Vjedhje Benz DPN1	800,000
12	Kontenier Firma E.	18,369,600
13	A.K./Motoçikletë	116,400
14	A.K./Biçikletë	18,000
15	E.H./Motoçikletë	116,400
16	R.R./Motoçikletë	116,400
	TOTALI :	20,496,402

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela 5. Formati nr. 1: Pozicioni Financiar/AAGJ në lekë

Nr	Nr. llogarie	Përshkrimi i operacioneve	Viti 2021	Viti 2020
42		II.Aktivët Afatgjata	1,318,023,495	1,282,835,903
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	0	0
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,318,023,495	1,282,835,903
48	210	Toka, Troje, Terrene		
49	211	Pyje, Plantacione	939,035,490	889,117,981
50	212	Ndërtese e Konstruksione	19,708,501	18,138,994
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	143,014,780	130,479,409
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	63,776,262	72,730,310
53	215	Mjete Transporti	80,243,050	100,303,812
56	218	Inventar ekonomik	6,458,134	7,857,199
57	24	Aktive afatgjata të dëmtuara	55,964,019	54,384,939
58	28	Caktime të Aktiveve Afatgjata	9,823,259	9,823,259
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
62		4.Investime	0	0

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela 6: Inventarizimi i aktiveve afatgjata materiale për vitin 2018.
lekë

në

Nr.	Urdh. Ngritje Kom	Proces Verbali	Relacioni	Llog. ekonomike	Gjendja kontabël	Gjendja fizike	Diferenca
1	Nr.3515, dt. 29.12.2018	Nr.3515/1, dt. 25.1.2019	Nr.3515/2, dt. 25.1.2019	Magazina Qendrore	9,798,588	9,798,588	-
2	Nr.3513, dt. 29.12.2018	Nr.3513/1, dt. 25.1.2019	Nr.3513/2, dt. 25.1.2019	Magazina e serave (Prodhimi në proces)	10,394,288	10,394,288	-
3	Nr.3514, dt. 29.12.2018	Nr.3514/1, dt. 25.1.2019	Nr.3514/2, dt. 25.1.2019	Magazina Rikupero(llog.24)	8,059,832	8,059,832	-
4	Nr.3521, dt. 29.12.2018	Nr.3521/1, dt. 25.01.2019	Nr.3521/2, dt. 25.01.2019	Drurë dhe Shkurre (llog.211)	840,120,733	840,120,733	-
5	Nr.3520, dt. 29.12.2018	Nr. 3520/1, dt. 25.1.2019	Nr. 3520/2, dt. 25.1.2019	Ndërtime dhe Konstruksione (llog.212)	29,331,747	29,331,747	-
6	Nr.3519, dt. 29.12.2018	Nr.3519/1, dt. 25.1.2019	Nr.3519/2, dt. 25.1.2019	Rikonstruksion dhe sisteme ujitës (llog.213)	110,080,363	110,080,363	-
7	Nr.3518, dt. 29.12.2018	Nr.3518/1, dt. 25.01.2019	Nr.3518/2, dt. 25.01.2019	Stola, Kosha, Gjeneratorë etj (llog.214)	191,511,213	170,866,135	20,645,078
8	Nr.3517, dt. 29.12.2018	Nr.3517/1, dt. 10.1.2019	Nr.3517/2, dt. 21.1.2019	Mjete transporti (llog.215)	307,623,661	307,623,661	-
9	Nr.3516, datë 29.12.2018	Nr.2954/1, dt. 6.1.2022	Nr.2954/2, dt. 11.1.2022	Inventari Ekonomik (llog.218)	18,546,203	18,546,203	-

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela 7: Inventarizimi i aktiveve afatgjata materiale për vitin 2019.
lekë

në

Nr.	Urdhri i Ngritjes të Komisionit	Proces Verbali	Relacioni	Llogaria ekonomike	Gjendja kontabël	Gjendja fizike	Diferenca
1	Nr.2978, dt. 30.12.2019	Nr.2978/1, dt. 20.1.2020	Nr.2978/2, dt. 20.1.2020	Magazina Qendrore	5,168,525	5,168,525	-
2	Nr.2981, dt. 30.12.2019	Nr.2981/1, dt. 17.1.2020	Nr.2981/2, dt. 17.1.2020	Magazina e serave (Prodhimi në proces)	10,917,695	10,917,695	-

3	Nr.2977, dt. 30.12.2019	Nr.2977/1, dt. 21.1.2020	Nr.2977/2, dt. 21.1.2020	Magazina Rikupero(llog.24)	19,096,400	19,096,400	-
4	Nr.2983, dt. 30.12.2019	Nr.2983/1, dt. 20.1.2020	Nr.2983/2, dt. 23.1.2020	Drurë dhe Shkurre (llog.211)	872,643,087	872,643,087	-
5	Nr.2985, dt. 30.12.2019	Nr.2985/1, dt. 24.1.2020	Nr.2985/2, dt. 24.1.2020	Ndërtime dhe Konstruksione (llog.212)	29,331,747	22,542,656	6,789,091
6	Nr.2984, dt. 30.12.2019	Nr.2951/1, dt. 24.1.2020	Nr.2951/2, dt. 24.1.2020	Rikonstruksion dhe sisteme ujitës (llog.213)	115,492,363	115,492,363	-
7	Nr.2982, dt. 30.12.2019	Nr.2982/1, dt. 21.1.2020	Nr.2982/2, dt. 24.1.2020	Stola, Kosha, Gjeneratorë etj (llog.214)	213,803,470	193,541,187	20,262,283
8	Nr.2980, dt. 30.12.2019	Nr.2980/1, dt. 24.1.2020	Nr.2980/2, dt. 24.1.2020	Mjete transporti (llog.215)	334,019,161	334,019,161	-
9	Nr.2979, dt. 30.12.2019	Nr.2979/1, dt. 24.1.2020	Nr.2979/2, dt. 24.1.2020	Inventari Ekonomik (llog.218)	15,769,686	15,769,686	-

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela 8: Inventarizimi i aktiveve afatgjata materiale për vitin 2020.
lekë

në

Nr.	Urdhri i Ngritjes të Komisionit	Proces Verbali	Relacioni	Llogaria ekonomike	Gjendja kontabël	Gjendja fizike	Diferenca
1	Nr.3035, dt. 30.12.2020	Nr. 3035/1, dt. 18.1.2021	Nr. 3035/2, dt. 20.1.2021	Magazina Qendrore	2,064,778	2,064,778	-
2	Nr.3038, dt. 30.12.2020	Nr.2981/1, dt. 20.1.2021	Nr.2981/2, dt. 22.1.2021	Magazina e serave (Prodhimi në proces)	9,955,906	9,955,906	-
3	Nr.3030 dt. 30.12.2020	Nr.3030/1, dt. 15.1.2021	Nr.3030/2, dt. 18.1.2021	Magazina Rikupero(llog.24)	54,384,939	54,384,939	-
4	Nr.3034, dt. 30.12.2020	Nr. 3034/1, dt. 18.1.2021	Nr. 3034/2, dt. 20.1.2021	Drurë dhe Shkurre (llog.211)	889,117,981	889,117,981	-
5	Nr.2985, dt. 30.12.2020	Nr.2985/1, dt. 24.1.2020	Nr.2985/2, dt. 22.1.2021	Ndërtime dhe Konstruksione (llog.212)	29,331,747	21,224,856	5,584,596
6	Nr.3032, dt. 30.12.2020	Nr. 3032/1, dt. 18.1.2021	Nr. 3032/2, dt. 22.1.2021	Rikonstruksion dhe sisteme ujitës (llog.213)	130,479,409	130,479,409	-
7	Nr.3031, dt. 30.12.2020	Nr. 3031/1, dt. 18.1.2021	Nr. 3031/2, dt. 22.1.2021	Stola, Kosha, Gjeneratorë etj (llog.214)	235,767,351	200,693,443	35,073,908
8	Nr.3037, dt. 30.12.2020	Nr. 3037/1, dt. 18.1.2021	Nr. 3037/2, dt. 20.1.2021	Mjete transporti (llog.215)	347,219,161	347,219,161	-
9	Nr.3036 dt. 30.12.2020	Nr. 3036/1, dt. 15.1.2021	Nr. 3036/2, dt. 18.1.2021	Inventari Ekonomik (llog.218)	18,277,403	18,277,403	-

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela 9: Inventarizimi i aktiveve afatgjata materiale për vitin 2020.
lekë

në


Nr .	Urdhri i Ngritjes të Komisionit	Proces Verbali	Relacioni	Llogaria ekonomike	Gjendja kontabël	Gjendja fizike	Diferenca
1	Nr.2947, dt. 31.12.2021	Nr.2947/1, dt.7.1.2022	Nr.2947/2, dt.10.1.2022	Magazina Qendrore	6,706,804	6,706,804	-
2	Nr.2950, dt. 31.12.2021	Nr.2950/1, dt.10.1.2022	Nr.2950/2, dt.12.1.2022	Magazina e serave (Prodhimi në proces)	9,287,790	9,287,790	-
3	Nr.2955, dt. 31.12.2021	Nr.2955/1, dt.12.1.2022	Nr.2955/2, dt.14.1.2022	Magazina Rikupero(llog.24)	55,964,019	55,964,019	-
4	Nr.2949, dt. 31.12.2021	Nr.2949/1, dt. 15.1.2022	Nr.2949/2, dt. 21.1.2022	Drurë dhe Shkurre (llog.211)	939,035,490	939,035,490	-
5	Nr.2948, dt. 31.12.2021	Nr.2948/1, dt. 11.1.2022	Nr.2948/2, dt.12.1.2022	Ndërtime dhe Konstruksione (llog.212)	29,285,909	23,701,313	5,584,596
6	Nr.2951, dt. 31.12.2021	Nr.2951/1, dt. 13.1.2022	Nr.2951/2, dt. 17.1.2022	Rikonstruksion dhe sisteme ujitës (llog.213)	143,014,780	143,014,780	-
7	Nr.2952, dt. 31.12.2021	Nr.2952/1, dt. 18.1.2022	Nr.2952/2, dt. 24.1.2022	Stola, Kosha, Gjeneratorë etj (llog.214)	249,958,349	249,958,349	-
8	Nr.2953, dt. 31.12.2021	Nr.2953/1, dt. 14.1.2022	Nr.2953/2, dt. 18.1.2022	Mjete transporti (llog.215)	347,219,161	347,219,161	-
9	Nr.2954, dt. 31.12.2021	Nr.2954/1, dt. 6.1.2022	Nr.2954/2, dt. 11.1.2022	Inventari Ekonomik (llog.218)	18,546,203	18,546,203	-

Burimi: DPPGJ, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi 2.4. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Aneksi 2.4.2. Procedura e Prokurimit me objekt :“Blerje Mjete Transporti”

Prn.Scr. Nr.1. Proces Verbali i datës 23.07.2018 i marrjes në dorezim



Aneksi 2.4.4. Procedura e Prokurimit me objekt :“Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra”

Tabela nr.1 Kerkesat per Dinamo dhe motorino

nr	emertimi	lloji	marka	tipi	numri i shasisë	sasia
1	motorrino /dinamo	mt	chengli	201	20161107609	1
2	motorrino	kamion	chengli	l2j	lval2jbb7ge282265	1
3	motorrino	apv	shandong	clë5041	lval2jbb2he268386	1
4	dinamo	kamion	shandong	clë5160	lgax2a125hl401815	1
5	motorrino	atv	sinotruk	zz1167n	lzz1bbmg5hë316763	1
6	dinamo	mt	shandong	lgjl	65080310508	1

Burimi: DPPGJ, përpunimi nga grupi i klsh

Tabela nr.2. Vlera e kontraktuar per dinamo dhe motorino

NR	EMERTIMI	LLOJI	MARKA	TIPI	NUMRI I SHASISE	SASIA	Cmimi	Vlera
1	MOTORRINO /DINAMO	MT	CHEGLI	201	20161107609	1	40,000	40,000
2	MOTORRINO	Kamion	CHEGLI	L2J	LVAL2JBB7GE282265	1	40,000	40,000
3	MOTORRINO	APV	SHANDONG	CLË5041	LVAL2JBB2HE268386	1	40,000	40,000
4	DINAMO	Kamion	SHANDONG	CLË5160	LGAX2A125HL401815	1	35,000	35,000
5	MOTORRINO	ATV	SINOTRUK	ZZI167N	LZZ1BBMG5HË316763	1	35,000	35,000
6	DINAMO	MT	SHANDONG	LGJL	65080310508	1	35,000	35,000
Vlera pa TVSH								225,000 leke
Vlera me TVSH								270,000 leke

Burimi: DPPGJ, përpunimi nga grupi i KLSH

Tabela nr.3. detyrimi i DPPGJ ndaj kontraktuesit per kamat vonesën e FT

Detyrimi mbi të cilin logaritët kamatëvonesa	Afati pagesës I	Pagesa	Datat pagesës e	Norma e interes për kamatë vonesën (REPO+8%)	Kamatëvonesë (lekë)
12,903,600.00	5/29/2021	5,000,000	6/10/2021	8.5%	36,059
7,903,600.00		6,703,423	8/20/2021	8.5%	130,680
1,200,177.00		1,210,177	9/14/2021	8.5%	6,987
TOTAL KAMATËVONESË					173,727

Burimi: DPPGJ, përlogaritja nga grupi i auditimit

Aneksi. 2.4.5. Procedura e Prokurimit me objekt :“Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Tabela nr.1. Mjetet e planifikuara për servis

Tipi i automjetit	Viti i prodhimit
Autobotin tip Benz	1986
Fadromin HITACHI	2008
Kamionin Benz	1984
Kaminin benz	1984
Autobotin Atv Shandong	2018
Autokull Nissan	1978
Autovinc Man	1988
Auto vinc EBRO	1987
Kamion IVECO	1993
Fadrom Caterpillar	2002
Fadrom Caterpillar	1997

Burimi: DPPGJ, përpunimi nga Grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr.2. Shërbimet për autobotin ATV Shandong

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	FV. Bllok Motor Cilindër Testat	cope	1
2	Riparim Injektoresh + Pompë Naftë	Komplet	1
3	FV. Pistocina Freni	cope	2
4	FV. Tamburo Frenimi	cope	2
5	FV Kambio Komplet	cope	1
6	FV pompe frenash	cope	1
7	FV Radiator Uji	cope	1
8	FV Koke paraleli	cope	2
9	FV Koke zbare	cope	2


Burimi: DPPGJ, përpunimi nga grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr.3. KM e realizuara brenda periudhës së auditimit

Muaji	Viti		Totali
	2019	2020	
Janar	0	260	260
Shkurt	0	0	0
Mars	0	758	758
Prill	0	1018	1018
Maj	0	1005	1005
Qershor	215	1051	1266
Korrik	992	1592	2584
Gusht	880	1347	2227
shtator	929	1490	2419
Tetor	602	0	602
Nëntor	160	1120	1280
Dhjetor	0	342	342
Totali në Km	3,778	9,983	13,761

Burimi: DPPGJ, Bashkia Tirane

Prn. Scr. Nr.1 Akt Difektimi per autobotin



Aneks III.1 Vegla dhe mjete pune

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Kazma	Copë	100	33	Shinë motosharrë 76.5 cm3; 40/45/50cm	Copë	5
2	Bishta Kazme	Copë	130	34	Shinë motosharrë 121.6 cm3; 63/75 cm	Copë	5
3	Lopata	Copë	10	35	Kokë dhe shinë motosteke kapacitet 25.4 cm3	Copë	5
4	Bishta Lopate	Copë	70	36	Fasho piston me motosharrë 76.5 cm3;40/45/50	Copë	2
5	Bela	Copë	250	37	Fasho piston me motosharrë 121.6 cm3; 63/75	Copë	3
6	Bishta Beli	Copë	300	38	Kokë motosteke motogërshëre 25.4 cm3	Copë	3
7	Krehër kopshti	Copë	50	39	Fasho piston motosharrë 25.4 cm3	Copë	5
8	Bishta për Krehra	Copë	60	40	Çelës kandelev	Copë	5
9	Shat për prashitje me majë ovale	Copë	100	41	Rripa për traktorët korrës 1	Copë	5
10	Bishta për shat për prashitje me m. ovale	Copë	120	42	Rripa për traktorët korrës 2	Copë	5
11	Prashitës për bimë dhe lule me dy krahe	Copë	5	43	Thika për traktorët korrës	Copë	10
12	Bishta për prashitës për bimë	Copë	5	44	Bombol gazi për temperim thikash	Copë	20
13	Prashitës me dy dhëmbë	Copë	5	45	Kandelev	Copë	20
14	Bishta prashitësi me dy dhëmbë	Copë	5	46	Koka hekurit për fildispanjë	Copë	5
15	Capa dore	Copë	100	47	Fildispanjë	Copë	25
16	Bishta për capa dore	Copë	120	48	Disqe për ferra (Koka)	Copë	5
17	Cfurgje	Copë	100	49	Litar i trashë Ø 16	Copë	200
18	Bishta për cfurgje	Copë	100	50	Shkallë dyshe 3.3 m	Copë	5
19	Kosa bari	Copë	25	51	Karrocë dore	Copë	7
20	Bishta kose	Copë	20	52	Pinca korrenti	Copë	5
21	Mprehës (guri)	Copë	70	53	Pompa për fryrje gomash	Copë	10
22	Rreth për bisht kose	Copë	10	54	Vazo lule plastike Ø 20	Copë	50
23	Sopatë e madhe	Copë	5	55	Vazo lule plastike Ø 30	Copë	50
24	Bisht për sopatë	Copë	5	56	Vazo plastike Ø 40	Copë	50
25	Gërshërë krasitje	Copë	20	57	Pompë zhytëse për puse 7.5 kë	Copë	1
26	Gërshërë krasitje me zgjatime për degët me perimetër 5 cm (majë papagall)	Copë	15	58	Pompë zhytëse për puse 4 kë	Copë	1
27	Sharrë dore për krasitje degësh	Copë	10	59	Pompë zhytëse për puse 2.2 kë	Copë	1
28	Sharrë druri me hark	Copë	5	60	Pompë zhytëse për puse 1.5 kë	Copë	2
29	Limë për mprehe të zinxhirit të motosharrës	Copë	70	61	Pompë zhytëse për puse 1.1 kë	Copë	2
30	Zinxhir motor sharre 76.5 cm3; 40/45/50 cm	Copë	30	62	Pompë centrifugale 0.75-1.5 kë	Copë	3
31	Zinxhir motor sharre 121.6 cm3; 63/75 cm	Copë	30	63	Pompë zhytëse dore (për drenazhim) 1.1 kë	Copë	3
32	Zinxhir motosteke 25.4 cm3 fuqi 0.95 kë/1.3 hp	Copë	30				

Aneks III.2 Vegla dhe mjete pune

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Bashkues plastik Ø 63	Copë	60	51	Automat 63 A	Copë	5
2	Bashkues plastik Ø 50	Copë	60	52	Automat 40 A	Copë	5
3	Bashkues plastik Ø 32	Copë	50	53	Automat 32 A	Copë	10

4	Bashkues plastik Ø 40	Copë	30	54	Ceflon	Copë	10
5	Bashkues plastik Ø 25	Copë	150	55	Izolant	Copë	20
6	Xhunto plastik mashkull Ø 63	Copë	60	56	Marseta elektrike 3.6 mm	Copë	100
7	Xhunto plastik femër Ø 63	Copë	30	57	Kabull 6x4	ml	500
8	Xhunto plastik mashkull Ø 50	Copë	40	58	Kabull 4x4	ml	400
9	Xhunto plastik femër Ø 50	Copë	20	59	Kabull 3 x 2.5	ml	500
10	Xhunto plastik mashkull Ø 40	Copë	03	60	Litar kundër ujit	ml	300
11	Xhunto plastik femër Ø 40	Copë	20	61	Bërryl Ø 63	Copë	20
12	Xhunto plastik mashkull Ø 32	Copë	30	62	Bërryl Ø 50	Copë	20
13	Xhunto plastik femër Ø 32	Copë	30	63	Bërryl Ø 40	Copë	20
14	Stafa plastik Ø 63	Copë	70	64	Bërryl Ø 32	Copë	20
15	Stafa plastik Ø 50	Copë	40	65	T I Ø 63	Copë	20
16	Stafa plastik Ø 40	Copë	40	66	T I Ø 50	Copë	20
17	Stafa plastik Ø 32	Copë	50	67	T I Ø 40	Copë	20
18	Saraçneska ¾ tunxh	Copë	250	68	T I Ø 32	Copë	20
19	Saraçneska 1 polshe tunxh	Copë	50	69	Fshesë për fshirje rruge	Copë	200
20	Saraçneska 1 ½ tunxh	Copë	30	70	Farashka	Copë	200
21	Saraçneska 2 polshe tunxh	Copë	30	71	Sfungjer	Copë	60
22	Saraçneska ¾ plastike	Copë	100	72	Kalla	Copë	50
23	Nipples ¾ xingato	Copë	150	73	Qyski	Copë	20
24	Nipples 1 polshe xingato	Copë	50	74	Kosë bari	Copë	5
25	Nipples 1 polshe e ½ xingato	Copë	30	75	Sqeparë	Copë	5
26	Nipples 2 polshe xingato	Copë	30	76	Gur fresibël (fletë)	Copë	200
27	Reduksion ¾-1 polshe xingato	Copë	100	77	Qese mbeturinash	Copë	100
28	Reduksion ¾-1 polshe xingato	Copë	100	78	Litar (çimentoje)	M linear	50
29	Reduksion ¾ polshe plastike	Copë	100	79	Bishta druri për fshesë	Copë	200
30	Mufle ¾ polshe xingato	Copë	50	80	Bishta druri për vare	Copë	20
31	Mufle 1 polshe 1 ½ xingato	Copë	50	81	Pastro izolant	Copë	40
32	Fv tub plastik i verdhë ¾ 30*50	ml	1500	82	Krik mbi 10 ton	Copë	1
33	Tuba kauçuku Ø 63	ml	250	83	Vidiatore 20V	Copë	1
34	Tuba kauçuku Ø 32	ml	250	84	Set çelësa yll	Copë	1
35	Gur fresibël	Copë	2	85	Set çelësa krket nga Ø 10 - 41	Copë	2
36	Komplet çelësa heksagonal (set)	Copë	2	86	Set çelësa poligon nga Ø 10 - 22	Copë	2
37	Çelësa anglez universal (set)	Copë	3	87	Pinca	Palë	4
38	Komplet kaçavidash kryq + yll (set)	Copë	2	88	Set çelësa yll	Palë	2
39	Çelësa papagall 1 polësh (hidraulik)	Copë	3	89	Set kaçavida	Palë	2
40	Çelësa papagall 2 polësh (hidraulik)	Copë	3	90	Bullona nga Ø 4 – 26 dhe dado	Copë	20
41	Çelësa papagall 3 polësh (hidraulik)	Copë	2	91	Piceta fermosh	Copë	4
42	Leshues 63 A	Copë	5	92	Precina	Copë	20
43	Leshues 60 A	Copë	5	93	Punto betoni dhe hekuri nga Ø 14-18	Copë	2
44	Kondensator 35 A	Copë	5	94	Sprai për zhblokimin e vidave	Copë	10
45	Kondensator 40 A	Copë	5	95	Gur fresibël fleta	Copë	20
46	Kondensator 60 A	Copë	5	96	Maska saldimi me rreze	Copë	20
47	Kondensator 70 A	Copë	5	97	Maska saldimi	Copë	2
48	Çelës elektrik 15 A	Copë	10	98	Elektroda 2.5 dhe 4	Copë	100
49	RRL termik 15 A	Copë	10	99	Furça	Copë	10
50	RRL termik 25 A	Copë	10	100	Valixhe për mbajtje veglash metalike	Copë	1

Aneks III.3 Vegla dhe mjete pune

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Kazma + Bishta	Copë	50	40	Piston për motosharrë model Makita EA700P	Copë	2
2	Lopata + Bishta	Copë	200	41	Fasho për motosharrë model Makita EA700P	Copë	2
3	Bela + bishta	Copë	150	42	Shinë për motosharrë model Makita EA700P	Copë	3
4	Krehër kopshti + bishta	Copë	100	43	Zinxhir për motosharrë model Makita EA700P	Copë	10
5	Shat për prashitje me majë ovale + bishta	Copë	100	44	Tamburo dhe litar për motosharrë model Makita EA700P	Copë	3
6	Prashitës për bimë dhe lule me dy krahë + bishta	Copë	5	45	Bosh për motostekë Sthil HT103	Copë	20
7	Prashitës me dy dhëmbë + bishta	Copë	5	46	Yllëz për motostekë Sthil HT103	Copë	20
8	Capa dore + bishta	Copë	100	47	Kosë për motostekë Sthil HT103	Copë	20
9	Cfurgje + bishta	Copë	100	48	Zinxhir për motostekë Sthil HT103	Copë	50
10	Kalla + bishta	Copë	20	49	Shinë për motostekë Sthil HT103	Copë	5
11	Kosa bari + bishta të kompletuar	Copë	50	50	Çelës kandle	Copë	5
12	Mprehës për kosë bari (gur kose)	Copë	100	51	Set Çelësash të ndryshëm (fiso, poligon.)	Copë	3
13	Kudhër dhe çekiq për kalitje kose	Copë	15	52	Rripa për traktor korrës 1	Copë	10
14	Sëpata të mëdha + bishta	Copë	5	53	Rripa për traktor korrës 2	Copë	10
15	Sëpata të vogla + bishta	Copë	25	54	Thika për traktorët korrës1	Çifte	10
16	Sqepar	Copë	5	55	Thika për traktorët korrës2	Çifte	10
17	Mistri	Copë	5	56	Bombol gazi për temperim thikash	Copë	10
18	Nivel	Copë	5	57	Kandle	Copë	50

19	Metër Shirit (50m)	Copë	5	58	Koka hekuri për fildispanjë	Copë	50
20	Metër metalik (5m)	Copë	10	59	Fildispanjë (fije)	Copë	200
21	Spango	Copë	10	60	Disqe për ferra (koka)	Copë	5
22	Shirit për rrethimin e objekteve (50 lm)	Copë	100	61	Litar i trashë Ø 16	Metër	100
23	Thika për prerje tapeti	Copë	10	62	Shkallë dyshe 3 m	Copë	5
24	Gërshërë krasitje (për shkurre)	Copë	40	63	Karrocë dore	Copë	20
25	Gërshërë krasitje me zgjatime për degët me perimetër 10 cm	Copë	15	64	Pinca korrenti	Copë	10
26	Gërshërë dore krasitje	Copë	30	65	Pompë për fryrje gomash	Copë	10
27	Sharra dore për krasitje degësh	Copë	20	66	Kaçavida të ndryshme plus-minus-yll	Kuti	3
28	Sharrë druri me hark	Copë	5	67	Kone sinjalizues për punime	Copë	50
29	Limë për mprehje të zinxhirit të motosharrës	Copë	100	68	Tabela për njoftim punimesh në rrugë	Copë	10
30	Piston për motosharrë model Stihl MS 461	Copë	10	69	Vazo lule plastike Ø 80	Copë	50
31	Fasho për motosharrë model Stihl MS 461	Copë	10	70	Vazo lule plastike Ø 100	Copë	50
32	Yllëza për motosharrë model Stihl MS 461	Copë	10	71	Vazo lule plastike Ø 120	Copë	50
33	Shine për motosharrë model Stihl MS 461	Copë	10	72	Fshesa për pastrimin e rrugëve	Copë	50
34	Zinxhir për motosharrë model Stihl MS 461	Copë	100	73	Levë	Copë	10
35	Piston për motosharrë model Stihl MS 441 c	Copë	2	74	Vare	Copë	15
36	Fasho për motosharrë model Stihl MS 441 c	Copë	2	75	Qyski	Copë	10
37	Bobinë për motosharrë model Stihl MS 441 c	Copë	2	76	Pompë spërkatëse shpine jo motorike (material PVC, 16 lit)	Copë	3
38	Shine për motosharrë model Stihl MS 441 c	Copë	2	77	Matrapik për thyrje 1500 vat	Copë	1
39	Zinxhir për motosharrë model Stihl MS 441 c	Copë	5				

Aneks III.4 Vegla dhe mjete pune

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Pompë centrifugale për shatërvan 2.2 kë	Copë	2	57	Komplet kaçavidash kryq + yll (set)	Copë	3
2	Pompë centrifugale për shatërvan 1.5 kx	Copë	2	58	Çelësa papagall 1 polësh (hidraulik)	Copë	3
3	Pompë centrifugale për shatërvan 0.75-1.1 k	Copë	3	59	Çelësa papagall 2 polësh (hidraulik)	Copë	3
4	Pompë zhytëse dore (për drenazhim) 1.1 kë	Copë	4	60	Çelësa papagall 3 polësh (hidraulik)	Copë	2
5	Bashkues plastik ø 63	Copë	60	61	Çelësa papagall 4 polësh (hidraulik)	Copë	1
6	Bashkues plastik ø 50	Copë	60	62	Lëshues 63 A dhe RRL 18-25 A	Copë	10
7	Bashkues plastik ø 40	Copë	40	63	Lëshues 40 A dhe RRL 12-18 A	Copë	10
8	Bashkues plastik ø 32	Copë	130	64	Lëshues 25 A dhe RRL 12-18	Copë	10
9	Bashkues plastik Ø 25	Copë	150	65	Kondensator 60 MF	Copë	5
10	Stafa Plastik ø 63 me dalje ¾	Copë	80	66	Kondensator 50 MF	Copë	5
11	Stafa Plastik ø 50 me dalje ¾	Copë	80	67	Kondensator 45 MF	Copë	5
12	Stafa plastik ø 40 me dalje ¾	Copë	80	68	Kondensator 35 MF	Copë	5
13	Stafa Plastik ø 32 me dalje ¾	Copë	50	69	RRL termike monofazë 10-12 A	Copë	10
14	Saraçineska ¾ xingato	Copë	200	70	Automat 4 polar 80 A	Copë	5
15	Saraçineska 1 polëshe xingato	Copë	50	71	Automat 63 A	Copë	6
16	Saraçineska 1 e ½ xingato	Copë	30	72	Gur fresibël i vogël 850 vat ë	Copë	4
17	Saraçineska 2 polëshe xingato	Copë	20	73	Vare 6 kg+bisht 800 vat Ë	Copë	6
18	Saraçineska ¾ plastike	Copë	100	74	Furça	Copë	10
19	Saraçineska 1 polëshe plastike	Copë	30	75	Qese mbeturinash	Copë	1000
20	Saraçineska 2 polëshe plastike	Copë	10	76	Bojra për lyrje (verdh,kuq,jeshil...)	100 l	
21	Nipels ¾ xingato	Copë	150	77	Vida kokë çadër 8x6 me dado + rondele	Copë	3000
22	Nipels 1 polëshe xingato	Copë	100	78	Vida betoni 8x7 me up 10	Copë	5000
23	Nipels 1 e ¼ xingato	Copë	15	79	Gur fresibël Flet (betoni+hekuri)	Copë	3000
24	Nipels 2 polëshe xingato	Copë	15	80	Automat 40 A	Copë	6
25	Reduksion plastik ø63 mashkull me dalje 2 pol	Copë	15	81	Automat 32 A	Copë	10
26	Reduksion plastik ø50 mashkull me dalje 1/1/4	Copë	15	82	Izolant kundra ujit	Copë	10
27	Reduksion plastik ø40 mashkull me dalje 1/1/4	Copë	15	83	Izolant	Copë	30
28	Reduksion plastik ø32 mashkull me dalje 1 pol	Copë	100	84	Marseta elektrike 3-6 mm	Copë	100
29	Reduksion plastik ø25 mashkull me dalje ¾	Copë	100	85	Kabull elektrik 6x4	ml	200
30	Reduksion plastik mashkull 1 polësh me ¾	Copë	100	86	Kabull elektrik 4x4	ml	200
31	Reduksion plastik ø 63 femër me dalje 2 polshe	Copë	15	87	Kabull elektrik 3x2.5	ml	150
32	Reduksion plastik ø 50 femër me dalje 1/1/4	Copë	15	88	Kabull elektrik 3*1.5	ml	50
33	Reduksion plastik ø 40 femër me dalje 1/1/4	Copë	15	89	Litar kundra ujit	ml	150
34	Reduksion plastik ø 32 femër me dalje 1 polshe	Copë	100	90	Brryl plastik Ø 63	Copë	60

35	Reduksion plastik ϕ 25 femër me dalje $\frac{3}{4}$	Copë	100	91	Brryl plastik ϕ 50	Copë	30
36	Reduksion $\frac{3}{4}$ - 1 polëshe xingato	Copë	100	92	Brryl plastik ϕ 40	Copë	30
37	Reduksion $\frac{3}{4}$ - 1 polëshe plastike	Copë	100	93	Brryl plastik ϕ 32	Copë	100
38	Reduksion xingato $\frac{3}{4}$ me 1 polëshe	Copë	100	94	Brryl plastik ϕ 25	Copë	100
39	Mufte xingato 2 poleshe me 1/1/2	Copë	10	95	Ti plastik ϕ 63	Copë	20
40	Mufte xingato 1 polëshe me 1 e $\frac{1}{2}$	Copë	10	96	Ti plastik ϕ 50	Copë	20
41	Mufte xingato $\frac{3}{4}$ me dalje 1 poleshe	Copë	20	97	Ti plastik ϕ 40	Copë	30
42	Tub plastik i verdhë $\frac{3}{4}$, 30*50m	ml	1000	98	Ti plastik ϕ 32	Copë	100
43	Tub plastik 10 bar ϕ 63	ml	150	99	Ti plastik ϕ 25	Copë	100
44	Tub plastik 10 bar ϕ 50	ml	200	100	Ti plastik ϕ 32 me dalje $\frac{3}{4}$ për sprucator	Copë	100
45	Tub për vaditje ϕ 50	ml	200	101	Ti plastik ϕ 25 me dalje $\frac{3}{4}$ për sprucator	Copë	100
46	Tub për vaditje "botesh" ϕ 25	ml	400	102	Sprucator me hedhje 10 m	Copë	100
47	Tub plastik 10 bar ϕ 40	ml	150	103	Sprucator me hedhje 4 m	Copë	100
48	Tub plastik 10 bar ϕ 32	ml	150	104	Klor i lëngshëm	lit	400
49	Tub plastik 10 bar ϕ 25	ml	100	105	Acid për larje shatërvani	lit	50
50	Gur fresibël të mëdhenj 2400 vat ë	Copë	4	106	Litar për vinxh	ml	100
51	Matrapik 750 ë me bateri për çmim betoni	Copë	1	107	Kriketo për mjete	Copë	30
52	Trapan me korrent 2000 vat.ë	Copë	2	108	Punto betoni me slit ϕ 10-18	Copë	10
53	Trapan dore (Vidator) 22-vat ë	Copë	4	109	Maskë për saldim me rreze	Copë	5
54	Komplet çelsa fise 4-32 (set)	Copë	4	110	Elektroda me pik te kuqe (2.5 dhe 4)	kg	200
55	Komplet çelsa heksagon (set)	Copë	2	111	Elektroda 2.5 dhe 4	kg	30
56	Çelsa anglez universal (set)	Copë	3				

Aneks III.5 Vegla dhe mjete pune

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Kazma+bishta	Copë	40	26	Gërshërë dore për krasitje	Copë	22
2	Lopata+bishta	Copë	75	27	Sharrë dore për krasitje degësh	Copë	15
3	Bela+bishta	Copë	150	28	Sharrë druri me hark	Copë	4
4	Krëhër kopështi + bishta	Copë	75	29	Set çelësash të ndryshëm (fiso, poligon)	Copë	2
5	Shat për prashitje me majë ovale + bishta	Copë	75	30	Bombol gazi për temperim thikash	Copë	8
6	Prashitës për bimë dhe lule me dy krahe + bishta	Copë	4	31	Litar i trashë ϕ 16	metra	75
7	Prashitës me dy dhëmbë + bishta	Copë	4	32	Shkallë dyshe 3m	Copë	4
8	Capa dore + bishta	Copë	75	33	Karrocë dore	Copë	15
9	Cfurgje + bishta	Copë	75	34	Pinca korrenti	Copë	8
10	Kalla + Bishta	Copë	15	35	Pompë për fryrje gomash	Copë	8
11	Kosa bari + bishta të kompletuar	Copë	37	36	Kaçavida të ndryshme plus-minus-yll	kuti	2
12	Mprehës për kosë bari për kalitje kose	Copë	75	37	Kone sinjalizues për punime	Copë	22
13	Kudhër dhe çekiq për kalitje kose	Copë	11	38	Tabela për njoftime punimesh në rrugë	Copë	8
14	Sëpata të mëdha + bishta	Copë	4	39	Vazo lule plastike ϕ 80	Copë	38
15	Sëpata të vogla + bishta	Copë	19	40	Vazo lule plastike ϕ 100	Copë	38
16	Sqepar	Copë	4	41	Vazo lule plastike ϕ 120	Copë	38
17	Mistri	Copë	4	42	Fshesë për pastrimin e rrugëve	Copë	38
18	Nivel	Copë	4	43	Levë	Copë	8
19	Metër shirit (50m)	Copë	4	44	Vare	Copë	11
20	Metër metalik (5m)	Copë	8	45	Qyski	Copë	8
21	Spango	Copë	8	46	Pompë spërkatëse shpine jo motorike (material PVC 16l...	Copë	1
22	Shirit për rrethimin e objekteve (50m)	Copë	75	47	Matrapik për thyerje 1500vat	Copë	1
23	Thika për preje tapeti	Copë	8	48	Fildispanjë me ϕ 4mm për prerëse bari model stihl FS 250	top	75
24	Gërshërë krasitje (për shkurre)	Copë	26	49	Çelës kandelet	Copë	4
25	Gërshërë krasitje me zgjatime për degët me perimetër 10cm	Copë	11				

Aneks III.6 Vegla dhe mjete pune

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Pompë centrifugale për shatërvan 2.2kë	Copë	1	89	Ti plastik ϕ 25	Copë	15
2	Pompë centrifugale për shatërvan 1.5kë	Copë	1	90	Ti plastik ϕ 32 me dalje $\frac{1}{2}$ për sprucator	Copë	38
3	Pompë centrifugale për shatërvan 0.75-1.1kë	Copë	1	91	Ti plastik ϕ 25 me dalje $\frac{1}{2}$ për sprucator	Copë	75
4	Pompë zhytëse dore (për drenazhim) .1 kë	Copë	1	92	Sprucator me hedhje 10 m	Copë	53
5	Pompë pusi zhytëse 2.2 kë H=140m dhe paneli	Copë	2	93	Sprucator me hedhje 4 m	Copë	53
6	Pompë pusi zhytëse 1.5 kë H=140m dhe paneli	Copë	2	94	Klor i lëngshëm	Lt	300
7	Pompë pusi zhytëse 5.5 kë H=160m dhe paneli	Copë	1	95	Acid për larje shatërvani	Lt	75
8	Pompë pusi zhytëse 7.5 kë H=160m dhe paneli	Copë	1	96	Litar për vinç	ml	150
9	Bashkues plastik ϕ 63	Copë	8	97	Kriketo për mjete	Copë	23
10	Bashkues plastik ϕ 63-50	Copë	8	98	Punto betoni me slit ϕ 0.6-12	Copë	15
11	Bashkues plastik ϕ 50	Copë	8	99	Maskë për saldim me rreze	Copë	4
12	Bashkues plastik ϕ 50-40	Copë	8	100	Elektroda me pikë të kuqe (2.5 dhe 4)	Kg	75
13	Bashkues plastik ϕ 40	Copë	8	101	Elektroda 2.5 dhe 4	Kg	23

14	Bashkues plastik ϕ 40-32	Copë	8	102	Shinë për motosharrë model stihl Ms 461	Copë	2
15	Bashkues plastik ϕ 32	Copë	8	103	Zinxhir për motosharrë model stihl MS 461	Copë	6
16	Bashkues plastik ϕ 25	Copë	75	104	Kandele për motosharrë model stihl MS 461	Copë	2
17	Saraçineska $\frac{3}{4}$ xingato	Copë	112	105	Shinë për motosharrë model stihl Ms441c	Copë	1
18	Saraçineska 1 polëshe xingato	Copë	75	106	Zinxhir për motosharrë model stihl MS441c	Copë	5
19	Saraçineska 1 e $\frac{1}{2}$ xingato	Copë	15	107	Kandele për motosharrë model stihl MS441c	Copë	2
20	Saraçineska 2 polëshe xingato	Copë	23	108	Filtër ajri për motosharrë model stihl MS441c	Copë	1
21	Saraçineska $\frac{3}{4}$ xingato	Copë	112	109	Yllza për motosharrë model stihl MS 441c	Copë	4
22	Saraçineskë 1 polshe plastike	Copë	37	110	Kabrator ajri për motosharrë model stihl MS441c	Copë	1
23	Saraçineskë 2 polshe plastike	Copë	7	111	Tamburo dhe litar për motosharrë model stihl MS441c	Copë	1
24	Nipels $\frac{3}{4}$ xingato	Copë	75	112	Lima për motosharrë model stihl MS441c	Copë	15
25	Nipels 1 polshe xingato	Copë	37	113	Zinxhir për motosharrë model husqvarna T435	Copë	11
26	Nipels 1 e $\frac{1}{4}$ xingato	Copë	8	114	Kandele për motosharrë model husqvarna T435	Copë	4
27	Nipels 2 polshe xingato	Copë	8	115	Shinë për motosharrë model husqvarna T435	Copë	2
28	Reduksion plastik ϕ 32 mashkull me dalje 1 polshe	Copë	15	116	Fasho për motosharrë model husqvarna T435	Copë	2
29	Reduksion plastik ϕ 25 mashkull me dalje $\frac{3}{4}$	Copë	38	117	Permistop për motosharrë model husqvarna T435	Copë	2
30	Reduksion plastik mashkull 1 polsh me $\frac{3}{4}$	Copë	38	118	Tamburo dhe litar për motosharrë model husqvarna T435	Copë	1
31	Reduksion plastik ϕ 32 femër me dalje 1 polshe	Copë	38	119	Limë për motosharrë model husqvarna T435	Copë	15
32	Reduksion ϕ 25 femër me dalje $\frac{3}{4}$	Copë	38	120	Yllza për motosharrë model husqvarna T435	Copë	11
33	Reduksion plastik $\frac{3}{4}$ -1 polshe xingato	Copë	38	121	Filtër ajri për motosharrë model husqvarna T435	Copë	1
34	Reduksion plastik $\frac{3}{4}$ -1 polshe plastike	Copë	75	122	Zinxhir për motosharrë model husqvarna T435	Copë	5
35	Reduksion xingato $\frac{3}{4}$ me 1 ploshe	Copë	15	123	Kandele për motosharrë model husqvarna T435	Copë	1
36	Mufte xingato 2 polshe me 1/1/2	Copë	8	124	Shinë për motosharrë model husqvarna T435	Copë	1
37	Mufte xingato 1 polshe me 1 e $\frac{1}{2}$	Copë	8	125	Tambur dhe litar për motosharrë model husqvarna T435	Copë	2
38	Mufte xingato $\frac{3}{4}$ me $\frac{1}{2}$	Copë	8	126	Limë për motosharrë model husqvarna T435	Copë	15
39	Tub plastik i verdhë $\frac{3}{4}$, 30*50m	MI	1.125	127	Yllza për motosharrë model husqvarna T435	Copë	2
40	Tub plastik 10 bar ϕ 63	MI	75	128	Filtër ajri për motosharrë model husqvarna T435	Copë	1
41	Tub plastik 10 bar ϕ 50	MI	300	129	Zinxhir për motosharrë model Al-Ko BKS 3835	Copë	8
42	Tub për vaditje ϕ 50	MI	150	130	Kandele për motosharrë model Al-Ko BKS 3835	Copë	15
43	Tub për vaditje “botesh”	MI	300	131	Shinë për motosharrë model Al-Ko BKS 3835	Copë	4
44	Tub plastik 10 bar ϕ 40	MI	150	132	Limë për motosharrë model Al-Ko BKS 3835	Copë	8
45	Tub plastik 10 bar ϕ 32	MI	150	133	Yllza për motosharrë model Al-Ko BKS 3835	Copë	2
46	Tub plastik 10 bar ϕ 25	MI	75	134	Filtër ajri për motosharrë model Al-Ko BKS 3835	Copë	2
47	Gur fresibël të mëdhenj 2400 vat ë	Copë	2	135	Zinxhir për motosharrë model makita EA 7900P	Copë	4
48	Matrapik 750 ë me bateri për betoni	Copë	2	136	Tambur dhe litar për motosharrë model makita EA 7900P	Copë	1
49	Trapan me korrent 2000 vat.ë	Copë	2	137	Zinxhir për motostekë model stihl HT 75	Copë	15
50	Trapan dore (vidator) 22-vat.ë	Copë	2	138	Filtër ajri për motostekë model stihl HT 75	Copë	2
51	Komplete çelësash fise 4-32 set	Copë	1	139	Koka për motostekë model stihl HT 75	Copë	4
52	Komplete çelësash heksagon set	Copë	1	140	Kandele për motostekë model stihl HT 75	Copë	5
53	Çelësa anglez universal set	Copë	5	141	Shinë për motostekë model stihl HT 75	Copë	4
54	Komplet kaçavidash kryq+yll set	Copë	4	142	Lima për motostekë model stihl HT 75	Copë	15
55	Çelësa papagall 1 polëshe (hidraulik)	Copë	4	143	Yllza për motostekë model stihl HT 75	Copë	11
56	Çelësa papagall 2 polëshe (hidraulik)	Copë	4	144	Filtër ajri për motostekë model Force MT 330	Copë	4
57	Lëshues 63 A dhe RRL 18-25 A	Copë	6	145	Kandele për motostekë model Force MT 330	Copë	3
58	Lëshues 40 A dhe RRL 12-18 A	Copë	6	146	Koka për prerëse bari (fildispanjë) model Force MT 330	Copë	11
59	Lëshues 25 A dhe RRL 12-18	Copë	6	147	Kokë për motostekë model Force MT 330	Copë	4
60	Kondensator 60 MF	Copë	6	148	Kokë për motogërshtë model Force MT 330	Copë	2
61	Kondensator 50 MF	Copë	6	149	Kabrator për motostekë model Force MT 330	Copë	1
62	Kondensator 45 MF	Copë	6	150	Zinxhir për motogërshtë model Force MT 330	Copë	8
63	Kondensator 35 MF	Copë	6	151	Limë për motogërshtë model Force MT 330	Copë	15
64	RRL termike monofazë 10-12 A	Copë	11	152	Kandele për motokorsë model MTD smart 46 SPB Briggs&Stratton 450 E	Copë	2
65	Automat 4 polar 80 A	Copë	6	153	Kova për motokorsë model MTD smart 46 SPB Briggs&Stratton 450 E	Copë	3
66	Automat 63 A	Copë	6	154	Kabrator për motokorsë model MTD smart 46 SPB Briggs&Stratton 450 E	Copë	1

67	Gur fresibël i vogël 850 vat ë	Copë	2	155	Thika për motokorsë model MTD smart 46 SPB Briggs&Stratton 450 E	Copë	2
68	Vare 6kg+bisht 800 vat ë	Copë	5	156	Filtër ajri për motokorsë model MTD smart 46 SPB Briggs&Stratton 450 E		2
69	Furçë	Copë	8	157	Koka për prerëse bari (fildispanjë) model Stihl FS 250	Copë	15
70	Qese mbeturinash	Copë	750	158	Fildispanjë me Ø 4mm për prerëse bari (fildispanjë) model Stihl FS 250	Copë	60
71	Bojëra për lyrje (verdhe, kuqe, jeshile, blu, zez, gri, bardh)	lt	150	159	Kabrator për prerëse bari (fildispanjë) model Stihl FS 250	Copë	2
72	Vida kokë çadër 8*6 me dado + rondele	Copë	2250	160	Disk për prerëse bari (fildispanjë) model Stihl FS 250	Copë	11
73	Vida betoni 8*7 me up 10	Copë	3750	161	Kandelet për prerëse bari (fildispanjë) model Stihl FS 250	Copë	8
74	Gur fresibël flet (betoni+hekuri)	Copë	300	162	Limë për motogërshtë model stihl HS 82R	Copë	2
75	Automat 40 A trefazor	Copë	8	163	Kabrator për motogërshtë model stihl HS 82R	Copë	1
76	Automat 32 A	Copë	8	164	Kandelet për motogërshtë model stihl HS 82R	Copë	2
77	Izolant kundra ujit	Copë	4	165	Thika për motokorsë model viking	Copë	2
78	Izolant	Copë	22	166	Kandelet për motokorsë model viking	Copë	4
79	Marseta elektrike 3-6 mm	Copë	75	167	Kabrator për motokorsë model viking	Copë	1
80	Kabull elektrik 6*4	MI	225	168	Kavo për motokorsë model viking	Copë	2
81	Kabull elektrik 4*4	MI	225	169	Thika për traktor korrës 1	Copë	2
82	Kabull elektrik 3*2.5	MI	225	170	Kandelet për traktor korrës 1	Copë	2
83	Kabull elektrik 3*1.5	MI	150	171	Thika për traktor korrës 2	Copë	2
84	Litar kundra ujit	MI	500	172	Kandelet për traktor korrës 2	Copë	2
85	Bryll plastik Ø 63	Copë	11	173	Sabrator për frezë Viking	Copë	1
86	Bryll plastik Ø 50	Copë	8	174	Kabrator për frezë viking	Copë	1
87	Bryll plastik Ø 25	Copë	15	175	Kandelet për frezë viking	Copë	2
88	Ti plastik Ø 63	Copë	15	176	Vajmishë (1 kuq)	liter	150

V.3 Nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve.

1- Kontrata "Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore":

Ku konstatohet mungesa e zërave: Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat, Pllakë b/a granili mbi parapet tarace, Veshje fasade dekorative me elementë terrakote, Dyer të blinduara, Parapet shkalle e ballkoni me hekur e korimano (veranda).



Figura 1 Pamje e fasadës së jashtme të godinës

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 3.



Figura 2 Shkallët e godinës

2- Kontrata "Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi":

- Lulishte përgjatë rrugës "Sulejman Delvina" në mes blloqeve të banimit, si pasojë e ndërtimit të një pallati kjo lulishte zënë nga kantieri i ndërtimit.

- Lulishte përgjatë rrugës "Mustafa Qosja", pranë kopshtit Nr.11, ku shkurret e vendosura janë një pjesë në vazo dhe një pjesë me distancë më të vogël se 60 cm.



Figura 3 Lulishte e zënë nga kantieri i ndërtimit



Figura 4 Vendosja e shkurreve në vazo.

- Lulishte "Ali Demi", mungojnë spotet e ujit në shatërvanin.



Figura 5 Shatërvani në Lulishten Ali Demi

- Lulishtë pranë kryqëzimit të rrugës "Gjin Bue Shpata" dhe rrugës " Pjetër Bogdani", bordurat e realizuara me dimensione 15x30, mungojnë 2 stola pushimi dhe 20m gardh druri.



Figura 6 Lulishte kryqëzimit të rrugës "Gjin Bue Shpata" dhe rrugës" Pjetër Bogdani"

Lulishte "Vëllezrit Frashëri", ku shkurret e vendosura janë një pjesë në vazo dhe një pjesë me distancë më të vogël se 60 cm.



Figura 7 Lulishte "Vëllezrit Frashëri"



- Lulishte tek Ish Fusha e Aviacionit pranë kopshtit "Xixëllonja", ku shkurret janë vendosur në një distancë më të vogël se 60 cm dhe bordura e vendosur është 6x20 cm.



Figura 8 Lulishte Ish Fusha e Aviacionit pranë kopshtit "Xixëllonja"

- Lulishte pranë "TOB" janë vendosur 7 sprucator spërkatës për shatërvan.



Figura 9 Lulishte pranë "TOB"

- "Pylli Orbital", ndërmjet rrugëve "Dervish Luzha" dhe "Ali Beshiri", bordura e vendosur është me dimensionet 12x25 cm.



Figura 10 "Pylli Orbital", ndërmjet rrugëve "Dervish Luzha" dhe "Ali Beshiri"

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 4.

3- Kontrata "Drurë, shkurre dekorative":

- Lulishte (Trekëndëshat) Zogu i Zi dhe Lulishte përballë Ring Center, mungonin 2 likuidamber dhe 1 Acer Negundo.



Figura 11 Lulishte (Trekëndëshat) Zogu i zi

- Blloku i Pallateve në Rrugën Frosina Plaku, është realizuar me lejlandër sasia 17 copë.



Figura 12 Blloku i Pallateve Rruga Frosina Plaku

- Mbikalimi i Kthesës së Kamzës, mungonin 2 kumbull e kuqe dhe 2 cedrus.



Figura 13 Mbikalimi Kthesa e Kamzës

- Fusha e Aviacionit, mungonin 6 agruri



Figura 14 Fusha Aviacionit

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr.5.

4- Kontrata "Blerje drurë dhe shkurre dekorative":

- Lulishte Rruga Muhamet Gjollësja, mungonin 2 dafinë dhe 14 mimoza.



Figura 15 Rruga Muhamet Gjollës

- Blloku i Pallateve në Rrugën Frosina Plaku, mungonin 2 lejlandër.



- Rruga e Kavajës, mungon 1 lojfat.



Figura 16 Rruga Frosina Plaku

- Mbikalimi i Kthesës së Kamzës, mungojnë 5 pisha të buta dhe 4 rrap.



Figura 17 Rruga e Kavajës



Mbikalimi Kthesa e K



Figura 19 Zgjatimi Verior i rrugës Ana Komnena

- Rruga dytësore Autostrada Tiranë Durrës, mungojnë 30 rrap, 10 dafinë dhe 2 lis.



Figura 20 Fusha e Aviacionit



Figura 21 Rruga dytësore Autostrada Tiranë Durrës

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 6.

5- Kontrata “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”:

- Lulishte prapa Stadiumit Qemal Stafa, mungonin 60 ml strukturë metalike.




Figura 22 Lulishte prapa Stadiumit Qemal Stafa.

- Lulishte pranë shkollës Pjetër Budi, bordura e realizuar me dimensione 6x20.



Figura 23 Lulishte pranë shkollës Pjetër Budi.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 7.

KONTROLLI I LARTE I SHTETIT